

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI
PËR SIGURIMET SHOQËRORE
DHE SHËNDETËSORE**

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Dhjetor, 2017

ISBN 978-9928-01-079-7

Shtypur në shtypshkronjën e Qendrës së Botimeve Zyrtare

Adresa:

Rruga “Nikolla Jorgo”

Tel: 042427005, 04 2427006

www.qbz.gov.al

PËRMBAJTJA

I. SIGURIMET DHE KONTRIBUTET SHOQËRORE

Ligj nr. 7703, datë 11.5.1993	Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë	11
Vendim i KM nr. 161, datë 11.04.1994	Për miratimin e statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore <i>Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1022, datë 09.07.2008 dhe me VKM nr. 264, datë 07.05.2014</i>	48
Vendim i KM nr. 262, datë 7.5.2014	Për përzgjedhjen e organizatave të punëdhënësve dhe të sindikatave më të përfaqësuara në këshillin administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore	53
Vendim i KM nr. 263, datë 7.5.2014	Për caktimin e funksioneve të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore në përbërje të këshillit administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore	54
Vendim i KM nr. 120, datë 17.2.2016	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore (CMIS)	55
Vendim i KM nr. 122, datë 17.2.2016	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit, të kalkulimit dhe pagesës së përfitimit (PCAMS)	56
Vendim i KM nr.761, datë 19.11.2004	Për krijimin e arkivit qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore <i>Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.727, datë 28.5.2008</i>	57
Vendim i KM nr. 482, datë 29.6.2016	Për disa çështje të dokumentimit të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, për efekt pensioni	59
Vendim i KM nr. 837, datë 28.12.2005	Për informimin e kontribuesve dhe të përfituesve nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore	60
Vendim i KM nr.787, datë 26.11.2003	Për zbatimin e fazës së katërt të ngushtimit të diferencave në masën e pensioneve <i>Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 318, datë 13.5.2005</i>	61
Vendim i KM nr. 788, datë 14.12.2005	Për përcaktimin e aksidentit në punë ose për shkak të punës	81
Vendim i KM nr.223, datë 19.4.2006	Për pagesën e së ardhurës nga papunësia <i>Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 194, datë 9.3.2016</i>	82
Vendim i KM nr. 37, datë 21.1.2016	Për përcaktimin e pagës mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për personat e regjistruar si të vetëpunësuar, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale dhe punonjësit e papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të	84

Vendim i KM nr. 310, datë 24.7.1992	Për kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë <i>Ndryshuar me vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 351, datë 10.08.1992; nr. 440, datë 10.10.1992; nr. 99, datë 21.02.1995; nr. 196, datë 09.03.2016</i>	91
Vendim i KM nr. 274, datë 12.6.1993	Për kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimit të bukës <i>Ndryshuar me vendimet e Këshillit të Ministrave: nr.98, datë 15.3.1994; nr.99, datë 21.2.1995, nr. 195 09.03.2016</i>	94
Vendim i KM nr. 138, datë 31.3.1994	Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse <i>Ndryshuar me vendimet e Këshillit të Ministrave: nr.202, datë 16.5.1994; nr.320, datë 11.7.1994; nr.560, datë 21.11.1994; nr.115, datë 27.2.1995; nr. 193, datë 09.03.2016</i>	96
Vendim i KM nr. 471, datë 15.7.1996	Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm	99
Vendim i KM nr.167, datë 8.4.1999	Për mënyrën e caktimit dhe të përfitimit të shpërblimit dhe të pensionit familjar nga pjesëtarët e familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushjen e detyrës gjatë fluturimit	100
Vendim i KM nr. 703, datë 27.12.2001	Për skemën e kompensimit të shpenzimeve nga rritja e çmimit të bukës dhe të disa artikujve ushqimorë	101
Vendim i KM nr. 401, datë 21.6.2006	Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve	103
Vendim i KM nr. 565, datë 9.8.2006	Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike <i>Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.238, datë 7.4.2010</i>	103
Vendim i KM nr.763, datë 27.11.2006	Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve	104
Vendim i KM nr.17, datë 20.1.2007	Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit	105
Vendim i KM nr.850, datë 21.10.2010	Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve	107
Ligj nr.9136, datë 11.9.2003	Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë <i>Ndryshuar me ligjet: nr. 9164, datë 18.12.2003, nr. 9329, datë 6.12.2004, nr. 9933, datë 26.6.2008, nr. 10/2012, datë 9.2.2012, nr. 87/2014, datë 17.7.2014, nr. 143/2015, datë 17.12.2015, ndryshuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 60, datë 16.9.2016, aktin normativ nr. 1, datë 25.1.2017)</i>	108

Ligj nr.9986, datë 11.9.2008	Për faljen e detyrimeve doganore dhe tatimore, të detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve e të taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve, si dhe të gjobave e kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore	115
Ligj nr.10 184, datë 29.10.2009	Për faljen e kamatëvonesave të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, të papaguara, të të vetëpunësuarve në bujqësi	118
Ligj nr. 66/2015 datë 2.7.2015	Për faljen e gjobave për mospagimin në afat të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga subjektet juridike dhe fizike	119
Vendim i KM nr. 285, datë 4.5.2007	Për përcaktimin e pagës referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe të tatimit mbi të ardhurat personale, sipas nomenklaturës së veprimtarisë ekonomike, për të punësuarit në sektorin jopublik, që kryejnë punë, të pakualifikuara e të kualifikuara, si dhe për personelin drejtues e tekniko-ekonomik të tyre	120
Vendim i KM nr. 411 , datë 10.5.2017	Për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe njohjen si periudhë sigurimi të periudhës kur bashkëshorti/ja ka shoqëruar personelin e shërbimit të jashtëm në misionin diplomatik ose postin konsullor jashtë shtetit	163
Udhëzim i MF nr. 23 datë 9.12.2014	Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore <i>ndryshuar me udhëzimin nr. 1, datë 9.1.2015</i>	164
II. PENSIONE		
Ligj nr.9588, datë 25.7.2006	Për rillogaritjen e pensioneve	191
Vendim i KM nr.590, datë 31.8.2006	Për zbatimin e ligjit nr. 9588, datë 25.7.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”	192
Vendim i KM nr. 130, datë 22.2.2017	Për indeksimin e pensioneve	194
Vendim i KM nr. 409, datë 1.6.2016	Për ngushtimin e diferencave në masën e pensioneve <i>Ndryshuar me vendimin nr. 161, datë 1.3.2017</i>	197
Vendim i KM nr. 550, datë 27.7.2016	Për barazimin e masës së shtesës së pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara në harkun kohor 1.10.1993–31.12.2014, dhe indeksimin e Pensioneve të posaçme e të shtesës së pensioneve të posaçme shtetërore	199
Ligjnr.8097, datë 21.3.1996	Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit	200

III. SIGURIME DHE PENSIONE SUPLEMENTARE

Ligj nr.10 142, datë 15.5.2009	Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë <i>Ndryshuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.33, datë 24.6.2010, aktin normativ nr. 5, datë 10.11.2010, ligjin nr. 102/2016, datë 20.10.2016</i>	208
Vendim i KM nr. 429, datë 12.9.2002	Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore <i>Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 2.9.2015</i>	219
Vendim i KM nr.476, datë 30.6.2010	Për rritjen e pensioneve suplementare të ushtarakëve, të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të trajtimeve të veçanta financiare	220
Vendim i KM nr. 793, datë 24.9.2010	Për zbatimin e ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë” <i>Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 9.2.2011</i>	222
Vendim i KM nr. 548, datë 27.7.2016	Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit <i>Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 874, datë 14.12.2016</i>	246
Vendim i KM nr. 651, datë 14.9.2016	Për zbatimin e ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, qendrës së studimeve albanologjike, akademisë së shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, të ndryshuar	261
Udhëzim i MF dhe MASH nr. 17, datë 10.5.2010	Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj	262

IV. SKEMAT E TRAJTIMEVE TË VEÇANTA

Ligj nr.8607, datë 27.4.2000	Statusi i Dëshmorit të Atdheut	266
Vendim i KM nr. 151, datë 25.04.2002	Për statusin “Dëshmor i Atdheut”	271

Ligj nr. 7874, datë 17.11.1994	Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar	273
Vendim i KM nr.190, datë 3.5.1995	Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë”	276
Vendim i KM nr. 652, datë 22.7.2015	Për indeksimin e masës së shpërblimit të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar	280
Ligj nr.7663, datë 20.1.1993	Për statusin e invalidit të Luftës kundër pushtuesve nazifashiste të popullit shqiptar	281
Vendim i KM nr. 326, datë 21.6.1993	Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar	283
Ligj nr. 8626, datë 22.6.2000	Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik	285
Vendim i KM nr.78, datë 14.2.1994	Për çmimet e shitjes së karburanteve për invalidët paraplegjikë	288
Vendim i KM nr. 31, datë 20.1.2001	Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik	289
Udhëzim i MSHMS nr. 365, datë 21.9.2017	Mbi zbatimin e vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar	290
Vendim i KM nr. 404, datë 20.6.2012	Për përcaktimin e masës së kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse	291
Ligj nr. 7889, datë 14.12.1994	Për statusin e invalidëve të punës	293
Vendim i KM nr. 723, datë 19.11.1998	Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit"	296
Vendim i KM nr. 869, datë 18.6.2008	Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Statusi i invalidit"	297
Vendim i KM nr. 788, datë 14.12.2005	Për përcaktimin e aksidentit në punë ose për shkak të punës	298
Ligj nr. 46/2016 datë 28.4.2016	Për faljen e detyrimeve që kanë ish-ushtarakët në skemën e pensioneve suplementare, nga rillogaritja e pensioneve, në zbatim të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura, të punonjësve të policisë së shtetit, të gardës së republikës, të shërbimit informativ të shtetit, të policisë së burgjeve, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	299

Vendim i KM nr. 704, datë 12.10.2016	Për zbatimin e ligjit nr. 46/2016, “Për faljen e detyrimeve që kanë ish-ushtarakët në skemën e pensioneve suplementare, nga rillogaritja e pensioneve, në zbatim të ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”	301
Vendim i KM nr. 423, datë 2.7.2004	Për rritjen e pensioneve suplementare të ushtarakëve dhe të pensioneve familjare të familjeve të pilotëve, që kanë humbur jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit	302
Vendim i KM nr.820, datë 18.6.2008	Për rritjen e pensioneve suplementare të ushtarakëve, të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të trajtimeve të veçanta financiare	303
Vendim i KM nr. 433, datë 20.5.2015	Për sigurimin e jetës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura, që dërgohen në misione ushtarake jashtë vendit, për vitin 2015	304
Ligj nr. 8685, datë 9.11.2000	Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë	305
Vendim i KM nr. 73 datë 15.2.2001	Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në minierë, nëntokë	307
Ligj nr. 150/2014 datë 6.11.2014	Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë	308
Ligj nr. 72/2017 datë 27.4.2017	Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të personave në pension, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit	311
Ligj nr. 8/2017, datë 2.2.2017	Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit	312
Ligj nr.8455, datë 4.2.1999	Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve dhe të ekipit të ndihmës së shpejtë mjekësore që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit	318
Ligj nr. 9128, datë 29.7.2003	Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension	320
Vendim i KM nr. 386, datë 14.7.2000	Për rritjen e pensioneve suplementare	323
Vendim i KM nr.53, datë 29.1.2004	Për procedurat dhe masën e trajtimit të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension	324
Vendim i KM nr.644, datë 16.6.2010	Për përcaktimin e procedurës dhe të masës së trajtimit të veçantë financiar të pilotëve e të teknikëve fluturues të njësisë së transportit mjekësor me helikopter, në pension	325

V. SIGURIME SHËNDETËSORE

Ligj nr. 10 383, datë 24.2.2011	Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë	326
Vendim i KM nr. 124, datë 5.3.2014	Për miratimin e statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë	340
Vendim i KM nr. 185, datë 2.4.2014	Për përcaktimin e mënyrës së realizimit të kontrollit mjekësor bazë për shtetasit e moshës 35-70 vjeç	352
Vendim i KM nr. 307, datë 21.5.2014	Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga siguri i detyrueshëm shëndetësor	353
Vendim i KM nr. 308, datë 21.5.2014	Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor	355
Vendim i KM nr. 955, datë 29.12.2014	Për përcaktimin e kategorive të individëve të siguruar që përjashtohen nga pagesat e drejtpërdrejta të shërbimeve shëndetësore	361
Vendim i KM nr. 18, datë 11.1.2017	Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2017	362
Vendim i KM nr. 21, datë 18.1.2017	Për sigurimin shëndetësor të veçantë të punonjësve të disa strukturave të Policisë së Shtetit	367
Vendim i KM nr. 138, datë 22.2.2017	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri Elektronik Shëndetësor Kombëtar”	368

I. SIGURIMET DHE KONTRIBUTET SHOQËRORE

LIGJ

Nr. 7703, datë 11.05.1993

PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Ndryshuar me ligjet: nr. 7932, datë 17.05.1995; nr. 8286, datë 16.02.1998; nr. 8392, datë 02.09.1998; nr. 8575, datë 03.02.2000; nr. 8776, datë 26.04.2001; nr. 8852, datë 27.12.2001; nr. 8889, datë 25.04.2002; nr. 9058, datë 20.03.2003; nr. 9114, datë 24.07.2003; nr. 9377, datë 21.04.2005; nr. 9498, datë 03.04.2006; nr. 9600, datë 27.07.2006; nr. 9708, datë 05.04.2007; nr. 9768, datë 09.07.2007; nr. 10070, datë 05.02.2009; nr. 10447, datë 14.07.2011; nr. 13/2014, datë ; nr. 104/2014, datë 31.07.2014, nr. 144/2015, datë 17.12.2015, nr. 111/2016, 3.11.2016 dhe me aktin normativ nr. 1, datë 25.1.2017

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SE SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore *(Ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)*

Ligji për sigurimet shoqërore të Republikës së Shqipërisë rregullon marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore.

Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore përbëhet nga:

- a) sigurimet shoqërore të detyrueshme;
- b) sigurimi shoqëror vullnetar;
- c) sigurimi shoqëror suplementar;
- ç) pensionet shtetërore të posaçme;
- d) pensionet sociale;
- dh) fondet profesionale dhe fondet e pensionit vullnetar.

Neni 2

Sigurimet shoqërore të detyrueshme

(Shtuar fjala në titull me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; shtuar fjalë në paragrafin e parë me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; shtuar fjali në fund të paragrafit të dytë me ligjin nr. 9708, datë 05.04.2007; shfuqizuar paragrafi i dytë, i tretë dhe i katërt me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

Sigurimi shoqëror i detyrueshëm është jofitimprurës, që mbron me përfitime:

- a) Personat e punësuar në lidhje me:
 - paaftësinë e përkohshme në punë për shkak të sëmundjes;
 - barrë lindjen;
 - pleqërinë, invaliditetin dhe humbjen e mbajtësit të familjes;
 - aksidentin në punë dhe sëmundjet profesionale;

- papunësinë.
- b) personat e tjerë ekonomikisht aktivë (punëdhënësi dhe të vetëpunësuarit), në lidhje me:
 - barrë lindjen;
 - pleqërinë, invaliditetin dhe humbjen e mbajtësit të familjes.

Neni 3

Sigurimi shoqëror vullnetar

Personi i siguruar në mënyrë të detyrueshme, kur për një kohë dhe shkaqe të arsyeshme nuk mund të sigurohet detyrimisht, ka të drejtën e vazhdimit të sigurimit, sipas sistemit vullnetar.

Sigurimi vullnetar është i mundur edhe për periudhën e studimeve universitare, me kusht që personi i siguruar të paguajë kontribut për këtë periudhë, përpara datës së fillimit të së drejtës për përfitimet.

Sigurimi vullnetar mund të shtrihet edhe te personat që nuk përcaktohen në nenin 2. Sigurimi vullnetar, që parashikohet nga kjo dispozitë, bëhet në kushtet e përcaktuara nga

Rregullorja e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 4

Sigurimi shoqëror suplementar

(Shtuar fjalë në paragrafin e tretë me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001;

shtuar fjali në paragrafin e tretë me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; ndryshuar neni me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar neni me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Sigurimi shoqëror suplementar mbron me përfitime:

a) Personat që ushtrojnë funksione ose detyra të veçanta kushtetuese dhe personat me tituj shkencorë;

b) Punonjësit e shtetit, ushtarakët që shërbejnë në strukturat e Forcave të Armatosura, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, punonjësit e Shërbimit për Ankesat dhe Çështjet e Brendshme.

2. Kriteret për sigurim shoqëror suplementar të kategorive, të përfshira në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen me ligje të veçanta;

3. Skemë të sigurimit shoqëror suplementar, sipas kushteve të përcaktuara me ligj të veçantë, ka të drejtë të ngrejë çdo person juridik, me kapital shtetëror ose pjesërisht shtetëror, i autorizuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 5

Pensionet shtetërore të posaçme

(Shtuar shprehje në pikën "a" me ligjin nr. 8286, datë 16.02.1998)

Kanë të drejtë për pensione të posaçme që jepen nga shteti personat që:

a) Kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve nazifashistë brenda dhe jashtë Shqipërisë, në mbrojtjen e kufirit e ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë dhe në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta;

b) Kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës;

c) Kanë vuajtur nga persekutimi politik në regjimin komunist.

Personat e përmendur në shkronjat "a", "b", "c", të këtij neni përfitojnë:

a) Pension të posaçëm shtetëror, në rast se nuk përfitojnë pension nga sigurimet shoqërore, ose

b) Shtesë pensioni të posaçëm shtetëror mbi pensionin që iu takon nga sigurimet shoqërore.

Kushtet e përfitimit, shuma dhe procedura për dhënien e pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Këshilli i Ministrave ka të drejtë të vendosë që administrimi i pensioneve të posaçme shtetërore të bëhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe shpenzimet të mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

Neni 5/1

Pensioni social

(Shtuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

Pensioni social është një përfitim që i jepet çdo shtetasi shqiptar, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për pesë vitet e fundit, nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka përfitime, ose përfitime që përfiton nga çdo burim tjetër, janë më të ulëta se përfitimet që jep pensioni social.

Masa e pensionit social është e barabartë me përfitimet minimale që sigurohen nga pensioni i pjesshëm i pleqërisë me 15 vite të siguruara me pagë minimale, i llogaritur në datën 31.12.2014.

Masa e pensionit social për personat që kanë përfitime nga burime të tjera do të jetë sa diferenca e pensionit social me përfitimet e tjera që ka përfituesi.

Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pensionin social përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5/2

Fondet profesionale dhe fondet e pensionit vullnetar

(Shtuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.7.2014)

Krijimi, veprimtaria dhe mbikëqyrja e fondeve profesionale dhe fondeve të pensionit vullnetar bëhen sipas ligjit të veçantë.

PJESA II

PERSONAT QË PËRFITOJNË NGA SIGURIMET SHOQËRORE

Neni 6

Mbrojtja e detyrueshme

(Ndryshuar me ligjin nr. 144/2015, datë 17.12.2015 dhe me aktin normativ nr. 1, datë 25.1.2017)

Sigurimet shoqërore mbrojnë në mënyrë të detyrueshme të gjithë shtetasit ekonomikisht aktivë në Shqipëri, në rastin e pakësimit të përfitimeve si pasojë e barrëlindjes, pleqërisë, invaliditetit dhe humbjes së mbajtësit të familjes.

Sigurimet shoqërore, gjithashtu, i japin mbrojtje të detyrueshme të gjithë personave të punësuar, në rastin e pakësimit të përfitimeve, si pasojë e paaftësisë së përkohshme të shkaktuar nga sëmundja, aksidenti në punë, sëmundja profesionale dhe papunësia. Këshilli i Ministrave mund të vendosë për fusha të tjera mbrojtjeje, si dhe për përjashtime për:

- a) punëtorët sezonalë dhe të përkohshëm;
- b) të vetëpunësuarit në bujqësi;
- c) punëtorët e papaguar të familjes së personave të vetëpunësuar;
- ç) kursantët dhe studentët për kohën e praktikës mësimore, të cilët sigurohen vetëm për aksidentin në punë, nga punëdhënësi.

Neni 7

Mbrojtja për shtetasit shqiptarë jashtë shtetit dhe shtetasit e huaj
(Ndryshuar me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005)

Sigurimet shoqërore iu japin mbrojtje edhe:

- a) shtetasve shqiptarë dhe personave pa shtetësi, ish-shtetas shqiptarë, që janë jashtë shtetit, në përputhje me konventat, marrëveshjet dypalëshe dhe Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- b) shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, që punojnë në Shqipëri.

Neni 8

Periudha e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore

Periudha e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore nis ditën kur personi e ka filluar ligjërisht veprimtarinë ekonomike dhe mbaron ditën kur përfundon ligjërisht kjo veprimtari.

Periudha e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore vullnetare nis nga data e përcaktuar në kontratën e sigurimit dhe mbaron ditën e skadimit të kësaj kontrate.

Periudhë e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore për efekt të pensionit të pleqërisë, pensionit të invaliditetit dhe të pensionit familjar është edhe periudha kur personi përfiton përfitime nga sigurimet shoqërore për shkak sëmundjeje, barrë lindjeje, aksidenti në punë ose sëmundjeje profesionale dhe për papunësinë. Kontributet në favor të tyre do të transferohen nga llogaritë e degëve përkatëse. Detajet përcaktohen nga Rregullorja e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

PJESA E III
KONTRIBUTET

Neni 9

Llojet e kontributeve për t'u paguar

(Ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001;
ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 104/2014, datë 31.7.2014; shtuar paragrafi i katërt me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014; shtuar një paragraf pas paragrafit të 4-të, me ligjin nr. 144/2015, datë 17.12.2015 dhe shfuqizuar me aktin normativ nr. 1, datë 25.1.2017)

Personat e punësuar dhe punëdhënësit e tyre janë të detyruar të paguajnë kontribut për sëmundje, barrë lindje dhe pensione, në një shumë që varet nga paga e tyre totale (bruto). Kontributi nuk mund të caktohet nën një pagë minimale dhe mbi një pagë maksimale mujore.

Punëdhënësit detyrohen të paguajnë kontribut për aksident në punë e sëmundje profesionale dhe për papunësinë.

Personat e tjerë ekonomikisht aktivë janë të detyruar të paguajnë kontribut mujor për barrë lindje dhe për pensione të llogaritura, për një pagë jo më të vogël se paga minimale në shkallë vendi dhe jo më të lartë se paga maksimale kontributive.

Punonjësit e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, paguajnë kontribut për barrë lindje dhe për pensione, mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi.

Personat e vetëpunësuar në bujqësi janë të detyruar të paguajnë kontribut për barrë lindje dhe për pensione. Masat dhe kriteret caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Shteti paguan kontribute në varësi të veprimtarisë ekonomike, të zhvilluar më parë, për kohën që shtetasi kryen shërbimin e detyrueshëm ushtarak, si dhe për të gjithë kategoritë e personave të përcaktuar me ligje dhe me vendime të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Masa e kontributeve

(Ndryshuar shifra në paragrafin e dytë me ligjin nr. 8852, datë 27.12.2001; ndryshuar shifra në shkronjën "a" dhe "b", me ligjin nr. 8889, datë 25.04.2002; ndryshuar shifra në shkronjën "a", të paragrafit të parë, me ligjin nr. 9600, datë 27.7.2006; ndryshuar shifra në paragrafin e parë të shkronjës "a" me ligjin nr. 10 070, datë; 5.2.2009; ndryshuar paragrafi i dytë dhe i tretë me ligjin nr. 104/2014, datë 31.7.2014)

Kontributi që paguhet për sigurimet shoqërore në fondet e sigurimeve për sëmundje, barrë lindje dhe pensione do të jetë:

- a) për punëdhënësit 13,8 për qind e shumës bruto të listëpagesave;
- b) për personin e punësuar 9.5 për qind e pagesës së tij totale (bruto).

Kontributi llogaritet dhe paguhet mbi pagën bruto, brenda kufijve të pagës minimale në shkallë vendi dhe pagës maksimale për efekt kontributi për sigurimet shoqërore, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, e cila është në fuqi në datën 31.12.2014. Pas datës 01.01.2015, paga maksimale për efekt

kontributi indeksohet në të njëjtën kohë dhe në atë masë që indeksohet paga minimale në shkallë vendi. Kontributi minimal për personin e punësuar, punëdhënësin dhe të vetëpunësuarin është i barabartë dhe llogaritet mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi.

Personat e vetëpunësuar në bujqësi paguajnë kontribut për pension dhe barrë lindje, të llogaritur mbi pagën minimale në shkallë vendi. Pagesa e kontributit bëhet çdo tremujor.

Neni 11

Kontributi vullnetar

(Shtuar shprehje në paragrafin e parë dhe të dytë, me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014, neni 7)

Kontributi vullnetar llogaritet në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale të caktuar nga Këshilli i Ministrave dhe paguhet nga personi i siguruar në shumën dhe afatin e përcaktuar në kontratën e sigurimit vullnetar.

Kontributi vullnetar llogaritet në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale të caktuar nga Këshilli i Ministrave dhe ka të njëjtin rregull me kontributin e detyrueshëm.

Neni 12

(Zëvendësuar shprehja në shkronjën "b", me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; shtuar paragraf me ligjin nr. 8392, datë 02.09.1998, neni 1; shtuar fjali në paragrafin e tretë, me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001) shfuqizuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

MBLEDHJA E KONTRIBUTEVE

Neni 13

Detyrimi për të paguar kontributet

(Shtuar paragraf në pikën 3 me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; zëvendësuar fjala në pikën 4, me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; shtuar fjalët në pikën 3 me ligjin nr. 9114, datë 24.07.2003; ndryshuar fjalët në pikën 4 me ligjin nr. 9114, datë 24.07.2003; ndryshuar pika 3 dhe 4, me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Kontributet do të paguhën nga personat e siguruar.
2. Kontributet e personave të punësuar nën një kontratë pune do të ndahen ndërmjet personit të siguruar dhe punëdhënësit të tij, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe do të derdhen nga punëdhënësi.

3. Personat e detyruar për derdhjen e kontributeve janë përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tyre. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga e të punësuarve kontributet dhe t'i derdhë ato në llogari të administratës tatimore, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

4. Kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi dhe kontributet vullnetare derdhen në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Kriteret dhe procedurat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Inspektorët e kontributeve të sigurimeve shoqërore kanë të drejtë të kontrollojnë saktësinë e llogaritjes dhe afatet e pagesës së kontributeve. Çdo diferencë në shumën e kontributeve do të kthehet gjatë 5 vjetëve të pagesës së bashku me kamatëvonesën.

Neni 14

Shpërndarja e kontributeve

(Ndryshuar shifrat në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1, me ligjin nr. 8889, datë 25.04.2002; ndryshuar shifra në shkronjën "b" të pikës 2, me ligjin nr. 8889, datë 25.4.2002; ndryshuar shifra në shkronjën "c" të pikës 1, me ligjin nr. 9600, datë 27.7.2006; ndryshuar shifra në shkronjën "b" të pikës 2, me ligjin nr. 9600, datë 27.07.2006; ndryshuar shifra në shkronjën "a" të pikës 1, me ligjin nr. 10070, datë 5.02.2009; ndryshuar shifra në shkronjën "b" të pikës 1, me ligjin nr.10 070, datë 5.2.2009; ndryshuar shifra në shkronjën "c" të pikës 1, me ligjin nr.10 070, datë 05.02.2009; ndryshuar shifra në shkronjën "a" të pikës 2, me ligjin nr.10 070, datë 05.02.2009; ndryshuar shifra në shkronjën "b" të pikës 2, me ligjin nr.10 070, datë 05.02.2009)

1. Kontributet e paguara nga personat e punësuar shpërndahen në tri degë, që administrojnë fondet e sigurimeve shoqërore:

- a) dega e sigurimit të sëmundjeve, 0.3 për qind e shumës së listëpagesave;
- b) dega e sigurimit të barrë lindjes, 1.4 për qind e shumës së listëpagesave;
- c) dega e sigurimit të pensioneve, 21.6 për qind të shumës së listëpagesave.

2. Punëdhënësi përveç kësaj paguan:

a) tek dega e sigurimit të aksidenteve dhe e sëmundjeve profesionale, 0.3 për qind të shumës së listëpagesave;

b) tek dega e sigurimit të papunësisë, 0.9 për qind të shumës së listëpagesave.

3. Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të diferencojë pagesën e kontributit për aksidente, lidhur me rrezikshmërinë e jetës, që paraqet puna në degët e ekonomisë.

Neni 15

Pagesa e kontributeve

(Shtuar paragraf me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; shtuar paragraf me ligjin nr. 8392, datë 02.09.1998; zëvendësuar fjalët në fjalinë e dytë të paragrafit të parë me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; shtuar paragraf pas paragrafit të dytë, me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; shtuar fjalinë në paragrafin e fundit, me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; ndryshuar neni me ligjin nr. 9600, datë 27.07.2006)

Punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit, përjashtuar personat e vetëpunësuar në bujqësi, i paguajnë kontributet në fondin e sigurimeve shoqërore, sipas afatit dhe procedurave të përcaktuara në Ligjin nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Të vetëpunësuarit në bujqësi i paguajnë kontributet gjatë vitit kalendarik një herë në tre muaj. Afati i fundit të pagesës së tyre, është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik.

Këshilli i Ministrave përcakton mënyrën dhe procedurat e derdhjes së kontributeve.

Akti që përmban detyrimin për pagesën e kontributeve përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e përmbarimit.

Neni 16

Sanksionet

(Shtuar fjalët në pikën 1 dhe 2, rreshti i parë me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; shtuar pika 4 me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; zëvendësuar fjalët në pikën 3 me ligjin nr. 8392, datë 02.09.1998; ndryshuar neni me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; ndryshuar neni me ligjin nr. 9114, datë 24.07.2003; ndryshuar neni me ligjin nr. 9600, datë 27.07.2006; shtuar fjali në fund të paragrafit të dytë me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014; shfuqizuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

Ndaj punëdhënësve dhe të vetëpunësuarve, përjashtuar personat e vetëpunësuar në bujqësi, që nuk zbatojnë afatet dhe procedurat e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore, zbatohen sanksionet e përcaktuara në Ligjin nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Nëse nuk paguhen në afatet e përcaktuara në këtë ligj, të vetëpunësuarit në bujqësi do të paguajnë kamatëvonesa, që llogariten mbi shumën e kontributeve të papaguara nga data në të cilën pagesa ka qenë e detyrueshme deri në datën në të cilën pagesa kryhet. Masa e kamatëvonesës është sipas përcaktimeve të nenit 76, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kamatëvonesat llogariten nga inspektorët e agjencive lokale të sigurimeve shoqërore.

Neni 17

Apelimet

(Shtuar fjalë me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001)

Personi ka të drejtën e apelit në gjyq kundër vendimeve të gjobave, të inspektorëve të agjencive lokale të sigurimeve shoqërore.

Neni 18

Përparësia e kontributeve

(Shtuar paragraf me ligjin nr. 8392, datë 02.09.1998; zëvendësuar fjalët në fjalinë e parë me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; shtuar fjalia në fund të paragrafit të dytë me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001)

Pagesat e kontributeve gëzojnë përparësi në raport me detyrimet fiskale dhe borxhet.

Për kontributet e paderdhura nga subjektet brenda afatit, organet e sigurimeve shoqërore kanë të drejtën të nxjerrin aktdetyrimi, i cili është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e përmbarimit.

PJESA IV

Neni 19

Përfitimet në para

Përfitimet në para iu paguhen personave përfitues nga:

- a) dega e sigurimit të sëmundjes;
- b) dega e sigurimit të barrë lindjes;
- c) dega e sigurimeve të pensioneve;
- ç) dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale;
- d) dega e sigurimit të papunësisë.

KREU I PËRFITIMI PËR SËMUNDJE

Neni 20

Në degën e sigurimit të sëmundjeve paguhen:

- a) Përfitimet për sëmundje;
- b) Përfitimet për kompensim për sëmundje, kur ndryshon vendi i punës.

Neni 21

Kushtet e përfitimit

1. Personi i siguruar përfiton përfitimet për sëmundje, kur vërtetohet me raport mjekësor se ai është përkohësisht i paaftë për të punuar dhe kjo paaftësi nuk është pasojë e një aksidenti në punë ose e një sëmundjeje profesionale;

2. Personi i siguruar ka të drejtën e përfitimit të përfitimeve për sëmundje edhe brenda 30 ditëve kalendarike, pas mbarimit të sigurimit të tij të detyrueshëm. Kjo nuk do të zbatohet nëse i punësuar është pushuar nga puna për akt kriminal, sipas vendimit të Gjykatës.

Neni 22

Shuma e përfitimeve

(Ndryshuar neni me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Përfitimet për sëmundje janë 70 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes së të drejtës, kur i siguruari ka deri në 10 vjet sigurim dhe 80 për qind kur i siguruari ka mbi 10 vjet sigurim;

2. Për periudhën që përfituesi është shtruar në spital, kur nuk ka njeri në ngarkim, përfitimet për sëmundje janë 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto, të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes të së drejtës.

Neni 23

Periudha e përfitimit

1. Periudha e përfitimit për paaftësi të përkohshme fillon në ditën e 15 të raportit mjekësor dhe do të zgjasë jo më shumë se 6 muaj nga data e fillimit të pagesës;

2. Periudha e përfitimit mund të zgjatet përjashtimisht deri në 3 muaj të tjerë, në rast se komisioni i mjekëve ekspertë (KMCAP) provon që personi i siguruar do të shërohet në këtë periudhë dhe nuk do të deklarohet invalid;

3. Periudha e përfitimit të paaftësisë së përkohshme nga sëmundja, për ata që marrin pension invaliditeti të pjesshëm, është deri në 3 muaj nga data e fillimit të pagesës;

4. Periudha e përfitimit për punonjësit sezonalë dhe të përkohshëm, të cilët kanë qenë të punësuar të paktën 3 muaj në 12 muajt e fundit, është deri në 75 ditë.

Neni 24

Përfitimet për kompensim sëmundjeje, kur ndryshon vendi i punës ose redukton orarin e punës

(Ndryshuar pika 2, me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Personi i siguruar që për arsye shëndetësore, me vendim të komisionit mjekësor kompetent, ndryshon vendin e punës, ka të drejtë të përfitojë, nga sigurimet shoqërore, kompensimin e përfitimeve;

2. Shuma e së ardhurës, që do të përfitohet për kompensim, është e barabartë me diferencën ndërmjet pagës së vendit të punës së mëparshme dhe pagës së vendit të punës së re. Ky kompensim nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes të së drejtës;

3. Periudha e përfitimit nuk duhet të kalojë 3 muaj gjatë një viti nga dita e fillimit të sëmundjes, për të cilën është ndryshuar vendi i punës.

Neni 25

Detyrimi i punëdhënësit

Përfitimet në rastin e sëmundjes për periudhën deri në 14 ditët e para ose të kujdesjes së fëmijës në ngarkim paguhen nga punëdhënësi, sipas përcaktimit në Kodin e Punës dhe në kontratën e punësimit, ose sipas marrëveshjes që do të ketë me përfaqësuesit e punëtorëve, por jo më pak se pagesat e përcaktuara në këtë Ligj.

KREU II

PËRFITIMET PËR BARRËLINDJE

Neni 26

Në degën e sigurimit për barrëlindje paguhen:

- a) përfitimet për barrëlindje;
- b) përfitimet për kompensimin për barrëlindje, kur ndryshohet vendi i punës;
- c) shpërblimi për lindje fëmije.

Neni 27

E ardhura për barrëlindje

*(Ndryshuar pika 1, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005;
ndryshuar neni me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)*

1. E ardhura për barrëlindje i paguhet gruas së siguruar për barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ajo ka 12 muaj periudhë sigurimi, për çdo rast përfitimi. Përfshihet nga rregulli për periudhën e sigurimit rasti kur e drejta e pagesës për barrëlindjen e radhës ndodh brenda 24 muajve nga data e lindjes së fëmijës së mëparshëm;

2. Periudha e përfitimit do të jetë 365 ditë kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 35 ditësh para dhe 63 ditësh pas lindjes së fëmijës. Për gruan që do të ketë në barrë më shumë se një fëmijë, periudha e përfitimit do të jetë 390 ditë kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 60 ditë para dhe 63 ditë pas lindjes së fëmijëve;

3. E ardhura për barrëlindje për gruan e siguruar është:

a) 80 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të dymbëdhjetë muajve të fundit nga data e lindjes të së drejtës për pagesë për periudhën e paralindjes dhe për 150 ditë kalendarike pas lindjes;

b) 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të dymbëdhjetë muajve të fundit nga data e lindjes të së drejtës për pagesë për periudhën tjetër në vazhdim.

4. E ardhura për barrëlindje për gratë e siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi llogaritet sipas pikës 3, të këtij neni. Për periudhën deri në barazimin e kontributeve që paguajnë të vetëpunësuarit në bujqësi me të vetëpunësuarit në aktivitete jobujqësore, e ardhura për barrëlindje caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Nëna, që birëson fëmijën e moshës deri në 1 vjeç dhe që ka qenë e siguruar jo më pak se 12 muaj, ka të drejtë për leje pas lindjes, e cila fillon ditën e birësimit, por jo më parë se mbas ditës së 63-të të lindjes së fëmijës, dhe vazhdon jo më shumë se 330 ditë nga dita e lindjes së fëmijës. Minimumi i lejes për birësuesen është 28 ditë.

6. Kur një fëmijë është birësuar gjatë lejes së lindjes, nëna që ka lindur do të ketë një periudhë përfitimi deri në ditën e birësimit, por jo më pak se 63 ditë pas lindjes.

7. Pas periudhës prej 63 ditësh pas lindjes, të drejtën e lejes për kujdes ndaj fëmijës e ka edhe babai ose birësuesi i siguruar, nëse këtë të drejtë nuk e ushtron apo nuk ka kushte për ta përfituar nëna.”.

Neni 28

Përfitimi për kompensimin për shtatzëni

(Ndryshuar pika 2, me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Gruaja e siguruar, që me vendim të komisionit mjekësor kompetent ndryshon vendin e punës për arsye shtatzënie, ka të drejtë të përfitojë kompensim të ardhurash për pakësimin që pëson nga ndryshimi i vendit të punës. Ky kompensim jepet në rast se është derdhur kontribut për një kohë jo më pak se 12 muaj;

2. Shuma e të ardhurave që do të përfitohet për kompensim është e barabartë me diferencën ndërmjet pagës së vendit të punës të mëparshëm dhe pagës së vendit të punës së re. Ky kompensim nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të dymbëdhjetë muajve të fundit, nga data e lindjes të së drejtës për pagesë.

Neni 29

Shpërblimi për lindje fëmije

(Zëvendësuar fjalët në pikën 2, me ligjin nr. 8392, datë 02.09.1998)

1. Shpërblim për lindje fëmije i paguhet një personi të siguruar, i cili është nëna ose babai i një fëmijë që lind, me kusht që njëri prej tyre të ketë kontribuar për një vit para lindjes së fëmijës. Shpërblimi do të bëhet i pagueshëm vetëm një herë dhe nëna do të ketë përparësi në përfitimin e pagesës, në rast se ajo është e siguruar;

2. Shpërblimi për çdo fëmijë të lindur do të jetë një shumë e barabartë me 50 për qind të pagës minimale mujore.

KREU III PENSIONET

Neni 30

(Shtuar shkronja b/1, me ligjin nr. 8889, datë 25.04.2002; shfuqizuar shkronja “b”, me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014; shtuar shkronja ç/1, me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

Në degën e sigurimit të pensioneve paguhet:

- a) pension pleqërie;
- b) Shfuqizuar.
- b/1) pension pleqërie i reduktuar;
- c) pension invaliditeti;
- ç) pension invaliditeti i pjesshëm;
- ç/1) pension invaliditeti i reduktuar
- d) përfitime shtesë për kujdesje;
- dh) përfitime shtesë për fëmijën në ngarkim;
- e) pensione familjare;
- ë) pagesë për vdekje.

PENSIONET E PLEQËRISË

Neni 31

Pension pleqërie

(Hequr fjala në pikën 1 me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; ndryshuar shprehja në paragrafin e parë të pikës 1 me ligjin nr. 8889, datë 25.04.2002; ndryshuar titulli me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar pika 1, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar neni me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92, të këtij ligji;
2. Nënata, që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë rritur më shumë se 8 vjeç, kanë të drejtë të dalin në pension kur mbushin moshën 55 vjeç dhe kanë 30 vjet sigurim.

Neni 31/1

Pension pleqërie i reduktuar

(Shtuar neni me ligjin nr. 8889, datë 25.04.2002; ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 9058, datë 20.03.2003, neni 1; shfuqizuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 9058, datë 20.03.2003; ndryshuar neni me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

Personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar, deri tre vjet para mbushjes së moshës së daljes në pension të përcaktuar në nenin 92, kur:

- a) kanë plotësuar vitet e sigurimit, sipas nenit 92;
- b) nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar.

Pensioni i reduktuar është pjesë e pensionit të plotë dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë shumë më shumë se nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit, para mbushjes së moshës së përcaktuar në nenin 92, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë, për personat që plotësojnë kushtet e parashikuara në paragrafin e parë, të këtij neni, është 0,6 për qind në muaj.

Neni 32

Masa e pensionit

(Shtuar paragraf në fund të pikës 4, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar neni me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë.
2. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit, që ka realizuar personi, me periudhën e sigurimit të kërkuar, sipas nenit 92, shumëzuar me pensionin social;
3. Shtesa do të jetë 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, e llogaritur sipas nenit 59, të këtij ligji;
4. Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social.

Neni 33

Shtesë pensioni për shtyrje të datës së daljes në pension

(Ndryshuar titulli dhe neni me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; ndryshuar neni me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar neni me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

I siguruari, i cili ka plotësuar kushtet për pension pleqërie, sipas nenit 92, të këtij ligji, merr shtesë në masën 0,5 për qind të pensionit për çdo muaj që shtyn datën e daljes në pension dhe vazhdon të paguajë kontribute.

Përfituesi i pensionit të pleqërisë, që ndërpret pensionin, vazhdon të punojë dhe paguan kontribute, merr shtesë mbi pension në masën 0,5 për qind për çdo muaj ndërprerjeje. Kjo shtesë llogaritet mbi atë masë pensioni që rezulton pas rritjeve dhe indeksimit që ka pësuar pensioni gjatë kohës së ndërprerjes.

Neni 34

(Zëvendësuar shprehja me ligjin nr. 8889, datë 25.04.2002; zëvendësuar fjalët në pikën 1, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; shfuqizuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

PENSIONET E INVALIDITETIT

Neni 35

Kushtet e përfitimit

(Shtuar 3 paragrafë në fund të pikës 1, me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; hequr fjalët në paragrafin e parë të pikës 1, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar pika 2, me ligjin nr. 9377 datë 21.04.2005; shfuqizuar paragrafi i katërt i pikës 1, me ligjin nr. 10447, datë 14.07.2011; ndryshuar paragrafi i pestë i pikës 1, me ligjin nr. 10447, datë 14.07.2011; ndryshuar paragrafi i parë, pika 2, me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Personi që bëhet i paaftë merr pension invaliditeti, kur ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit dhe për çdo arsye, veç aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale. Ai e merr këtë pension kur bëhet i paaftë:

- a) për çdo veprimtari ekonomike;
- b) kur ka gjymtime të forta dhe dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin).

Invaliditeti caktohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

Në vendimin e tij shënohen shkaqet e invaliditetit, koha e fillimit të tij, si dhe shkalla e humbjes së aftësisë në punë.

Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve Eprore caktohen me këtë Ligj. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve të nivelit të parë caktohen me rregullore të ISSH-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror.

Personi, që është në kushtet e invaliditetit të plotë, por që nuk plotëson periudhën minimale të sigurimit, ka të drejtë për pension invaliditeti të reduktuar, në masën që rezulton nga raporti i periudhës së tij të sigurimit me periudhën e duhur për pension të plotë invaliditeti;

3. Personi që përfiton pension për invaliditet, kur plotëson moshën, ka të drejtë të kërkojë pension pleqërie, nëse ky do të jetë më i favorshëm për të.

Neni 36

Shuma e pensionit

(Shtuar paragraf në fund të pikës 4, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar neni me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Shuma e pensionit të invaliditetit të plotë llogaritet në të njëjtën mënyrë si pensioni i pleqërisë;

2. Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi.

Neni 37

Pensioni i invaliditetit të pjesshëm

1. I siguruari merr pension për invaliditet të pjesshëm, kur ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit, sipas nenit 35, dhe kur për çdo arsye, përveç aksidentit në punë dhe sëmundjes profesionale, bëhet i paaftë të kryejë punën e fundit, por mund të punojë në kushte të veçanta pune. Shkalla e invaliditetit dhe puna që do të kryejë i siguruari, përcaktohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP);

2. Pensioni i invaliditetit të pjesshëm është sa 50 për qind e pensionit të plotë të invaliditetit. Ai llogaritet në të njëjtën mënyrë si pensioni i plotë i invaliditetit.

Neni 37/1

Pension invaliditeti i reduktuar

(Shtuar me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005)

Masa e pensionit të invaliditetit të reduktuar llogaritet duke shumëzuar masën e llogaritur të invaliditetit të plotë me koeficientin që rezulton nga raporti i periudhës së tij të sigurimit me periudhën e duhur për pension të plotë invaliditeti.

Neni 38

E ardhura shtesë për kujdesje

(Zëvendësuar fjalë në fund të fjalisë së parë, me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

Kur përfituesi i një pensioni invaliditeti bëhet fizikisht ose psikikisht i paaftë dhe ka nevojë për një kujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër, atij i jepet një pagesë shtesë prej 15 për qind të bazës së vlerësuar neto. Nevoja për kujdesje të vazhdueshme e një personi tjetër përcaktohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

Neni 39

E ardhura shtesë për fëmijë në ngarkim

(Ndryshuar me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005)

Një person i siguruar i paaftë, që merr pension invaliditeti, sipas nenit 35, dhe që ka në ngarkim fëmijët deri në moshën 18 vjeç, ose kur këta studiojnë apo janë të paaftë për punë deri në moshën 25 vjeç, merr një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 për qind të pensionit bazë, por jo më shumë se 30 për qind.

Neni 39/1

Ankimi në Komisionin Epror

(Shtuar me ligjin nr. 10 447, datë 14.07.2011)

1. Kundër vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të nivelit të parë, personi mund të bëjë ankim brenda 30 ditëve në Komisionin Epror Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (më poshtë Komisioni Epror).

2. Ankimi paraqitet në formën e parashikuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë.

Neni 39/2

Përbërja e Komisioneve Eprore
(Shtuar me ligjin nr. 10 447, datë 14.07.2011)

1. Komisionet Eprore përbëhen nga 5 anëtarë secili, të cilët zgjidhen në detyrë me Vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Kryetari dhe 3 anëtarët e Komisionit Epror zgjidhen me propozim të përbashkët të Ministrit të Financave, ministrit që mbulon fushën shëndetësore dhe ministrit që mbulon çështjet sociale. Ministrat propozojnë dy kandidatura për çdo vend të anëtarit të Komisionit Epror. Anëtari i pestë i Komisionit Epror propozohet nga Ministri i Drejtësisë, me kandidaturë alternative, me profesion jurist dhe me përvojë në fushën gjyqësore.

3. Anëtar i Komisionit Epror mund të emërohet shtetasi që përmbush këto kriterë:

- a) të jetë me gradë shkencore "Profesor", "Profesor i asociuar" ose "Doktor shkencash";
- b) të ketë përvojë profesionale prej jo më pak se 10 vjet punë në fushën e vet të ekspertizës;
- c) të mos jetë i dënuar penalisht;
- ç) të ketë një figurë të pastër morale.

4. Rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Eprore, si dhe masa e shpërblimit mujor të tyre përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39/3

Mandati i anëtarit të Komisionit Epror
(Shtuar me ligjin nr. 10 447, datë 14.07.2011)

1. Anëtari i Komisionit Epror ka mandat 4-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje;

2. Anëtari i Komisionit Epror e ushtron këtë detyrë me kohë jo të plotë;

3. Anëtari i Komisionit Epror e ushtron funksionin në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me bindjen e tij profesionale;

4. Përpara fillimit të detyrës, anëtari i Komisionit Epror kryen betimin në një ceremoni publike, të organizuar nga Ministri i Financave, Ministri që mbulon fushën e shëndetësisë dhe Ministri që mbulon fushën e çështjeve sociale;

5. Teksti i betimit përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39/4

Mbarimi para kohe i mandatit
(Shtuar me ligjin nr. 10 447, datë 14.07.2011)

1. Mandati i anëtarit të Komisionit Epror mbaron para kohe kur:

- a) dënohet nga Gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- b) nuk paraqitet, pa arsye, në detyrë për më shumë se dy mbledhje radhazi;
- c) jep dorëheqjen;
- ç) deklarohet i paaftë me vendim gjykate të formës së prerë.

2. Anëtari i Komisionit Epror shkarkohet nga Këshilli i Ministrave:

- a) për shkelje të dispozitave të këtij ligji apo akteve të tjera ligjore;
- b) kur kryen veprimtari, që krijon konflikt interesash.

3. Në rast se vendi i anëtarit të Komisionit Epror mbetet vakant, ai zëvendësohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 39/2 të këtij ligji, pas 15 ditëve nga çasti i krijimit të vakancës dhe qëndron në detyrë deri në përfundimin e afatit të anëtarit që ka zëvendësuar.

PENSIONET FAMILJARE

Neni 40

Kushtet e përfitimit

(Shtuar shprehja në pikën 1, me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; ndryshuar shkronja ç e pikës 2, me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; ndryshuar pika 1, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; zëvendësuar shprehje në pikën 2, shkronja a, paragrafi i fundit, me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Personat që janë në ngarkim të personit që vdes, i cili kishte kushte për përfitimin e njërit nga llojet e pensioneve ose merrte pension, kanë të drejtë të marrin pension familjar;
2. Pension familjar përfitojnë:
 - a) E veja, kur provohet se ajo është:
 - mbajtëse e një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç;
 - e paaftë për punë ose
 - ka mbushur moshën 55 vjeç.
 - b) Burri i ve, kur provohet se ai është:
 - mbajtës i një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në 8 vjeç;
 - i paaftë për punë ose
 - ka mbushur moshën 60 vjeç.
 - c) Jetimi kur provohet që ai ishte në ngarkim të atij që vdiq dhe ka një moshë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, nëse studioi ose është i paaftë për punë, para se të arrijë moshat e mësipërme;
 - ç) Prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë, prindërit e prindërve, njerku e njerka, kur nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë, nëse provohet se ata jetonin në të njëjtën familje me atë që vdiq, jo më pak se një vit para momentit të vdekjes dhe kanë arritur moshën 65 vjeç, ose janë të paaftë për punë;
 - d) Nipërit e mbesat, kur janë në ngarkim të atij që vdiq dhe bënin pjesë në të njëjtën familje me të. Në një rast të tillë ata trajtohen si jetimë.
3. E veja dhe personi i ve humbasin të drejtën për pension familjar kur martohen.

Neni 41

Shuma e pensionit

(Shtuar paragraf pas paragrafit të parë të shkronjës b të pikës 1, me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; riformuluar shkronja b e pikës 1, me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; riformuluar paragrafi i dytë i pikës 1, me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; riformuluar fjalia e dytë e pikës 2, me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001, ndryshuar pika 1, paragrafi i parë me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Pensioni familjar është pjesë e pensionit që kishte ose i takonte të ndjerit. Pensioni, që do t'i takonte të ndjerit, llogaritet sipas rregullave për pensionet e invaliditetit. Pensioni familjar jepet në masën:"
 - a) 50 për qind për personin e ve dhe
 - b) 25 për qind për çdo jetim ose persona të tjerë që përfitojnë.Kur nuk merret pension i parashikuar nga shkronja "a" e këtij neni, masa e pensionit për jetimin është 50 për qind, kur ai është ose mbetet vetëm pjesëtar në pension. Kur pjesëtarë në pension janë më shumë se një jetim, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25 për qind.
- Shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merrte ose do të merrte personi që vdes.
2. Jetimi ka të drejtën e një pensioni familjar edhe në qoftë se prindi që jeton është i punësuar, është ekonomikisht aktiv ose merr një pension si të drejtë të tij. Në këtë rast masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25 për qind e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50 për qind e tij;

3. Jetimi që humbet të dy prindërit, do të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre.

PAGESAT PËR VDEKJE

Neni 42

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Pagesa për vdekje i jepet:

a) një personi të siguruar ose një pensionisti në rast vdekjeje të një anëtar të familjes, që ai e ka në ngarkim;

b) personit që u kujdes për personin e siguruar të vdekur, i cili pagoi shpenzimet e varrimit.

2. Pagesa për rast vdekjeje është e barabartë me 50 për qind të pagës minimale në shkallë vendi.

KREU IV

PAGESAT PËR SIGURIMIN NGA AKSIDENTET NË PUNË DHE SËMUNDJET PROFESIONALE

Neni 43

Llojet e përfitimeve

(Ndryshuar neni me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

Personat e siguruar, në rastet e aksidenteve në punë ose sëmundjeve profesionale, përfitojnë të drejtën e së ardhurës, pavarësisht nga vjetërsia në punë:

a) për kujdes mjekësor shtesë dhe riaftësimi;

b) në rast paaftësie;

c) për kompensim për dëme të arsyeshme;

ç) në rast vdekjeje.

Neni 44

Aksidenti në punë dhe sëmundje profesionale

(Ndryshuar neni me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005)

Aksidenti në punë ose për shkak të punës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Sëmundjet profesionale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 45

Kujdesi mjekësor shtesë dhe riaftësimi

Një person i siguruar që vuan nga një aksident në punë ose sëmundje profesionale, do të marrë kompensim shtesë ose ndonjë kualifikim-rikualifikim të nevojshëm për të rikthyer aftësinë e humbur, siç përcaktohet në Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 46

Përfitimet në rast paaftësie

I siguruari që për shkak të aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale humbet aftësinë për punë, do të përfitojë:

a) përfitime për paaftësi të përkohshme;

b) përfitime për invaliditet të përhershëm;

- c) përfitime për invaliditet të pjesshëm të përhershëm dhe
- ç) përfitime për paaftësi të përhershme në masë të vogël.

Neni 47

E ardhura për paaftësi të përkohshme
(Ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

E ardhura për paaftësi të përkohshme, si pasojë e një aksidenti në punë ose sëmundjeje profesionale, e provuar nga një komision mjekësh ekspertë kompetentë (KML), do të jetë e barabartë me 100 për qind të mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit, nga data e lindjes së të drejtës, paguar për një periudhë përfitimi deri në 12 muaj.

Neni 48

E ardhura për invaliditet të përhershëm
(Shtuar paragraf me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

E ardhura për invaliditet të përhershëm në punë, që ka shkaktuar të paktën humbjen e 67 për qind të aftësisë për punë, e vërtetuar nga një Komision Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), është e barabartë me 80 për qind të bazës së vlerësuar mesatare neto të vitit të fundit para lindjes së të drejtës, por jo më pak se 80 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi.

Personit, që përfiton të ardhura, sipas paragrafit të parë, të këtij neni, dhe ka nevojë për një kujdesje të vazhdueshme nga një person tjetër, sipas vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), i jepet një pagesë shtesë prej 15 për qind të bazës së vlerësuar neto të vitit të fundit para lindjes së të drejtës.

Personi, që përfiton të ardhura, sipas paragrafit të parë, të këtij neni, dhe ka në ngarkim fëmijë deri në moshën 18 vjeç ose kur këta studiojnë apo janë të paaftë për punë deri në moshën 25 vjeç, përfiton një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 për qind të pensionit, por jo më shumë se 30 për qind.

Neni 49

E ardhura për invaliditet të pjesshëm të përhershëm
(Ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

E ardhura për invaliditet të pjesshëm të përhershëm në punë, që ka shkaktuar të paktën humbjen e 33 për qind të aftësisë për punë, e vërtetuar nga KMCAP-ja, është e barabartë me një pjesë të 80-përqindëshit të bazës mesatare të vlerësuar neto të vitit të fundit para lindjes së të drejtës, në varësi nga shkalla e humbjes së aftësisë për punë, por jo më pak se 50 për qind dhe që përcaktohet në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 50

E ardhura për paaftësi të përhershme në masë të vogël

E ardhura për paaftësi të përhershme në masë të vogël në më pak se 33 përqind, por më shumë se 10 për qind, e vërtetuar nga një KMCAP, është një shumë të hollash që jepet menjëherë dhe caktohet në përputhje me Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 51

Kompensimet për dëmtimet e arsyeshme

Dëmtimi material që i ndodh personit të siguruar në lidhje me aksidentin në punë e sëmundje profesionale, do të kompensohet deri në fund sipas Rregullos së Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 52

Përfitimet në rast vdekjeje dhe pensioni familjar

(Shtuar paragraf në pikën 4, me ligjin nr. 8392, datë 02.09.1998; ndryshuar pika 4 dhe hequr pika 5, me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001)

1. Personi që paguan shpenzimet e vdekjes të një personi të sigurvear, që vdes si rezultat i një aksidenti në punë ose sëmundjeje profesionale, do të ripaguhet plotësisht në nivelet që do të përcaktohen nga Rregullorja e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
2. Kur një person i sigurvear vdes, personat në ngarkim të tij dhe që kanë lidhje në një familje me të, kanë të drejtë për pension familjar, me një shumë që varet nga numri i tyre;
3. Personat që kanë të drejtë për pension familjar, janë ata që përcaktohen në nenin 40 të këtij ligji;
4. Në rastet kur personi i sigurvear vdes nga një aksident në punë apo sëmundje profesionale, masa e pensionit familjar për personat pasjetues, do të jetë ajo e përcaktuar në nenin 41, të këtij ligji.

KREU V

PËRFITIMET E PAPUNËSISË

Neni 53

Kushtet e përfitimit

(Shtuar fjalët në shkronjën a të pikës 1, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar shkronja b e pikës 1, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005)

1. Personat e sigurvear përfitojnë përfitime papunësie, në rast se:
 - a) kanë kontribuar në sigurimin shoqëror jo më pak se 12 muaj për çdo rast përfitimi dhe
 - b) janë vërtetuar nga zyra përkatëse e punës se:
 - janë punëkërkues të papunë, të gatshëm të punësohen kur iu ofrohet një punë e paguar, e përshtatshme;
 - pranojnë të kualifikohen ose të rikualifikohen.
 - c) nuk marrin përfitime të tjera nga ky Ligj, me përjashtim të pensionit të pjesshëm të invaliditetit.
2. Sigurimi i papunësisë mund të paguhet edhe në rastet e pjesëmarrjes në programet speciale publike shtetërore e lokale, me kusht që ai të mos marrë më shumë se paga minimale mujore.

Neni 54

Shuma e së ardhurës

(Ndryshuar pika 3, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005)

1. E ardhura nga papunësia do të jetë një shumë bazë që siguron të paktën një nivel jetese minimale çdo vit e indeksuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, lidhur me llogaritjen e indeksit të çmimeve të mallrave të zgjedhura;
2. Niveli bazë do të vendoset nga Këshilli i Ministrave;
3. Përfituesi me fëmijë në ngarkim deri në moshën 18 vjeç do të marrë një shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 për qind të përfitimeve nga papunësia, por jo më tepër se 30 për qind. Kur njëri nga prindërit është në marrëdhënie pune ose merr pension të plotë, shtesa reduktohet në masën 50 për qind.

Neni 55

Periudha e përfitimit

(Ndryshuar pika 1, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005)

1. E ardhura e papunësisë paguhet deri në 12 muaj, sipas përcaktimit të VKM;
2. Për personat që punësohen me ndërprerje gjatë periudhës 1-vjeçare të përfitimit të papunësisë, afati i saj mund të shtyhet deri në 2 vjet, por me kusht që gjithsej të mos përfitojnë më shumë se 365 ditë kalendarike;
3. Personat që ndjekin kurset e kualifikimit dhe të rikualifikimit, përfitojnë pagesën e papunësisë gjatë gjithë kohës së zhvillimit të kurseve, në rast se nuk paguhen për këtë periudhë, por jo më shumë se 6 muaj tej afatit 1-vjeçar të përfitimit të papunësisë. Këtë të drejtë e gëzojnë edhe të siguruarit gjatë kohës së përfitimit të barrë lindjes dhe të pensionit të plotë të invaliditetit.

KREU VI

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA PËR TË GJITHA PËRFITIMET

Neni 56

Kushtet e përfitimit të përfitimeve

1. Personi i siguruar që e ka plotësuar periudhën e kërkuar të sigurimit, si dhe gjithë personat në ngarkim të atij që vdes, të cilët nuk kanë plotësuar moshën ose nuk plotësojnë kushtet e tjera për pension, kanë të drejtë të marrin pension kur të plotësojnë moshën ose kushte të tjera;
2. Personat që i kanë përmbushur të gjitha kushtet, por jo atë të paaftësisë, marrin pension, pasi të provohet se janë të paaftë për punë;
3. Bashkëshorti pasjetues që bëhet i paaftë për punë pas 10 vjetëve nga vdekja e bashkëshortit, nuk ka të drejtë për pension familjar.

Neni 57

Tërheqja e kësteve të përfitimit

1. Përfitimet duhet të zëvendësojnë pakësimin e përfitimeve nga punësimi ose nga një veprimtari tjetër ekonomike;
2. Përfituesi nuk ka të drejtë për këste përfitimi për çfarëdo periudhe, kur merr pagë ose përfitime nga veprimtaria ekonomike si i punësuar ose i vetëpunësuar;
3. Pagesat e përfitimeve ndalohen për çdo kohë që përfituesi është punësuar ose ka qenë ekonomikisht aktiv;
4. Pagesa nuk ndalohet vetëm kur Ligji parashikon qartë punësim dhe veprimtari ekonomike (psh, pension invaliditeti të pjesshëm).

Neni 58

Periudha e sigurimit

(Shtuar fjalët në fund të shkronjës b, me ligjin nr. 8392, datë 02.09.1998)

1. Periudhat e sigurimit përfshijnë të gjitha periudhat:
 - a) për të cilat janë paguar kontributet;
 - b) gjatë të cilave është bërë pagesa nga sigurimet shoqërore, përfshirë edhe periudhën e përfitimit të pensionit të pjesshëm të invaliditetit.
2. Këshilli i Ministrave mund të deklarojë edhe periudha të tjera si periudha të sigurimit, duke u derdhur kontributi në fondin e sigurimit shoqëror nga Buxheti i Shtetit.

Neni 59

Baza e vlerësuar për llogaritjen e përfitimeve

(Ndryshuar titulli i nenit me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; riformuluar pika 1 me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; riformuluar pika 3 me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; riformuluar pika 5 me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar neni me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi.

Për periudhën e sigurimit nga data 01.01.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merret shuma e pagave për të cilat janë paguar kontributet nga data 01.01.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit.

Për periudhën e sigurimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore para datës 01.01.1994, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merren pagat referuese, të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Për periudhën e sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merren pagat referuese të caktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 01.01.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit si ish- punonjës i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore, përpara vitit 1994, si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikisht aktiv pas datës 01.01.1994.

Për efekt të llogaritjes së pensioneve me datë fillimi pas 01.01.2015 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese, sipas llojit të punës ose funksionit përpara datës 01.01.1994, si edhe mbi pagat individuale, mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 01.01.1994 deri në 31.12.2014, të indeksuara me indeksin që del nga pjestimi i pagës minimale në shkallë vendi të vitit 2014 me pagën minimale të vitit 1994 ose me pagën minimale të vitit përkatës. Koeficientët e indeksimit sipas viteve përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave;

2. Baza e vlerësuar neto për llogaritjen e pagesave për sëmundje e barrë lindje dhe për përfitime të tjera afatshkurtra do të jenë pagat mbi të cilat janë paguar kontributet pasi zbritet tatimi mbi përfitimet personale, norma e kontributit të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe suplementare që mbahet nga paga e punonjësit, sipas dispozitave në fuqi për periudhën përkatëse;

3. Çdo vit, pas 01.01.2015, duke filluar nga data 1 janar, baza e vlerësuar vjetore individuale indeksohet me koeficientin, që llogaritet si raport i kontributit mesatar të personave të siguruar, të mbledhur në vitin e fundit kalendarik, kundrejt të njëjtit tregues të vitit pararendës. Ky koeficient caktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave;

4. Pensionet e invaliditetit nuk do të llogariten me një bazë të vlerësuar më të ulët se ajo e paguar më parë. Sapo të jetë përfituar një pension invaliditeti, shuma e pensionit do të merret si kufi minimal, kur llogaritet çdo pension tjetër sipas ligjit të sigurimeve shoqërore.

Neni 60

(Shtuar fjalët me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005)

Për personat që nuk kanë pagë ose që nuk kanë dokumentin, i cili vërteton pagën, përfitimet llogariten mbi pagën minimale.

Neni 61

Indeksi i përfitimeve

(Ndryshuar neni me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar neni me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

Pensioni social, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit, familjare si edhe të ardhurat nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale indeksohen çdo vit për të kompensuar pasojat e ndryshimit të çmimeve të mallrave dhe të shërbimeve të zgjedhura për nivelin minimal të jetesës së pensionistëve. Këshilli i Ministrave cakton listën e mallrave të zgjedhura, mbi të cilën llogaritet indeksi, metodën e llogaritjes dhe datën e indeksimit.

Neni 62

E drejta për përfitim

(Ndryshuar pika 2 dhe 3, me ligjin nr. 8392, datë 02.09.1998; ndryshuar titulli me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; shtuar fjalia në fund të pikës 1, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; shtuar fjalët në paragrafin e tretë të pikës 3, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; shtuar fjalët në paragrafin e katërt të pikës 3, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar paragrafi i katërt i pikës 3, me ligjin nr. 9768, datë 09.07.2007)

1. Personat që kanë të drejtë për më shumë se 1 lloj pensioni, mund të zgjedhin vetëm një prej tyre, kjo e drejtë mund të ushtrohet jo më shumë se tri here.

2. E drejta e pensionit nuk parashkruhet. Personi, i cili kërkon pensionin jo më vonë se 1 vit nga data që i lind kjo e drejtë, ky pension i paguhet që nga kjo ditë. Në raste të tjera pensioni do të paguhet nga data e paraqitjes së kërkesës për pension.

E drejta për përfitimet e tjera parashkruhet me kalimin e një viti nga data e fillimit të së drejtës për përfitimin e tyre.

3. Pensionet e njohura, por të patërhequra do të paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet vjet.

Pensionet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet.

E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti, ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit dhe masa e ndalesës për çdo muaj është 20% e kështit mujor të pensionit.

Personi, që ka përfituar pension ose përfitime të tjera nga sigurimet shoqërore, në mënyra e mjete në kundërshtim me ligjin, detyrohet të kthejë të gjithë shumën e marrë tepër, të cilën e shlyen duke iu mbajtur çdo muaj 50% e kështit mujor të përfitimit. Gjithashtu, personi dënohet me gjobë në masën katërfish të dëmit të shkaktuar, pavarësisht nga dënimi i parashikuar në dispozitën përkatëse të Kodit Penal;

4. Pensioni i invaliditetit do të ndërpritet për periudhat që pensionisti refuzon të vizitohet te komisioni i mjekëve ekspertë kompetent. Gjithashtu pensioni i invaliditetit ndërpritet edhe për periudhat kur ai refuzon të marrë pjesë në kurset e kualifikimit e të rikualifikimit, në ripërtëritjen mjekësore dhe në trajtimin kundër alkoolit e drogës, që synojnë të reduktojnë aftësinë tij për punë.

Neni 62/1

E drejta për informim

(Shtuar me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005)

Personi i siguruar ka të drejtë të informohet në lidhje me kontributet dhe/ose përfitimet nga sigurimet shoqërore. Procedura dhe periudhat për informim caktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

PJESA V
FONDI I SIGURIMIT SHOQËROR

Neni 63

Përfitimet nga ky ligj nuk taksohen.

Neni 64

(Shtuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

Përfitimet që parashikon ky ligj, financohen nga fondi i sigurimeve shoqërore, tek i cili do të kontribuojnë rregullisht punëdhënësit, të punësuarit dhe personat e tjerë vullnetarisht të siguruar.

Kontributet e personave të punësuar do të ndahen me punëdhënësit e tyre.

Pensioni social financohet nga Buxheti i Shtetit.

Neni 65

1. Fondi i sigurimeve shoqërore është i ndarë nga buxheti i shtetit. Ai administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në përputhje me statusin e tij, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

2. Një pjesë e fondit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore të jetë në valutë, e cila të përdoret për obligimet ndërkombëtare.

Neni 66

Përfitimet

(Ndryshohet emërtimi në shkronjën d, me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

Përfitimet e fondit të sigurimeve shoqërore përbëhen nga:

- a) kontributet e personave të siguruar dhe e punëdhënësve të tyre;
- b) kontributet nga Buxheti i shtetit për personat që nuk mund të paguajnë kontribute, veçanërisht për:

- shtetasit që shërbejnë në shërbimin e detyrueshëm ushtarak;

- punonjësit që marrin një pagesë nga sigurimi i papunësisë;

- shtetasit që mbulohen nga skema e përfitimit me Vendim të Këshillit të Ministrave.

- c) subvencione të Buxhetit të Shtetit për të mbështetur shpenzimet shtesë, si pasojë e:

- indeksimit që bëhet sipas këtij Lligji, miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe që përcakton ky Ligj dhe

- mbulimit të shpenzimeve, kur përfitimet nuk mjaftojnë.

- ç) pagesa për veprimtari shtesë, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave;

- d) subvencione të Buxhetit të Shtetit, të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;

- dh) përfitimet nga investimet e fondit të sigurimeve shoqërore;

- e) përfitime të tjera, duke përfshirë gjobat, përfitime nga veprimtaritë administrative të sigurimit shoqëror, dhurata, trashëgimi etj.

Neni 67

Shpenzimet

(Ndryshuar pika 3, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005)

1. Shpenzimet e fondit të sigurimeve shoqërore përfshijnë:

- a) pagesat në para e në natyrë të përfitimeve për sigurime, ndihma dhe pensione;

- b) shpenzime administrative.

2. Kur shpenzimet për sigurimet shoqërore nuk mbulohen me përfitimet e parashikuara në nenin 66, diferenca mbulohet nga Buxheti i Shtetit.

3. Për shpenzime administrative në buxhetin e sigurimeve shoqërore planifikohet një shumë deri në 5% të shpenzimeve totale.

Neni 68

Përdorimi i fondeve për sigurimet shoqërore

(Shtuar fjalët në fund të paragrafit të parë të pikës 2, me ligjin nr. 8392, datë 02.09.1998; shtuar pika 4, me ligjin nr. 9114, datë 24.07.2003; ndryshuar paragrafi i dytë i pikës 2, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005)

1. Kontributet administrohen në mënyrë të ndarë në 5 degët e sigurimit shoqëror:

- a) dega e sigurimit të sëmundjes;
- b) dega e sigurimit të barrë lindjes;
- c) dega e sigurimit të pensionit;
- ç) dega e sigurimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;
- d) dega e sigurimit të papunësisë.

2. Transferimi i fondeve midis degëve të sigurimit shoqëror nuk është i lejueshëm, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë miratohet në buxhetin vjetor të sigurimeve shoqërore. Transferimi dhe përdorimi i fondeve bëhen vetëm sipas këtij Ligji dhe rregullave të caktuara në Statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Përfitimet dhe shpenzimet e sigurimeve shoqërore pasqyrohen rregullisht dhe do të revizionohen çdo vit nga Komisioni i Revizionit, i ngritur në përputhje me Statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

4. Përfitimet, shpenzimet dhe gjendja financiare e fondit të sigurimeve shoqërore auditohen një herë në pesë vjet nga subjekte të specializuara në këtë fushë. Zgjedhja e subjekteve bëhet në përputhje me ligjin nr. 7971, datë 26.07.1995 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar).

Neni 69

(Ndryshuar neni me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005)

Shteti garanton fondin e sigurimeve shoqërore të detyrueshme në rast falimentimi. Këshilli i Ministrave ka të drejtën e mbikqyrjes së financimit për sigurimet shoqërore, të revizionimit të llogarive vjetore dhe të miratimit të buxhetit.

Neni 70

Fondi rezervë

(Ndryshuari me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Instituti i Sigurimeve Shoqërore krijon një fond rezervë që të mbulojë të paktën 1 muaj shpenzimet për pensione.

2. Rezerva të plotësohet gjatë 3 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në çdo rast, kur fondi rezervë është nën nivelin përcaktues, merren masat e nevojshme për ta vendosur në kuotën e caktuar. Procedurat e plotësimit përcaktohen në statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore miratuar nga Këshilli i Ministrave.

PJESA VI
DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 71

(Ndryshuar pika 2, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005)

1. Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë do të drejtohen e administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH).

2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore është institucion publik i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohen me këtë Ligj.

3. Instituti i Sigurimeve Shoqërore është person juridik shqiptar, me qendër në Tiranë. Ai mund të koeporojë dhe të përfundojë marrëveshje e të marrë kontakte me organizata joqeveritare ndërkombëtare, në fushën e sigurimeve shoqërore.

4. Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të drejtohet nga:

- a) Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe
- b) Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 72

Përbërja dhe emërimi i Këshillit Administrativ

(Ndryshuar neni me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar nënndarjet “i” “ii” “iii” “iv” “v” të shkronjës a, të pikës 1, me ligjin nr. 13/2014, datë 13.02.2014)

1. Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore përbëhet nga 12 anëtarë, nga të cilët:

a) 6 anëtarë të ndarë si më poshtë:

- i) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e financave;
- ii) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e ekonomisë;
- iii) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore;
- iv) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë;
- v) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë.
- vi) një përfaqësues nga Instituti i Statistikave.

Funksionet e këtyre përfaqësuesve caktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

b) 3 anëtarë caktohen nga organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve, të cilat përzgjidhen me Vendim të Këshillit të Ministrave;

c) 3 anëtarë caktohen nga sindikatat më të përfaqësuara, të cilat përzgjidhen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Emërimi i anëtarëve të përcaktuar në shkronjat “b” dhe “c” është i vlefshëm për një periudhë jo më shumë se 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë;

3. Shkarkimi i anëtarëve mund të bëhet në çdo rast, nga autoriteti që i cakton.

Neni 73

Kryesia e Këshillit Administrativ

Këshilli Administrativ zgjedh me votim të fshehtë kryetarin dhe dy zëvendëskryetarët e tij. Kryetari zgjidhet nga 6 anëtarë, që janë përfaqësues të Këshillit të Ministrave dhe 2 zëvendëskryetarët zgjidhen: njëri nga përfaqësuesit e punëdhënësve dhe tjetri nga përfaqësuesit e punëtorëve.

Neni 74

Kompetencat e Këshillit Administrativ

(Shtuar shkronja “e” me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; shtuar shkronja “b/1”, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar shkronja “e”, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar shkronja “ç”, e pikës 1, me ligjin nr. 9498, datë 03.04.2006; ndryshuar shkronja “ç”, pika 1, me ligjin nr. 13/2014, datë 13.02.2014)

1. Këshilli Administrativ ka këto kompetenca:
 - a) zgjedh Drejtorin e Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
 - b) Miraton çdo vit raportin vjetor, bilancin vjetor, buxhetin vjetor dhe perspektivat 3-vjeçare financiare të skemës së sigurimeve shoqërore;
 - b/1) Përcakton e miraton strukturën dhe numrin e punonjësve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
 - c) Vendos për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me investimet e fondeve;
 - ç) propozon te ministri përgjegjës për çështjet e sigurimeve shoqërore ndryshimet në statusin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe ligjin e sigurimeve shoqërore;
 - d) Vendos për lidhjen e marrëveshjeve dhe të kontratave të rëndësishme;
 - dh) Miraton Komisionin e kontrollit, për veprimtarinë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
 - e) Miraton rregulloret e propozuara nga Drejtori i Përgjithshëm, sipas përgjegjësive që përcaktohen nga Ligji dhe statuti, dhe që kanë të bëjnë me çështje financiare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
 - ë) Me kërkesë të punëdhënësve vendos për ngrirjen e kamatëvonesave për një periudhë të caktuar kohe dhe për pagimin e tyre në një periudhë të mëvonshme, por jo më shumë se një vit financiar, pa të drejtë përsëritjeje, në ato raste kur pagesa e menjëhershme e kamatëvonesave do të bënte të pamundur vazhdimin e veprimtarisë ekonomike, që ndodhet në vështirësi financiare.

Neni 75

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm

(Ndryshuar me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005)

- Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore ka këto detyra e përgjegjësi:
- a) Përfaqëson Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe drejton veprimtarinë e tij;
 - b) Miraton rregulloret e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për organizimin, administrimin dhe procedurat administrative, sipas Ligjit;
 - c) Mbledh bordin e drejtuesve, si një organ këshillues pranë tij, ku bëjnë pjesë zëvendësdrejtorët e përgjithshëm dhe drejtorët e Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore;
 - ç) Përcakton rregullat e brendshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
 - d) Emëron punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, drejtorët e Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, si dhe përcakton rregullat e rekrutimit të personelit për këto drejtori;
 - dh) Vendos për të gjitha çështjet e veprimtarisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore brenda kufijve të planit financiar dhe dispozitave ligjore në fuqi;
 - e) Përgjigjet për të gjitha çështjet e administrimit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe raportin para Këshillit Administrativ;
 - ë) Propozon në Këshillin Administrativ buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, planin financiar, paraqet raportin vjetor, parashikimin financiar 3-vjeçar. si dhe Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për kontributet dhe problemet financiare.

Neni 76

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005)

Neni 77

**Marrëdhëniet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me ministrinë përgjegjëse për
çështjet e sigurimeve shoqërore**

(Shfuqizuar pika 3, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005;

shtuar pikat 3 e 4, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar titulli i nenit me ligjin nr. 9498, datë 03.04.2006; zëvendësuar fjalët në pikën 1, me ligjin nr. 9498, datë 03.04.2006; zëvendësuar fjalët në pikën 2, me ligjin nr. 9498, datë 03.04.2006; zëvendësuar emërtimi në pikën 3, me ligjin nr. 9498, datë 03.04.2006; zëvendësuar emërtimi në pikën 4, me ligjin nr. 9498, datë 03.04.2006; ndryshuar titulli me ligjin nr. 13/2014, datë 13.02.2014; zëvendësuar fjalë në pikën 1, 2, 3 dhe 4, me ligjin nr. 13/2014, datë 13.02.2014)

Raportimi:

1. Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore do t'i paraqesë çdo vit nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore Këshillit të Ministrave:

- a) raportin vjetor dhe bilancin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- b) buxhetin vjetor të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe planin financiar; zhvillimin financiar 3-vjeçar dhe perspektivën e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
- c) Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore një herë në 5 vjet do t'i paraqesë ministrit përgjegjës për çështjet e sigurimeve shoqërore dhe, nëpërmjet tij,

2. Këshilli të Ministrave perspektivën për 5 vjet.

3. Instituti i Sigurimeve Shoqërore raporton te ministri përgjegjës për çështjet e sigurimeve shoqërore për realizimin e politikave të Qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore, për realizimin e programit vjetor të zhvillimit të skemës së sigurimeve shoqërore, si dhe probleme të tjera të ngarkuara nga Ministri.

4. Ministria përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore mbikëqyr zbatimin e politikave të Qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore.

Neni 78

Statuti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore

(Ndryshuar me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; zëvendësuar fjalët me ligjin nr. 9498, datë 03.04.2006; zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 13/2014, datë 13.02.2014)

Këshilli i Ministrave miraton Statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i cili rregullon veprimtarinë e këtij institucioni dhe marrëdhëniet ndërmjet ministrisë përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore, Këshillit Administrativ dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

**PJESA VII
PROCEDURAT**

Neni 79

Detyrimet e punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit

(Ndryshuar me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; shtuar paragraf në fund të pikës 1, me ligjin nr. 9114, datë 24.07.2003; ndryshuar neni me ligjin nr. 10 070, datë 05.02.2009)

Punëdhënësi dhe i vetëpunësuarit janë të detyruar:

- a) të regjistrojnë në regjistrin vjetor të gjithë të punësuarit;
- b) të njoftojnë në organet tatimore për ndryshimet dhe lëvizjen e punonjësve, sipas procedurave të përcaktuara me Ligj;

c) të bëjnë sigurimin nga dita e parë, kur i punësuar fillon punë;
ç) të dorëzojnë në organet tatimore dokumentacionin, ku evidentohen paga dhe kontributi për çdo të punësuar, sipas formatit dhe afateve të përcaktuara me Ligj.

Rregullat e lëvizjes së informacionit dhe të dokumentacionit ndërmjet punëdhënësit, strukturave tatimore dhe strukturave të sigurimeve shoqërore përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 80

Punëdhënësi përgjigjet për punësimin dhe riaftësimin profesional të invalidëve, që janë të aftë për punë në kushte të veçanta, sipas rekomandimit të organit kompetent (KMCAP), dhe që caktohen nga zyrat e punës. Rregullat përcaktohen me ligj të veçantë.

Neni 81

Regjistrimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; shtuar paragraf pas paragrafit të parë me ligjin nr. 9114, datë 24.07.2003; ndryshuar neni me ligjin nr. 9600, datë 27.07.2006; ndryshuar neni me ligjin nr. 10 070, datë 05.02.2009)

Personat juridikë, publikë, privatë dhe personat fizikë, që fillojnë veprimtari ekonomike për herë të parë, janë të detyruar të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe në strukturat tatimore, sipas rregullave të përcaktuara me Ligj. Regjistrimi i subjekteve, në bazë të të dhënave të sigurimeve shoqërore dhe mbyllja e veprimtarisë bëhen sipas rregullave të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Regjistrimi është akt administrativ, që nuk tregon detyrim për mbulimin me sigurime shoqërore.

Neni 82

Procedura për transferimin dhe pagimin e kontributeve

(Ndryshuar pika 1, me ligjin nr. 9114, datë 24.07.2003; ndryshuar titulli me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Të gjitha përfitimet nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe nga kamatëvonesat e tyre, të mbledhura nga organet tatimore, transferohen në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe organeve në vartësi të tij. Procedurat e transferimit përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore i shpërndan kontributet e mbledhura në të 5 degët e sigurimit shoqëror dhe i përdor veçmas.

Neni 83

(Ndryshuar me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005)

Personeli mjekësor dhe anëtarët e komisionit mjekësor ose të KMCAP-it, që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre veprojnë në kundërshtim me normat e caktuara dhe cenojnë fondet e sigurimeve shoqërore dënohen me gjobë, në masën nga 3 deri në 5-fishin e pagës minimale në shkallë vendi. Gjoka vendoset nga personeli i ISSH-së, përgjegjës për paaftësinë e përkohshme, barrë lindjen dhe ekspertizën mjekësore.

Kundër vendimit të gjobës bëhet ankim brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, tek Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së, i cili vendos lënien në fuqi, shfuqizimin ose ndryshimin e masës së gjobës.

Neni 84

Kërkesa

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014, ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 111/2016, 3.11.2016)

1. Personi i siguruar ka të drejtë të kërkojë përfitime sa herë që mendon se i plotëson kushtet për përfitimin e tyre.

2. Kërkesat, së bashku me dokumentet e përcaktuara në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, paraqiten dhe administrohen në sportelet e shërbimit, në ato bashki ku ndodhet vendbanimi i përhershëm i personit, sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel.

3. Kërkesat për përfitimin e papunësisë bëhen në zyrat e punës me procedurë, sipas qendrës së punës ose vendbanimit.

Neni 85

Përlogaritjet

(Zëvendësuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 8776, datë 26.04.2001; shtuar fjalët në fund të pikës 3 me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar pika 2, me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Përfitimet afatshkurtra për degët e sëmundjes, barrë lindjes dhe aksidenteve në punë për personat e punësuar, do të llogariten nga qendrat e punës, kurse për personat e tjerë ekonomisht aktivë, nga zyrat lokale të sigurimeve shoqërore;

2. Përfitimet afatshkurtra për papunësinë caktohen nga zyrat e punësimit. Dokumentacioni, kriteret dhe procedurat e caktimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

3. Pensionet do caktohen nga zyrat rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, brenda ditës së fundit të muajit të ardhshëm nga data e pranimi të kërkesës dhe dokumentave të plota e të sakta për pension.

Neni 86

Ankimimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005, shtuar një fjali pas fjalisë së parë të pikës 1)

1. Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Ankimi, në këto raste, depozitohet pranë sporteleve të shërbimit, në përputhje me legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel.

2. Ankimi kundër vendimeve të Komisionit të Ankimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

3. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar;

4. Këshilli Administrativ përcakton përbërjen, numrin dhe procedurën e funksionimit të Komisionit të Ankimit pranë Drejtorive Rajonale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 87

Pagesat

(Ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

Pagesa e përfitimeve nga sigurimet shoqërore u ngarkohet institucioneve financiare profesionale, që do të caktohen nga Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Pagesa për përfitimin e papunësisë bëhet nga institucione financiare profesionale ose nga zyrat e punës, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave.

PJESA VIII DISPOZITA PËR PERIUDHËN TRANSITORE

Neni 88

Të drejtat e fituara

(Shtuar shprehje në pikën 7 me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; ndryshuar fjalia e fundit e pikës 1 me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar fjalia e fundit e pikës 2 me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; shfuqizuar pika 5 me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; shtuar fjalët në pikën 7 me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; shtuar fjalët në fund të fjalisë së parë të pikave 1 e 2 me ligjin nr. 9708, datë 05.04.2007; ndryshuar neni me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Sigurimi shoqëror është jofitimprurës. Me kontributet e derdhura garantohej pagesa në para për të kompensuar pakësimin e të ardhurave në një shumë që mbulon të paktën një standard minimal jetese, i cili përcaktohet nga Këshilli i Ministrave. Kur standardi minimal i jetesës nuk arrihet nga pensioni, për pensionistët me datë fillimi deri më 31.12.2014, Këshilli i Ministrave ka të drejtë të vendosë një shtesë të ardhurash në formë kompensimi të plotë.

2. Pensionet e caktuara në bazë të ligjit nr. 4171, datë 13.4.1966, “Për sigurimet shoqërore të Republikës Popullore të Shqipërisë”, quhen të mirëqena dhe nuk do të jenë objekt i ndonjë ndryshimi, me përjashtim të indeksimit dhe kompensimit, sipas pikës 1, të këtij neni.

3. Pensionet e caktuara në bazë të ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore të Republikës Popullore të Shqipërisë”, me të gjitha ndryshimet e tij të mëvonshme, quhen të mirëqena dhe nuk janë objekt i ndonjë ndryshimi, me përjashtim të indeksimit dhe kompensimit, sipas pikës 1, të këtij neni.

4. Pensionet për personat që u lind e drejta deri më 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë, caktohen sipas dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi deri në atë datë dhe nuk janë objekt ndryshimi apo rillogaritjeje përveç indeksimit dhe kompensimit, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Pensionet dhe përfitimet e tjera nga sigurimi shoqëror suplementar, të caktuara sipas dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi deri më 31.12.2014, për kategoritë e përfshira në pikën 1, të nenit 4, të këtij ligji, nuk janë objekt i ndonjë ndryshimi, me përjashtim të indeksimit dhe kompensimit sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Personat, që marrin përfitime afatshkurtra për paaftësi, barrë lindje, sigurim papunësie etj., me datë fillimi përpara datës 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë, do ta përfitojnë atë në masën dhe kriteret e përcaktuara në dispozitat që kanë qenë në fuqi deri në atë datë.

7. Personat, të cilët deri në datën 31.12.2014, merrnin pension pleqërie, pension të parakohshëm, pension familjar, pension për vjetërsi shërbimi, pension për vjetërsi shërbimi në raste të veçanta, do të vazhdojnë të tërheqin pensionin e tyre. E njëjta gjë do të zbatohet edhe për shtesat e dhëna për pjesëmarrjen në luftën kundër pushtuesve nazifashistë.

8. Personat që deri në datën 31.12.2014 përfitojnë pension invaliditeti, do të vazhdojnë ta marrin atë me përjashtim të rastit kur, pas një rivlerësimi të gjendjes shëndetësore, ligji i ri rezulton me kushte më të favorshme.

Neni 89

Zbatimi i dispozitave të reja

1. Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen vetëm në raste kur e drejta lind mbas datës së hyrjes në fuqi të tij.

Neni 90

Pagesat e kontributeve

(Ndryshuar paragrafi i fundit i pikës 1 me ligjin nr. 8889, datë 25.04.2002; ndryshuar pika 2, me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Kontributi prej 10 për qind që i takon të derdhin të punësuarit, sipas nenit 9 të këtij ligji, do të derdhet në këtë mënyrë:

-Për vitin 1993, të punësuarit nuk do të derdhin, kurse buxheti i shtetit do të derdhë 10 për qind;

-Për vitin 1994, të punësuarit 3 për qind, kurse buxheti i shtetit 7 për qind;

-Për vitin 1995, të punësuarit 6 për qind, kurse buxheti i shtetit 4 për qind;

-Për vitin 1996 deri më 01.07.2002 të punësuarit 10 për qind e në vazhdim 9.5 për qind.

2. Kontributi i të vetëpunësuarve në bujqësi do të rritet gradualisht deri në barazimin me kontributet e personave të vetëpunësuar në aktivitete jobujqësore në vitin 2018. Rritja vjetore e masës së kontributit caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 91

Periudhat e quajtura si periudha sigurimi

(Shtuar fjalët në pikën 4, me ligjin nr. 8392, datë 02.09.1998; shtuar paragraf në fund të pikës 4, me ligjin nr. 8392, datë 02.09.1998; ndryshuar pika 4, me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Të gjitha periudhat e punësimit para hyrjes në fuqi të këtij ligji, të njohura si vjetërsi pune, të vlefshme për sistemin e sigurimit shoqëror të kaluar, do të quhen si periudha sigurimi edhe për këtë ligj.

2. Periudhat, në të cilat nuk është punuar, por të njohura si vjetërsi pune për sigurimet shoqërore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të njihen si periudha të sigurimit edhe për këtë ligj;

3. Koha pas hyrjes në fuqi të këtij ligji njihet si periudhë e sigurimit shoqëror vetëm kur është derdhur kontribut, sipas këtij ligji.

4. Periudha e kryerjes së studimeve në shkollën e lartë, me shkëputje nga puna për gruan, duke filluar nga data 01.09.2000 dhe deri më 31.12.2032, pavarësisht nga vendi se ku janë kryer studimet dhe për jo më shumë se 6 vjet, njihet periudhë sigurimi vetëm për efekt pensioni pleqërie. Në kuptim të këtij neni, viti shkollor është me 12 muaj.

Në këtë rast, kontributet përballohen nga Buxheti i Shtetit, në kohën kur merret vendim për caktimin e pensionit.

Neni 92

Zgjatja graduale e moshës dhe periudhës së sigurimit për pension

(Ndryshuar me ligjin nr. 8889, datë 25.04.2002; ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

1. Mosha dhe periudha e sigurimit për pension pleqërie, deri në arritjen e moshës dhe plotësimin e periudhës së sigurimit, që përcaktohet në pikën 1, të nenit 31, të këtij Ligji, do të rriten sipas tabelave që vijojnë:

MOSHA DHE PERIUDHA E SIGURIMIT QË KËRKOHET NË VITE PËR
SECILËN KATEGORI

BURRI

	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
Vitet	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
1993	50	20	55	25	60	25
1994	50	20	55	25	60	25
1995	51	21	56	26	60	26
1996	51	21	56	27	60	27
1997	52	22	57	28	60	28
1998	52	22	57	29	60	29
1999	53	23	58	30	60	30
2000	53	23	58	31	60	31
2001	54	24	59	32	60	32
01.07.2002 - 30.06.2003	54	24	59	33	60v 6m	33
01.07.2003 - 30.06.2004	55	25	60	34	61v	34
01.07.2004 - 30.06.2005	55	25	60v 6m	35	61v 6m	35
01.07.2005 - 30.06.2006	56	26	61v	35	62v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	56	27	61v 6m	35	62v 6m	35
01.07.2007 - 30.06.2008	57	28	62v	35	63v	35
01.07.2008 - 30.06.2009	57	29	62v 6m	35	63v 6m	35
01.07.2009 - 30.06.2010	58	30	63v	35	64v	35
01.07.2010 - 30.06.2011	58	31	63v 6m	35	64v 6m	35
01.07.2011 - 30.06.2012	59	32	64v	35	65v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	59	33	64v 6m	35	65v	35
01.07.2013 - 30.06.2014	60	34	65v	35	65v	35
01.07.2014 - 31.12.2014	60v 6m	35	65v	35v	65v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	61v	35v 4m	65v	35v 4m	65v	35v 4m
01.01.2016 - 31.12.2016	61v 6m	35v 8m	65v	35v 8m	65v	35v 8m
01.01.2017 - 31.12.2017	62v	36v	65v	36v	65v	36v
01.01.2018 - 31.12.2018	62v 6m	36v 4m	65v	36v 4m	65v	36v 4m
01.01.2019 - 31.12.2019	63v	36v 8m	65v	36v 8m	65v	36v 8m
01.01.2020 - 31.12.2020	63v 6m	37v	65v	37v	65v	37v
01.01.2021 - 31.12.2021	64v	37v 4m	65v	37v 4m	65v	37v 4m
01.01.2022 - 31.12.2022	64v 6m	37v 8m	65v	37v 8m	65v	37v 8m
01.01.2023 - 31.12.2023	65v	38v	65v	38v	65v	38v
01.01.2024 - 31.12.2024	65v	38v 4m	65v	38v 4m	65v	38v 4m
01.01.2025 - 31.12.2025	65v	38v 8m	65v	38v 8m	65v	38v 8m
01.01.2026 - 31.12.2026	65v	39v	65v	39v	65v	39v
01.01.2027 - 31.12.2027	65v	39v 4m	65v	39v 4m	65v	39v 4m

01.01.2028 - 31.12.2028	65v	39v 8m	65v	39v 8m	65v	39v 8m
01.01.2029 - 31.12.2029	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2030 - 31.12.2030	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2031 - 31.12.2031	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2032 - 31.12.2032	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2033- 31.12.2033	65v 1m	40v	65v 1m	40v	65v 1m	40v
01.01.2034- 31.12.2034	65v 2m	40v	65v 2m	40v	65v 2m	40v
01.01.2035- 31.12.2035	65v 3m	40v	65v 3m	40v	65v 3m	40v
01.01.2036- 31.12.2036	65v 4m	40v	65v 4m	40v	65v 4m	40v
01.01.2037- 31.12.2037	65v 5m	40v	65v 5m	40v	65v 5m	40v
01.01.2038- 31.12.2038	65v 6m	40v	65v 6m	40v	65v 6m	40v
01.01.2039- 31.12.2039	65v 7m	40v	65v 7m	40v	65v 7m	40v
01.01.2040- 31.12.2040	65v 8m	40v	65v 8m	40v	65v 8m	40v
01.01.2041- 31.12.2041	65v 9m	40v	65v 9m	40v	65v 9m	40v
01.01.2042- 31.12.2042	65v10m	40v	65v10m	40v	65v10m	40v
01.01.2043- 31.12.2043	65v11m	40v	65v11m	40v	65v11m	40v
01.01.2044- 31.12.2044	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2045- 31.12.2045	66v1m	40v	66v1m	40v	66v1m	40v
01.01.2046- 31.12.2046	66v 2m	40v	66v 2m	40v	66v 2m	40v
01.01.2047- 31.12.2047	66v 3m	40v	66v 3m	40v	66v 3m	40v
01.01.2048- 31.12.2048	66v 4m	40v	66v 4m	40v	66v 4m	40v
01.01.2049- 31.12.2049	66v 5m	40v	66v 5m	40v	66v 5m	40v
01.01.2050- 31.12.2050	66v 6m	40v	66v 6m	40v	66v 6m	40v
01.01.2051- 31.12.2051	66v 7m	40v	66v 7m	40v	66v 7m	40v
01.01.2052- 31.12.2052	66v 8m	40v	66v 8m	40v	66v 8m	40v
01.01.2053- 31.12.2053	66v 9m	40v	66v 9m	40v	66v 9m	40v
01.01.2054- 31.12.2054	66v10m	40v	66v10m	40v	66v10m	40v
01.01.2055- 31.12.2055	66v11m	40v	66v11m	40v	66v11m	40v
01.01.2056- 31.12.2056	67v	40v	67v	40v	67v	40v

MOSHA DHE PERIUDHA E SIGURIMIT QË KËRKOHEË NË VITE PËR SECILËN
KATEGORI

GRUAJA

	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
Vitet	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
1993	45	15	50	20	55	20
1994	45	15	50	21	55	21
1995	46	16	51	22	55	22
1996	46	17	51	23	55	23
1997	47	18	52	24	55	24
1998	47	19	52	25	55	25
1999	48	20	53	26	55	26
2000	48	21	53	28	55	28
2001	49	22	54	30	55	30
01.07.2002 - 30.06.2003	49	23	54	32	55v 6m	32
01.07.2003 - 30.06.2004	50	24	55	34	56v	34
01.07.2004 - 30.06.2005	50	25	55v 6m	35	56v 6m	35
01.07.2005 - 30.06.2006	51	26	56v	35	57v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	51	27	56v 6m	35	57v 6m	35
01.07.2007 - 30.06.2008	52	28	57v	35	58v	35
01.07.2008 - 30.06.2009	52	29	57v 6m	35	58v 6m	35
01.07.2009 - 30.06.2010	53	30	58v	35	59v	35
01.07.2010 - 30.06.2011	53	31	58v 6m	35	59v 6m	35
01.07.2011 - 30.06.2012	54	32	59v	35	60v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	54	33	59v 6m	35	60v	35
01.07.2013 - 30.06.2014	55	34	60v	35	60v	35
01.07.2014 - 31.12.2014	55v 6m	35	60v	35	60v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	56v	35	60v 2m	35v4m	60v2m	35v4m
01.01.2016 - 31.12.2016	56v 6m	35	60v4m	35v8m	60v4m	35v8m
01.01.2017 - 30.12.2017	57v	35	60v6m	36v	60v6m	36v
01.07.2018 - 30.06.2018	57v 6m	35	60v8m	36v4m	60v8m	36v4m
01.01.2019 - 31.12.2019	58v	35	60v10m	36v8m	60v10m	36v8m
01.01.2020 - 31.12.2020	58v 6m	35	61v	37v	61v	37v
01.01.2021 - 31.12.2021	59v	35	61v2m	37v4m	61v2m	37v4m
01.01.2022 - 31.12.2022	59v 6m	35	61v4m	37v8m	61v4m	37v8m
01.01.2023 - 31.12.2023	60v	35	61v6m	38v	61v6m	38v
01.01.2024 - 31.12.2024	60v4m	35v6m	61v8m	38v4m	61v8m	38v4m
01.01.2025 - 31.12.2025	60v8m	36v	61v10m	38v8m	61v10m	38v8m
01.01.2026 - 31.12.2026	61v	36v6m	62v	39v	62v	39v
01.01.2027 - 31.12.2027	61v4m	37v	62v2m	39v4m	62v2m	39v4m

01.01.2028 - 31.12.2028	61v8m	37v6m	62v4m	39v8m	62v4m	39v8m
01.01.2029 - 31.12.2029	62v	38v	62v6m	40v	62v6m	40v
01.01.2030 - 31.12.2030	62v4m	38v6m	62v8m	40 v	62v8m	40v
01.01.2031 - 31.12.2031	62v8m	39v	62v10m	40v	62v10m	40v
01.01.2032 - 31.12.2032	63v	40v	63v	40v	63v	40v
01.01.2033- 31.12.2033	63v 2m	40v	63v 2m	40v	63v 2m	40v
01.01.2034- 31.12.2034	63v 4m	40v	63v 4m	40v	63v 4m	40v
01.01.2035- 31.12.2035	63v 6m	40v	63v 6m	40v	63v 6m	40v
01.01.2036- 31.12.2036	63v 8m	40v	63v 8m	40v	63v 8m	40v
01.01.2037- 31.12.2037	63v10m	40v	63v10m	40v	63v10m	40v
01.01.2038- 31.12.2038	64v	40v	64v	40v	64v	40v
01.01.2039- 31.12.2039	64v2m	40v	64v2m	40v	64v2m	40v
01.01.2040- 31.12.2040	64v4m	40v	64v4m	40v	64v4m	40v
01.01.2041- 31.12.2041	64v6m	40v	64v6m	40v	64v6m	40v
01.01.2042- 31.12.2042	64v8m	40v	64v8m	40v	64v8m	40v
01.01.2043- 31.12.2043	64v10m	40v	64v10m	40v	64v10m	40v
01.01.2044- 31.12.2044	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2045- 31.12.2045	65v2m	40v	65v2m	40v	65v2m	40v
01.01.2046- 31.12.2046	65v4m	40v	65v4m	40v	65v4m	40v
01.01.2047- 31.12.2047	65v6m	40v	65v6m	40v	65v6m	40v
01.01.2048- 31.12.2048	65v8m	40v	65v8m	40v	65v8m	40v
01.01.2049- 31.12.2049	65v10m	40v	65v10m	40v	65v10m	40v
01.01.2050- 31.12.2050	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2051- 31.12.2051	66v2m	40v	66v2m	40v	66v2m	40v
01.01.2052- 31.12.2052	66v4m	40v	66v4m	40v	66v4m	40v
01.01.2053- 31.12.2053	66v6m	40v	66v6m	40v	66v6m	40v
01.01.2054- 31.12.2054	66v8m	40v	66v8m	40v	66v8m	40v
01.01.2055- 31.12.2055	66v10m	40v	66v10m	40v	66v10m	40v
01.01.2056- 31.12.2056	67v	40v	67v	40v	67v	40v

2. I siguruari ka të drejtë të marrë pension pleqërie në kushtet e kategorisë së parë ose të dytë, pasi ka plotësuar në këtë kategori jo më pak se $\frac{3}{4}$ e viteve të sigurimit. I siguruari që ka plotësuar vitet e sigurimit, sipas tabelës së mësipërme, nga të cilat jo më pak se $\frac{1}{2}$ ka punuar në nëntokë, ka të drejtë të marrë pension në kushtet e kategorisë së parë.

Neni 93

Për nënat me shumë fëmijë

(Zëvendësuar fjalë dhe ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

Nënat që kanë lindur 6 ose më shumë fëmijë, të cilët janë rritur më shumë se 8 vjeç, marrin pensionin e pleqërisë, kur kanë plotësuar moshën 55 vjeç dhe kanë vjetërsi në punë si vijon:

Vitet	Vitet e sigurimit
1993	15
1994	16
1995	17
1996	18
1997	19
1998	20
1999	21
2000	22
2001	24
2002	26
2003	28
2004	30

Në rastet kur si vjetërsi pune, sipas kësaj tabele, kërkohet të njihet edhe vjetërsia si ish-anëtar i kooperativës bujqësore, dhe data e fillimit të pensionit është nga data 1.1.2015 e në vazhdim, masa e pensionit llogaritet sipas neneve 32 dhe 96, të këtij ligji.

Neni 94

Për kategoritë e punës

Dalja më parë në pension nga koha e caktuar në këtë Ligj për grupe të veçanta punonjësish (si minatorë etj) mund të kontraktohet nëpërmjet sigurimit suplementar të pensioneve, sipas një skeme të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 95

Pensioni i pjesshëm

(Shtuar një paragraf pas paragrafit të dytë me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; ndryshuar neni me ligjin nr. 8889, datë 25.04.2002; ndryshuar tabela me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

Mosha dhe periudha e sigurimit për pension të pjesshëm pleqërie, deri në arritjen e moshës dhe plotësimin e periudhës së sigurimit, që përcaktohet në nenin 34 të këtij ligji, rriten sipas tabelës që vijon:

MOSHA DHE PERIUDHA E SIGURIMIT QË KËRKOHEN NË VITE PËR PËRFITIMIN E PENSIONIT TË PJESSHËM TË PLEQËRISË

Vitet	Mosha për burrat	Vitet e sigurimit për burrat	Mosha për gratë	Vitet e sigurimit për gratë
1993	60	12v 6m	55	10v
1994	60	12v 6m	55	10v 6m
1995	60	13v	55	11v
1996	60	13v 6m	55	11v 6m
1997	60	14v	55	12v
1998	60	14v 6m	55	12v 6m
1999	60	15v	55	14v
2000	60	15v 6m	55	15v
2001	60	16v	55	16v
01.07.2002 - 30.06.2003	60v 6m	17v	55v 6m	17v

01.07.2003 - 30.06.2004	61v	18v 6m	56v	18v 6m
01.07.2004 - 30.06.2005	61v 6m	15 v	56v 6m	15 v
01.07.2005 - 30.06.2006	62v	15 v	57v	15 v
01.07.2006 - 30.06.2007	62v 6m	15 v	57v 6m	15 v
01.07.2007 - 30.06.2008	63v	15 v	58v	15 v
01.07.2008 - 30.06.2009	63v 6m	15 v	58v 6m	15 v
01.07.2009 - 30.06.2010	64v	15 v	59v	15 v
01.07.2010 - 30.06.2011	64v 6m	15 v	59v 6m	15 v
2011 e në vazhdim	65v	15 v	60v	15 v

Pensioni i pjesshëm jepet në raport me vjetërsinë në punë, që kërkohet në vitin përkatës.
Për pensionet me datë fillimi nga 01.01.2015 e në vazhdim ky nen nuk zbatohet.

Neni 96

(Hequr dhe zëvendësuar fjalët në paragrafin e parë me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; ndryshuar neni me ligjin nr. 8392, datë 02.09.1998; zëvendësuar fjalia në paragrafin 3 me ligjin nr. 8575, datë 03.02.2000; ndryshuar neni me ligjin nr. 9377, datë 21.04.2005; ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014; shtuar paragraf i gjashtë me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

Personat, që krahas periudhës së sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, kanë dhe jo më pak se gjysmën e periudhës së sigurimit, që kërkohet në vitin përkatës, sipas nenit 92 të këtij Ligji, në marrëdhënie pune me shtetin, përfitojnë pension pleqërie, sipas dispozitave të këtij ligji, ndërsa pension invaliditeti e pension familjar, përfitojnë kur kanë jo më pak se gjysmën e periudhës së sigurimit, që parashikojnë, respektivisht nenet 35 e 40 të këtij ligji.

Në rastet e tjera, pensioni mujor i pleqërisë do të përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. Shuma bazë caktohet nga Këshilli i Ministrave, ndërsa shtesa që iu jepet këtyre personave do të jetë 1përqind për çdo vit sigurimi, nga data 01.10.1993 e në vazhdim, shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar, që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve.

Të vetëpunësuarve në bujqësi, që plotësojnë kushtet për pension, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund t'u njihen periudhat e së kaluarës, si periudha sigurimi kundrejt pagesës së kontributeve, sipas masës së kontributeve të përcaktuara për vitin kur kryhet pagesa, por jo për periudhat para datës 1.10.1993.

Kushtet për pension janë ato të përcaktuara në Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

Periudha e sigurimit, për të cilën është derdhur kontribut, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, njihet vjetërsi pune në marrëdhënie me shtetin, për efekt të zbatimit të këtij neni.

Për personat, të cilëve e drejta për përfitim u lind në datën 1.1.2015 e në vijim dhe kanë periudha sigurimi në ish-kooperativat bujqësore, si dhe periudha të tjera në marrëdhënie pune me shtetin, apo periudha sigurimi pas vitit 1994, për llogaritjen e pensioneve të pleqërisë do të zbatohen nenet 31, 32, 92 dhe 93, të këtij ligji, ndërsa për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare do të zbatohen nenet 35, 36, 40 dhe 41, të këtij ligji.

Neni 97

(Shtuar paragraf pas paragrafit të parë me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; shtuar fjalët në paragrafin e tretë me ligjin nr. 8889, datë 25.04.2002)

Gratë që deri me 31 dhjetor 1994 kanë punuar në punët e kategorisë së parë dhe të dytë dhe që kanë plotësuar jo më pak se 23 vjet në këto profesione, me kërkesën e tyre marrin pension të parakohshëm në masën 60 për qind të pagës mesatare mujore që nxirret nga shuma e përgjithshme e pagave të marra gjatë 3 vjetëve rresht brenda 10 vjetëve të fundit të punës.

Punonjësit e nëntokës që janë në marrëdhënie pune në nëntokë me 01.01.1995, dhe kanë plotësuar periudhën e sigurimit sipas nenit 92 të këtij ligji, pavarësisht nga mosha, me kërkesë të tyre marrin pension të parakohshëm në masën 60 për qind të pagës mesatare mujore që nxirret nga shuma e përgjithshme e pagave të marra gjatë 3 vjetëve rresht, brenda 10 vjetëve të fundit të punës. Afati i paraqitjes së kërkesës për këtë pension është deri në datën 31.12.1995. Pensioni nuk mund të jetë më i lartë se kufiri maksimal i pensionit të pleqërisë.

Me arritjen e moshës së pensionit sipas nenit 92, marrin pensionin e plotë.

Pensioni i parakohshëm nuk mund të jetë më i lartë se pensioni maksimal i pleqërisë.

Neni 98

(Shtuar paragraf me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; shfuqizuar paragrafi i parë me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

Këshilli i Ministrave mund të vendosë që pensionistët e punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat gjatë periudhës së tranzicionit të tërheqin pensionin mujor të pleqërisë dhe të derdhin kontribut për kohën që kryejnë veprimtari ekonomike.

PJESA IX DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 99

(Shtuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014)

Ligjet, dekretet, vendimet, udhëzimet dhe çdo dispozitë tjetër që bie ndesh me këtë ligj shfuqizohen.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda vitit 2014, të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 100

Ky ligj hyn në fuqi me 1 tetor 1993.

Shpallur më dekretin nr. 542, datë 03.06.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

VENDIM
Nr. 161, datë 11.04.1994

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE
SHOQËRORE

(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1022, datë 9.7.2008, dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 264, datë 7.5.2014)

Në mbështetje të nenit 78 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Ministrit të Punës, Emigracionit e Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e "Statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore", që i bashkëngjitet këtij vendimi.
 2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 3.9.1992 "Për miratimin e statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore", shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

STATUTI
I INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

KREU I
KRIJIMI DHE VENDI

Neni 1
(Ndryshuar me VKM nr. 1022, datë 9.7.2008)

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është institucion publik, i pavarur. Organizimi dhe funksionimi i këtij instituti, që më poshtë do të quhet ISSH, rregullohen me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 2
(Ndryshuar me VKM nr. 1022, datë 9.7.2008)

ISSH-ja është person juridik, shqiptar, me qendër në Tiranë, dhe përbëhet nga drejtoria qendrore, drejtoritë rajonale dhe agjencitë lokale të sigurimeve shoqërore, që veprojnë në të gjithë vendin.

KREU II
FONDET THEMELORE, BURIMET E FORMIMIT DHE PËRDORIMI I TYRE

Neni 3

ISSH-ja administron fondin e sigurimeve shoqërore në mënyrë të pavarur. Të ardhurat realizohen dhe shpenzimet kryhen sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Neni 4
(Ndryshuar me VKM Nr. 1022, datë 9.7.2008)

Fondi i ISSH-së administrohet në pesë degë të veçanta:

- Dega e sigurimit për sëmundje;
- Dega e sigurimit për barrë lindje;
- Dega e sigurimit për pensione;
- Dega e sigurimit për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale;
- Dega e sigurimit të papunësisë.

Llogaria e sigurimeve shoqërore mbahet në Bankën e Shqipërisë, ndërsa llogaria e shpenzimeve administrative mbahet në llogari të veçantë.

Transferimet për pagesën e kontributeve e të shpenzimeve administrative lejohen vetëm me ligjin e buxhetit.

Neni 5
(Ndryshuar me VKM nr. 1022, datë 9.7.2008)

ISSH-ja krijon një fond rezervë, të barabartë me shumën e pagesave që nevojiten për të përballuar të paktën 3 muaj shpenzimet për pensione.

ISSH-ja krijon një fond rezervë, të barabartë me shumën e pagesave, që nevojiten për të përballuar, të paktën 3 muaj, shpenzimet për pensione.

Fondi rezervë mbahet në një llogari të veçantë.

KREU III
VEPRIMTARIA E INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Neni 6
(Ndryshuar me VKM nr. 1022, datë 9.7.2008)

Veprimtaria e Institutit të Sigurimeve Shoqërore përfshin:

- i) arkëtimin e detyrimeve, që rrjedhin nga derdhja e kontributit të punëmarrësve, punëdhënësve dhe të të vetëpunësuarve;
- ii) pagimin e përfitimeve të sigurimeve, sipas dispozitave ligjore;
- iii) investimin e fondit rezervë, me qëllimin rritjen e tij."

Neni 7
(Ndryshuar me VKM nr. 1022, datë 9.7.2008)

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nëpërmjet drejtorive rajonale dhe agjencive lokale, kryen veprime për sigurimin shoqëror.

Drejtoritë rajonale caktojnë pensionet, në bazë të dokumenteve të paraqitura nga personat e interesuar.

Përfitimet afatshkurtra për të punësuarit caktohen dhe paguhen nga punëdhënësit e tyre dhe, pas miratimit, rimbursohen nga drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore dhe agjencitë e sigurimeve shoqërore.

Përfitimet afatshkurtra për të vetëpunësuarit dhe pensionet e të gjitha llojeve paguhen nga agjencitë paguese financiare, të specializuara, për llogari të fondeve të sigurimeve shoqërore, sipas marrëveshjeve, që lidhen, ku përcaktohet edhe masa e komisionit.

Neni 8

ISSH-ja, për shërbimet që u bëhen personave të siguruar, mban shpenzimet e kryera të barabarta me vlerën e materialit të shpenzuar nga ky institucion.

KREU IV KONTABILITETI DHE BILANCI I ISSH-së

Neni 9

Viti financiar i ISSH-së është vit kalendarik, 1 janar deri më 31 dhjetor.

Neni 10

(Ndryshuar me VKM nr. 1022, datë 9.7.2008)

ISSH-ja mban regjistrat dhe librat, në përputhje me ligjin për kontabilitetin, manualin kontabël, miratuar nga Ministria e Financave, si dhe rregulloren financiare, miratuar nga këshilli administrativ.

Neni 11

(Ndryshuar me VKM: nr. 1022, datë 9.7.2008; nr. 264, datë 7.5.2014)

ISSH-ja përgatit raportin dhe llogaritë financiare në fund të çdo viti financiar, si dhe harton projektbuxhetin e vitit ushtrimor. Ato përfshijnë bilancin, llogaritë e të ardhurave e të shpenzimeve dhe evidencat e tjera përkatëse. Raporti vjetor dhe programi i veprimtarisë së ardhshme financiare miratohen nga këshilli administrativ i ISSH-së dhe i paraqiten, çdo vit, nëpërmjet ministrit përgjegjës për çështjet e sigurimeve shoqërore Këshillit të Ministrave.

Neni 12

(Ndryshuar me VKM nr. 1022, datë 9.7.2008)

1. Këshilli administrativ, pas miratimit të buxhetit, miraton ndarjen e buxhetit, sipas drejtorive rajonale.

2. Në përbërje të ISSH-së ngrihet njësia e auditimit të brendshëm, e cila auditon veprimtarinë e strukturave të saj jo më pak se një herë në dy vjet. Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm emërohet/shkarkohet me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe me miratimin e këshillit administrativ. Drejtuesi i njësisë raporton periodikisht dhe sipas kërkesave të këshillit.

Neni 10

ISSH-ja mban regjistrat dhe librat në përputhje me ligjin dhe rregulloren financiare.

Neni 11

ISSH-ja përgatit raportin dhe llogaritë financiare në fund të çdo viti financiar, si dhe harton planin financiar të vitit ushtrimor. Ato përfshijnë bilancin, llogaritë e të ardhurave e të shpenzimeve dhe evidencat e tjera përkatëse. Raporti vjetor dhe programi i veprimtarisë së ardhshme financiare miratohen nga këshilli administrativ i ISSH-së dhe i paraqiten çdo vit, nëpërmjet Ministrit të Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Këshilli administrativ miraton komisionin e kontrollit për revizionimin e veprimtarisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Zyrat rajonale kontrollohen nga sektori i kontroll-revizionit në ISSH, kurse agjencitë nga sektori i kontroll-revizionit të zyrave rajonale; revizioni kryhet në përputhje me rregulloren financiare të ISSH-së.

KREU V DREJTORI DHE ADMINISTRIMI I ISSH-së

Neni 13

(Shfuqizuar me VKM nr. 1022, datë 9.7.2008)

Neni 14

Këshilli administrativ zgjedh me votim të fshehtë kryetarin dhe 2 nënkryetarët, të cilët drejtojnë veprimtarinë e këshillit.

Kryetari zgjidhet nga 6 përfaqësuesit e ministrive, kurse 2 zëvendëskryetarët një nga sindikatat dhe një nga punëdhënësit.

Neni 15

Këshilli administrativ mbledhet jo më pak se 4 herë në vit.

Neni 16

Mbledhja e këshillit administrativ thirret nga kryetari, nga dy nënkryetarët e tij dhe nga drejtori i përgjithshëm i ISSH-së. Ky i fundit ka të drejtë të mbledhë këshillin administrativ kur interesat e ISSH-së kërkojnë vendime të shpejta, që nuk janë në kompetencë të tij.

Neni 17

Mbledhja e këshillit administrativ njoftohet me shkrim të paktën 10 ditë përpara, duke bërë të ditur edhe rendin e ditës. Kur mbledhja e këshillit administrativ thirret nga drejtori i përgjithshëm i ISSH-së, mund të mos zbatohen kriteret e mësipërme.

Neni 18

Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm dy të tretat e anëtarëve, duke përfshirë së paku një përfaqësues të punëdhënësve dhe të sindikatave si anëtarë të këshillit administrativ. Vendimet merren me shumicë votash.

Nëse shumica nuk arrihet, mbledhja shtyhet për ditën tjetër, duke bërë edhe njëherë njoftimin e pjesëmarrësve. Për mbledhjen e përsëritur do të jetë e nevojshme gjysma e anëtarëve, duke përfshirë një përfaqësues nga punëdhënësit dhe një nga sindikata. Megjithatë, vendimet merren vetëm me dy të tretat e votave.

Neni 19

Për mbledhjet e këshillit administrativ mbahet procesverbal. Kryetari autorizon një person të përhershëm për mbajtjen e tij.

Vendimet e këshillit administrativ nënshkruhen nga kryetari ose një nga nënkryetarët dhe depozitohen në drejtorinë e ISSH-së.

Neni 20

Vendimet e këshillit merren me shumicë absolute votash.

Anëtari i këshillit administrativ ka të drejtën e një vote.

Në rastet kur votat barazohen, vendos vota e kryetarit të këshillit administrativ.

Neni 21

(Shfuqizuar me VKM nr. 1022, datë 9.7.2008)

Neni 22

Anëtarët e këshillit administrativ hiqen nga detyra kur:

a) dënohen për vepra penale;

b) japin dorëheqjen;

c) marrin pjesë ose ndihmojnë në korrupsion;

ç) janë të paaftë për kryerjen e detyrës.

Neni 23

Anëtarët e këshillit administrativ të ISSH-së marrin një shpërblim për pjesëmarrje, masa e të cilit caktohet nga vetë këshilli administrativ.

Neni 24

(Shfuqizuar me VKM nr. 1022, datë 9.7.2008)

Drejtori i përgjithshëm i ISSH-së zgjidhet nga këshilli administrativ i ISSH-së. Ai përfaqëson ISSH-në dhe drejton veprimtarinë e tij.

Përgjigjet për administrimin dhe raporton çdo vit për veprimtarinë e ISSH-së në këshillin administrativ.

Shfuqizuar.

Neni 25

(Shfuqizuar me VKM nr. 1022, datë 9.7.2008)

Neni 26

(Shfuqizuar me VKM nr. 1022, datë 9.7.2008)

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 27

ISSH-ja ka të drejtë të lëshojë udhëzime, urdhëresa dhe akte të tjera administrative, në mbështetje të akteve ligjore dhe kompetencave që janë dhënë.

Neni 28

(Ndryshuar me VKM nr. 1022, datë 9.7.2008)

ISSH-ja ka të drejtë të bashkëpunojë dhe të lidhë marrëveshje a të kryejë veprimtar i të përbashkëta me institucione homologe, vendase ose të huaja, në fushën e sigurimeve shoqërore.

Marrëveshjet me karakter ekonomik, para nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm, si përfaqësues i ISSH-së, i paraqiten, paraprakisht, këshillit administrativ, për miratim.

Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë të bashkëpunojë dhe të lidhë marrëveshje a të kryejë veprimtari të përbashkëta me institucione homologe, vendase ose të huaja, në fushën e sigurimeve shoqërore, vetëm pas miratimit të këshillit administrativ.

Neni 29

ISSH-ja ka të drejtën e depozitimit, të përdorimit dhe investimit të mjeteve të tij financiare në bazë të ligjit, rregullores financiare dhe vendimeve të këshillit administrativ.

Neni 30

Nga veprimtaria e ISSH-së caktohet një fond në lekë e në valutë që përdoret për pagesat e kuotacionit të anëtarësisë në ISSA për seminare, kurse e specializime brenda e jashtë vendit, si dhe për pajisje për pritje e përcjellje delegacionesh e specialistësh të huaj, madhësia e të cilave caktohet nga këshilli administrativ.

Neni 31

ISSH-ja ka stemën dhe vulën e tij me shenjat e stemës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 32

Për problemet që nuk janë të përcaktuara në këtë statut, rregullimi do të bëhet me vendim të këshillit administrativ, brenda kompetencave që lejojnë dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 33

Ky statut hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Këshilli i Ministrave dhe i shtrin efektet që nga data e krijimit të ISSH-së.

VENDIM

Nr. 262, datë 7.5.2014

PËR PËRZGJEDHJEN E ORGANIZATAVE TË PUNËDHËNËSVE DHE TË SINDIKATAVE MË TË PËRFAQËSUARA NË KËSHILLIN ADMINISTRATIV TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “b” e “c”, të pikës 1, të nenit 72, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizatat e punëdhënësve dhe sindikatat më të përfaqësuar, që do të përzgjidhen për në Këshillin Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, janë si më poshtë vijon:

A) Për punëdhënësit:

- | | |
|--------------------------------------|------------------|
| - Biznes Albania | një përfaqësues; |
| - Shoqata e Bizneseve të Ushqim-Pije | një përfaqësues; |
| - Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë | një përfaqësues. |

B) Për sindikatat:

- Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë
(KSSH) një përfaqësues;

- Bashkimi i Sindikatave të Pavarura
(BSPSH) një përfaqësues;

- Sindikata Autonome Ushqim,
Tregtisë, Turizmit një përfaqësues.

2. Vendimi nr. 702, datë 10.11.2005, i Këshillit të Ministrave, “Për përzgjedhjen e organizatave të punëdhënësve dhe të sindikatave më të përfaqësuara në Këshillin Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 263, datë 7.5.2014

**PËR CAKTIMIN E FUNKSIONEVE TË PËRFAQËSUESVE TË
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE NË PËRBËRJE TË KËSHILLIT
ADMINISTRATIV TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 72, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Funksionet e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 72, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në përbërje të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, janë si më poshtë vijon:

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	ministër;
Ministria e Financave	Zëvendësministër (që mbulon veprimtarinë e të ardhurave);
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Pronës Publike;
Ministria e Shëndetësisë	drejtor i përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
Ministria e Drejtësisë	drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit;
Instituti i Statistikave	drejtor i përgjithshëm

2. Vendimi nr. 562, datë 12.8.2005, i Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e funksioneve të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore në përbërje të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen institucionet e përmendura në pikën 1 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 120, datë 17.2.2016

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE (CMIS)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi është krijimi i bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të kontributeve, e quajtur CMIS.

2. CMIS-i administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

3. Përbërësit e arkitekturës *software* dhe *hardware* të sistemit miratohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues.

4. Të dhënat që përmban sistemi ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen ato që grumbullohen nga vetë kjo bazë të dhënash, të cilat përfshijnë:

- periudhën kontributive;
- kërkesat për sigurim (numrin dhe datën);
- periudhën e siguruar (periudha, datat);
- shumën e derdhur e të vetësiguruarve.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen ato që merren nga baza të tjera të dhënash, të dhëna referenciale nga regjistri i Gjendjes Civile dhe regjistri i Tatimeve:

- numrin e identifikimit NID;
- emri;
- mbiemri;
- atësia;
- emri i nënës;
- datëlindja;
- vendlindja;
- mbiemri i vajzërisë;
- ZGJC_CODE;
- punëdhënësi;
- periudha e siguruar;
- shuma e derdhur.

5. Dhënës të informacionit janë:

a) qytetarët, përfitues të skemave;

b) drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore;

c) Drejtoria e Tatimeve;

ç) baza e të dhënave të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile.

6. Niveli i aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave të CMIS-it është, si më poshtë vijon:

a) Qytetarët kanë vetëm të drejtë të marrin informacion, duke patur mjet identifikimi;

b) Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka të drejta të plota administrative mbi bazën e të dhënave dhe sistemin, në rolet:

- i) administrator;
- ii) raportues;
- iii) auditues;
- iv) zhvillues.

c) Subjektet e tjera, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave, mund të kenë akses në nivelin raportues apo statistikor, për të monitoruar apo për të raportuar.

7. CMIS-i ndërvepron me bazën e të dhënave të RKGJC-së dhe të DPT-së vetëm me të dhënat parësore.

Proceset e punës në bazën e të dhënave të CMIS-it përcaktohen me rregullore të brendshme ose me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të ISSH-së, në përputhje me rregullat e miratuara në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”.

8. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe strukturat në varësi të tij për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 122, datë 17.2.2016

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT, TË KALKULIMIT DHE PAGESËS SË PËRFITIMIT (PCAMS)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit, të kalkulimit dhe pagesës së përfitimeve, të quajtur PCAMS.

2. PCAMS-ja administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

3. Përbërësit e arkitekturës, *software* dhe *hardware* të sistemit, miratohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues.

4. Të dhënat që përmban sistemi ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen ato të dhëna të cilat grumbullohen nga vetë kjo bazë të dhënash dhe përfshijnë:

- periudhën kontributive;
- dokumentet e nevojshme të skanuara;
- kërkesat për caktim pensioni (numrin dhe datën);
- kërkesat për rishqyrtim pensioni (numrin, datën dhe arsyen);
- kërkesat për transferim pensioni (numrin, datën);
- llojin e pensionit;
- masën e pensionit;
- datën e fillimit të pensionit;
- pikën paguese të pensionit.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që merren nga baza të tjera të dhënash dhe përfshijnë të dhënat referencare nga regjistri i Gjendjes Civile, si: numrin e identifikimit, emrin, mbiemrin, atësinë, emrin e nënës, vendlindjen, datëlindjen, mbiemrin e vajzërisë, ZGJC_CODE.

5. Subjektet përgjegjëse të PCAMS-së janë si më poshtë vijon:

- a) Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- b) Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore përkatëse;

- c) Degët e sigurimeve shoqërore;
- ç) Agjencia Rajonale e Sigurimeve Shoqërore përkatëse.
- 6. Dhënës të informacionit janë:
 - a) Qytetarët të cilët plotësojnë kushtet për përfitim;
 - b) Drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore;
- 7. Niveli i aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave të PCAMS-së është, si më poshtë vijon:
 - a) Qytetarët kanë të drejtë të marrin informacion vetëm duke pasur një mjet identifikimi;
 - b) Shërbimi social ka vetëm të drejtë të lexojë dhe të marrë informacion për çdo individ që është në bazën e të dhënave;
 - c) Institucionet që kryejnë pagesat kanë vetëm të drejtë të lexojnë dhe të kryejnë pagesat;
 - ç) Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka të drejta të plota administrative mbi bazën e të dhënave dhe sistemin në rolet e:
 - i) administratorit;
 - ii) raportuesit;
 - iii) audituesit;
 - iv) zhvilluesit.
 - d) Subjektet e tjera, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave, mund të kenë akses në nivelin raportues apo statistikor për të monitoruar apo për të raportuar.
- 8. PCAMS-ja ndërvepron me bazën e të dhënave të RKGJC-së vetëm me të dhënat parësore.
- Proceset e punës në bazën e të dhënave të PCAMS-së përcaktohen me rregullore të brendshme ose me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në përputhje me rregullat në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”.
- 9. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe strukturat në varësi të tij për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM Nr.761, datë 19.11.2004

PËR KRIJIMIN E ARKIVIT QENDROR PËR SISTEMIMIN, RUAJTJEN DHE SHFRYTËZIMIN E DOKUMENTACIONIT TË PERIU DHËS SË SIGURIMIT PRANË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE (ndryshuar me vendimin nr.727, datë 28.5.2008)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 shkronja “c” e 3 të nenit 9 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e arkivit qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
Rrjeti i këtij arkivi të shtrihet në drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore.
2. Drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore të mbledhin, brenda datës 30.4.2009, dokumentacionin e periudhës së sigurimit për ndërmarrjet dhe institucionet, buxhetore e jobuxhetore, që kanë ndërprerë veprimtarinë, si dhe për ndërmarrjet që, për arsye të reformës, ushtrojnë veprimtari të kufizuar.
3. Ndërmarrjet dhe institucionet, buxhetore e jobuxhetore, që do ta mbyllin veprimtarinë apo do ta kufizojnë atë pas datës 30.6.2005, detyrohen të dorëzojnë dokumentacionin e periudhës së sigurimit të punonjësve të tyre në drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore.

4. Në këtë dokumentacion përfshihen regjistrat themeltarë, listëpagesat dhe çdo dokument tjetër që ka lidhje me periudhën e sigurimit ose prej të cilave burojnë të drejta nga sigurimet shoqërore.

5. Regjistrat themeltarë të dorëzohen në drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore pasi dokumentacioni i periudhës së sigurimit të punonjësve të jetë përditësuar plotësisht, duke përputhur listëpagesat me regjistrat themeltarë dhe librezat e punës. Regjistrat themeltarë të mbyllen për çdo person.

Drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore, para marrjes në dorëzim të këtij dokumentacioni, të numërtojnë, kontrollojnë dhe konfirmojnë saktësinë për çdo fletë të regjistrave themeltarë të vjetërsisë në punë.

6. Ndërmarrjet që zhvillojnë veprimtari të kufizuar, para se të dorëzojnë dokumentet e periudhës së sigurimit, ku është e gjithë periudha e punës, që nga krijimi, të hapin regjistra themeltarë të rinj vetëm për punonjësit që kanë në punë.

7. Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë të gjitha masat për marrjen në dorëzim të dokumentacionit të periudhës së sigurimit nga fondkrijuesit dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit për sistemimin dhe ruajtjen e këtij dokumentacioni.

8. Dokumentacioni i periudhës së sigurimit të punonjësve të ndërmarrjeve shtetërore, ish-kooperativave bujqësore, institucioneve, i cili deri më tani është administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, të dorëzohet brenda datës 30.4.2009 pranë strukturave të rrjetit të arkivit qendror të dokumenteve të periudhës së sigurimit.

9. Ngarkohen ministratë që kanë në varësi subjektet e përcaktuara në këtë vendim, Ministria e Financave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e këtij vendimi.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të ndjekin procedurat për kalimin në përgjegjësi administrimi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore të mjediseve të gatshme, ku ndodhet dokumentacioni i periudhës së sigurimit.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të përcaktojnë një program pune për kalimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit.

12. Vendimi nr.464, datë 22.7.1998 i Këshillit të Ministrave “Për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të sigurimit të punonjësve të ish-kooperativave bujqësore, ndërmarrjeve dhe institucioneve që kanë ndërprerë veprimtarinë e tyre ose janë në procesin e mbylljes” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 482, datë 29.6.2016

**PËR DISA ÇËSHTJE TË DOKUMENTIMIT TË PERIUDHAVE TË SIGURIMIT
DHE VJETËRSISË NË PUNË, PËR EFEKT PENSIONI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 91/1, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të njihen vjetërsi pune për efekt pensioni periudhat e punës të kryera nga personat e punësuar në ish-ndërmarrjet shtetërore dhe vitet e punës të ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore, sipas dokumentimit në regjistrat e vjetërsisë në punë, në rastet kur të gjitha fletët e regjistrit ose vite pune të veçanta në të gjitha fletët e regjistrit janë të dokumentuara me laps.

2. Në rastet kur vjetërsia e punës ose elemente të veçanta të fletës individuale të regjistrit janë të plotësuara me laps dhe nga strukturat e sigurimeve shoqërore nuk gjendet mundësia për të provuar saktësinë e tyre në mënyrë indirekte me dokumente të tjera administrative, saktësia e të dhënave të regjistrit ose vërtetimi i fakteve bëhet me vendim të gjykatës.

3. Në rastet kur rubrika të veçanta të fletëve individuale të regjistrave të vjetërsisë në punë janë të paplota, evidentojnë fillimin por jo mbarimin e periudhës së punës, nuk janë të shkruara dukshëm ose kanë germa të rishkruara, janë të dëmtuara fizikisht ose të padallueshme për shkak të periudhës së gjatë nga data e krijimit të fondit arkivor, mungojnë elemente të veçanta të identifikimit të personit ose janë të shkruara me shkurtime dhe, për rrjedhojë, me të dhënat e fletës së regjistrit nuk mund të provohet e gjithë periudha e sigurimit ose pjesë të saj, të kërkuara dhe dokumentuar nga personi i interesuar, strukturat përgjegjëse të Institutit të Sigurimeve Shoqërore marrin në konsideratë të dhëna të tjera dokumentare, të prodhuara nga organe shtetërore, të cilat indirekt i shërbejnë vërtetimit dhe plotësimit të periudhave të sigurimit.

4. Në zbatim të pikës 3 të këtij vendimi, për dokumentimin e vjetërsisë në punë, për efekt pensioni, përveç të dhënave të dokumentuara në librezën e punës, në regjistrat e vjetërsisë në punë, në listëpagesat apo borderotë dhe vërtetimet e lëshuara nga ndërmarrjet dhe institucionet me objekt vërtetimin e vjetërsisë në punë, si dokumente alternative plotësuese do të shërbejnë edhe të dhënat e regjistrave themeltarë të punonjësve, indekset e regjistrave të vjetërsisë në punë, librat kontabël me të dhënat individuale të pagave mujore, vendime të organeve shtetërore qendrore, lokale dhe të ndërmarrjeve e institucioneve, për emërimet, transferimet, kualifikimet, ngritjen në pagë apo kalimin nga një detyrë në tjetrën, si dhe dokumente të tjera shtetërore, që mund të gjenden në dosjet personale të punonjësve dhe që i shërbejnë këtij qëllimi. Saktësimi i periudhave të sigurimit nëpërmjet dokumenteve dhe të dhënave të tjera arkivore bëhet me vendime të komisioneve të posaçme. Rregullat e funksio-nimit dhe procedurat administrative të punës së komisioneve përcaktohen me vendim të Këshillit Administrativ të ISSH-së, i ngritur në zbatim të neneve 72, 73, dhe 74, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Në rastet kur dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit, të evidentuara në pikën 4, të këtij vendimi, janë të djegura ose janë bërë të papërdorshme për shkak të kushteve të papërshtatshme të ruajtjes, vërtetimi i vjetërsisë në punë dhe periudhave të sigurimit bëhet vetëm në gjykatë. Për të gjitha rastet kur strukturat e sigurimeve shoqërore nuk kanë argumente apo prova dokumentare të veçanta që të vërtetojnë të kundërtën e përcaktimeve në vendimet e gjykatave të shkallës së parë, vendimet e tyre nuk apelojnë dhe vjetërsia në punë, e dokumentuar në këto vendime, është e vlefshme për caktimin e pensioneve.

6. Instituti i Sigurimeve Shoqërore merr të gjitha masat, që, brenda 6 muajve nga data e këtij vendimi, të skanojë dhe të evidentojë në një bazë të dhënash të veçantë të gjitha periudhat e sigurimit të evidentuara me laps, si dhe certifikimin me komision të përmbajtjes së tyre.

7. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 837, datë 28.12.2005

**PËR INFORMIMIN E KONTRIBUESVE DHE TË PËRFITUESVE NGA SKEMA
E DETYRUESHME E SIGURIMEVE SHOQËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 62/1 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Instituti i Sigurimeve Shoqërore informon kontribuesit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për kontributet e paguara nga ai ose për llogari të tij, për periudhën nga 1 janari 2006 e në vazhdim.

Informacioni të përmbajë të dhëna për kontributet vjetore, në total, si dhe të ndara në muaj. Formulari-tip i informacionit për kontributet e ndryshme të sigurimeve shoqërore miratohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore informon pensionistët për përfitimet e caktuara dhe të paguara, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, për periudhën nga 1 janari 2006 e në vazhdim.

Informacioni të përmbajë të dhëna për masën e përgjithshme të përfitimit dhe për elementet e saj përbërëse. Formulari-tip i informacionit për përfitimet e caktuara dhe të paguara miratohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

3. Informacioni të bëhet, çdo vit në mënyrë të alternuar, një vit për kontribuesit dhe një vit për përfituesit, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit në vazhdim.

4. Kontribuesit e vetëpunësuar dhe ata punëdhënës informohen drejtpërdrejt nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

5. Kontribuesit e punësuar informohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet punëdhënësve të tyre.

6. Pensionistët informohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nëpërmjet agjencive dhe/ose zyrave të pagesës së pensioneve.

7. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.787, datë 26.11.2003

PËR ZBATIMIN E FAZËS SË KATËRT TË NGUSHTIMIT TË DIFERENCAVE
NË MASEN E PENSIONEVE
(ndryshuar me VKM nr. 318, datë 13.5.2005)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara deri në datë 30.6.1991, sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", që në datë 1.7.2003 kanë mase pensioni nga 6728 leke deri në 10 751 leke në muaj, dhe që vazhdojnë të paguhen pas datës 1.12.2003, shtohen me shuma fikse nga 93 leke deri në 684 leke në muaj.

Shuma individuale e pensionit, e rillogaritur sipas kësaj pike, paraqitet në tabelën "A", që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara në periudhën nga 1.7.1991 deri në 30.9.1993, sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", që në datë 1.7.2003 kanë mase pensioni nga 6 983 leke deri në 10 767 leke në muaj dhe që vazhdojnë të paguhen pas datës 1.12.2003, shtohen me shuma fikse nga 252 leke deri në 684 leke në muaj.

Shuma individuale e pensionit, e rillogaritur sipas kësaj pike, paraqitet në tabelën "B", që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Pensionet e plota të pleqërisë të caktuara në periudhën 1.1.1993 deri në 31.12.1996, sipas neneve 31 dhe 32 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", dhe që vazhdojnë të paguhen pas datës 1.12.2003, ndryshohen si me poshtë vijon:

a) Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara në periudhën nga 1.10.1993 deri në 31.12.1993, me mase pensioni në këtë periudhë nga 1286 leke deri në 3840 leke në muaj, dhe që pas datës 1.12.2003 kanë mase pensioni nga 6793 leke deri në 10 768 leke në muaj, shtohen me shuma fikse nga 103 leke deri në 676 leke në muaj.

b) Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara në periudhën 1.1.1994 deri në 30.9.1994, me mase pensioni në këtë periudhë nga 3366 leke deri në 3840 leke në muaj, dhe që pas datës 1.12.2003 kanë mase pensioni 10 768 leke në muaj, shtohen me shuma fikse nga 147 leke deri në 676 leke në muaj.

c) Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara në periudhën nga 1.10.1994 deri në 30.9.1995, me mase pensioni në këtë periudhë nga 3647 leke deri në 4120 leke në muaj dhe që pas datës 1.12.2003, kanë mase pensioni 10 768 leke në muaj, shtohen me shuma fikse nga 105 leke deri në 675 leke në muaj.

ç) Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara në periudhën nga 1.5.1995 deri në 30.9.1995, me mase pensioni në këtë periudhë nga 3993 leke deri në 4400 leke në muaj, dhe që pas datës 1.12.2003 kanë mase pensioni 10 768 leke në muaj, shtohen me shuma fikse nga 107 leke deri në 678 leke në muaj.

d) Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara në periudhën nga 1.10.1995 deri në 31.3.1996, me mase pensioni në këtë periudhë nga 4401 leke deri në 4928 leke në muaj, dhe që pas datës 1.12.2003 kanë mase pensioni 10768 leke në muaj, shtohen me shuma fikse nga 63 leke deri në 679 leke në muaj.

dh) Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara ne periudhën nga 104.1996 deri ne 31.12.1996, me mase pensioni ne këtë periudhe nga 5421 leke deri ne 6500 leke ne muaj, dhe qe pas datës 1.12.2003 kane mase pensioni 10 766 leke ne muaj, shtohen me shuma fikse nga 56 leke deri ne 679 leke ne muaj.

Shuma individuale e pensionit, e rillogaritur sipas kësaj pike, paraqitet ne tabelat "C" (përkatësisht Ca, Cb, Cc, Cd, Ce, Cf), qe i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara sipas neneve 31 dhe 32 të ligjit nr.7703, date 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore ne Republikën e Shqipërisë", në periudhën nga 1.1.1997 deri më datë 31.12.1998, dhe qe vazhdojnë të paguhën pas datës 1.12.2003, ndryshohen si me poshtë vijon:

a) Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara ne periudhën nga 1.1.1997 deri ne 31.1.1998, me mase pensioni ne këtë periudhe nga 3302 leke deri ne 6500 leke ne muaj, dhe qe pas datës 1.12.2003 kane mase pensioni nga 6838 leke deri ne 12 789 leke ne muaj, shtohen me shuma fikse nga 111 leke deri ne 764 leke ne muaj.

b) Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara në periudhën nga 1.2.1998 deri më 31.12.1998, me mase pensioni ne këtë periudhe nga 4061 leke deri ne 8000 leke ne muaj, dhe qe pas datës 1.12.2003 kane mase pensioni nga 6 834 leke deri ne 12 790 leke ne muaj, shtohen me shuma fikse nga 107 leke deri ne 140 leke ne muaj.

Shuma individuale e pensionit, e rillogaritur sipas kësaj pike, paraqitet ne tabelat "D" (përkatësisht Da, Db) qe i bashkëlidhen këtij vendimi.

5. Pensionet e plota të invaliditetit, të caktuara sipas ligjit nr.4171, date 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore ne Republikën Popullore të Shqipërisë", deri ne date 30.9.1993, qe vazhdojnë të paguhën pas datës 1.12.2003, dhe qe ne date 1.7.2003 kane mase pensioni:

a) 9876 leke ne muaj, shtohen ne shuma fikse nga 100 leke deri ne 1559 leke ne muaj;

b) 7467 leke deri ne 9638 leke ne muaj shtohen ne shuma fikse nga 105 leke deri ne 1 789 leke ne muaj.

Shuma individuale e pensionit, e rillogaritur sipas kësaj pike, paraqitet ne tabelat "E" (përkatësisht Ea, Eb), qe i bashkëlidhen këtij vendimi.

6. Efektet financiare, qe rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten ne shumën 60000000 (gjashtëdhjetë milionë) leke ne muaj.

Për vitin 2003, efektet financiare llogariten ne shumën 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) leke dhe përballohen nga fondi rezerve i Këshillit të Ministrave.

M	69	69.1	69.10	Aktivitete juridike (ligjore)	Noter	73,800	73,800	68,634	64,944	61,254	
M	69	69.1	69.10	Aktivitete juridike (ligjore)	Përmbaarues	62,600	52,300	48,639	46,024		
M	69	69.1	69.10	Aktivitete juridike (ligjore)	Ndërmjetës në një proces gjyqësor	62,600	52,300	48,639	46,024		
M	69	69.2-70.2	69.2-70.22	Aktivitete të llogarive dhe konsulencës	Konsulent/këshillues në fushën ekonomike, fiskut, sigurimeve, si kontabilist, ekonomist, jurist, inxhinier, këshillues fiskal dhe profesione të fushave të tjera.	73,800	62,600	58,218	55,088		
M	69	69.2	69.20	Aktivitete të llogarive dhe konsulencës	Ekspert kontabël i regjistruar	73,800	62,600	58,218	55,088	51,958	
M	69	69.2	69.20	Aktivitete të llogarive dhe konsulencës	Kontabilist i miratuar	62,600	62,600	58,218	55,088	51,958	
M	71			Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	Arkitekti	73,800	62,600	58,218	55,088	51,958	
M	71			Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	Inxhinier	73,800	62,600	58,218	55,088	51,958	
M	71			Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	Projektues	73,800	62,600	58,218	55,088	51,958	
M	74	74.9	74.90	Të tjera aktivitete prof. shkenc. teknik	Agronom	62,600	62,600	58,218	55,088	51,958	43,820

M	74	74.3	74.30	Aktivitetet përkthimi dhe interpretimi	Përkthyes	62,600	62,600	58,218	55,088		
M	74	74.3	74.30	Aktivitetet përkthimi dhe interpretimi	Shoqërues dhe shpjegues në udhëtime	52,300	52,300	48,639	46,024		
M	75	75.0	75.00	Aktivitetet veterinarë	Veteriner	62,600	62,600	58,218	55,088	51,958	43,820
P	85			Arsimi	Mësues (mësimdhënës)	58,100	55,100	51,243	48,488	45,733	41,325
P	85			Arsimi	Trajnues në veprimtari të ndryshme përfshirë edhe fushën e kulturës, artit dhe sportit.	62,600	52,300	48,639	46,024	43,409	
Q	86	86.2	86.21	Aktivitetet të mjekëve të përgjithshëm	Mjek i përgjithshëm	65,000	55,000	51,150	48,400	45,650	41,250
Q	86	86.2	86.22	Aktivitetet të mjekëve të specializuar	Mjek i specializuar	73,000	60,000	55,800	52,800	49,800	45,000
Q	86	86.2	86.23	Aktivitetet të dentistëve	Dentist i specializuar dhe dentist	73,000	60,000	55,800	52,800	49,800	
Q	86	86.9	86.90	Shërbime të tjera shëndetësore e kurative”: fizioterapi, qendra estetike ku afrohet shërbim mjekësor, qendra të trajtimit të vartësisë nga droga, qendra balneare, të kujdesit paliativ dhe të tjera	Fizioterapist	66,100	56,100	52,173	49,368		

Shënim. Kur kryhen aktivitetet profesionale në qendrat e bashkive të ndara në kategorinë V ose në zonën rurale të bashkive përkatëse dhe në tabelë nuk ka pagë të përcaktuar, si pagë referuese merret paga e përcaktuar në kategorinë IV, për profesionin përkatës.

Aneksi 3. Kategoria e qendrave të bashkive ku zhvillohet biznesi

			Kategoria e qendrave të bashkive, ku zhvillohet biznesi					Zona rurale e bashkisë përkatëse
Bashkia	Qarku	Qendra e bashkisë	I	II	III	IV	V	
38. Pustec	Korçë	Pustec					x	x
29. Libohovë	Gjirokastër	Libohovë					x	x
45. Fushë-Arrëz	Shkodër	Fushe-Arrëz					x	x
28. Këlcyrë	Gjirokastër	Këlcyrë					x	x
58. Konispol	Vlorë	Konispol					x	x
32. Tepelenë	Gjirokastër	Tepelenë				x		x
3. Poliçan	Berat	Poliçan					x	x
8. Klos	Dibër	Klos					x	x
39. Has	Kukës	Krume					x	x
55. Delvinë	Vlorë	Delvinë					x	x
4. Skrapar	Berat	Çorovodë				x		x
30. Memaliaj	Gjirokastër	Memaliaj					x	x
31. Përmet	Gjirokastër	Përmet				x		x
34. Kolonjë	Korçë	Ersekë				x		x
26. Dropull	Gjirokastër	Jergucat						x
41. Tropojë	Kukës	B. Curri				x		x
57. Himarë	Vlorë	Himarë				x		x
25. Roskovec	Fier	Roskovec						x
13. Belsh	Elbasan	Belsh					x	x
19. Përrenjas	Elbasan	Përrenjas					x	x
54. Vorë	Tiranë	Vorë				x		x
60. Selenicë	Vlorë	Selenice					x	x
18. Peqin	Elbasan	Peqin					x	x
44. Mirditë	Lezhë	Rrëshen				x		x
5. Ura Vajgurore	Berat	Ura Vajgurore					x	x
6. Bulqizë	Dibër	Bulqizë				x		x
9. Mat	Dibër	Burrel				x		x
16. Gramsh	Elbasan	Gramsh				x		x
56. Finiq	Vlorë	Finiq					x	x
52. Rrogozhinë	Tiranë	Rrogozhinë					x	x
17. Librazhd	Elbasan	Librazhd				x		x
12. Shijak	Durrës	Shijak				x		x
23. Mallakastër	Fier	Ballsh				x		x
24. Patos	Fier	Patos				x		x

33. Devoll	Korçë	Bilisht				x		x
14. Cërrik	Elbasan	Cërrik					x	x
49. Vau i Dejës	Shkodër	Vau i Dejës					x	x
20. Divjakë	Fier	Divjakë					x	x
27. Gjirokastrë	Gjirokastrë	Gjirokastrë			x			x
46. Malësi e Madhe	Shkodër	Koplik					x	x
47. Pukë	Shkodër	Pukë				x		x
1. Berat	Berat	Berat			x			x
2. Kuçovë	Berat	Kuçovë				x		x
40. Kukës	Kukës	Kukës			x			x
59. Sarandë	Vlorë	Sarandë			x			x
36. Maliq	Korçë	Maliq					x	x
42. Kurbin	Lezhë	Laç				x		x
7. Dibër	Dibër	Peshkopi			x			x
11. Krujë	Durrës	Krujë				x		x
51. Kavajë	Tiranë	Kavajë			x			x
43. Lezhë	Lezhë	Lezhë			x			x
37. Pogradec	Korçë	Pogradec			x			x
50. Kamzë	Tiranë	Kamzë				x		x
22. Lushnjë	Fier	Lushnjë			x			x
35. Korçë	Korçë	Korçë		x				x
61. Vlorë	Vlorë	Vlorë		x				x
21. Fier	Fier	Fier		x				x
48. Shkodër	Shkodër	Shkodër		x				x
15. Elbasan	Elbasan	Elbasan		x				x
10. Durrës	Durrës	Durrës		x				x
53. Tiranë	Tiranë	Tiranë	x					x

Shënim. Kur vendi i ushtrimit të veprimtarisë ekonomike profesionale, nga profesionet e mësipërme, kryhen në fshatra në juridiksionet sipas bashkive, paga referuese zbritet me 20 % por jo më pak se paga minimale në shkallë vendi.

VENDIM
Nr. 310, datë 24.7.1992

**PËR KOMPENSIMIN PËR FRYMË TË SHPENZIMEVE NGA RRITJA E
ÇMIMEVE TË DISA ARTIKUJVE USHQIMORË**

*(Ndryshuar me vendimet e KM nr. 351, datë 10.08.1992; nr. 440, datë 10.10.1992; nr. 99,
datë 21.02.1995; nr. 167, datë 8.4.1999; nr. 196, datë 09.03.2016)*

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Ministrisë së Punës, Emigracionit, përkrahjes Sociale dhe të të përndjekurve Politike, si dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. T'u jepet një kompensim mujor për frymë:

1. Në masën deri në 280 lekë në muaj:

- a) Të punësuarve në sektorin shtetëror e privat;
- b) Shfuqizuar.

c) Personave që marrin pension sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore" dhe sipas ligjit nr. 4976, datë 20.6.1972 "Për pensionet e anëtareve të kooperativave bujqësore", kur këta të fundit janë me banim të përhershëm në qytet, NB e qendra të banuara (të vërtetuara nga organet e pushtetit, bashkia ose komuna) si dhe atyre që marrin pension familjar, sipas ligjeve të mësipërme, kur janë vetëm ose kur janë kryefamiljarë;

ç) Personave që marrin ndihmë ekonomike, kur janë të vetëm ose kur janë kryefamiljarë sipas dispozitave në fuqi;

Ndihma ekonomike caktohet nga këshilli i bashkisë.

d) Studentëve që përfitojnë bursë, kur janë kryefamiljarë;

e) Shfuqizuar.

2. Në masën 200 lekë në muaj për frymë:

a) Shfuqizuar.

b) Shfuqizuar.

c) Shfuqizuar.

Quhen persona në ngarkim të gjithë ata që janë në regjistrin e familjes dhe që nuk përfitojnë kompensim sipas pikës 1 të kapitullit I. Nuk quhen persona në ngarkim, për efekt të llogaritjes së kompensimeve, ata që janë refugjatë jashtë shtetit ose në emigracion.

II. Nuk përfitojnë kompensim mujor për frymë:

1. Pensionistët që kanë përfituar pension sipas ligjit "për pensionet e anëtareve të kooperativave bujqësore", si dhe pjesetarët e familjes së tyre, që ata kanë në ngarkim sipas pikës 2 të kapitullit të parë të këtij vendimi.

2. Personat që përmenden në pikën 2 të kreut I, kur familja e tyre ka tokë në pronësi ose në përdorim mbi 0,5 dynym për frymë.

3. Të vetëpunësuarit në sektorin privat që nga koha e marrjes së lejes së ushtrimit të profesionit.

4. Personat që janë në ngarkim të pensionistit, i cili është njëkohësisht i vetëpunësuar në sektorin privat, që nga koha e marrjes së lejes së ushtrimit të profesionit.

5. Ushtarët e shërbimit të detyrueshëm.

6. Nxënësit dhe studentët e shkollave ushtarake që marrin pension familjar (nuk përfitojnë kompensim për periudhën e vitit mësimor).

7. Nxënësit dhe studentët që studiojnë jashtë shtetit me bursë të shtetit, të organizatave ndërkombëtare e të shoqërive të ndryshme, për kohën që trajtohen me bursë.

8. Punonjësit që dërgohen jashtë shtetit për studime, specializime, specializime pasuniversitare, ose për të ndjekur kurse të ndryshme mbi 3 muaj. Anëtarët e familjes që ata kanë në ngarkim, trajtohen sipas pikës 2 të kreut I.

9. Personat që janë refugjatë jashtë shtetit ose emigrantë.

III. Për mënyrën e llogaritjes dhe të pagesës së kompensimit për frymë:

1. Për të përfituar këtë kompensim paraqitet deklarata sipas modelit bashkëlidhur. Personi që nuk përcakton të vërtetën në deklaratë ose nuk njofton brënda 15 ditëve për çdo ndryshim të deklaratës, detyrohet të kthejë 20-fishin e kompensimeve të përfituara padrejtësisht, pavarësisht nga ndjekja penale që mund t'i bëhet. Urdhri lëshohet nga drejtuesi i ndërmarrjes ose i institucionit, ku janë marrë kompensimet, dhe është titull ekzekutiv.

2. Kompensimet llogariten nga deklaruesi, së bashku me punonjësën e ngarkuar përkatësisht nga qendra e punës, zyrat e punës, drejtoritë e sigurimeve shoqërore, seksionet e financës dhe shkollat, duke e ndarë ngarkesën në raport të barabartë ndërmjet dy mbajtësve të familjes (që si rregull janë burri dhe gruaja).

3. Pagesa e kompensimit bëhet një herë në muaj nga qendra e punës, nga punëdhënësit shtetërorë e privat, nga zyrat e punës dhe qendrat ku paguhën pensionet, nga seksionet e financës dhe poer bursistet atje ku merret bursa. Kompensimet regjistrohen në kolonë të veçantë në borderotë e pagesave (pagat, pensionet, bursat etj.) dhe jepen në fillim të muajit.

4. Në ndërmarrjet buxhetore dhe në institucionet buxhetore, si dhe për pensionet, përkrahjen sociale e ndihmat ekonomike, fondet për kompensimet e mesipërme përballohen nga Buxheti i Shtetit, duke i dhënë personit kompensim të plotë për vete prej 280 lekësh në muaj, si dhe kompensimin e plotë për personat që atij i takojnë të ketë në ngarkim sipas pikës 2 të kapitullit I.

Ndërmarrjet dhe institucionet jobuxhetore, fondet për kompensim i përballojnë vetë në ngarkim të shpenzimeve të aktivitetit, duke i dhënë personit kompensimet sipas mundësive ekonomike që ato kanë, brenda kufijve të miratuar në pikën 1 e 2 të kreut III përkatësisht deri më 280 lekë dhe deri në 200 lekë në muaj. Kompensimet do të jepen deri në miratimin e studimit të sistemit të pagave, i cili do të marrë në konsideratë rritjen e tyre për efekt të inflacionit.

Punëdhënësit privatë përballojnë kompensimet për të punësuarit në sektorin e tyre.

5. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë të bëjë detajimin e fondeve të miratuara që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për çdo ministri e institucion tjetër qëndror.

6. Për përballimin e vëllimit të punës që krijohet si efekt i zbatimit të këtij vendimi, Institutit të Sigurimeve Shoqërore i shtohen për vitin 1992 një fond page prej 1,2 milion lekë dhe Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të të Përndjekurve Politike i shtohen për vitin 1992 një fond page prej 1,1 milionë lekë.

7. Aparati i Këshillit të Ministrave të organizojë shumëfishimin dhe shpërndarjen e deklaratës brënda muajit gusht të vitit 1992. Për përballimin e shpenzimeve shtohen 1 milionë lekë për shpenzimet buxhetore të vitit 1992.

8. Për zbatimin e menjëhershëm të këtij vendimi, në sektorët ku kompensimi përballohet nga Buxheti i Shtetit, pagesat e kompensimeve të muajit gusht të bëhen në fillim të muajit për personat që përfitojnë sipas pikës 1 të kapitullit të parë të këtij vendimi dhe për një person në ngarkim (në qofte se ka sipas pikës 2 të kapitullit I) pa plotësuar deklaratën përkatëse. Në muajin shtator të plotësohet dokumentacioni i nevojshëm, të bëhen llogaritjet e plota dhe pagesat të jepen nga data e hyrjes në fuqi të vendimit. Përgjatë muajit gusht, në rast se dokumentacioni plotësohet i rregullt sipas kërkesave të këtij vendimi, bëhen llogaritjet për diferencat që mund të lindin. Rekomandimet që edhe në sektorët e tjerë të veprohet si më sipër.

9. Ngarkohet Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Ministria e Punës, Emigracionit, përkrahjes Sociale dhe të përndjekurve Politike, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Banka e Kursimeve të leshojnë udhëzimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 gusht 1992.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

DEKLARATË
PËR PËRBËRJEN FAMILJARE PËR EFEKT TË KOMPENSIMEVE PËR FRYMË TË
SHPENZIMEVE NGA RRITJA E ÇMIMEVE TË DISA ARTIKUJVE USHQIMORË

Deklaroj nën përgjegjësinë personale së familja ime në datën.....përbehet nga këta persona:

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Lidhja me Kryefamiljarin	Datëlindja (dita, muaji, viti)	Qendra e punës ku punojnë	Punësuar në sektor privat ose vetëpunësuar	Disponon tokë familja ose jo	Kompensimit në lekë	Shënime
a	b	1	2	3	4	5	6	7

Llogaritja e kompensimeve për secilën mbajtës
 Numri i mbajtësve (si rregull burri dhe grua);
 Numri i personave të ngarkesës;
 Shuma e kompensimeve të ngarkesës (200x numri rendor 2);
 Ngarkesa për çdo mbajtës (nr. 3: nr.1);
 Kompensimi gjithësej që përfiton mbajtësi (280 + nr. 4).
 Deklaruesi përfiton gjithësej në lekë.....

DEKLARUESI:	PERSONI I NGARKUAR PËR LLOGARITJET E KOMPENSIMIT
Emri, mbiemri	Emri, mbiemri

Shënim:

Çdo i punësuar në punëdhënës shtetëror ose privat, person që merr përkrahje sociale nga zbatimi i reformës ekonomike, pensionisti dhe person i vetëm që është pa të ardhura dhe që merr ndihmë ekonomike, paraqet deklaratën atje ku merr pagën ose përkrahjen sociale, ku i caktohet pensioni ose ndihma ekonomike.

Plotësohet nga vetë deklaruesi për të gjithë përbërjen e familjes, e cila të jetë e njëjte me regjistrimin në gjëndjen civile për kolonat b,1,2.

Në kolonën 3, për personat e tjerë në ngarkim të shënohet për të papunët, “i papunë” ose shkolla ku meson, studion, reparti ku kryen detyrimin ushtarak, ku e merr përkrahjen sociale, pensionin etj.

Deklaruesi në kolonen 4 e 5 shënon “po” apo “jo”.

Kolona 6 plotësohet nga deklaruesi, së bashku me personin e ngarkuar nga qendrat e punës ose me personin e ngarkuar atje ku bëhen pagesat për përkrahjen sociale, ku caktohen pensionet dhe ndihmat ekonomike.

Për çdo ndryshim në përmbajtjen e deklaratës njoftohet brënda 15 ditëve.

Në të gjitha rastet për shumat e marra padrejtësisht deklaruesit, detyrohet të kthejë 200-fishin e kompensimeve të përfituara padrejtësisht, pavarësisht nga ndjekja penale që mund t'i bëhet. Urdhri i lëshuar nga drejtuesi i ndërmarrjes ose i institucionit është titull ekzekutiv.

VENDIM
Nr. 274, datë 12.6.1993

**PËR KOMPENSIMIN PËR FRYMË TË SHPENZIMEVE NGA RRITJA E
ÇMIMIT TË BUKËS**

*(Ndryshuar me vendime të KM nr.98, datë 15.3.1994; nr.99, datë 21.2.1995; nr. 167, datë 8.4.1999;
nr. 195, datë 09.03.2016)*

Me propozimin e Ministrisë së Financave e të Ekonomisë, Ministrisë së Punës,
Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, Ministrisë së Bujqësisë e të
Ushqimit si dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Për efekt të ndryshimit të çmimit të bukës, t'u jepet një kompensim mujor për frymë në masën deri 214 lekë:

1. Të punësuarve në sektorin shtetëror, në sektorin privat, në organizatat politike e shoqërore dhe në shoqata.

2. Personave që marrin përkrahje sociale nga zbatimi i reformës ekonomike.

3. Personave që marrin pension sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore", ligjit nr.4976, datë 20.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", kur janë me banim të përhershëm në qytet, NB e qendra të banuara të vërtetuara nga bashkia ose komuna, si dhe personave që do të marrin pension nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore" (me përjashtim të personave që sipas nenit 96 të këtij ligji nuk plotësojnë kushtet e ligjit nr.4171, datë 13.9.1966).

4. Personave që marrin ndihma ekonomike sipas ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.40, datë 29.1.1993 "Për ndihmën ekonomike për ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë", si dhe sipas pikës 3 të vendimit nr.59, datë 18.3.1983 "Për trajtimin e të huajve që strehohen në Republikën e Shqipërisë".

5. Studentëve dhe nxënësve që përfitojnë bursë.

6. Shfuqizuar.

7. Shfuqizuar.

II. Nuk përfitojnë kompensim mujor për frymë:

1. Pensionistët që kanë përfituar pension sipas ligjit nr.4976, datë 20.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore" si dhe pjesëtarët e familjes së tyre kur janë me banim në fshat.

2. Personat në ngarkim të atyre që përfitojnë sipas kreut I të këtij vendimi, kur familja e tyre ka tokë në pronësi ose në përdorim.

3. Të vetëpunësuarit në sektorin privat që nga koha e marrjes së lejes të ushtrimit të profesionit.

4. Personat që janë në ngarkim të pensionistit ose të të punësuarit, të cilët janë njëkohësisht edhe të vetëpunësuar në sektorin privat që nga koha e marrjes së lejes së ushtrimit të profesionit.

5. Ushtarët e shërbimit të detyrueshëm.

6. Nxënësit dhe studentët e shkollave ushtarake që marrin pension familjar për periudhën e vitit mësimor.

7. Nxënësit dhe studentët që studiojnë jashtë shtetit me bursë të shtetit, të organizatave ndërkombëtare e të shoqërive të ndryshme për kohën që trajtohen me bursë.

8. Punonjësi që dërgohet jashtë shtetit për studime, specializime pasuniversitare ose për të ndjekur kurse të ndryshme mbi 3 muaj. Anëtarët e familjes që ata kanë në ngarkim, trajtohen sipas pikës 1.

9. Personat që janë refugjatë jashtë shtetit ose emigrantë.

10. Personat dhe pjesëtarët e familjes së tyre që kanë në ngarkim, kur refuzojnë marrjen e tokës në pronësi ose në përdorim.

III. Mënyra e llogaritjes dhe e pagesës së kompensimit për frymë

1. Për të përfituar kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimit të bukës vlen e njëjta deklaratë që është përdorur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.310, datë 24.7.1992 "Për kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë". Personi që nuk deklaron të vërtetën ose nuk njofton brenda 15 ditëve, për çdo ndryshim të deklaratës, detyrohet të kthejë 20-fishin e kompensimeve të përfituara padrejtësisht, pavarësisht nga ndjekja penale që mund të bëhet. Urdhri lëshohet nga drejtuesi i ndërmarrjes ose institucionit, ku janë marrë kompensimet dhe është titull ekzekutiv.

2. Ky kompensim llogaritet në kolonë të veçantë në deklaratën e përmendur në pikën 1 të këtij kapitulli nga deklaruesi së bashku me punonjësin e ngarkuar përkatësisht nga qendra e punës, zyrat e punës, drejtoritë e sigurimeve shoqërore, seksionet ose zyrat e financës në rreth, bashkie komuna dhe shkolat duke e ndarë ngarkesën në raport të barabartë ndërmjet dy mbajtësve të familjes (që si rregull janë burri dhe gruaja).

3. Pagesa e kompensimit bëhet një herë në muaj në të njëjtën kohë me kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë. Të dy këto kompensime regjistrohen në kolona të veçanta në borderotë e pagesave (paga, pensione, përkrahje sociale, ndihma, bursa etj.) dhe jepen në fillim të muajit.

4. Në ndërmarrjet shtetërore, institucionet shtetërore jobuxhetore dhe pjesërisht jobuxhetore ky kompensim nuk përfshihet në pagën mesatare mujore për efekt të kontrollit.

5. Fondet për kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimit të bukës përballohen si vijon:

a) Nga Buxheti i Shtetit për ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore buxhetore, për pensionistët, për punonjësit që përfitojnë përkrahje sociale, vetëm për pjesën e ngarkesës që i takon në familje, 214 lekë në muaj për frymë.

Nga Buxheti i Shtetit për ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore jobuxhetore, për personin dhe për pjesën e ngarkesës që i takon në familje për periudhën 1 janar – 31 mars, dhe vetëm për personin e punësuar për periudhën 1 prill - 30 qershor.

Duke filluar nga data 1 korrik, kompensimi nga rritja e çmimit të bukës do të përballohet tërësisht si për personat në punë, ashtu edhe për ngarkesën nga vetë ndërmarrjet dhe institucionet jobuxhetore.

b) Nga punëdhënësit privatë, shoqëritë dhe ndërmarrjet e përbashkëta, bankat, instituti i sigurimeve (INSIG), ndërmarrjet e Ministrisë së Turizmit, organizatat shoqërore dhe shoqatat tërësisht me fondet e tyre, duke i dhënë punonjësit dhe pjesës së ngarkesës që i takon në familje deri në 214 lekë në muaj për frymë.

c) Organizatave politike sipas ligjit të partive u jepet ndihmë financiare shtesë.

6. Efektet financiare prej 2,34 miliardë lekë që përballohen nga Buxheti i Shtetit për vitin 1993, të detajohen nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë për çdo ministri e institucion qendror dhe për organet e pushtetit lokal.

7. Për përballimin e vëllimit të punës që krijohet nga zbatimi i këtij vendimi, Institutit të Sigurimeve Shoqërore i shtohen për vitin 1993 mesatarisht 80 punonjës dhe 3,9 milionë lekë fond page.

8. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë lëshon udhëzim për mënyrën e administrimit të fondeve.

Në çdo bashki e komunë shtohet nga një llogaritar-arkëtar me shtesë fond page gjithsej 4,6 milionë lekë.

Këto fonde përballohen nga Buxheti i Shtetit për vitin 1993.

9. Për zbatimin e menjëhershëm të këtij vendimi për pensionistët pagesa e kompensimit për muajin korrik të vitit 1993 të bëhet në fillim të muajit për vete dhe për ngarkesën, sipas të dhënave të deklaruesit.

Në muajin gusht të vitit 1993 drejtoritë e sigurimeve shoqërore bëjnë llogaritjen e plotë dhe korrigjimet përkatëse për diferencat që mund të lindin nga pagesa e muajit korrik.

IV. Në vendimin nr.310, datë 24.7.1992 "Për kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë", në kreun II pika 10 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 korrik 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr. 138, datë 31.3.1994

**PËR KOMPENSIMIN E SHPENZIMEVE NGA NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE DHE LËNDËVE DJEGËSE**

(Ndryshuar me vendimet e KM nr.202, datë 16.5.1994; nr.320, datë 11.7.1994; nr.560, datë 21.11.1994; nr.115, datë 27.2.1995; nr. 193, datë 09.03.2016)

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. Për efekt të ndryshimit të çmimeve të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse, t'u jepet kompensim mujor:

1. Në masën 600 lekë në muaj:

- familjeve që marrin ndihmë ekonomike të plotë sipas ligjit nr. 7710, datë 18.05.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore".

2. Në masën deri 350 lekë në muaj:

a) Të punësuarve në sektorin shtetëror buxhetor, privat, në shoqëritë e ndërmarrjet e përbashkëta, bankat, INSIG, ndërmarrjet në vartësi të Ministrisë së Turizmit, organizatat politike e shoqërore e në shoqatat.

b) shfuqizuar.

c) Personat që marrin pension sipas ligjit nr. 4171, datë 13.09.1966 "Për sigurimet shoqërore", ligjit nr. 4976, datë 20.06.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", kur janë në banim të përhershëm në qytet, në ish - NB-të e qendra të banuara të vërtetuara nga bashkia ose komuna, si dhe personat që marrin pension nga ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me përjashtim të atyre që sipas nenit 96 të këtij ligji nuk plotësojnë kushtet e ligjit nr. 4171, datë 13.09.1966.

Këtë të drejtë pensionistët e mësipërm e përfitojnë edhe kur janë të punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat.

d) Familjet jobujqësore që marrin ndihmë ekonomike të pjesshme mujore sipas ligjit nr. 7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore".

dh) Familjet bujqësore që marrin ndihmë ekonomike të pjesshme mujore sipas ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", dhe asnjë anëtar i familjes nuk merr kompensim në masën 350 lekë në muaj.

e) Personat që marrin ndihmë ekonomike si të paaftë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.15, datë 24.1.1994 "Për pagesën e ndihmës ekonomike për personat me paaftësi", kur janë të vetëm.

f) Personat që marrin ndihmë ekonomike sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.40, datë 29.01.1993 "Për ndihmën ekonomike për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë", si dhe sipas pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.59, datë 18.03.1993 "Për trajtimin e të huajve që strehohen në Republikën e Shqipërisë.

g) Ushtarakëve që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Në masën 300 lekë në muaj :

- Të punësuarit në sektorin shtetëror jobuxhetor.

4. Në masën 200 lekë në muaj :

- personat që marrin pension sipas ligjit nr. 4976, datë 20.06.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", dhe nuk janë me banim të përhershëm në qytet, në ish-NB- të dhe qendrat e banuara.

5. Në masën 150 lekë në muaj:

- Familjet bujqësore që marrin ndihmë ekonomike të pjesshme sipas ligjit nr.7710, datë 18.05.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", kur një nga anëtarët e familjes merr kompensim sipas pikës 4 të këtij vendimi.

6. Masa e kompensimit për familjet bujqësore të përmendura në germën "dh" të pikës 2 dhe pikës 5 të këtij vendimi, në çdo rast nuk kalon 350 lekë në muaj.

7. Në masën deri në 700 lekë në muaj:

- Familjet të cilat kanë vetëm një person që përfiton kompensim sipas pikës 2, shkronjat "a", "b", "c", "f", si dhe sipas pikës 3, me përjashtim të familjeve bujqësore dhe nuk përfiton ndihmë ekonomike.

8. Për përfitimin e këtij kompensimi nuk merret parasysh ndarja e familjes pas dates 30.06.1993, me përjashtim të rastit kur brenda saj krijohet kurorë e re. Në këtë rast familje konsiderohen prindërit dhe fëmijët që ata kanë në ngarkim, si dhe çdo person tjetër, të cilët bashkëjetojnë ekonomikisht në të njëjtën strehë sipas nenit 3, pika 1 e ligjit nr.7710, datë 18.5.1993.

I/A. Kompensimi i dytë (shtesë) i shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse, duke filluar nga data 1 dhjetor 1994:

1) Në masën 150 lekë në muaj:

a) Të punësuarve në sektorin shtetëror buxhetor që kanë pagën bazë sipas klasës deri në 6700 lekë në muaj (pa shtesat e ndryshme mbi pagën bazë).

b) Personat që përmenden në kreun I, pika 2, shkronjat b,c, dhe pika 4 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 31.03.1994.

c) Ushtarakët që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kur shpërblimi që përfitojnë sipas vendimit të Këshillit të

Ministrave nr.225, datë 29.05.1992, është deri në 6700 lekë në muaj. Kur këta persona punojnë si civilë pranë personave juridikë a fizikë, vendas ose të huaj, dhe paga, së bashku me shpërblimin si ushtarak, është mbi 6700 lekë në muaj, nuk e përfitojnë këtë kompensim.

2) Në masën 300 lekë në muaj:

Familjet, të cilat kanë vetëm një person që përfiton kompensim sipas pikës 1, shkronjat a,b dhe c të këtij vendimi.

3) Efektet financiare prej 124 milionë lekë për periudhën 1 dhjetor deri në 31 dhjetor 1994 përballohen brënda Buxhetit të Shtetit për vitin 1994. Ministria e Financave të bëjë detajimin e fondeve për çdo ministri dhe institucion qendror dhe për organet e pushtetit lokal.

4) Rekomandohet për t'u zbatuar ky vendim edhe për të punësuarit në sektorin shtetëror jobuxhetor, në sektorin privat, në shoqëritë e përbashkëta, banka, INSIG-u, organizatat politike, shoqërore e në shoqata brenda mundësive financiare që ato kanë.

II. Mënyra e pagesës

1. Kompensimi regjistrohet në kolonë të veçantë në borderonë e pagesës (Pagë, pension, pagesë papunësie, ndihmë etj.) dhe jepet në fillim të muajit.

2. Për të përfituar këtë kompensim vlen e njëjta deklaratë që është përdorur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.310, datë 24.07.1992 "Për kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë". Në deklaratë duhet të shtohet numri i kontratës familjare të energjisë elektrike të lidhur me ndërmarrjen elektrike.

Personat, familja e të cilëve nuk ka lidhur kontratë me ndërmarrjen elektrike, nuk e përfitojnë këtë kompensim deri në lidhjen e kontratës.

Personi që nuk deklaron të vërtetën ose nuk njofton brenda 15 ditëve, për çdo ndryshim të deklaratës, detyrohet të kthejë 20-fishin e kompensimeve të përfituara padrejtësisht, pavarësisht nga ndjekja penale që mund të bëhet. Urdhri lëshohet nga drejtuesi i ndërmarrjes ose institucionit, ku janë marrë kompensimet dhe është titull ekzekutiv.

3. Pagesa bëhet:

a) Nga qendra e punës për të punësuarit në sektorin shtetëror buxhetor, jobuxhetor, organizata politike - shoqërore e shoqata.

b) Nga drejtoritë e sigurimeve shoqërore për pensionistët. Bëjnë përjashtim pensionistët invalidë që punojnë në sektorin shtetëror buxhetor, kompensimi i të cilëve do të bëhet nga qendra e punës, dhe pensionistët invalidë që marrin edhe pegasë papunësie, kompensimi i të cilëve do të bëhet nga zyrat e punës.

Nga drejtoritë e sigurimeve shoqërore paguhet edhe kompensimi për personat që marrin ndihmë ekonomike si të paaftë, kur janë të vetëm.

c) shfuqizohet.

d) Nga bashkitë dhe komunat për familjet që marrin ndihmë ekonomike të plotë e të pjesshme.

4. Në ndërmarrjet shtetërore, institucionet shtetërore jobuxhetore dhe pjesërisht, jobuxhetore ky kompensim nuk përfshihet në pagën mesatare mujore për efekt kontrolli.

III. 1. Fondet për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike e lëndëve djegëse përballohen si vijon:

a) Nga Buxheti i Shtetit për ndërmarrjet e institucionet shtetërore buxhetore, si dhe për pensionet, pagesën e papunësisë e ndihmat ekonomike dhe për repartin ushtarak nr.9186 (Kombinati Mekanik në Poliçan).

b) Nga punëdhënësit privatë, shoqëritë e ndërmarrjet e përbashkëta, bankat, INSIG-u, ndërmarrjet në vartësi të Ministrisë së Turizmit, organizatat politike e shoqërore dhe shoqatat.

c) Për ndërmarrjet dhe institucionet jobuxhetore përballohen nga Buxheti i Shtetit deri në masën 300 lekë.

Pagesat sipas pikës 7, kreu I, përballohen nga fondet e vetë ndërmarrjes a institucionit jobuxhetor.

2. Efektet financiare prej 3.5 miliardë lekësh që përballohen nga Buxheti i Shtetit për periudhën prill- dhjetor 1994 të detajohen nga Ministria e Financave për çdo ministri e institucion tjetër qendror dhe për organet e pushtetit lokal.

3. Për përballimin e vëllimit të punës që krijohet nga zbatimi i këtij vendimi, Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 1994 i shtohen 6 milionë lekë fonde page.

4. Familjet që do të kërkojnë të përfitojnë ndihmë ekonomike të pjesshme, në dokumentet e të ardhurave që do të paraqesin, detyrimisht të shënohet edhe masa e kompensimit, nëse përfitohet sipas këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Efektet financiare i shtrín nga data 1 prill 1994 dhe pagesa e kompensimeve fillon pas datës 1 maj 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.471, datë 15.7.1996

**PËR KOMPENSIMIN NGA NDRYSHIMI I ÇMITIT TË BUKËS, VAJGURIT
DHE GAZIT TË LËNGSHËM**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrisë së Bujqësisë e Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Për efekt të ndryshimit të çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm, t'u jepet kompensim:

1. Në masën 250 lekë në muaj:

a) Të punësuarve në sektorin shtetëror e privat, në shoqëritë tregtare, bankat, INSIG, ISSH, ISKSH, organizatat politike e shoqërore dhe në shoqatat.

b) Personave që trajtohen me pagesë nga ARN-ja.

c) Ushtarakëve që kanë dalë në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura.

2. Në masën 150 lekë në muaj:

a) Personave që marrin pension sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1996 "Për sigurimet shoqërore", ligjit nr.4976, datë 20.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", kur janë me banim të përhershëm në qytet, si edhe personave që marrin pension nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me përjashtim të atyre që sipas nenit 96 të këtij ligji nuk plotësojnë kushtet për të përfutur masë pensioni shtetëror.

b) Personave që përfitojnë pagesë paaftësie.

3. Niveli bazë i pagesës së papunësisë dhe niveli maksimal i ndihmës ekonomike të plotë që përfiton familja rritet 12%.

II. Nuk përfitojnë kompensim mujor:

Punonjësit e administratës së lartë shtetërore, shpërblimi i të cilëve bëhet me pagë mujore të fiksuar.

Pensionistët, që kanë përfutur pension sipas ligjit nr.4976, datë 20.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore" dhe ata që kanë përfutur pension sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe sipas nenit 96 të këtij ligji, marrin masë pensioni fshati, kur banojnë në fshat dhe në territorin e ish-ndërmarrjeve bujqësore.

Të vetëpunësuarit në sektorin privat, nga koha e marrjes së lejes së ushtrimit të profesionit.

Punonjësit që dërgohen jashtë shtetit për studime, specializime pasuniversitare ose për të ndjekur kurse mbi tre muaj.

III. Mënyra e llogaritjes dhe e pagesës së kompensimeve:

1. Familjet bujqësore me të ardhura të pamjaftueshme, kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm do ta përfitojnë pranë zyrave të ndihmës dhe përkujdesit shoqëror në komuna, nëse niveli i të ardhurave të tyre përfshihet në kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike.

2. Kompensimet paguhen një herë në muaj në fillim të muajit për muajin korrent dhe regjistrohen në një kolonë të veçantë të listëpagesës.

3. Të ardhurat personale nga kompensimet nuk tatohen.

4. Në ndërmarrjet shtetërore, institucionet shtetërore jobuxhetore dhe pjesërisht jobuxhetore, ky kompensim nuk përfshihet në pagën mesatare për efekte të kontrollit.

IV. Fondet për kompensimin në zbatim të këtij vendimi përballohen:

Nga Buxheti i Shtetit për punonjësit e institucioneve buxhetore, për personat që marrin pension, personat që përfitojnë pension, pagesë papunësie, pagesë paaftësie, ushtarakët e dalë në

lirim nga reforma, personat që trajtohen me pagë nga ARN-ja, si dhe për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike.

Nga vetë subjektet për të punësuarit në shoqëritë tregtare, bankat, INSIG, ISKSH, ISSH, organizatat shoqërore dhe shoqatat.

V. Organizatat politike sipas ligjit të partive u jepet financim shtesë.

VI. Efekti financiar në Buxhetin e Shtetit do të përballohet nga fondi i parashikuar në buxhet për vitin 1996 në zërin "Kontingjencë" prej 400 milionë lekësh, si dhe nga pjesa e subvencionit të diferencës së çmimit të grurit të përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, sipas urdhrit të Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

Ngarkohet Ministria e Financave për të bërë detajimin dhe shpërndarjen e këtij fondi sipas drejtimeve të përdorimit në zbatim të këtij vendimi.

VII. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore hartojnë udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 16 korrik 1996.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.167, datë 8.4.1999

PËR MËNYRËN E CAKTIMIT DHE TË PËRFITIMIT TË SHPËRBLIMIT DHE TË PENSIONIT FAMILJAR NGA PJESËTARËT E FAMILJEVE TË PILOTËVE, QË HUMBASIN JETËN NË PËRMBUSHJEN E DETYRËS GJATË FLUTURIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 5 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pension familjar, në zbatim të nenit 1 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 përfitojnë pjesëtarët e familjeve të pilotëve që humbasin jetën, si dhe ata që e kanë humbur jetën para hyrjes në fuqi të ligjit.

Data e fillimit të pensionit familjar për pjesëtarët e familjeve në ngarkim të pilotëve që kanë humbur jetën, është data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999.

2. Pagë referuese bazë, mujore e muajit më të fundit kalenarik të shërbimit, për efekt të caktimit të masës së pensionit, është paga, sipas funksionit, që zbatohet në datën e fillimit të këtij pensioni.

Paga referuese përbëhet nga:

- paga bazë;
- paga me vjetërsi;
- paga për vështirësi dhe gradë.

3. Fakti i humbjes së jetës së pilotit për shkak të detyrës, gjatë fluturimit, vërtetohet nga ministria përkatëse.

4. Shpërblimin e menjëhershëm, të parashikuar në nenin 3 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 e përfitojnë pjesëtarët e familjeve në ngarkim të pilotëve që humbasin jetën pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

5. Përfitojnë diferenca pensioni familjar, sipas nenit 6 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 vetëm pjesëtarët e familjeve të pilotëve të shpallur "Dëshmor i Atdheut" dhe që në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitojnë pension familjar nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993. Diferenca e pensionit familjar të llogaritet nga data e shpalljes së pilotit "Dëshmor i Atdheut".

Paga për llogaritjen e diferencave të pensionit familjar është paga referuese e pilotit në çastin e shpalljes "Dëshmor i Atdheut", e rritur sipas periudhave përkatëse, me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Efektet financiare në zbatim të këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, për vitin 1999.

Për vitet në vazhdim efektet financiare të programohen në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

7. Caktimi i përfitimeve, në zbatim të ligjit, bëhet me kërkesën e personave të interesuar.

Dokumentacioni për përfitimet e mësipërme caktohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

8. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Mbrojtjes dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

VENDIM

Nr. 703, datë 27.12.2001

PËR SKEMËN E KOMPENSIMIT TË SHPENZIMEVE NGA RITJA E ÇMIMIT TË BUKËS DHE TË DISA ARTIKUJVE USHQIMORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Skema e kompensimeve, që rrjedh nga liberalizimi i çmimit të bukës e të disa artikujve ushqimorë që përfitojnë nga pensionistët, për anëtarët e familjes, në ngarkim të tyre, mbështetur në vendimet nr. 310, datë 24.7.1992, dhe nr. 274, datë 12.6.1993 të Këshillit të Ministrave do të jetë:

a) Në kuptim të këtij vendimi, quhen persona në ngarkim të pensionistëve:

- fëmijët nën moshën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur vazhdojnë shkollën;

- nipat dhe mbesat, kur nuk i kanë prindërit, të cilët bashkëjetojnë me pensionistin dhe janë nën moshën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur vazhdojnë shkollën;

- bashkëshorti, prindërit, njerku e njerka që nuk kanë të ardhura.

b) Përfitojnë kompensime në masën 414 lekë në muaj për çdo person në ngarkim, personat që përfitojnë ose do të përfitojnë sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", dhe ligjit 4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore shtetërore të Republikës së Shqipërisë", me banim të përhershëm në qytet dhe qendra të banuara, të njohura nga organet e pushtetit vendor.

c) Përfitojnë kompensime në masën 414 lekë në muaj, për çdo person në ngarkim, personat që kanë përfituar pension sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore" dhe ata që përfitojnë ose do të përfitojnë pension sipas paragrafit të dytë, të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" me banim të përhershëm në qytet.

ç) Nuk përfitojnë kompensime sipas këtij vendimi, pensionistët që realizojnë të ardhura nga veprimtari ekonomike, (të punësuar, punëdhënës, të vetëpunësuar, ose kur kanë tokë në pronësi, përdorim, pavarësisht nga vendbanimi.

d) Kur më shumë se një person në familje merr pension nga sigurimet shoqërore apo të ardhura nga veprimtari ekonomike, masa e kompensimit që përfitohet sipas pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi përpjestohet ndërmjet tyre.

dh) Kompensimet për efekt të zbatimit të këtij vendimi llogariten dhe administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore pas paraqitjes nga pensionisti të deklaratës personale, të shoqëruar me certifikatën e gjendjes familjare, me vërtetimin nga zyrat e tatim-taksave, se zhvillon ose jo veprimtari ekonomike dhe vërtetimin nga zyrat e regjistrimit të pasurisë për pronësinë mbi tokën.

2. Shkronja "a" e pikës 2 të vendimit nr. 310, datë 24.7.1992 të Këshillit të Ministrave dhe pika 1/7 e vendimit nr. 274, datë 12.6.1993 të Këshillit të Ministrave shfuqizohen.

3. Efektet financiare nga zbatimi i këtij vendimi të përlogariten çdo vit në buxhetin e sigurimeve shoqërore dhe të përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2002.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM **Nr. 401, datë 21.6.2006**

PËR KOMPENSIMIN E TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONISTËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ardhurat mujore të pensionistëve, që marrin pensione të plota pleqërie, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara, në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nuk mund të jenë më pak se 9 240 (nëntë mijë e dyqind e dyzet) lekë.

2. Në kuptim të këtij vendimi, të ardhurat mujore të pensionistit, përfshijnë masën e pensionit të pleqërisë, kompensimin, që jepet sipas vendimeve nr.138, datë 31.3.1994 të Këshillit të Ministrave, "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse" dhe nr.471, datë 15.7.1996 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm".

3. Kompensimi i të ardhurave mujore të pensionistit, deri në kufijtë e pikës 1, të këtij vendimi, të bëhet, si më poshtë vijon:

a) Pensionistëve, që marrin pensione, të plota dhe të pjesshme, pleqërie, të cilët para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kanë të ardhura mujore nga 8 740 (tetë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë deri në 9 239 (nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë) lekë, t'u shtohet shuma fikse individuale deri në 500 (pesëqind) lekë në muaj.

b) Pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme pleqërie, të cilët para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kanë të ardhura mujore nën 8 740 (tetë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë, t'u shtohet shuma fikse 500 (pesëqind) lekë në muaj.

4. Kompensimin shtesë për të ardhurat mujore, të shkronjave "a" e "b" të pikës 2, të këtij vendimi, e marrin edhe pensionistët, që datën e fillimit të pensionit e kanë në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, përfshirë edhe këtë datë.

5. Kompensimet e përfituara sipas këtij vendimi nuk do të jenë objekt ndryshimi, në rastet e rritjes së pensioneve, me vendime të Këshillit të Ministrave.

6. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, për vitin 2006, në shumën 110 milionë lekë, të përballohen nga fond i kontigjencës, i caktuar në pikën 1/3 të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006".

7. Shpenzimet administrative për realizimin e këtij vendimi, që arrijnë vlerën 7.6 milionë lekë, të shtohen: në buxhetin e vitit 2006, miratuar për ISSH-në dhe të përballohen nga fond i kontigjencës, të caktuar në pikën 1/3 të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin Shtetit të vitit 2006".

8. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.11.2006.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr. 565, datë 9.8.2006

PËR MBROJTJEN E SHITESAVE NË NEVOJË, NGA RRIJTJA E ÇMIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

(Ndryshuar me vendim të KM nr.238, datë 7.4.2010)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 1 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin për efekt të rritjes së çmimit të energjisë elektrike, për nivelin e konsumit 200 kw/orë, për:

a) familjet, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, si dhe familjet, që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuar, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-it, sipas pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", kur personi me aftësi të kufizuar është kryefamiljar dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat;

b) kryefamiljarët, që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror, dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat;

c) kryefamiljarët, që përfitojnë pension pleqërie shtetëror, dhe jetojnë të vetëm ose kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura;

ç) familjet e punonjësve buxhetorë, me pagë mujore bruto nën 35 mijë lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të vetëpunësuar në sektorin privat.

2. Kompensimi për familjet, që do të kompensohen sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet vetëm për një kontratë të energjisë elektrike dhe jepet vetëm një herë për një familje, pavarësisht se ato mund të kenë në përbërje edhe të punësuar të tjerë në sektorin buxhetor, që kanë pagë nën 35

mijë lekë, apo persona të paaftë a invalidë, persona që përfitojnë pension pleqërie, invaliditeti apo ndihmë ekonomike.

3. Përfituesit, që kompensohen për të përballuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të përcaktohen nga institucionet përkatëse ku përfituesi merr pagën, pensionin dhe përfitimet e tjera, kundrejt deklaramit personal të përfituesit. Marrja e përfitimit pa deklaram dhe kundrejt deklaramit të rremë përbën shkelje administrative, përkatësisht, për dhënësin dhe për përfituesin e kompensimit. Në këtë rast institucioni përkatës zbaton dispozitat ligjore në fuqi.

4. Përfituesi i kompensimit, në zbatim të pikës 3 të këtij vendimi, detyrohet ta kthejë përfitimin e padrejtë dhe përjashtohet përgjithmonë nga e drejta e përfitimit të kompensimit për energjinë elektrike.

5. *Masa e kompensimit, për çdo përfitues, është 640 (gjashtëqind e dyzet) lekë në muaj. Efekti financiar i shtesës së kompensimit për çdo përfitues të përballohet nga fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2010, për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.*

6. Rregullat e veçanta të përfitimit të pagesës dhe të zbatimit të skemës së kompensimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave, të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.763, datë 27.11.2006

PËR KOMPENSIMIN E TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONISTËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin, deri në 760 (shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë, të të ardhurave mujore të pensionistëve, që marrin pensione pleqërie, pensione invaliditeti dhe pensione familjare, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe të pensioneve të caktuara, në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, që në datë 30.11.2006 janë deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

2. Në kuptim të këtij vendimi, të ardhurat mujore të pensionistit, përfshijnë masën e pensionit të pleqërisë, kompensimin, që jepet sipas vendimeve nr.138, datë 31.3.1994 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, nr.471, datë 15.7.1996 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm” dhe nr.401, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”.

3. Kompensimi i të ardhurave mujore të pensionistit, deri në kufirin e pikës 1 të këtij vendimi, të bëhet, si më poshtë vijon:

a) Pensionistëve, që marrin pensione të plota pleqërie, të cilët para datës 1.12.2006 kanë të ardhura mujore nga 9 240 (nëntë mijë e dyqind e dyzet) lekë deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë, t'u shtohet shuma deri në 760 (shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj dhe, pas kësaj, shuma e të ardhurave mujore arrin 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

b) Pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme pleqërie, të cilët para datës 1.12.2006 kanë të ardhura mujore nën 9 240 (nëntë mijë e dyqind e dyzet) lekë, t'u shtohet shuma deri në 760 (shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj.

Masa individuale e kompensimit llogaritet, duke shumëzuar masën e plotë të kompensimit me masën e pensionit mujor, pjesëtuar me masën e pensionit minimal.

c) Pensionistëve, që marrin pensione të plota invaliditeti dhe pensione të plota familjare, të cilët para datës 1.12.2006 kanë të ardhura mujore nga 8 740 (tetë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë deri në 9 500 (nëntë mijë e pesëqind) lekë, t'u shtohet shuma deri në 760 (shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj.

ç) Pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme invaliditeti dhe pensione të pjesshme familjare, të cilët para datës 1.12.2006 kanë të ardhura mujore nën 8 740 (tetë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë, t'u shtohet shuma deri në 760 (shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj.

Masa individuale e kompensimit llogaritet, duke shumëzuar masën e plotë të kompensimit me masën e pensionit mujor, pjesëtuar me masën e pensionit minimal.

4. Kompensimin shtesë për të ardhurat mujore, të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç” të pikës 3 të këtij vendimi, e marrin edhe pensionistët, që datën e fillimit të pensionit e kanë nga data 1.12.2006 e në vazhdim, përfshirë dhe këtë datë.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, në shumën 154 766 000 (njëqind e pesëdhjetë e katër milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2006.

6. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.12.2006.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.17, datë 20.1.2007

PËR KOMPENSIMIN E TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONISTËVE TË FSHATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ardhurat mujore të pensionistëve, që marrin pensione pleqërie, pensione invaliditeti dhe pensione familjare, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, që në datë 31.12.2006 janë deri në 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj, të kompensohen deri në 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë.

2. Në kuptim të këtij vendimi, në të ardhurat mujore të pensionistit që merr pension fshati përfshihen:

a) Për pensionistin që banon në fshat, masa e pensionit të pleqërisë, të pensionit të invaliditetit, të pensionit familjar, kompensimi, që jepet sipas vendimit nr.138, datë 31.3.1994 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”.

b) Për pensionistin që banon në qytet, masa e pensionit të pleqërisë, e pensionit të invaliditetit, të pensionit familjar, kompensimi, që jepet sipas vendimit nr.138, datë 31.3.1994 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, dhe kompensimi, që jepet në përputhje me vendimin nr.471, datë 15.7.1996 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, për pensionistët e qytetit.

3. Kompensimi i të ardhurave mujore të pensionistit, deri në kufirin e pikës 1 të këtij vendimi, të bëhet, si më poshtë vijon:

a) Pensionistëve, që marrin pensione të plota pleqërie, të cilët para datës 1.1.2007, kanë të ardhura mujore nga 4 310 (katër mijë e treqind e dhjetë) lekë deri në 5 000 (pesë mijë) lekë, t’u shtohet shuma deri në 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj dhe, pas kësaj, shuma e të ardhurave mujore arrin në 5 000 (pesë mijë) lekë.

b) Pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme pleqërie, të cilët para datës 1.1.2007, kanë të ardhura mujore nën 4 310 (katër mijë e treqind e dhjetë) lekë, t’u shtohet shuma deri në 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj.

Masa individuale e kompensimit llogaritet duke shumëzuar masën e pensionit të plotë të kompensimit me masën e pensionit mujor, pjesëtuar me masën e pensionit minimal.

c) Pensionistëve, që marrin pensione të plota invaliditeti dhe pensione të plota familjare, të cilët para datës 1.1.2007 kanë të ardhura mujore nga 4 310 (katër mijë e treqind e dhjetë) lekë deri në 5 000 (pesë mijë) lekë, t’u shtohet shuma deri në 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj dhe pas kësaj, shuma e të ardhurave mujore arrin në 5 000 (pesë mijë) lekë.

ç) Pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme invaliditeti dhe pensione të pjesshme familjare, të cilët para datës 1.1.2007, kanë të ardhura mujore nën 4 310 (katër mijë e treqind e dhjetë) lekë, t’u shtohet shuma deri në 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj.

Masa individuale e kompensimit llogaritet duke shumëzuar masën e pensionit të plotë të kompensimit me masën e pensionit mujor, pjesëtuar me masën e pensionit minimal.

4. Kompensimin shtesë për të ardhurat mujore, të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç” të pikës 3 të këtij vendimi, e marrin edhe pensionistët që datën e fillimit të pensionit e kanë nga data 1.1.2007 e në vazhdim, përfshirë dhe këtë datë.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2007, në shumën 1 344 milion lekë, të përballohen nga buxheti i sigurimeve shoqërore i miratuar për vitin 2007.

6. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.850, datë 21.10.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTËVE TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË
VLERËSIMIT VJETOR, INDIVIDUAL, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË
PENSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve, sipas viteve, të jenë, si më poshtë vijon:

Për vitin 2009	1.00;
Për vitin 2008	1.04;
Për vitin 2007	1.11;
Për vitin 2006	1.04;
Për vitin 2005	1.02;
Për vitin 2004	1.12;
Për vitin 2003	1.10;
Për vitin 2002	1.09;
Për vitin 2001	1.14;
Për vitin 2000	1.07;
Për vitin 1999	1.09;
Për vitin 1998	1.05;
Për vitin 1997	1.22;
Për vitin 1996	1.09;
Për vitin 1995	1.37;
Për vitin 1994	1.32.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, janë vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2010 dhe përballohen nga buxheti i vitit 2010, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.642, datë 11.6.2009 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIGJ¹
Nr.9136, datë 11.9.2003

**PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE
SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 9164, datë 18.12.2003, 9329, datë 6.12.2004, nr.9933, datë 26.6.2008, nr.
10/2012, datë 9.2.2012, 87/2014, datë 17.7.2014, nr. 143/2015, datë 17.12.2015, ndryshuar me
vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 60, datë 16.9.2016, aktin normativ
nr. 1, datë 25.1.2017)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj rregullon mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shëndetësore.

Neni 2
Përkufizime

(Ndryshuar me ligjin nr. 87/2014, datë 17.7.2014)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Kontribute të detyrueshme të sigurimeve shëndetësore” janë kontributet që paguhën në mbështetje të nenit 5, të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. “Kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore” janë kontributet që paguhën në mbështetje të neneve 9 dhe 13, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. “Kontribute” janë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe, pagesat e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe pagesat e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore.

¹ Ligji nr.9136, datë 11.9.2003 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84/2003.

Ligji nr. 9164, datë 18.12.2003 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105/2003.

Ligji nr. 9329, datë 6.12.2004 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 103/2004.

Ligji nr.9933, datë 26.6.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 112/2008.

Ligji nr. 10/2012, datë 9.2.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 12/2012.

Ligji nr. 87/2014, datë 17.7.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126/2014.

Ligji nr. 143/2015, datë 17.12.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 244/2015.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 60, datë 16.9.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 172/2016.

Akti normativ nr. 1, datë 25.1.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 11, datë 27 janar 2017.

4. “Numri i sigurimit shoqëror” është “Numri personal”, që ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 8951, datë 10.10.2002, “Për numrin e identitetit të shtetasve”, të ndryshuar.

5. “Organe tatimore” janë, sipas rastit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe drejtoritë rajonale tatimore.

6. “Paga bruto” është paga që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. “Person i detyruar për të paguar kontribute” është çdo person që detyrohet të paguajë kontributet e detyrueshme, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

8. “I vetëpunësuar” është një tatimpagues i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe në organet tatimore si “person fizik”. I vetëpunësuar mund ta ushtrojë veprimtarinë ekonomike me këto statuse: “i vetëpunësuar i vetëm”, “i vetëpunësuar me punëmarrës”, “i vetëpunësuar me punëmarrës dhe punonjës të papaguar të familjes”, “i vetëpunësuar pa punëmarrës me punonjës të papaguar të familjes”. Në kuptim të kësaj pike, termi “i vetëpunësuar” nuk përfshin personin e vetëpunësuar në bujqësi.

9. “Punëdhënës” dhe “persona të punësuar” kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

10. “Shkalla e kontributeve” janë përqindjet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të vendosura me ligjet nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

11. “Punonjës i papaguar i familjes” është anëtar i familjes në moshën e përcaktuar në legjislacionin përkatës në fuqi për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, që punon e bashkëjeton ligjërisht me të vetëpunësuarin.

Neni 3

Përgjegjësia për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme

Kontributet mbliidhen nga organet tatimore për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore.

Neni 4

Transferimi i kontributeve

Procedurat për transferimin e kontributeve dhe të kamatëvonesave të mbledhura, sipas përcaktimit në këtë ligj, nga organet tatimore në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Njoftimi

Organet tatimore u japin Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Institutit të Statistikave (INSTAT) të dhënat përkatëse për mbledhjen e kontributeve. Forma dhe përmbajtja e këtyre të dhënave, si dhe kushtet dhe afatet për dhënien e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II PROCEDURAT

Neni 6

Detyrimet e personave që paguajnë kontributet

(Ndryshuar pika 3, me ligjin nr. 143/2015, datë 17.12.2015 dhe aktin normativ nr. 1, datë 25.1.2017)

1. Personi i detyruar për të paguar kontributet është përgjegjës për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e kontributeve në kohën dhe në masën e duhur.
2. Punëdhënësi është përgjegjës për mbajtjen e kontributeve të punëmarrësit dhe për pagesën në organet tatimore, së bashku me kontributet e punëdhënësit.
3. Personi i vetëpunësuar është përgjegjës për pagesën e kontributit edhe për punonjësit e papaguar të familjes.

Neni 7

Regjistrimi i të punësuarve në organin tatimor

(Ndryshuar me ligjin nr. 10/2012, datë 9.2.2012, shtuar fjalë në fund të paragrafit të parë, me ligjin nr. 143/2015, datë 17.12.2015 dhe aktin normativ nr. 1, datë 25.1.2017)

Personat juridikë ose fizikë, brenda dy ditëve pune pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në administratën tatimore, deklarojnë në organin tatimor listën e të punësuarve, pagën përkatëse, përfshirë për personin fizik edhe punonjësit e papaguar të familjes mbi 16 vjeç, me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht.

Për personat fizikë të vetëpunësuar pa punëmarrës dhe pa punonjës të papaguar të familjes mbi 16 vjeç, me të cilët ai punon dhe bashkëjeton ligjërisht, pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në administratën tatimore, ky deklarim në organin tatimor bëhet të paktën 3 ditë përpara afatit të paraqitjes së deklaratës, siç përcaktohet në nenin 11, të këtij ligji, por llogaritja e detyrimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhet me efekte nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në administratën tatimore.

Neni 8

Llogaritja e kontributeve për punëmarrësin

(Shtuar fjalë me ligjin nr. 10/2012, datë 9.2.2012, ndryshuar me ligjin nr. 87/2014, datë 17.7.2014, ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 143/2015, datë 17.12.2015)

1. Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera, me karakter të përhershëm, që lindin nga marrëdhëniet e punës, brenda një page bruto minimale dhe nivelit maksimal të pagës, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore, që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Kontributet e detyrueshme të sigurimit shëndetësor të punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm që lindin nga marrëdhëniet e punës, e cila nuk mund të jetë më e vogël nga paga minimale e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Neni 9²

Llogaritja e kontributeve për personin e vetëpunësuar dhe punonjës e papaguar të familjes

(Shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 9164, datë 18.12.2003, shtuar fjalë në pikën 1, me ligjin nr. 10/2012, datë 9.2.2012, ndryshuar me ligjin nr. 87/2014, datë 17.7.2014, me ligjin nr. 143/2015, datë 17.12.2015 dhe aktin normativ nr. 1, datë 25.1.2017)

1. Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore për personin e vetëpunësuar, përfshirë punëdhënësin e vetëpunësuar, llogariten si përqindje mbi një pagë bruto, jo më të ulët se paga minimale në shkallë vendi dhe jo më të lartë se paga maksimale, e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore për punonjës të papaguar të familjes llogariten mbi pagën minimale në shkallë vendi, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kontributet e detyrueshme të sigurimit shëndetësor për personin e vetëpunësuar, përfshirë punëdhënësin e vetëpunësuar dhe punonjës të papaguar të familjes, llogariten sipas nivelit të parashikuar si përqindje mbi dyfishin e pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Kur veprimtaria ekonomike e tatimpaguesit fillon, ndërpritet, përfundon apo kalon në regjistrin pasiv gjatë një muaji, llogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore bëhet në bazë të pagës për ditët e punuara për muajin.

Neni 10

Detyrimi për të deklaruar

(Ndryshuar me ligjin nr. 9164, datë 18.12.2003, ndryshuar pikat 2 dhe 3 me ligjin nr. 9329, datë 6.12.2004, ndryshuar me ligjin nr. 10/2012, datë 9.2.2012, nr. 87/2014, datë 17.7.2014)

1. Personi juridik dhe fizik i detyruar për të paguar kontribute, për çdo periudhë, duhet të deklarojë, në formë elektronike, në organin tatimor të dhënat e detyrimeve për kontributet në total dhe për çdo individ.

2. Personat juridikë dhe fizikë që janë të detyruar të paguajnë kontribute deklarojnë, në formë elektronike, në organin tatimor, të dhënat e detyrimeve për kontributet, sipas deklaratës përkatëse, ku, përveç të tjerave, deklarohet për çdo person emri e mbiemri, numri personal, paga, shuma për t'u paguar e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të sigurimeve shëndetësore, si dhe e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

3. Forma, përmbajtja dhe rregullat e deklarimit, në organet tatimore, të kontributeve dhe ndryshimit të numrit të punonjësve, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 11

(Ndryshuar me ligjin nr. 9164, datë 18.12.2003, nr. 9329, datë 6.12.2004, me ligjin nr. 10/2012, datë 9.2.2012, ndryshuar pika 1 dhe 3 me ligjin nr. 87/2014, datë 17.7.2014)

Deklarimet e parashikuara në nenin 10 dhe pagesa e kontributeve bëhen në afatet e mëposhtme:

a) nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër;

² Ndryshimi i ligjit nr. 143/2015, datë 17.12.2015 është shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 60, datë 16.9.2016.

b) nga personat fizikë, përjashtuar personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes si dhe të punësuarit;

c) nga personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 10 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër;

ç) nga personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 10 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes, si dhe të punësuarit.

2. Shfuqizuar.

3. Personi juridik e fizik është i detyruar të deklarojë zyrtarisht, në organin tatimor, çdo punonjës që fillon punë për herë të parë te subjekti apo të punësuar rishtazi pranë tij, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës.

Të larguarit nga puna subjektet duhet t'i deklarojnë zyrtarisht në organin tatimor brenda 10 ditëve kalendarike nga data e largimit. Këto deklarata shërbejnë si deklarime edhe për Inspektoratin Shtetëror të Punës, siç përcaktohet në nenin 22, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006, "Për Inspektoratin e Punës", të ndryshuar, dhe i vihen në dispozicion këtij të fundit nga ana e administratës tatimore në rrugë elektronike.

Neni 12

Vendi i pagesës

1. Kontributet paguhen në bankat, të cilat kanë marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

2. Pagesa në valutë këmbëhet në lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit ditën kur bëhet pagesa.

3. Procedurat për pagesën e kontributeve përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

Neni 13

Rimbursimi i kontributeve të paguara mbi vlerën e duhur

(Shfuqizuar fjalia e dytë e pikës 2 me ligjin nr. 9164, datë 18.12.2003, ndryshuar pika 1, me ligjin nr. 10/2012, datë 9.2.2012)

1. Nëse si rezultat i një kontrolli, konstatimi apo vlerësimi shuma e kontributeve të paguara e tejkalon shumën e llogaritur të detyrimit për kontributin, organi përkatës rimbursion diferencën, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Nëse të gjitha ose pjesë të kontributeve të paguara lidhen me kontributet e punëmarrësit, punëdhënësi është përgjegjës për rimbursimin e punëmarrësve brenda 30 ditëve.

Neni 14

Masat shtrënguese

Nëse kontributet nuk paguhen në kohë, organi përkatës ka të drejtë të marrë masa shtrënguese, në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 15

Mbajtja e regjistrimeve

(Ndryshuar me ligjin nr. 10/2012, datë 9.2.2012)

Punëdhënësi duhet të mbajë regjistrime për periudhën e marrëdhënieve të punës dhe shumat e paguara në para ose si përfitime në natyrë, për çdo punëmarrës, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Punës dhe me vendim të Këshillit të Ministrave. Këto regjistrime u vihen në dispozicion punonjësve të autorizuar të administratës tatimore sa herë që kërkohet prej tyre.

Tatimpaguesi duhet të vendosë në listëpagesë numrin personal të çdo punonjësi. Tatimpaguesi i jep çdo punëmarrësi një formular me të dhënat, të ndara sipas muajve, për pagën, kontributet dhe tatimin e paguar gjatë periudhës së punësimit brenda një viti kalendarik.

KREU III KONTROLLI

Neni 16

Kontrolli i organeve tatimore

1. Organet tatimore kanë të drejtë të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklaratat dhe pagesat e kontributeve të detyrueshme janë të plota dhe të sakta.

2. Për ushtrimin e kontrollit organet tatimore kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime si ato të kontrollit tatimor, në mbështetje të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 17

Vlerësimi

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10/2012, datë 9.2.2012)

Neni 18

Vlerësimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 10/2012, datë 9.2.2012, nr. 87/2014, datë 17.7.2014)

Kur organet tatimore zbulojnë se kontributet nuk janë llogaritur në masën e duhur, bëjnë vlerësime. Për vlerësimet, mbledhjen e detyrimeve për kontributet, kamatëvonesat e gjobat, si dhe radhën e pagesës së tyre, zbatohen rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar afatin e parashkrimit të detyrimeve.”

KREU IV KAMATËVONESAT DHE GJOBAT

Neni 19

Kamatëvonesat për pagesën e vonuar

1. Nëse kontributet nuk paguhen në kohë, mbahen kamatëvonesa për pagesë të vonuar. kamatëvonesat nuk falen nga asnjë autoritet.

2. Masa e kamatëvonesës për pagesë të vonuar është ajo e përcaktuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 20

Kundërvajtjet administrative dhe gjobat

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 9329, datë 6.12.2004, ndryshuar me ligjin nr.9933, datë 26.6.2008, me ligjin nr. 143/2015, datë 17.12.2015)

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, që përbëjnë kundërvajtje administrative, dhe gjobat përkatëse përcaktohen në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

KREU V APELIMET

Neni 21

E drejta e apelit

1. Çdo person, që detyrohet të paguajë kontribute, gëzon të drejtën e apelit për vlerësimin e kontributit shtesë të kamatëvonesave ose gjobave.
2. Çdo punëmarrës ka të drejtën e apelit për llogaritjen e vlerës së kontributit, të mbajtur nga punëdhënësi.

Neni 22

Procedura e apelit

1. Çdo i punësuar mund të apelojë me shkrim pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore për llogaritjen e shumës së kontributeve të mbajtura nga punëdhënësi.
2. Punëdhënësi dhe personi i vetëpunësuar mund të apelojnë me shkrim në organet tatimore, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 23

Dispozita kalimtare

1. Ky ligj zbatohet ndaj personave, të cilët, me vendim të Këshillit të Ministrave, janë të detyruar të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në organet tatimore.
2. Këshilli i Ministrave përcakton grupet e personave, të cilët detyrohen të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në organet tatimore, si dhe afatet dhe procedurat përkatëse.
3. Të gjitha kontributet, që lindin para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbledhen në përputhje me ligjet nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Personat, të cilët nuk janë të detyruar të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në organet tatimore, do t'i paguajnë këto kontribute në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 24

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4, 5, 8, 9 dhe 23 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzimet përkatëse, në zbatim të neneve 7, 9, 10, 11 dhe 12 të këtij ligji.

Neni 25
Shfuqizime

Çdo dispozitë, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3972, datë 29.9.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ
Nr.9986, datë 11.9.2008

**PËR FALJEN E DETYRIMEVE DOGANORE DHE TATIMORE, TË
DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË TAKSËS VJETORE TË QARKULLIMIT
RRUGOR TË MJETEVE E TË TAKSËS SË REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË
MJETEVE, SI DHE TË GJOBAVE E KAMATËVONESAVE TË PAPAGUARA TË
KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE TË DETYRUESHME SHOQËRORE DHE
SHËNDETËSORE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
FALJA E DETYRIMEVE TATIMORE DHE DOGANORE

Neni 1

Personave fizikë e juridikë, që janë debitorë ndaj administratës doganore dhe administratës tatimore, të evidentuar dhe të kontabilizuar pa vendime administrative përkatëse apo me vendime administrative të panjoftuara brenda afateve ligjore, të parashikuara në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin për procedurat tatimore, u falet detyrimi doganor dhe tatimor, së bashku me komponentët, gjobat dhe kamatëvonesat.

Neni 2

Personave fizikë e juridikë, debitorë ndaj administratës doganore dhe administratës tatimore, që janë aktualisht të evidentuar dhe të kontabilizuar si të tillë në këto dy administrata, për të cilët procedura e evidentimit, marrjes së vendimit administrativ përkatës, si dhe njoftimit të tij

debitorit është bërë në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë dhe ligjit për procedurat tatimore, u falen gjobat dhe kamatëvonesat, me kusht që principlali i detyrimit të paguhet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 3

1. Personave fizikë, individë, debitorë ndaj administratës doganore, për automjetet e importuara, të evidentuara dhe të kontabilizuara deri në datën 31.12.2000, u falet detyrimi doganor, me të gjithë komponentët e tij, si kamatëvonesa, gjoba dhe ditë-qëndrimi.

2. Personave fizikë e juridikë, debitorë ndaj administratës doganore, për automjetet e importuara, të evidentuara dhe të kontabilizuara nga data 1.1.2001 deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, u falen kamatëvonesat, gjobat dhe taksa për ditë-qëndrimi, me kusht që principlali i detyrimit të arkëtohet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 4

Institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve e shoqërive me kapital tërësisht shtetëror, debitorë ndaj administratës doganore dhe administratës tatimore, u falen detyrimi doganor dhe detyrimi tatimor, me të gjithë komponentët, si kamatëvonesa dhe gjoba.

KREU II

FALJA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË TAKSËS VJETORE TË QARKULLIMIT RRUGOR TË MJETEVE DHE TË TAKSËS SË REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE

Neni 5

Taksapaguesve të mjeteve rrugore, debitorë ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për taksën vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve dhe debitorë ndaj njësive të qeverisjes vendore, për taksën e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve, u falen detyrimet e prapambetura me kusht që:

a) pronarët e mjeteve, që nuk janë në qarkullim, të kenë kryer, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, veprimet përkatëse të regjistrimit, sipas nenit 102 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) pronarët e mjeteve, që janë në qarkullim, të kenë kryer, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, veprimet përkatëse të pagesës së detyrimeve, me të gjithë komponentët, për vitin 2008, sipas ligjit nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9632, datë 15.12.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

KREU III

FALJA E GJOBAVE DHE KAMATËVONESAVE TË PAPAGUARA TË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE TË DETYRUESHME SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE

Neni 6

1. Ndërmarrjeve dhe shoqërive me kapital tërësisht shtetëror, institucioneve shtetërore, buxhetore e jobuxhetore, ndërmarrjeve e shoqërive me kapital të përbashkët me shtetin, personave juridikë e fizikë privatë u falen gjobat dhe kamatëvonesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që principlali i kontributit të paguhet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Personave fizikë të vetëpunësuar, të cilët e kanë ndërprerë veprimtarinë ekonomike përpara

datës 31.12.2005 dhe që janë debitorë, të evidentuar dhe të kontabilizuar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, u falen të gjitha detyrimet e papaguara për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, gjobat dhe kamatëvonesat.

3. Personave të vetëpunësuar në bujqësi u falen gjobat dhe kamatëvonesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të papaguara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që principalin e kontributit ta paguajnë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

4. Gjobat dhe kamatëvonesat e papaguara falen edhe kur kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore janë paguar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

KREU IV DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 7

Individët, personat fizikë dhe juridikë, debitorë ndaj administratës doganore e tatimore dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për të cilët ka filluar një procedim penal dhe që në përfundim të tij deklarohen fajtorë, apo detyrimi i të cilëve është përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, ose që e kanë paguar detyrimin, me të gjithë komponentët e tij, nuk janë përfitues të faljes së detyrimeve, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 8

Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë aktet nënligjore për kontabilizimin e të ardhurave, të mbledhura në përputhje me nenet 2, 3, 4 e 6 të këtij ligji dhe për sistemimin e detyrimeve të papaguara të subjekteve debitorë në një llogari kontabël “Detyrimi i keq”.

Neni 9

1. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe njësitë e qeverisjes vendore për sistemimin e detyrimeve të prapambetura, sipas nenit 5 të këtij ligji.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5890, datë 17.9.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 184, datë 29.10.2009

**PËR FALJEN E KAMATËVONESAVE TË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE
TË DETYRUESHME SHOQËRORE, TË PAPAGUARA, TË TË
VETËPUNËSUARVE NË BUJQËSI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

1. Të vetëpunësuarve në bujqësi u falen kamatëvonesat e kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, të papaguara, me kusht që detyrimet e këtyre kontributeve të arkëtohen brenda datës 31.3.2010.

2. Kamatëvonesat e papaguara falen edhe kur kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore janë paguar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 2

Kamatëvonesat e kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, të paguara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kthehen.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6343, datë 17.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr. 66/2015

**PËR FALJEN E GJOBAVE PËR MOSPAGIMIN NË AFAT TË KONTRIBUTEVE
TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NGA
SUBJEKTET JURIDIKE DHE FIZIKE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Falen, në masën 100 për qind, gjobat e lidhura me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë evidentuar deri më 31 dhjetor 2014, në zbatim të neneve 113, “Mosdeklarimi në afat”, pavarësisht vlerës së detyrimit, dhe 114, “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për subjektet juridike dhe fizike, kur kontributi dhe kamatëvonesa është paguar plotësisht deri në datën 30 shtator 2015.

Neni 2

Gjobat për mosdeklarimin dhe mospagimin në afatet ligjore të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, të paguara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kthehen.

Neni 3

Brenda 3 muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, administrata tatimore fshin dënimet administrative, të falura sipas këtij ligji, dhe bën pasqyrimet konkrete të fshirjes në regjistrat e saj.

Listat e subjekteve përfituese dhe vlera e gjobave përkatëse publikohen, brenda 3 muajve, në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 4

Gjobat që janë në proces apelimi administrativ apo në proces gjyqësor falen, sipas përcaktimeve të nenit 1, të këtij ligji, nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 5

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.7.2015

Shpallur me dekretin nr. 9171, datë 14.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 285, datë 4.5.2007

PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS REFERUESE MUJORE, PËR EFEKT TË LLOGARITJES SË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE, DHE TË TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE, SIPAS NOMENKLATURËS SË VEPRIMTARISË EKONOMIKE, PËR TË PUNËSUARIT NË SEKTORIN JOPUBLIK, QË KRYEJNË PUNË, TË PAKUALIFIKUARA E TË KUALIFIKUARA, SI DHE PËR PERSONELIN DREJTUES E TEKNIKO-EKONOMIK TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007” dhe të nenit 36 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kur administrata tatimore vëren se pagat e deklaruara nga punëdhënësit jopublikë, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe të tatimit mbi të ardhurat personale të të punësuarve të tyre, nuk janë reale dhe nuk i përgjigjen vlerës së tregut për shërbimet e punësimit, ajo ka autoritetin t’i rivlerësojë, sipas niveleve të pagave, të dhëna në këtë vendim.

2. Paga referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, si dhe të tatimit mbi të ardhurat personale për të punësuarit në sektorin jopublik, që kryejnë punë të pakualifikuara e të kualifikuara, si dhe për personelin drejtues e tekniko-ekonomik, sipas nomenklaturës së veprimtarive ekonomike dhe të kërkesave të vendit të punës për kualifikim, përcaktohet në seksionet A deri në O dhe në nënndarjet, sipas klasifikimit në tri kategori të rretheve, ku ushtrohet veprimtaria e biznesit (tabelat, që i bashkëlidhen këtij vendimi). Për degët e naftës, hotelerinë dhe peshkimin administrata tatimore mund të zbatojë pagën referuese të pozicionit “Administrator/drejtor i përgjithshëm” të rrethit të Tiranës, për të njëjtin pozicion për subjektet, që ushtrojnë veprimtari në rrethet e kategorisë së dytë e të tretë.

3. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm do të nënkuptohen:

a) “Punë e pakualifikuar apo me kualifikim të ulët” punët, që nuk kërkojnë kualifikim paraprak apo që mund të kryhen nga një punëmarrës, i cili mund të mos e ketë kryer ndonjëherë atë punë. Këtu përfshihen, pa u kufizuar vetëm në to, punë të tilla, si pastrues, korrier, shitës, kamerier, paketues, lavazhier, përgatitës llaçi me krahë, transportues me krahë, punëtor ngarkim-shkarkimi me krahë, punëtor për gjermim toke me krahë, qepës cope e lëkure, si dhe punëtorë për punë të ngjashme.

b) “Punë e kualifikuar” punët apo profesionet, që kërkojnë aftësim profesional dhe që nuk mund të kryhen nga një punëmarrës pa kualifikim paraprak apo që nuk e ka ushtruar ndonjëherë atë punë a profesion. Njohuritë e shprehite e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale në nivelin e punëtorit të kualifikuar, për një specialitet të dhënë, mund të jenë fituar nga punëmarrësi përkatës, nëpërmjet arsimit profesional, kurseve të formimit profesional apo dhe gjatë praktikës. Punëmarrësit, që punojnë në punë të kualifikuara, si:

- Në sektorin e ndërtimit (murator, karpentier, suvaxhi, shtrues pllakash, bojaxhi, betonues, izolues, zdrukthëtar ndërtues, montator, saldator, hidraulik, elektrikist etj., të krahasueshme).

- Në sektorin e industrisë së veshjeve dhe atë të lëkurës e këpucëve (modelist, prestar, lustrues etj., të krahasueshme).

- Në sektorin e prodhimit të mobilieve (modelist, zdrukthëtar, tapicier, mobilist, lustrues etj.).

- Në sektorin e ushqimit social (receptionist, kuzhinier, banakier, pastičier, picier etj., të krahasueshme).

- Në sektorin e medieve (reporter, gazetar, kameraman etj., të krahasueshme).

Nuk mund t'i kryejnë këto punë e profesione, nëse nuk kanë kryer, paraprakisht, një shkollë profesionale, një kurs formimi profesional apo nuk e kanë përfituar këtë profesion gjatë praktikës.

c) "Personel drejtues dhe tekniko-ekonomik", pa u kufizuar vetëm në to, punëmarrësit, që kryejnë detyrën apo funksionin e menaxherit të degës a të njësisë, drejtuesit e degës, njësisë, sektorit, repartit, zëvendësdrejtori, juristi, noteri, avokati, inxhinieri, teknologu, ekonomisti, financieri, agronomi, mjeku, farmacisti, stomatologu, laboranti, lektori, web-masteri, faqosësi, redaktori, specialisti teknik, ekonomik, i shitjeve, blerjeve, përgjegjësi i sektorit, degës, repartit, instruktori etj., të krahasueshme.

ç) "Administrator/drejtor i përgjithshëm", pa u kufizuar vetëm në to, punëmarrës, që kryejnë detyrën apo funksionin e drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv të shoqërisë, të administratorit të përgjithshëm, kryeredaktorit, rektorit, dekanit etj., të krahasueshme.

4. Vendimi nr.42, datë 31.1.2007 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e pagës minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, sipas nomenklaturës së veprimtarisë ekonomike për punëmarrësit e sektorit privat, që punojnë në punë të kualifikuara, si dhe personelin drejtues tekniko-ekonomik të tyre", shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

**STRUKTURA PERMBLEDHESE E EKONOMISE SIPAS
NOMENKLATURES SE VEPRIMTARIVE EKONOMIKE**

SEKSIONI	NENSEKSIONI	PERSHKRIMI	NDARJA
A	AA	BUJQESIA, GJUETIA DHE SILVIKULTURA	01\02
B	BB	PESHKIMI	05
C		INDUSTRIA NXJERRESE	10-14
	CA	NXJERRJA E PRODUKTEVE ENERGJITIKE	10-12
	CB	NXJERRJA E PRODUKTEVE JO ENERGJITIKE	13/14
D		INDUSTRIA PERPUNUESE	15-37
	DA	INDUSTRIA USHQIMORE	15/16
	DB	INDUSTRIA TEKSTILE DHE E VESHJEVE	17/18
	DC	INDUSTRIA E LEKURES DHE E KEPUCEVE	19
	DD	PUNIME ME DRU DHE FAB.I ARTIK.ME DRU	20
	DE	INDUSTRIA E LETRES, KARTONIT, BOTIME	21/22
	DF	KOKSIFIKIMI, RAFINIMI, INDUS.NUKLEARE	23
	DG	INDUSTRIA KIMIKE	24
	DH	INDUSTRIA E KAUÇUKUT DHE PLASTIKES	25
	DI	FABRIKIMI I ART. MINERALE JO METALIKE	26
	DJ	METALURGJIA DHE PERPUNIMI I METALEVE	27/28

	DK	FABRIKIMI I MAKINAVE, PAJISJEVE, PJESE NDRRIMI	29
	DL	FABRIKIMI I PAJISJEVE ELEKTRIKE E ELEKTRONIKE	30-33
	DM	FABRIKIMI I MJETEVE TE TRANSPORTIT	34/35
	DN	INDUSTRI TE TJERA PERPUNUESE	36/37
E	EE	PRODHIMI, SHPERNDARJA E ENERGJISE ELEKTRIKE E GAZIT DHE E UJIT	40/41
F	FF	NDERTIMI	45
G	GG	TREGETIA, RIPARIMI I AUTOMJETEVE DHE ARTIKUJVE SHTEPIAKE	50-52
H	HH	HOTELE DHE RESTORANTE	55
I	II	TRANSPORTI DHE TELEKOMUNIKACIONI	60-64
J	JJ	AKTIVITETE FINANCIARE	65-67
K	KK	PASURITE E PATUNDSHME; DHENIA ME QIRA DHE SHERBIME PER NDERMARRJET	70-74
L	LL	ADMINISTRIMI PUBLIK	75
M	MM	ARESIMI	
N	NN	SHENDETËT DHE VEPRIMTARITE SOCIALE	85
O	OO	SHERBIME KOLEKTIVE, SOCIALE DHE PERSONALE	90-93

PAGA REFERUESE MUJORE PER EFEKT TE LLOGARITJES SE KONTRIBUTEVE TE SIGURIMEVE SHOQERORE DHE SHENDETESORE DHE TATIMIT MBI TE ARDHURAT PERSONALE PER PUNEMARRESIT QE PUNOJNE NE SEKTORIN PRIVAT SIPAS NOMENKLATURES SE VEPRIMTARIVE EKONOMIKE

Ndarja	Grupi	Klasa	VEPRIMTARITE EKONOMIKE	Administrator/ Drejtor i Përgjithshëm		Drejtues te degëve, njësive dhe specialiste me arsim te larte		Teknike dhe specialiste ne zbatim	Punëtore te kualifikuar	Punëtore te pakualifikuar
				DTM	Subjekte te tjera	DTM	Subjekte te tjera			
KATEGORIA I: Rrethi TIRANE										
			SEKSIONI AB: BUJQESIA, GJUETIA, SILVIKULTURA DHE PESHKIMI							
			SEKSIONI A: BUJQESIA, GJUETIA DHE SILVIKULTURA							
01			BUJQESIA, GJUETIA DHE SHERBIME PLOTESUESE							
	01.1		Kulturat e drithërave, te perimeve, hortikultura							
		01.11	Kulturat e drithërave dhe kulturat industriale	150,000	80,000	90,000	49,000	27,000	24,000	17,000
		01.12	Kulturat e perimeve, hortikultura (lulet) dhe fidanishtja	150,000	80,000	90,000	49,000	20,000	16,000	17,000
		01.13	Kultura e frutave ,te frutave me lëvohgë, te bimëve për pije dhe për erëzat	150,000	80,000	90,000	49,000	27,000	24,000	17,000
	01.2		Blegtoia	150,000	80,000	90,000	49,000	27,000	24,000	17,000
02			SILVIKULTURA, SHFRYTEZIMI I PYJEVE, SHERBIME PLOTESUESE.							
	02.0		Silvikultura, shfrytëzimi i pyjeve, shërbime plotësues							
		02.01	Silvikultura dhe shfrytëzimi i pyjeve	150,000	80,000	90,000	49,000	27,000	24,000	17,000
		02.02	Shërbime plotësuese ne silvikulture dhe ne shfrytëzimin e pyjeve	150,000	80,000	90,000	49,000	27,000	24,000	17,000
			SEKSIONI B: PESHKIMI							
05			PESHKIMI, KULTIVIMI I PESHKUT, KULTURAT UJORE DHE							
			SHERBIME PLOTESUESE NE PESHKIM							

	05.0		Peshkimi, kultivimi i peshkut, kulturat ujore, shërbime plotësuese ne peshkim							
		05.01	Peshkimi	150,000	80,000	90,000	49,000	27,000	24,000	17,000
		05.02	Kultivimi i peshkut, kulturat ujore	150,000	80,000	90,000	49,000	27,000	24,000	17,000
		05.03	Shërbime plotësuese ne peshkim	150,000	80,000	90,000	49,000	27,000	24,000	17,000
KATEGORIA II: Durrës, Elbasan, Korçe, Vlore, Shkodër, Fier Gjirokastrë										
			SEKSIONI AB: BUJQESIA, GJUEITIA, SILVIKULTURA DHE PESHKIMI							
			SEKSIONI A: BUJQESIA, GJUEITIA DHE SILVIKULTURA							
01			BUJQESIA, GJUEITIA DHE SHERBIME PLOTESUESE							
	01.1		Kulturat e drithërave, te perimeve, hortikultura							
		01.11	Kulturat e drithërave dhe kulturat industriale	90,000	50,000	60,000	36,000	20,000	16,000	15,000
		01.12	Kulturat e perimeve, hortikultura (lulet) dhe fidanishtja	90,000	50,000	60,000	36,000	23,000	20,000	15,000
		01.13	Kultura e frutave ,te frutave me lëvozhgë, te bimëve për pije dhe për erëzat	90,000	50,000	60,000	36,000	23,000	20,000	15,000
	01.2		Blegtoia	90,000	50,000	60,000	36,000	23,000	20,000	15,000
02			SILVIKULTURA, SHFRYTËZIMI I PYJEVE, SHERBIME PLOTESUESE.							
	02.0		Silvikultura, shfrytëzimi i pyjeve, shërbime plotësues							
		02.01	Silvikultura dhe shfrytëzimi i pyjeve	90,000	50,000	60,000	36,000	23,000	20,000	15,000
		02.02	Shërbime plotësuese ne silvikulture dhe ne shfrytëzimin e pyjeve	90,000	50,000	60,000	36,000	23,000	20,000	15,000
			SEKSIONI B: PESHKIMI							
05			PESHKIMI, KULTIVIMI I PESHKUT, KULTURAT UJORE DHE							
			SHERBIME PLOTESUESE NE PESHKIM							
	05.0		Peshkimi, kultivimi i peshkut, kulturat ujore, shërbime plotësuese ne peshkim							
		05.01	Peshkimi	90,000	50,000	60,000	36,000	23,000	20,000	15,000
		05.02	Kultivimi i peshkut, kulturat ujore	90,000	50,000	60,000	36,000	23,000	20,000	15,000
		05.03	Shërbime plotësuese ne peshkim	90,000	50,000	60,000	36,000	23,000	20,000	15,000
KATEGORIA III: Rrethet e tjera										
			SEKSIONI A: BUJQESIA, GJUEITIA DHE SILVIKULTURA							

			SEKSIONI A: BUJQESIA, GJUEITIA DHE SILVIKULTURA							
01			BUJQESIA, GJUEITIA DHE SHERBIME PLOTESUESE							
	01.1		Kulturat e drithërave, te perimeve, hortikultura							
		01.11	Kulturat e drithërave dhe kulturat industriale	60,000	35,000	40,000	30,000	20,000	16,000	14,000
		01.12	Kulturat e perimeve, hortikultura (lulet) dhe fidanishtja	60,000	35,000	40,000	30,000	21,000	19,000	14,000
		01.13	Kultura e frutave ,te frutave me lëvozhgë, te bimëve për pije dhe për erëzat	60,000	35,000	40,000	30,000	21,000	19,000	14,000
	01.2		Blegtoia	60,000	35,000	40,000	30,000	21,000	19,000	14,000
02			SILVIKULTURA, SHFRYTEZIMI I PYJEVE, SHERBIME PLOTESUESE.							
	02.0		Silvikultura, shfrytëzimi i pyjeve, shërbime plotësuese							
		02.01	Silvikultura dhe shfrytëzimi i pyjeve	60,000	35,000	40,000	35,000	21,000	19,000	14,000
		02.02	Shërbime plotësuese ne silvikulture dhe ne shfrytëzimin e pyjeve	60,000	35,000	40,000	30,000	21,000	19,000	14,000
			SEKSIONI B: PESHKIMI							
05			PESHKIMI, KULTIVIMI I PESHKUT, KULTURAT UJORE DHE							
			SHERBIME PLOTESUESE NE PESHKIM							
	05.0		Peshkimi, kultivimi i peshkut, kulturat ujore, shërbime plotësuese ne peshkim							
		05.01	Peshkimi	60,000	35,000	40,000	30,000	21,000	19,000	14,000
		05.02	Kultivimi i peshkut, kulturat ujore	60,000	35,000	40,000	30,000	21,000	19,000	14,000
		05.03	Shërbime plotësuese ne peshkim	60,000	35,000	40,000	30,000	21,000	19,000	14,000

PAGA REFERUESE MUJORE PER EFEKT TE LLOGARITJES SE KONTRIBUTEVE TE SIGURIMEVE SHOQERORE DHE SHENDETESORE DHE TATIMIT MBI TE ARDHURAT PERSONALE PER PUNEMARRESIT QE PUNOJNE NE SEKTORIN PRIVAT SIPAS NOMENKLATURES SE VEPRIMTARIVE EKONOMIKE

Ndarja	Grupi	Klasa	VEPRIMTARITE EKONOMIKE	Administrator/Drejtor i Përgjithshëm		Drejtues te degëve, njësive dhe specialiste me arsim te larte		Teknike dhe specialiste ne zbatim	Punëtore te kualifikuar	Punëtore te pakualifikuar
				DTM	Subjekte te tjera	DTM	Subjekte te tjera			
KATEGORIA I: Rrethi TIRANE										
			SEKSIONI C: INDUSTRIA NXJERRESE							
			NENSEKSIONI CA: NXJERRJA E PRODUKTEVE ENERGJITIKE							
10			NXJERRJA E QYMYRGURIT, TE LINJITEVE , DHE TE SHTRESAVE							
			TE VARFRA TE MINERALIT	150,000	80,000	90,000	60,000	27,000	24,000	17,000
11			NXJERRJA E NAFTES BRUTO, GAZIT NATYRAL, SHERBIME PLOTESUESE							
			NE NXJERRJEN E NAFTES DHE TE GAZIT ,							
			PERVEC STUDIMEVE GJEOLLOGJIKE							
	11.1		Nxjerrja e naftës bruto dhe e gazit natyral	150,000	80,000	90,000	51,600	27,000	24,000	17,000
		11.10	Nxjerrja e naftës bruto, gazit natyror, rërës dhe shistit bituminoz	150,000	80,000	90,000	51,600	27,000	24,000	17,000
	11.2		Shërbime plotësuese ne nxjerrjen e naftës dhe te gazit	150,000	80,000	90,000	37,200	25,000	22,000	17,000
			NENSEKSIONI CB: NXJERRJA E PRODUKTEVE JO ENERGJITIKE							
13			NXJERRJA E MINERALEVE METALIKE							
	13.1		Nxjerrja e mineralit te hekurit	150,000	80,000	90,000	57,600	27,000	24,000	17,000
	13.2		Nxjerrja e mineralit te metaleve jo-ferromanjetike (alumin, bakër, krom etj)	150,000	80,000	90,000	51,600	27,000	24,000	17,000
			përveç uraniumit dhe toriumit	150,000	80,000	90,000	57,600	27,000	24,000	17,000
14			INDUSTRITE TE TJERA NXJERRESE							

	14.1		Nxjerrja e gurit							
		14.11	Nxjerrja e gurit për ndërtim	150,000	80,000	90,000	42,000	28,000	24,000	17,000
		14.12	Nxjerrja e gurit gëlqeror , te gipsit, dhe te gëlqeres natyrale	150,000	80,000	90,000	48,000	33,000	27,000	17,000
	14.2		Nxjerrja e rërës dhe e argjilit	150,000	80,000	90,000	39,600	27,000	23,000	17,000
	14.4		Prodhimi i kripës	150,000	80,000	90,000	39,600	27,000	23,000	17,000
	14.5		Aktivitetet e tjera nxjerrëse (nxjerrje amianti, bitum natyral etj)	150,000	80,000	90,000	48,000	33,000	27,000	17,000
KATEGORIA II: Rrethet: Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë, Shkodër, Fier Gjirokastrë										
			SEKSIONI C: INDUSTRIA NXJERRESE							
			NENSEKSIONI CA: NXJERRJA E PRODUKTEVE ENERGJITIKE							
10			NXJERRJA E QYMYRGURIT, TE LINJITEVE , DHE TE SHITESAVE							
			TE VARFRA TE MINERALIT	90,000	50,000	60,000	55,000	42,000	34,650	15,000
11			NXJERRJA E NAFTES BRUTO, GAZIT NATYRAL, SHËRBIME PLOTËSUES							
			NE NXJERRJEN E NAFTES DHE TE GAZIT ,							
			PERVEÇ STUDIMEVE GJEOLLOJIKE							
	74.1		Aktivitetet juridike, kontabile dhe këshilla për administrim e drejtim	200,000	80,000	100,000	38,400	26,400	22,220	17,000
	74.2		Aktivitetet e arkitekturës dhe të inxhinierisë	200,000	80,000	100,000	38,400	26,400	22,220	17,000
	74.4		Publikimi (reklamat, afishet, vitrinat etj)	150,000	80,000	90,000	38,400	26,400	22,220	17,000
	74.6		Aktivitetet të hetimit dhe të ruajtjes së objekteve dhe personave	150,000	80,000	90,000	30	22	17,600	17,000
	74.7		Aktivitetet të pastrimit të ndërtesave	150,000	80,000	90,000	38,400	26,400	22,220	17,000
75			ADMINISTRIMI PUBLIK DHE I MBROJTJES;							
			SIGURIMI SHOQËROR I DETYRUAR	150,000	80,000	90,000	48,000	33,000	27,830	17,000
KATEGORIA II Rrethet: Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë, Shkodër, Fier, Gjirokastrë										
SEKSIONI J/K: NDERMJETESIMI FINANCIAR, PASURITË E PATUNDËSHME, DHENIA ME QIRA,DHE SHËBIMET KUNDREJT NDERRMARJEVE										
			SEKSIONI J: NDERMJETESIMI FINANCIAR							
65			NDERMJETESIMI FINANCIAR PËRVEÇ AKTIVITETETËVE							
			TË SIGURIMIT DHE ARKAVE TË PENSIONEVE							
	65.1		Ndërmjetësimi monetar	140,000	80,000	80,000	47,300	33,600	28,350	15,000
	65.2		Ndërmjetësime të tjera financiare	90,000	50,000	60,000	47,300	33,600	28,350	15,000
66			AKTIVITETE TË SIGURIMIT, DHE TË ARKAVE TË PENSIONEVE,							
			PËRVEÇ SIGURIMEVE SHOQËRORE TË DETYRUESHME	90,000	50,000	60,000	47,300	33,600	28,350	15,000
67			AKTIVITETET NDIHMESE TË NDERMJETESIMIT FINANCIAR							
			DHE TË SIGURIMIT	200,000	80,000	80,000	47,300	33,600	28,350	15,000
			SEKSIONI K: PASURITË E PATUNDËSHME, DHENIA ME QIRA,							

			DHE SHEBIMET KUNDREJT NDERRMARJEVE							
70			AKTIVITETE E PASURIVE TE PATUNDESHME	90,000	50,000	60,000	59,400	42,000	35,385	15,000
				-						
71			DHENIA ME QIRA E PAJISJEVE PA OPERATOR, DHE E ARTIKUJVE							
			PERSONALE DHE SHTEPIAKE	90,000	50,000	60,000	49,500	42,000	35,385	15,000
				-						
72			AKTIVITETE INFORMATIKE DHE AKTIVITETE TE LIDHURA ME TO	90,000	50,000	60,000	44,000	31,500	28,350	15,000
	72.1		Rekomandime me ane te sistemit informativ	90,000	50,000	60,000	44,000	31,500	28,350	15,000
	72.2		Realizimi i programeve informatike	90,000	50,000	60,000	44,000	31,500	28,350	15,000
	72.5		Mirëmbajtja dhe riparimi i makinave, pajisjeve te zyrave dhe te mjeteve informatike	90,000	50,000	60,000	44,000	36,750	28,350	15,000
73			KERKIME - APLIKIME EKSPERIMENTALE	90,000	50,000	60,000	44,000	36,750	28,350	15,000
74			AKTIVITETE TE TJERA TE SHERBIMEVE QE KRYHEN KRYESISHT PER							
			NDERRMARJET							
	74.1		Aktivitete juridike, kontabile dhe këshilla për administrim e drejtim	100,000	50,000	80,000	35,200	25,200	21,210	15,000
	74.2		Aktivitete te arkitekturës dhe te inxhinierisë	100,000	50,000	80,000	35,200	25,200	21,210	15,000
	74.4		Publikimi (reklamati, afishet, vitrinat etj)	90,000	50,000	60,000	35,200	25,200	21,210	15,000
	74.6		Aktivitete te hetimit dhe te ruajtjes se objekteve dhe personave	90,000	50,000	60,000	27.500	21.000	16,800	15,000
	74.7		Aktivitete te pastrimit te ndërtesave	90,000	50,000	60,000	35,200	25,200	21,210	15,000
75			ADMINISTRIMI PUBLIK DHE I MBROJTJES;							
			SIGURIMI SHOQEROR I DETYRUAR	90,000	50,000	60,000	44,000	31,500	26,565	15,000
KATEGORIA III: Rrethet e tjera										
SEKSIONI J/K: NDERMJETESIMI FINANCIAR, PASURITE E PATUNDESHME, DHENIA ME QIRA,DHE SHEBIMET KUNDREJT NDERRMARJEVE										
			SEKSIONI J: NDERMJETESIMI FINANCIAR							
65			NDERMJETESIMI FINANCIAR PERVEC AKTIVITETETEVERE							
			TE SIGURIMIT DHE ARKAVE TE PENSIONEVE							
	65.1		Ndërmjetësimi monetar	60,000	35,000	40,000	43,000	32,000	27,000	14,000
	65.2		Ndërmjetësimi te tjera financiare	60,000	35,000	40,000	43,000	32,000	27,000	14,000

66			AKTIVITETE TE SIGURIMIT, DHE TE ARKAVE TE PENSIONEVE,							
			PERVEC SIGURIMEVE SHOQERORE TE DETYRUESHME	60,000	35,000	40,000	43,000	32,000	27,000	14,000
67			AKTIVITETET NDIHMESE TE NDERMJETESIMIT FINANCIAR							
			DHE TE SIGURIMIT	60,000	35,000	40,000	43,000	32,000	27,000	14,000
			SEKSIONI K PASURITE E PATUNDESHME, DHENIA ME QIRA,							
			DHE SHEBIMET KUNDREJT NDERRMARJEVE							
70			AKTIVITETE E PASURIVE TE PATUNDESHME	60,000	35,000	40,000	54,000	40,000	33,700	14,000
71			DHENIA ME QIRA E PAJISJEVE PA OPERATOR, DHE E ARTIKUJVE							
			PERSONALE DHE SHTEPIAKE	60,000	35,000	40,000	45,000	40,000	33,700	14,000
72			AKTIVITETE INFORMATIKE DHE AKTIVITETE TE LIDHURA ME TO	60,000	35,000	40,000	40,000	30,000	27,000	14,000
	72.1		Rekomandime me ane te sistemit informativ	60,000	35,000	40,000	40,000	30,000	27,000	14,000
	72.2		Realizimi i programeve informatike	60,000	35,000	40,000	40,000	30,000	27,000	14,000
	72.5		Mirëmbajtja dhe riparimi i makinave, pajisjeve te zyrave dhe te mjeteve informatike	60,000	35,000	40,000	40,000	35,000	27,000	14,000
73			KERKIME - APLIKIME EKSPERIMENTALE	60,000	35,000	40,000	40,000	35,000	27,000	14,000
74			AKTIVITETE TE TJERA TE SHERBIMEVE QE KRYHEN KRYESISHT PER							
			NDERRMARJET	60,000	35,000	40,000	32,000	24,000	20,200	14,000
	74.1		Aktivite juridike, kontabile dhe këshilla për administrim e drejtim	60,000	35,000	40,000	32,000	24,000	20,200	14,000
	74.2		Aktivite te arkitekturës dhe te inxhinierisë	60,000	35,000	40,000	32,000	24,000	20,200	14,000
	74.4		Publikimi (reklamat, afishet, vitrinat etj)	60,000	35,000	40,000	32,000	24,000	20,200	14,000
	74.6		Aktivite te hetimit dhe te ruajtjes se objekteve dhe personave	60,000	35,000	40,000	25,000	20,000	16,000	14,000
	74.7		Aktivite te pastrimit te ndërtesave	60,000	35,000	40,000	32,000	24,000	20,200	14,000
75			ADMINISTRIMI PUBLIK DHE I MBROJTJES;							
			SIGURIMI SHOQEROR I DETYRUAR	60,000	35,000	40,000	40,000	30,000	25,300	14,000

PAGA REFERUESE MUJORE PER EFEKT TE LLOGARITJES SE KONTRIBUTEVE TE SIGURIMEVE SHOQERORE DHE SHENDETESORE DHE TATIMIT MBI TE ARDHURAT PERSONALE PER PUNEMARRESIT QE PUNOJNE NE SEKTORIN PRIVAT SIPAS NOMENKLATURES SE VEPRIMTARIVE EKONOMIKE

Ndarja	Grupi	Klasa	VEPRIMTARITE EKONOMIKE	Drejtor Administrator		Drejtues te degëve, njësie dhe specialiste me arsim te larte		Teknike dhe specialiste ne zbatim	Punëtore te kualifikuar	Punëtore te pakualifikuar
				DTM	Subjekte te tjera	DTM	Subjekte te tjera			
KATEGORIA I Rrethi TIRANE										
			SEKSIONI M: ARSIMI							
80			ARESIMI							
	80.1		Aktivitete te arsimit fillor	150,000	80,000	90,000	40,800	28,600	23,760	17,000
	80.2		Aktivitete te arsimit te mesëm	150,000	80,000	90,000	30,000	22,000	20,020	17,000
	80.3		Aktivitete te arsimit te larte	200,000	80,000	130,000	36,000	26,400	22,000	17,000
	80.4		Aktivitete te kurseve te vazhdueshme dhe aktivitete te tjera te arsimit	150,000	80,000	90,000	40,800	28,600	23,760	17,000
KATEGORIA II Rrethet: Durrës, Elbasan, Korçe, Vlore, Shkodër, Fier, Gjirokastrër										
			SEKSIONI M: ARSIMI							
80			ARESIMI							
	80.1		Aktivitete te arsimit fillor	80,000	50,000	60,000	37,400	27,300	22,680	15,000
	80.2		Aktivitete te arsimit te mesëm	80,000	50,000	60,000	27,500	21,000	19,110	15,000
	80.3		Aktivitete te arsimit te larte	150,000	50,000	100,000	33,000	25,200	21,000	15,000
	80.4		Aktivitete te kurseve te vazhdueshme dhe aktivitete te tjera te arsimit	80,000	50,000	60,000	37,400	27,300	22,680	15,000
KATEGORIA III: Rrethet e tjera										
			SEKSIONI M: ARSIMI							
80			ARESIMI							
	80.1		Aktivitete te arsimit fillor	60,000	35,000	40,000	34,000	26,000	21,600	14,000
	80.2		Aktivitete te arsimit te mesëm	60,000	35,000	40,000	25,000	20,000	18,200	14,000
	80.3		Aktivitete te arsimit te larte	60,000	35,000	40,000	30,000	24,000	20,000	14,000
	80.4		Aktivitete te kurseve te vazhdueshme dhe aktivitete te tjera te arsimit	60,000	35,000	40,000	34,000	26,000	21,600	14,000

PAGA REFERUESE MUJORE PER EFEKT TE LLOGARITJES SE KONTRIBUTEVE TE SIGURIMEVE SHOQERORE DHE SHENDETESORE DHE TATIMIT MBI TE ARDHURAT PERSONALE PER PUNEMARRESIT QE PUNOJNE NE SEKTORIN PRIVAT SIPAS NOMENKLATURES SE VEPRIMTARIVE EKONOMIKE

Ndarja	Grupi	Klasa	VEPRIMTARITE EKONOMIKE	Drejtor Administrator		Drejtues te degëve, njësive dhe specialiste me arsim te larte		Teknike dhe specialist e ne zbatim	Punëtore te kualifikuar	Punëtore te pakualifikuar
				VIP	Subjekte te tjera	VIP	Subjekte te tjera			
KATEGORIA I Rrethi TIRANE										
			SEKSIONI N: SHENDETI DHE VEPRIMTARITE SOCIALE							
85			SHENDETI DHE VEPRIMTARITE SOCIALE							
	85.1		Aktivitete për kujdesin e shëndetit							
		85.12	Aktivitete mjekësore ambulatorë (klinike private, ambulance, shtëpi etj)	200,000	80,000	150,000	40,800	28,600	23,760	17,000
		85.13	Aktivitete te praktikes ambulatorë dentare	200,000	80,000	150,000	40,800	28,600	23,760	17,000
	85.3		Veprimtari sociale	150,000	80,000	90,000	40,800	28,600	22000	17,000
KATEGORIA II Rrethet: Durrës, Elbasan, Korçe, Vlore, Shkodër, Fier, Gjirokaštër										
			SEKSIONI N: SHENDETI DHE VEPRIMTARITE SOCIALE							
85			SHENDETI DHE VEPRIMTARITE SOCIALE							
	85.1		Aktivitete për kujdesin e shëndetit							
		85.12	Aktivitete mjekësore ambulatorë (klinike private, ambulance, shtëpi	120,000	50,000	80,000	37,400	27,300	22,680	15,000

			eti)							
		85.13	Aktivitetet e praktikës ambulatorë dentare	120,000	50,000	80,000	37,400	27,300	22,680	15,000
	85.3		Veprimtari sociale	90,000	50,000	60,000	37,400	27,300	21,000	15,000
KATEGORIA III: Rrethet e tjera										
			SEKSIONI N: SHENDETI DHE VEPRIMTARIË SOCIALE							
85			SHENDETI DHE VEPRIMTARIË SOCIALE							
	85.1		Aktivitetet për kujdesin e shëndetit							
		85.12	Aktivitetet mjekësore ambulatorë (klinike private, ambulance, shtëpi eti)	60,000	35,000	40,000	34,000	26,000	21,600	14,000
		85.13	Aktivitetet e praktikës ambulatorë dentare	60,000	35,000	40,000	34,000	26,000	21,600	14,000
	85.3		Veprimtari sociale	60,000	35,000	40,000	34,000	26,000	20,000	14,000

PAGA REFERUESE MUJORE PER EFEKT TE LLOGARITJES SE KONTRIBUTEVE TE SIGURIMEVE SHOQERORE DHE SHENDETESORE DHE TATIMIT MBI TE ARDHURAT PERSONALE PER PUNEMARRESIT QE PUNOJNE NE SEKTORIN PRIVAT SIPAS NOMENKLATURES SE VEPRIMTARIVE EKONOMIKE

Ndarja	Grupi	Klasa	VEPRIMTARITE EKONOMIKE	Drejtor Administrator		Drejtues te degëve, njësive dhe specialiste me arsim te larte		Teknike dhe specialist ne zbatim	Punëtore te kualifikuar	Punëtore te pakualifikuar
				VIP	Subjekte te tjera	VIP	Subjekte te tjera			
KATEGORIA I Rrethi TIRANE										
			SEKSIONI O : AKTIVITETE TE TJERA TE SHERBIMIT KOLEKTIV,							
			SOCIAL DHE INDIVIDUAL							
90			PASTRIMI, HEQJA E MBETURINAVE , TRAJTIMI I HEDHURINAVE							
			DHE AKTIVITETE TE TJERA TE NGJASHME	150,000	80,000	90,000	36,000	27,500	24,090	17,000
91			AKTIVITETE TE ORGANIZATAVE TE NDRYSHME SHOQERORE							
	91.1		Aktivitete te organizatave ekonomike	150,000	80,000	90,000	40,800	28,600	24,090	17,000
	91.2		Aktivitete te sindikatave te punës.	150,000	80,000	90,000	30,000	22,000	20,020	17,000
	91.3		Aktivitete te tjera te shoqërive	150,000	80,000	90,000	30,000	22,000	20,020	17,000
92			AKTIVITETE DEFRIMI, KULTURORE DHE SPORTIVE							
	92.1		Aktivitete kinematografike	150,000	80,000	90,000	34,800	24,200	20,020	17,000
	92.2		Aktivitete te radios dhe te televizionit	250,000	80,000	150,000	40,800	28,600	24,090	17,000
	92.2.1		TV Kombëtar	300,000	80,000	150,000	40,800	28,600	24,090	17,000
	92.2.2		TV Lokal	250,000	80,000	150,000	40,800	28,600	24,090	17,000
	92.3		Aktivitete te tjera te shfaqjeve	150,000	80,000	90,000	34,800	24,200	20,020	17,000
	92.6		Aktivitete sportive	150,000	80,000	90,000	34,800	24,200	20,020	17,000
	92.7		Aktivitete argëtuese	150,000	80,000	90,000	44,400	30,800	25,300	17,000
93			AKTIVITETE TE SHERBIMEVE PERSONALE							
		93.01	Larja dhe pastrimi i tekstileve gëzoftave, tapeteve	150,000	80,000	90,000	36,000	26,400	22,220	17,000

		93.02	Floktoret dhe institutet e tjera te bukurisë	150,000	80,000	90,000	36,000	26,400	22,220	17,000
		93.03	Shërbimet funebre dhe aktivitetet e tjera te lidhur ne to	150,000	80,000	90,000	36,000	26,400	22,220	17,000
		93.04	Aktivitetet e mirëmbajtjes trupore (banjat termale, banja avulli, etj)	150,000	80,000	90,000	36,000	26,400	22,220	17,000
KATEGORIA II Rrethet: Durrës, Elbasan, Korçe, Vlore, Shkodër, Fier, Gjirokastrë										
			SEKSIONI O : AKTIVITETE TE TJERA TE SHERBIMIT KOLEKTIV ,							
			SOCIAL DHE INDIVIDUAL							
90			PASTRIMI, HEQJA E MBETURINAVE , TRAJTIMI I HEDHURINAVE							
			DHE AKTIVITETE TE TJERA TE NGJASHME	90,000	50,000	60,000	33,000	26,250	22,995	15,000
91			AKTIVITETE TE ORGANIZATAVE TE NDRYSHME SHOQERORE							
	91.1		Aktivitetet te organizatave ekonomike	90,000	50,000	60,000	37,400	27,300	22,995	15,000
	91.2		Aktivitetet te sindikatave te punës.	90,000	50,000	60,000	27,500	21,000	19,110	15,000
	91.3		Aktivitetet te tjera te shoqërive	90,000	50,000	60,000	27,500	21,000	19,110	15,000
92			AKTIVITETE DEFRIMI, KULTURORE DHE SPORTIVE							
	92.1		Aktivitetet kinematografike	90,000	50,000	60,000	31,900	23,100	19,110	15,000
	92.2		Aktivitetet te radios dhe te televizionit	120,000	50,000	80,000	37,400	27,300	22,995	15,000
	92.2.1		TV Kombëtar	150,000	80,000	60,000	31,900	27,300	22,995	15,000
	92.2.2		TV Lokal	100,000	70,000	60,000	31,900	27,300	22,995	15,000
	92.3		Aktivitetet te tjera te shfaqjeve	90,000	50,000	60,000	31,900	23,100	19,110	15,000
	92.6		Aktivitetet sportive	90,000	50,000	60,000	31,900	23,100	19,110	15,000
	92.7		Aktivitetet argëtuese	90,000	50,000	60,000	31,900	29,400	24,150	15,000
93			AKTIVITETE TE SHERBIMEVE PERSONALE	90,000	50,000	60,000	33,000	25,200	21,210	15,000
	93.01		Larja dhe pastrimi i tekstileve gëzoftave, tapeteve	90,000	50,000	60,000	33,000	25,200	21,210	15,000
	93.02		Floktoret dhe institutet e tjera te bukurisë	90,000	50,000	60,000	33,000	25,200	21,210	15,000
	93.03		Shërbimet funebre dhe aktivitetet e tjera te lidhur ne to	90,000	50,000	60,000	33,000	25,200	21,210	15,000
	93.04		Aktivitetet e mirëmbajtjes trupore (banjat termale, banja avulli, etj)	90,000	50,000	60,000	33,000	25,200	21,210	15,000

KATEGORIA III: Rrethet e tjera										
			SEKSIONI O : AKTIVITETE TE TJERA TE SHERBIMIT KOLEKTIV ,							
			SOCIAL DHE INDIVIDUAL							
90			PASTRIMI, HEQJA E MBETURINAVE , TRAJTIMI I HEDHURINAVE							
			DHE AKTIVITETE TE TJERA TE NGJASHME	60,000	35,000	40,000	30,000	25,000	21,900	14,000
91			AKTIVITETE TE ORGANIZATAVE TE NDRYSHME SHOQERORE							
	91.1		Aktivite te organizatave ekonomike	60,000	35,000	40,000	34,000	26,000	21,900	14,000
	91.2		Aktivite te sindikatave te punës.	60,000	35,000	40,000	25,000	20,000	18,200	14,000
	91.3		Aktivite te tjera te shoqërive	60,000	35,000	40,000	25,000	20,000	18,200	14,000
92			AKTIVITETE DEFRIMI, KULTURORE DHE SPORTIVE							
	92.1		Aktivite kinematografike	60,000	35,000	40,000	29,000	22,000	18,200	14,000
	92.2		Aktivite te radios dhe te televizionit	60,000	35,000	40,000	34,000	26,000	21,900	14,000
	92.2.1		TV Kombëtar	60,000	35,000	40,000	34,000	26,000	21,900	14,000
	92.2.2		TV Lokal	60,000	35,000	40,000	34,000	26,000	21,900	14,000
	92.3		Aktivite te tjera te shfaqjeve	60,000	35,000	40,000	29,000	22,000	18,200	14,000
	92.6		Aktivite sportive	60,000	35,000	40,000	29,000	22,000	18,200	14,000
	92.7		Aktivite argëtuese	60,000	35,000	40,000	37,000	28,000	23,000	14,000
93			AKTIVITETE TE SHERBIMEVE PERSONALE							
		93.01	Larja dhe pastrimi i tekstileve gëzofave, tapeteve	60,000	35,000	40,000	30,000	24,000	20,200	14,000
		93.02	Floktoret dhe institutet e tjera te bukurisë	60,000	35,000	40,000	30,000	24,000	20,200	14,000
		93.03	Shërbimet funebre dhe aktivite te tjera te lidhur ne to	60,000	35,000	40,000	30,000	24,000	20,200	14,000
		93.04	Aktivite te mirëmbajtjes trupore (banjat termale, banja avulli, etj)	60,000	35,000	40,000	30,000	24,000	20,200	14,000

VENDIM
Nr. 411 , datë 10.5.2017

**PËR DERDHJEN E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE
NJOHJEN SI PERIUDHË SIGURIMI TË PERIUDHËS KUR BASHKËSHORTI/JA
KA SHOQËRUAR PERSONELIN E SHËRBIMIT TË JASHTËM NË MISIONIN
DIPLOMATIK OSE POSTIN KONSULLOR JASHTË SHTETIT**

Në mbështetje të neneve 52, pika 1, 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, të neneve 9 e 58, pika 2, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 54, të ligjit nr.23/2015, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Punëve të Jashtme, në bazë të listës së bashkëshortëve që kanë shoqëruar personelin e shërbimit të jashtëm në misionet diplomatike ose postet konsullore të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, të bëjë pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore të paderdhura, si më poshtë vijon:

a) Për periudhën 1 janar 1998 deri më 31 dhjetor 2015, pagesa të mbulohet me kontribute vetëm nga dega e pensioneve, ndërsa për periudhën 1 janar 2016 deri më 31 dhjetor 2016 pagesa të mbulohet me kontribute të të gjitha degëve të sigurimit shoqëror, bazuar në normën e kontributit sipas degëve të sigurimit, të përcaktuar në dispozitat e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b) Masa e kontributit të sigurimeve shoqërore për personat përfitues, për periudhën 1 janar 1998 deri më 31 dhjetor 2015, të llogaritet në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në fuqi për vitin 2016, ndërsa për periudhën 1 janar 2016 deri më 31 dhjetor 2016, bazuar në pagën që përfituesi kishte përpara ndërprerjes së punës. Në rastet kur përfituesi nuk ka qenë i punësuar, kontributet e sigurimeve shoqërore llogariten bazuar në pagën minimale në shkallë vendi në fuqi për vitin 2016.

c) Pagesa e kontributeve të bëhet drejtpërdrejt për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Mënyra e pagesës së kontributeve, llogaritë bankare ku do të kryhen transfertat dhe dokumentacioni që pasqyron kontributet individuale caktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Lista e personave që përfitojnë këtë trajtim, sipas viteve, do të jetë pjesë e udhëzimit dhe do të arkivohet në arkivat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

2. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, në bazë të listë-pagesave të paraqitura nga Ministria e Punëve të Jashtme, të bëjë njohjen e periudhave të paguara sipas pikës 1, të këtij vendimi, si periudhë sigurimi për bashkëshortin e personelit të shërbimit të jashtëm.

3. Për efekt të këtij vendimi, bashkëshort i personelit të shërbimit të jashtëm, janë:

a) bashkëshorti/ja që ka shoqëruar personelin diplomatik në misionet diplomatike ose postet konsullore të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja;

b) bashkëshorti/ja që ka shoqëruar personelin administrativo-teknik në misionet diplomatike ose postet konsullore të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, pa përfshirë personelin teknik vendas.

4. Fondi financiar për pagesën e kontributit të sigurimeve shoqërore të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme që do të miratohet për vitin 2018.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

UDHËZIM³
Nr. 23 datë 9.12.2014

**PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË
SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE**

(Ndryshuar me udhëzimin nr.1, datë 9.1.2015)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr.10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Regjistrimi i tatimpaguesve në organet tatimore

1.1 Regjistrimi për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore i tatimpaguesve të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Procedurat për regjistrimin për efekte të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pajisjen me numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT), kalimin në regjistrin pasiv dhe çregjistrimin e tatimpaguesve, do të jenë ato të përcaktuara në ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 në zbatim të tij.

1.2 Regjistrimi për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore i tatimpaguesve që nuk regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

1.2.1 Organizatat jofitimprurëse, entet publike kombëtare apo vendore, fondacionet e ndryshme, organizatat politike apo shoqërore, përfaqësuesit tatimorë, personat e tjerë juridikë të cilët nuk regjistrohen në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, përfaqësitë dhe ambasadat e huaja, njësitë e zbatimit të projekteve të veçanta dhe persona të tjerë të ngjashëm me to, personat “i vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi ambulant”, si dhe “kryefamiljari, që punëson persona si punëtorë shtëpie”, regjistrohen dhe pajisen me numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT-i) në administratën tatimore sipas përcaktimeve në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

1.2.2 Regjistrimi në çdo rast bëhet përpara se tatimpaguesi të fillojë veprimtarinë e tij.

1.2.3 “I vetëpunësuar” është një tatimpagues i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe në organet tatimore si “person fizik”. Statuset e mundshme të personit fizik janë:

I vetëpunësuar i vetëm.

I vetëpunësuar me punëmarrës.

I vetëpunësuar me punëmarrës dhe punonjës të papaguar të familjes.

I vetëpunësuar pa punëmarrës, me punonjës të papaguar të familjes.

1.2.4 “Punonjës i papaguar i familjes” është anëtar i familjes që punon e bashkëjeton ligjërisht me të vetëpunësuarin.

1.2.5 Tatimpaguesi person fizik që kërkon të ndryshojë statusin e tij (p.sh. nga i vetëpunësuar i vetëm në i vetëpunësuar me punëmarrës ose anasjelltas, etj.), është i detyruar të kryejë veprimet për këto ndryshime në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe të deklarojë ndryshimet në drejtorinë rajonale tatimore.

³ Udhëzimi nr. 23 datë 9.12.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 186, datë 10 dhjetor 2014.

1.2.6 Tatimpaguesit, persona juridikë, kanë gjithmonë vetëm statusin e punëdhënësit me punëmarrës.

1.2.7 Lidhur me regjistrimin e personave si “të vetëpunësuar në aktivitet tregtar apo shërbimi ambulant”, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a. Regjistrohen si persona të vetëpunësuar në aktivitet tregtar apo shërbimi ambulant, në kuptim të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, personat fizikë kur nuk janë të siguruar si punëmarrës a si të vetëpunësuar në veprimtari ekonomike të vijueshme, të cilët sigurohen, në mënyrë të detyrueshme, vetëm për degën e pensioneve dhe sigurimin shëndetësor, që vetëpunësohen në veprimtari:

- i) të përkohshme e të vijueshme, por pa një vend qëndrimi apo shërbimi të përcaktuar;
- ii) të përkohshme e me ndërprerje gjatë javës, por pa një vend qëndrimi apo shërbimi të përcaktuar;
- iii) të vijueshme në veprimtari tregtare në tezga, pa vend qëndrimi të përhershëm ose në mjete që lëvizin;
- iv) të vijueshme, në veprimtari transporti, me ndërprerje gjatë javës.

b. Regjistrohen si persona të vetëpunësuar në aktivitet tregtar apo shërbimi ambulant dhe paguajnë kontribut të sigurimit shoqëror dhe shëndetësor në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave vetëm personat që nuk kanë detyrimin ligjor për të paguar kontribute të detyrueshme në masë të plotë si të vetëpunësuar që ushtrojnë veprimtari ekonomike e cila ka vijueshmëri.

c. Personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi ambulant, të cilët janë edhe të vetëpunësuar në bujqësi do të sigurohen jo si të vetëpunësuar në bujqësi, por për veprimtarinë që kryejnë si ambulant.

ç. Në të gjitha rastet personat e vetëpunësuar në aktivitet tregtar apo shërbimi ambulant” janë të vetëpunësuar të vetëm dhe nuk mund të punësojnë persona të tjerë apo punonjës të paguar të familjes.

1.2.8 Për personat kryefamiljarë, që punësojnë persona si punëtorë shtëpie, në kuptim të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave të zbatohen rregullat si vijon:

a) Kryefamiljari, i cili në këtë rast është përcaktuar në rolin e punëdhënësit, ka detyrimin për regjistrim në drejtorinë rajonale tatimore, e cila mbulon territorin ku kryefamiljari ka banimin e tij sipas përcaktimit në nenin 12 të Kodit Civil.

b) Kryefamiljari, që punëson persona si punëtorë shtëpie, në momentin e paraqitjes për regjistrim në organin tatimor, dorëzon kërkesën me shkrim, si dhe kopje të marrëveshjes së punës së nënshkruar ndërmjet palëve, ku përveç të tjerave shënohet detyrimisht, numri i sigurimit shoqëror të personit të punësuar, koha e fillimit të punës, zgjatja e saj “me ose pa afat”, si dhe paga mujore bruto. Drejtoria rajonale tatimore, pasi bën verifikimin e të gjithë të dhënave të kërkuara, bën regjistrimin e kryefamiljarit dhe i lëshon atij NIPT-in përkatës.

c) Çregjistrimi nga organi tatimor i krye-familjarit, që punëson persona si punëtorë shtëpie, do të bëhet duke paraqitur në drejtorinë rajonale tatimore vetëm një kërkesë me shkrim nga kryefamiljari. Çregjistrimi i kryefamiljarit, që punëson persona si punëtorë shtëpie, miratohet nga drejtori i drejtorisë rajonale tatimore. Përpara çregjistrimit nga organi tatimor kryefamiljari, që punëson persona si punëtorë shtëpie, duhet të ketë plotësuar të gjitha detyrimet ndaj administratës tatimore për dorëzimin e dokumentacionit dhe pagimin e detyrimeve.

ç) Në kuptim të zbatimit të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave dhe të këtij udhëzimi, për personat e punësuar si punëtorë shtëpie, njëloj me kryefamiljarin, trajtohet edhe çdo shtetas shqiptar apo i huaj, madhor me zotësi për të vepruar.

d) Personat e punësuar si punëtorë shtëpie, sikurse dhe personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi ambulante, pajisen me librezën e kontributit, nga strukturat e sigurimeve shoqërore, të cilat janë të detyruara t’ia plotësojnë në vijimësi, në bazë të kontributeve të paguara, duke shënuar në librezë “Të siguruar vetëm për pension dhe sigurim shëndetësor”.

2. NUMRI PERSONAL I INDIVIDËVEQË PAGUAJNË KONTRIBUTE

2.1 Personat juridikë dhe fizikë, për punonjësit shtetas shqiptarë, deklarojnë në rubrikën përkatëse

të deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” dhe “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”, numrin personal të letërnjoftimit të çdo individ.

2.2 Për të punësuarit apo të vetëpunësuarit shtetas të huaj që punojnë në Shqipëri, si numër personal për efekt të deklarimit të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore shërben numri i lejes së qëndrimit ose i lejes provizore të qëndrimit.

3. LLOGARITJA E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE

3.1 Llogaritja e kontributeve nga tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë për punëmarrësit që punojnë me kohë të plotë për më shumë se 87 orë në muaj

3.1.1 Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punëdhënësit për punëmarrësin dhe të vetë punëmarrësit, llogariten për çdo punëmarrës individual mbi bazën e pagës bruto të tyre. Paga bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, është paga e përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

3.1.2 Përbërja e pagës bruto për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohet në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave. Në këtë vendim përcaktohet paga maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore të punëmarrësit. Në këtë pagë përfshihet edhe shuma e lekëve që zbritet nga paga bruto gjithsej dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit.

3.1.3 Paga maksimale për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit shëndetësor të punëmarrësit është paga bruto e tij pa kufi të sipërm të saj. Në këtë pagë përfshihet edhe shuma e lekëve që zbritet nga paga bruto gjithsej dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit.

3.1.4 Paga minimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe ato shëndetësore për individët e punësuar (punëmarrës) te tatimpagues persona juridikë ose fizikë, është e njëjtë me pagën për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore për personat fizikë të vetëpunësuar, për vete dhe për punonjësit e papaguar të familjes me të cilët ata punojnë e bashkëjetojnë ligjërisht. Kjo pagë është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, i cili miratohet në zbatim të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë. Kjo do të thotë se asnjë punëdhënës, person juridik ose fizik, me punëmarrësit e vet, me kohë të plotë ose të pjesshme, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen në bazë të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, nuk mund të lidhë marrëveshje kolektive ose kontratë individuale me pagë më të ulët se paga minimale e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, i cili miratohet në zbatim të këtij Kodi.

3.1.5 Paga minimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimit shëndetësor për personin fizik të vetëpunësuar për vete dhe për punonjësit e papaguar të familjes me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht është e barabartë me dyfishin e pagës minimale në shkallë vendi mbi të cilën edhe llogariten kontributet e sigurimeve shoqërore.

3.1.6 Llogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore të punëmarrësit mbështetet në rregullat e shprehura më poshtë:

Paga bruto mujore e punëmarrësit:	Kontributi i llogaritur:
Deri në minimumin e pagës mujore	Paga mujore minimale (sipas VKM-së përkatës) x tarifa e aplikueshme
Më shumë se paga minimale mujore, por më pak se paga maksimale	Paga mujore bruto x tarifa e aplikueshme
Më shumë se paga mujore maksimale sipas VKM-së përkatës	Paga mujore maksimale (sipas VKM-së përkatës) x tarifa e aplikueshme

3.1.7 Llogaritja e kontributit të sigurimit shëndetësor të punëmarrësit mbështetet në shumën e pagës bruto të tij, e cila nuk mund të jetë nën kufirin e pagës minimale në shkallë vendi dhe pa kufi maksimal.

3.2 Llogaritja e kontributeve nga tatimpaguesit, persona juridikë dhe fizikë, për punëmarrësit që punojnë me kohë të pjesshme, që zgjat më pak se 87 orë në muaj

3.2.1 Mënyra e llogaritjes dhe masa e kontributeve të sigurimeve për punëmarrësit që punojnë me kohë të pjesshme, që zgjat më pak se 87 orë në muaj, përcaktohet nga vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave. Në zbatim të këtij vendimi, për të punësuarit, që janë me kontratë pune me ose pa afat, por me kohë të pjesshme, që zgjat më pak se 87 orë në muaj, kontributi i detyrueshëm për sigurimet, shoqërore e shëndetësore, llogaritet për degët e sigurimit, barrëlindje, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale dhe sigurim shëndetësor, në përqindjet përkatëse, mbi pagën bruto mujore sipas listëpagesës, por jo më pak se niveli i pagës minimale në shkallë vendi.

3.2.2 Paga maksimale mujore për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore, për këta të punësuar, do të jetë ajo e përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu mbështetur në këtë vendim, paga maksimale për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit shëndetësor për këta të punësuar është paga bruto pa kufi të sipërm të saj.

Në këtë pagë përfshihet edhe shuma e lekëve që zbritet nga paga bruto gjithsej dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit.

3.2.3 Punëdhënësi ka detyrimin ligjor të bëjë sigurimin e punëmarrësit, me kohë të plotë ose të pjesshme, duke filluar nga data e fillimit të punës, sipas përcaktimit në kontratën e punës apo në aktin e emërimit dhe vazhdon të paguajë kontribute gjatë gjithë kohës, që vazhdojnë marrëdhëniet e punës. Kur fillimi dhe ndërprerja përfundimtare e marrëdhënieve të punës bëhen gjatë muajit, kontributet llogariten e paguhen në bazë të pagës së realizuar gjatë ditëve të punës.

3.2.4 Në mbështetje të Kodit të Punës, tatimpaguesit, persona juridikë dhe fizikë, punëdhënësit janë të detyruar të nënshkruajnë kontratë pune me punëmarrësit e tyre, me kohë të plotë ose të pjesshme. Gjithashtu në mbështetje të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003, i ndryshuar, të Kodit të Punës, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 594, datë 22.12.1997 “Për regjistrin që mban punëdhënësi për punëmarrësit e tij, i ndryshuar”, ata janë të detyruar të mbajnë regjistrime për periudhën e marrëdhënieve të punës dhe shumat e paguara (në të holla ose si përfitime në natyrë) për çdo punëmarrës, me kohë të plotë ose të pjesshme. Ky regjistër, kur kërkohet, vihet në dispozicion të punonjësve të administratës tatimore, që ushtrojnë kontrolle tatimore tek tatimpaguesi.

3.3 Llogaritja e kontributeve nga tatimpaguesit persona fizikë për të vetëpunësuarit dhe për punonjësit e paguar të familjes

3.3.1 Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për personat fizikë, tatimpagues të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, ose të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me ose pa punëmarrës, për vete dhe për punonjësit e paguar të familjes, me të cilët punojnë e bashkëjetojnë ligjërisht, llogariten me përqindje mbi pagën mujore minimale në shkallë vendi. Përqindjet përkatëse dhe niveli i pagës minimale janë siç përcaktohet në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave. Në këtë vendim është përcaktuar dhe shuma mujore fikse e kontributit të detyrueshëm të sigurimeve shoqërore, që duhet të paguajë personi i vetëpunësuar në aktivitet, tregtar apo shërbimi, ambulant, si dhe kryefamiljari, që punëson persona si punëtorë shtëpie.

Në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, personi fizik, për vete, me dëshirën e tij, kontributet e sigurimeve shoqërore mund t’i llogarisë e paguajë mbi bazën e një page edhe më të madhe nga paga minimale në shkallë vendi deri në kufirin e pagës maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore të punëmarrësit.

3.3.2 Në rastin kur gruaja si person fizik “i vetëpunësuar i vetëm” regjistruar si tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël është me raport barrë lindjeje dhe paguhet si e tillë, por tatimpaguesi ushtron veprimtarinë nëpërmjet një personi tjetër, pjesëtar ose jo i familjes, ajo deklaron ndryshimin të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të ndërprerjes së punës dhe fillimit të raportit të lejes së paralindjes me anë të “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”. Në këtë rast në deklaratën e radhës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” tatimpaguesi deklaron të dhënat për të dy punonjësit, ndërsa llogaritja e detyrimit për kontributet do të jetë vetëm për një person duke bërë shënime përkatëse në rubrikën shënime të listëpagesës. Kur gruaja si person fizik “i vetëpunësuar i vetëm” përfundon lejen e barrë lindjes dhe do të rifillojë punën, apo kur ajo do të rifillojë punën pa përfunduar lejen e barrë lindjes, të paktën një ditë kalendarike përpara rifillimit të punës duhet të deklarojë në drejtorinë rajonale tatimore me anë të deklaratës “Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna” largimin nga puna të punonjësit tjetër.

3.4 Llogaritja e kontributeve të sigurimit shoqëror suplementar

3.4.1 Kontributi i sigurimit shoqëror suplementar llogaritet, deklarohet dhe administrohet në mbështetje të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar”, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.10139, datë 15.5.2009 “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të këtyre ligjeve. Kontributi i sigurimit shoqëror suplementar llogaritet në përqindjet e caktuara mbi pagën bruto mujore të punonjësve përkatës.

3.4.2 Kontributi i detyrueshëm i sigurimit shoqëror shtesë për punonjësit e minierave që punojnë në nëntokë llogaritet, deklarohet dhe administrohet në mbështetje të ligjit përkatës. Kontributi shtesë për punonjësit e minierave që punojnë në nëntokë llogaritet mbi pagën bruto për efekt të llogaritjes së kontributeve për sigurimet shoqërore të punonjësve përkatës, në përqindjet e caktuara për punëdhënësin dhe për punëmarrësin. Lloji i punës në minierë për çdo punonjës të shënohet në rubrikën përkatëse të listëpagesës dhe në se puna kryhet në nëntokë ajo duhet cilësuar me fjalën “nëntokë”, në rubrikën “shënime” të listëpagesës.

3.4.3 Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore suplementare, sipas kushteve të përcaktuara me ligje të veçanta, llogariten, deklarohen dhe administrohen nga tatimpaguesit punëdhënës, sipas rregullave të përcaktuara.

3.4.4 Në pagën bruto për efekt të llogaritjes së kontributit të detyrueshëm të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, kontributit të detyrueshëm të sigurimit shoqëror shtesë për punonjësit e minierave që punojnë në nëntokë, si dhe kontributit të detyrueshëm të sigurimeve shoqërore suplementare, përfshihet edhe shuma e lekëve, që zbritet nga paga e punëmarrësit dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit. Në pagën bruto për llogaritjen dhe deklarimin e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi përjashtohet shuma e lekëve që zbritet nga paga bruto gjithsej dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit.

4. DETYRIMI PËR DEKLARIMIN DHE PAGESËN E KONTRIBUTEVE

4.1 Tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë janë të detyruar të deklarojnë në formë elektronike në administratën tatimore të punësuarit (përfshirë dhe punonjësit e papaguar të familjes së personit fizik me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht), që fillojnë punë për herë të parë apo të punësuar rishtazi pranë tij. Ky deklaram me të dhënat e kërkuara për secilin punonjës bëhet të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës së të punësuarve të rinj apo rishtazi. Personat juridikë dhe fizikë janë të detyruar të deklarojnë në formë elektronike në organet tatimore të larguarit nga puna, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e largimit. Nëse ato nuk deklarojnë largimin brenda këtij afati, detyrimet e tyre për kontributet e sigurimeve llogariten për të gjitha periudhat tatimore deri në datën e deklarimit në organet tatimore të punonjësve të larguar nga puna. Në të dy rastet deklarimi bëhet vetëm në formë elektronike dhe ai përmban të dhënat e deklarates “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna” sipas rubrikave të formularit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4.2 Tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë janë të detyruar të deklarojnë në organet tatimore vetëm në formë elektronike të dhënat për kontributet në total dhe për çdo individ, brenda afateve të caktuara. Deklarimi në formë elektronike përmban të dhënat e deklarates “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” sipas rubrikave të formularit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4.3 Afatet e deklarimit dhe të pagesës së detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore përcaktohen bazuar në statusin e regjistrimit të tatimpaguesve.

a) Deklarojnë dhe paguajnë çdo muaj, brenda datës 20 të muajit pasardhës:

- Tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe për tatimin mbi fitimin.

- Tatimpaguesit organizata jofitimprurëse, ente publike kombëtare apo vendore, fondacione të ndryshme, organizata politike apo shoqërore, persona të tjerë juridikë të cilët nuk regjistrohen në QKR, përfaqësi dhe ambasada të huaja, njësi të zbatimit të projekteve të veçanta dhe persona të tjerë të ngjashëm.

b) Deklarojnë dhe paguajnë çdo tre muaj, mbi baza mujore, brenda datës 20 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendariq :

- Tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë të regjistruar për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

- Tatimpaguesit persona fizikë të regjistruar si persona të vetëpunësuar në aktivitet tregtar apo shërbimi ambulant në kuptim të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

- Tatimpaguesit persona fizikë kryefamiljarë që punësojnë individë si punëtorë shtëpie në kuptim të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

Afatet e deklarimit dhe pagesës së kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Deklarimi në formë elektronike i të dhënave për kontributet, sipas përmbajtjes së rubrikave të deklarates “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” si dhe pagesa e tyre, sipas tatim-paguesve, kryhet në afatet e mëposhtme:

Kategoria e tatimpaguesve	Kontributet që paguhen	Shpeshtësia e deklarimit dhe pagesës	Afati i deklarimit dhe pagesës
Personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin	a) Kontributet që mbahen nga paga e punëmarrësve b) Kontributet e punëdhënësit për punëmarrësit	Mujore	Jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës
Personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin	a) Kontributet e të vetëpunësuarit për vete b) Kontributet për punonjësit e papaguar të familjes c) Kontributet që mbahen nga paga e punëmarrësve d) Kontributet e të vetëpunësuarit për punëmarrësit	Mujore	Jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës
Entet publike kombëtare apo vendore, organizatat jo fitimprurëse, fondacionet e ndryshme, organizatat politike apo shoqërore, përfaqësi dhe ambasada të huaja, njësi të zbatimit të projekteve	a) Kontributet që mbahen nga paga e punëmarrësve b) Kontributet e punëdhënësit për punëmarrësit	Mujore	Jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës
Personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	a) Kontributet që mbahen nga paga e punëmarrësve b) Kontributet e punëdhënësit për punëmarrësit	Për çdo tremujor, mbi baza mujore, brenda datës 20 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik	Jo më vonë se datat: 20 prill; 20 korrik; 20 tetor; 20 janar.
Personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	a) Kontributet e të vetëpunësuarit për vete b) Kontributet për punonjësit e papaguar të familjes c) Kontributet që mbahen nga paga e punëmarrësve d) Kontributet e të vetëpunësuarit për punëmarrësit	Për çdo tremujor, mbi baza mujore, brenda datës 20 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik	Jo më vonë se datat: 20 prill; 20 korrik; 20 tetor; 20 janar.
Personat e vetëpunësuar në aktivitet, tregtar apo shërbimi, ambulant sipas kuptimit të VKM-së përkatës.	Kontributet e të vetëpunësuarit për vete.	Për çdo tremujor, mbi baza mujore, brenda datës 20 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik	Jo më vonë se datat: 20 prill; 20 korrik; 20 tetor; 20 janar.
Kryefamiljarët, që punësojnë persona si punëtorë shtëpie sipas kuptimit të VKM-së përkatës .	Kontributet për të punësuarit si punëtorë shtëpie.	Për çdo tremujor, mbi baza mujore, brenda datës 20 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik	Jo më vonë se datat: 20 prill; 20 korrik; 20 tetor; 20 janar.

4.4 Në të dhënat e deklaratës “Listëpagesa e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, i vetëpunësuarit në aktivitet tregtar apo shërbimi ambulant shënon në rubrikat përkatëse emrin, mbiemrin dhe numrin personal të tij. Shumat fikse të kontributit shoqëror dhe të kontributit shëndetësor shënohen vetëm në rubrikat e totalit të kontributeve përkatëse.

4.5 Kontributet e sigurimeve për personat e punësuar si punëtorë shtëpie, deklarohen e paguhen

nga kryefamiljari që i punëson. Në të dhënat e deklaratës “Listëpagesa e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” në rubrikat përkatëse kryefamiljari shënon emrin, mbiemrin dhe numrin personal të personave të punësuar si punëtorë shtëpie.

4.6 Kryefamiljari që punëson persona si punëtorë shtëpie është i detyruar të deklarojë dhe paguajë kontributet për personat që punëson, pavarësisht se ata gjatë periudhës tatimore mund të jenë të punësuar edhe në punëdhënës të tjerë ose të vetëpunësuar. Të njëjtin veprim janë të detyruar të kryejnë edhe punëdhënësit e tjerë ose të vetëpunësuarit, në rastin e anasjelltë.

4.7 Në zbatim të ligjit “Për procedurat tatimore” dhe udhëzimit në zbatim të tij, personat juridikë dhe fizikë janë të detyruar të paraqesin deklaratën “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” edhe në qoftë se ato, për periudhën tatimore nuk kanë për të paguar kontribute, pasi ai mund të mos ketë kryer aktivitet gjatë asaj periudhe tatimore. Të gjithë personat juridikë dhe fizikë të cilët kanë kaluar në regjistrin pasiv të tatimpaguesve në zbatim të pikës 1, shkronja “a”, “b” dhe “c” të nenit 44 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nuk llogariten dhe paguhen detyrime për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

4.8 Në rastin kur veprimtaria ekonomike e tatimpaguesit person juridik dhe fizik fillon, ndërpritet, përfundon apo kalon në regjistrin pasiv gjatë një muaji, llogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore bëhet në bazë të pagës për ditët e punuara për muajin.

5. FORMA DHE PROCEDURAT E DEKLARIMIT PËR KONTRIBUTET

5.1 Deklarimi i të dhënave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga të gjithë tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë, nga periudha tatimore dhjetor 2014 e në vazhdim, bëhet vetëm në formë elektronike sipas përmbajtjes së rubrikave të dokumenteve “Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi” dhe “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”. Vetëm për tatimpaguesit subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, deklarimi për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhet vetëm në formë elektronike sipas përmbajtjes së rubrikave të dokumenteve “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” dhe “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”, nga periudha tatimore tetor 2014 e në vazhdim.

Në kuptimin e nenit 10 të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të këtij udhëzimi, deklaratat “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” dhe “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”, janë deklarata tatimore sipas përcaktimit në nenin 64 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Deklarata “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” është njëkohësisht deklarim i detyrimeve të tatimpaguesit për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi.

5.2 Tatimpaguesit punëdhënës persona juridikë ose fizikë, kanë detyrimin për mbajtjen e kontributeve të punëmarrësit së bashku me kontributet e punëdhënësit dhe pagimin e tyre në organet tatimore. Në këtë kuptim, çdo tatimpagues punëdhënës, pavarësisht nga pamundësia e tij financiare për të paguar të gjitha detyrimet për kontributet, është i detyruar që brenda afateve të caktuara, të paguajë tërësisht pjesën e detyrimeve për kontributet që mbahen nga paga e punëmarrësve. Në të kundërt, ndaj tatimpaguesit zbatohen masat e mbledhjes me forcë të detyrimit të papaguar, siç përcaktohet në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5.3 Sipas përcaktimit në vendimin përkatës e Këshillit të Ministrave, drejtoria rajonale tatimore dërgon on-line përkatësisht, në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të dhënat analitike vetëm për listëpagesat e likuiduara plotësisht për detyrimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe të dhënat e tjera për kontributet të përcaktuara në këtë vendim.

5.4 Për deklarimin në formë elektronike të të dhënave të rubrikave të deklaratave “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” dhe “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna” zbatohen rregullat dhe procedurat si më poshtë:

a) Deklarimi i të dhënave të deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” nga të gjithë personat juridikë dhe fizikë bëhet mbi baza mujore.

b) Përmbajtja e rubrikave me të dhënat e deklaratave elektronike “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” dhe “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna” janë sipas formës bashkëlidhur këtij udhëzimi. Të dhënat e rubrikave të deklaratave “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” dhe “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna” nga të gjitha subjektet duhet të plotësohen në përputhje me shënimet përkatëse. Përmbajtja dhe shënimet për plotësimin në formë elektronike të rubrikave me të dhënat që përmbajnë këto deklarata janë bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij udhëzimi të detyrueshme për t’u zbatuar.

5.5 Deklarimi i të dhënave të “Listëpagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” është i detyrueshëm të kryhet edhe në rastet kur tatimpaguesi nuk është në gjendje të paguajë detyrimin për kontributet tërësisht apo pjesërisht.

5.6 Deklarimi për herë të parë pas regjistrimit nga personi juridik apo fizik i të dhënave për punonjësit e deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, përfshirë sipas përkatësisë, administratorin, vetë personin fizik apo punonjësin e papaguar të familjes me të cilin ai punon e bashkëjeton ligjërisht, si dhe ndryshimet (shpesh ose paksimet) në numrin e personave të një listëpagese ekzistuese, bëhen vetëm me anë të deklarimit elektronik të të dhënave të rubrikave të deklaratës “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”.

5.7 Për individët punëmarrës të cilët gjatë të njëjtit muaji kanë punuar njëkohësisht në dy ose më shumë tatimpagues punëdhënës, sistemi informatik bën evidentimin e tyre me të gjitha të dhënat për kontributet sipas tatimpaguesve ku kanë punuar gjatë muajit përkatës, bazuar në numrin personal të letërnjoftimit të deklaruar në listëpagesat përkatëse.

5.8 Për treguesin e numrit të punonjësve që kanë punuar te tatimpaguesi gjatë periudhës midis datave të dy deklaratave “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”, në radhë njëra pas tjetrës, sistemi informatik evidenton diferencat midis të dhënave të rubrikave të dy deklaratave. Me deklaratën e radhës krahasuar me deklaratën paraardhëse, duke mbledhur apo zbritur numrin e punonjësve, që shtohen apo që largohen gjatë muajit, deklarohet numri gjithsej i punonjësve që punojnë te subjekti duke filluar nga data që përmban pasqyra pasardhëse rubrikat 21.a dhe 21.b. Ky numër rakor-dohet nga sistemi informatik duke u nisur nga numri i punonjësve sipas deklarimit me deklaratën paraardhëse rubrikat 21.a dhe 21.b mbi të cilat bëhen shtesat e paksimit sipas deklaratës pas-ardhëse.

5.9 Deklarimi në organet tatimore i të dhënave të deklaratave elektronike “Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi” dhe “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna” për personin juridik bëhet nga administratori ose nga një person i autorizuar prej tij dhe për personin fizik, nga vetë ai ose një person i autorizuar prej tij.

5.10 Deklarata “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” dhe deklarata “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna” duhet të kenë nënshkrimin elektronik të përfaqësuesit të tatimpaguesit.

5.11 Në rastet kur, për një periudhë tatimore, nuk ka përputhje ndërmjet shumës totale të kontributeve të deklaruar nga tatimpaguesi dhe shumës së detyrimit të paguar, shuma e paguar mbulon detyrimet e papaguara sipas radhës së pagesave të përcaktuar në nenin 79 të ligjit 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5.12 Nëse për periudhën e deklarimit, mbështetur në aktet ligjore e nënligjore përkatëse, tatimpaguesi person juridik apo fizik, nuk ka kontribute për të paguar, ai ka detyrimin për të deklaruar, sipas procedurave të përcaktuara në pikën 65.1.2 të udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në këto raste me të dhënat e deklarimit “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna” deklarohet largimi nga puna i të gjithë punonjësve, përjashtuar administratorin e personit juridik dhe të vetëpunësuarin.

5.13 Në kuptim të nenit 67 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, tatimpaguesi ka të drejtën për të korrigjuar deklaratën e tij tatimore “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” vetëm njëherë brenda muajit të parë pas deklarimit.

5.14 Të dhënat e deklarimit “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” dërgohen “on line” në organet e sigurimeve shoqërore dhe ato të sigurimeve të kujdesit shëndetësor vetëm pasi të jetë paguar plotësisht e gjithë shuma totale e detyrimit për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që përmban listëpagesa përkatëse.

5.15 Në organet e sigurimeve shoqërore dhe ato të sigurimeve të kujdesit shëndetësor dërgohet “on line” çdo version më i fundit i të dhënave të deklarimit “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, të likuiduar plotësisht për kontributet, sa herë që mund të ndodhin ndryshime në të dhënat e saj duke dhënë shpjegimet përkatëse në rubrikën “shënime”.

5.16 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi dhe protokolle për shkëmbimet elektronike lidhur me rregullat dhe afatet e dërgimit të të dhënave për kontributet.

5.17 Sistemi informatik i tatimeve ofron mundësinë për individët e interesuar, të shohin pagat mujore mbi të cilat janë llogaritur kontributet, si dhe shumat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të paguara dhe ato të pa paguara në emrin e tij sipas historikut.

5.18 Procedurat e evidentimit, të njoftimit, rakordimit dhe të kalimit të kontributeve në llogaritë e fondit të sigurimeve shoqërore dhe në fondin e sigurimeve të kujdesit shëndetësor përcaktohen në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

5.19 Administrata tatimore dërgon në organet përkatëse të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimeve të kujdesit shëndetësor, të dhënat për kontributet siç përcaktohet në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave. Administrata tatimore dërgon në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore të dhënat mujore dhe progresive për kontributet e papaguara në afat, në mënyrë të përmbledhur dhe për çdo tatimpagues.

5.20 Sistemi informatik ofron mundësinë që të dhënat e deklarimit “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” tatimpaguesi t’i kryejë me dy mënyra, si më poshtë:

a) Me hedhje (mbivendosje) të të dhënave të listëpagesës. Pra subjekti të dhënat e listëpagesës së periudhës pasardhëse t’i hedhë mbi formatin e të dhënave të listëpagesës së periudhës paraardhëse duke ruajtur kështu formatimin e uniformitetin, si dhe për të pasur mundësinë e një kontrolli logjik dhe vizual gjatë hedhjes (mbivendosjes) së të dhënave nga subjekti.

b) Me ngarkim të një skedari *xml* me të dhënat e listëpagesës, të prodhuar nga tatimpaguesi, duke respektuar standardin (formatin) e listëpagesës. Ky skedar gjatë ngarkimit të të dhënave kontrollohet nga sistemi informatik për respektimin e të njëjtave rregulla si në rastin e hedhjes me mbivendosje të të dhënave të listëpagesës.

5.21 Për deklaratat dhe listë pagesat e padorëzuara të periudhave tatimore përpara janarit 2012 dhe janar 2012 deri në dhjetor 2014, deklarimi bëhet sipas formës, mënyrës dhe rregullave në fuqi në periudhat tatimore përkatëse.

6.KONTROLI I ORGANEVE TATIMORE

6.1 Organet tatimore kanë të drejtën dhe detyrimin të kontrollojnë tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë për të verifikuar nëse deklaratat dhe pagesat e kontributeve të detyrueshme janë të plota

dhe të sakta, siç përcaktohet në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në udhëzimin në zbatim të tij.

6.2 Në mbështetje të nenit 119 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, punonjësit e administratës tatimore, të autorizuar me shkrim, kryejnë verifikime e kontrole në vendndodhjen e biznesit lidhur me deklarin e numrit të punonjësve. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar, që fillon punë për herë të parë te tatimpaguesi apo të punësuar rishtazi pranë tij, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës (përfshirë dhe punonjësit e papaguar të familjes së të vetëpunësuarit me të cilët ai punon e bashkë-jeton), përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të paguara të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatim-paguesi përkatës detyrohet të paguajë edhe një gjobë prej:

a) 500 000 (pesëqind mijë) lekë kur është tatimpagues i regjistruar njëkohësisht për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tatimin mbi fitimin; dhe

b) 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për çdo rast mosdeklarimi për të gjithë tatimpaguesit e tjerë që nuk përfshihen në shkronjën “a” të kësaj pike.

6.3 Për rastet e konstatuara nga zyra lidhur me shkeljen e afatit të deklarimit të punonjësve, që fillojnë punë për herë të parë te tatimpaguesi apo të punësuar rishtazi, tatimpaguesi punëdhënës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe të kontributeve të paguara të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, detyrohet të paguajë gjobë, sipas nenit 113 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për çdo deklaratë të dorëzuar jashtë afatit sipas përcaktimeve në nenin 119. Kushti për deklarimin e punonjësve të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës nuk përfshin administratorin e shoqërisë të saporegjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Në këtë rast deklarimi i administratorit në administratën tatimore bëhet dy ditë pune pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, nëpërmjet deklaratës “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”.

6.4 Tatimpaguesi duhet të deklarojë në organin tatimor të larguarit nga puna, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e largimit. Nëse ai nuk e bën një gjë të tillë, detyrimet e tij tatimore për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore vlerësohen për të gjithë periudhën deri në datën e deklarimit të tyre në organet tatimore.

6.5 Në kuptim të zbatimit të nenit 119, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, punonjës që fillojnë punë për herë të parë apo rishtas konsiderohen ata që fillojnë apo rifillojnë një marrëdhënie të re punësimi me tatimpaguesin mbi bazën e një kontrate të re pune, ndërsa punonjës që largohen nga puna konsiderohen ata që shkëpusin përfundimisht marrëdhëniet e punës me tatim-paguesin përkatës.

6.6 Kur organet tatimore mbi bazën e rezultateve të verifikimeve apo kontroleve në vendndodhjen e biznesit për numrin e punonjësve, zbulojnë se kontributet nuk janë paguar, lëshojnë një njoftim vlerësimi, ku paraqitet shuma e kontributeve kamatëvonesave dhe gjobave që duhen paguar. Llogaritja e shumave të vlerësuar, si dhe mbledhja e detyrimeve për kontributet, bëhet sipas afateve, procedurave e rregullave të përcaktuara në Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimit në zbatim të tij.

6.7 Në rastet e rivlerësimeve të bëra nga administrata tatimore si rezultat i një kontrolli për kontribute shtesë që lidhen me diferenca në numrin e punonjësve ose në nivelin e pagave, tatimpaguesi është i detyruar të deklarojë në formë elektronike të dhënat shtesë me anë të deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” me shumën e kontributit të shtuar për çdo punonjës, për periudhën tatimore të rivlerësuar. Këto të dhëna shtesë të listëpagesës, regjistrohen në versionin e fundit të listëpagesës së rregulluar.

6.8 Në raste të veçanta, kur gjatë një kontrolli të ushtruar nga administrata tatimore rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar dhe paguar të gjitha detyrimet e duhura të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe këto kontribute është e pamundur të lidhen dhe të alokohen për individë të punësuar, pika 6.7 më sipër nuk zbatohet dhe për tatimpaguesin lëshohet një njoftim

vlerësimi për të gjithë shumën e kontributeve shtesë të vlerësuara.

6.9 Mbi bazën e rivlerësimeve të kryera si më lart, organet tatimore, përgatisin njoftim vlerësimit tatimor, i cili i dërgohet tatimpaguesit përkatës. Tatimpaguesi ka detyrimin dhe përgjegjësinë për pagimin e kontributeve shtesë dhe për deklarimin në administratën tatimore të të dhënave të listepagesës me shumën e kontributeve shtesë, të detajuar me emrat e punëmarrësve sipas periudhave tatimore përkatëse.

6.10 Nëse detyrimet për kontributet e sigurimeve nuk deklarohen apo paguhen brenda afatit të caktuar, organet tatimore kanë të drejtë të marrin masa shtrënguese, në përputhje me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

6.11 Në bazë të ligjit 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, çdo i punësuar mund të apelojë, përkatësisht pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për llogaritjen e shumës së kontributeve të mbajtura nga punëdhënësi. Tatimpaguesi punëdhënësi dhe personi i vetëpunësuar mund të apelojnë në organet tatimore, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

7. VENDI I PAGESËS

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paguhen në degët e bankave të nivelit të dytë ose në “Postën Shqiptare”, të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Këto marrëveshje bashkëpunimi përcaktojnë mekanizmin e pranimit dhe transferimit të pagesës, kushtet që duhet të përmbushen, procedurat e raportimit dhe të dhënat për pagesat e kryera. Në bazë të VKM-së përkatëse procedurat teknike për transferimin e shumave të arkëtuara përcaktohen në udhëzimet përkatëse.

8. RIMBURSIMI I KONTRIBUTEVE

8.1 Nëse si rezultat i një kontrolli ose për arsye të tjera shuma e paguar e detyrimeve për kontributet e sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, tejkalon shumën e llogaritur të detyrimeve për kontributet, drejtoria rajonale tatimore rimbursion diferencën përkatëse sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Kthimi i shumave të detyrimeve, për kontributet e sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, të paguara më tepër nga tatimpaguesi, ose rimbursimi i tyre, nga administrata tatimore, mund të bëhet në një nga format e mëposhtme, duke kryer, sipas radhës, këto veprime:

a) Shuma e detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore ose shëndetësore (detyrim, kamatëvonesa, gjoba) të paguara më tepër kalohet:

- së pari, për llogari të pagimit të detyrimeve të papaguara të kontributeve të të njëjtit lloji;
- së dyti, për llogari të pagimit të detyrimeve të papaguara të kontributeve të llojit tjetër, në rast se nuk ka detyrime të papaguara të të njëjtit lloj kontributesh.

b) Mbipagesa e gjobave të vendosura nga inspektorët, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, mund të përdoret për të mbuluar detyrimet, interesat dhe gjobat e papaguara për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe detyrimet, interesat dhe gjobat e papaguara për tatimet e tjera.

c) Me pëlqimin e tatimpaguesit, shuma e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të paguara më tepër kalon për llogari të pagimit të shumës detyrimeve të mëvonshme të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

d) Nëse të gjitha ose pjesë të kontributeve të paguara më tepër lidhen me kontributet e punëmarrësit, punëdhënësi është përgjegjës për rimbursimin e punëmarrësve brenda 30 ditëve.

e) Shuma e kontributit të sigurimeve shoqërore ose shëndetësore (detyrim kontributiv) e paguar më tepër nuk mund të kalohet për mbulimin e detyrimeve, interesave dhe gjobave të papaguara të tatimeve të tjera.

f) *Shfuqizuar.*

8.2 Gjithë rastet që lidhen me rimbursimin e kontributeve miratohen nga drejtori i drejtorisë rajonale tatimore. Të gjitha veprimet, që lidhen me rimbursimin e detyrimeve për kontributet,

regjistrohen në kontabilitet, në sistemin informatik dhe në dosjen e tatimpaguesit përkatës, duke zbatuar rregullat standarde në fuqi.

8.3 Për shumat e gjobave, që lidhen me kontributet, të cilat mund të kenë kaluar në llogarinë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore apo të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor bashkë me shumat e arkëtuara nga detyrimet e principalit dhe kamatëvonesave për kontributet, drejtoria rajonale tatimore kërkon rimbursimin e tyre nga Drejtoria e Thesarit e cila përcakton rregullat përkatëse dhe mënyrën e raportimit.

8.4 Kur nga rimbursimi i detyrimeve për kontributet e sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore do të duhet të ndryshohen të dhënat e deklaruara të listëpagesës atëherë versioni i listëpagesës me të dhënat e ndryshuara pas rimbursimit, me sqarimet përkatëse, i dërgohet Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

9. DEKLARIMI I KONTRIBUTEVE PËR PERSONAT EKONOMIKISHT AKTIVË NË DY OSE MË SHUMË SUBJEKTE

Për rastet kur i njëjti person (i punësuar, i vetëpunësuar, pjesëtar i familjes, që nuk trajtohet me pagë, por që punon e bashkëjeton ligjërisht me të vetëpunësuarin), gjatë muajit, është ekonomikisht aktiv në dy ose më shumë subjekte (persona juridikë ose persona fizikë), me kontratë pune, me ose pa afat, me kohë të plotë apo të pjesshme pune, pavarësisht nga lloji i kontratës, llogaritja dhe deklarimi për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, nga secili prej tatimpaguesve bëhet sipas rregullave më poshtë:

9.1 Secili prej subjekteve, sipas përmbajtjes së të dhënave të rubrikave të deklaratës “Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”, bën deklarimin e punonjësit në drejtorinë rajonale tatimore njësoj sikur personi të mos ishte i punësuar në punëdhënësit tjetër.

9.2 Për personin e punësuar në dy tatimpagues (persona juridikë ose fizikë) deklarimi i të dhënave sipas përmbajtjes së deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” bëhet, nga të dy tatimpaguesit, si më poshtë:

a. Kur shuma e pagave bruto mujore, që punonjësi merr nga të dy tatimpaguesit është më e vogël se kufiri i pagës maksimale për kontributet shoqërore, atëherë për këtë punëmarrës, secili prej subjekteve në mënyrë të pavarur, llogarit dhe deklaron kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore njësoj sikur personi të mos ish i punësuar në punëdhënësit tjetër. Pra kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore deklarohen mbi bazën e pagës reale por jo më pak se niveli i pagës minimale në shkallë vendi.

b. Kur shuma e pagave bruto mujore, që punonjësi merr nga të dy tatimpaguesit është sa, ose më e madhe, nga kufiri i pagës maksimale për kontributet shoqërore, atëherë për këtë punëmarrës, tatimpaguesi nga i cili ai merr pagën më të lartë llogarit dhe deklaron kontributet shoqërore mbi bazën e pagës reale deri në kufirin e pagës maksimale për kontributet shoqërore. Tatimpaguesi tjetër, nga i cili punëmarrësi merr pagën më të ulët deklaron dhe paguan kontributet shoqërore mbi bazën e pagës mujore, që rezulton si diferencë midis pagës maksimale për kontributet shoqërore me pagën, që punonjësi merr nga tatimpaguesi prej të cilit ai merr pagën më të lartë. Në këtë rast tatimpaguesi i dytë, nga i cili punëmarrësi merr pagën më të ulët, te emri i personit, në rubrikën “Shënime” të të dhënave të listëpagesës, shënon “Deklaruar kontribute shoqërore me pagë te tatimpaguesi “x” me NIPT.....”, si dhe ruan vërtetimin e lëshuar nga tatimpaguesi që deklaron dhe paguan pagën më të lartë. Kontributet e sigurimit shëndetësor llogariten dhe deklarohen nga të dy tatimpaguesit mbi bazën e pagës bruto mujore të punonjësit por jo më pak nga paga minimale në shkallë vendi dhe pa kufi të sipërm të saj.

c. Kur paga bruto mujore e punonjësit te njëri nga tatimpaguesit është sa, ose më e madhe, se kufiri i pagës maksimale për kontributet shoqërore, atëherë nga ky tatimpagues ato llogariten dhe deklarohen në nivelin e pagës maksimale për kontributet shoqërore. Tatimpaguesi tjetër nga i cili punonjësi merr pagën më të ulët, nuk llogarit dhe nuk deklaron kontribute shoqërore, por te emri i personit, në rubrikat e vlerave të kontributit shoqëror të të dhënave të listëpagesës vendos zero, si dhe në rubrikën “Shënime” ky subjekt shënon “Deklaruar kontribute shoqërore me pagë maksimale te

tatimpaguesi “x” me NIPT.....”, si dhe ruan vërtetimin e lëshuar nga tatimpaguesi që deklaroi dhe paguan kontributet shoqërore në nivelin e pagës maksimale. Kontributet e sigurimit shëndetësor llogariten dhe deklarohen nga të dy tatimpaguesit mbi bazën e pagës bruto mujore të punonjësit por jo më pak nga paga minimale në shkallë vendi dhe pa kufi të sipërm të saj.

9.3 Në rastet kur personi fizik i vetëpunësuar, është njëkohësisht edhe i punësuar te një punëdhënës (person juridik ose person fizik), ai duhet gjithashtu të paguajë kontributet edhe si i punësuar te ky punëdhënës. Për llogaritjen dhe deklarimin e kontributeve për personin e vetëpunësuar, i cili njëkohësisht është edhe punëmarrës te një punëdhënës tjetër veprohet si më poshtë:

a) Kur paga mujore e të vetëpunësuarit si punëmarrës tek një tatimpagues tjetër është më e vogël se kufiri maksimal i pagës për kontributet shoqërore, veprohet si vijon:

i. Tatimpaguesi punëdhënës (person juridik ose person fizik), ku i vetëpunësuar është i punësuar, bën gjithë veprimet e llogaritjes dhe deklarimit të kontributeve njësoj si për gjithë punëmarrësit e tjerë sikur personi të mos ishte edhe i vetëpunësuar. Pra kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore llogariten dhe deklarohen mbi bazën e pagës reale por jo më pak nga paga minimale në shkallë vendi.

ii. I vetëpunësuar, si i tillë, për vete, te personi fizik do të llogaritë dhe deklarojë kontribute shoqërore deri në kufirin e pagës minimale në shkallë vendi, në atë masë që shuma e pagës si punëmarrës dhe paga deri në kufirin minimal si i vetëpunësuar të mos kalojë kufirin maksimal të pagës për kontributet shoqërore. Në këtë rast te emri i tij në rubrikën “Shënime” të të dhënave të listëpagesës, shënon “Deklaruar kontribute shoqërore me pagë te subjekti “x” me NIPT.....”, si dhe ruan vërtetimin e tatimpaguesit ku është i punësuar. Për këtë rast, nga personi fizik, kontributi i sigurimit shëndetësor të të vetëpunësuarit për vete llogaritet dhe deklarohet mbi bazën e pagës minimale për kontributin e sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarin, njësoj sikur i vetëpunësuar të mos ishte edhe i punësuar.

b) Kur paga mujore e të vetëpunësuarit si punëmarrës është sa ose më e madhe se kufiri maksimal i pagës për kontributet shoqërore, veprohet si vijon:

i. Tatimpaguesi punëdhënës (person juridik ose person fizik), ku i vetëpunësuar është i punësuar, kontributet e sigurimeve shoqërore i llogarit dhe deklaroi mbi pagën deri në nivelin e pagës maksimale për kontributet shoqërore. Kontributet e sigurimit shëndetësor i llogarit dhe deklaroi mbi bazën e pagës bruto reale të të vetëpunësuarit si punëmarrës pa kufi të sipërm të saj.

ii. I vetëpunësuar, si i tillë, për vete, te personi fizik nuk llogarit dhe nuk deklaroi kontribute shoqërore, por te emri i personit, në rubrikat e vlerave të kontributit shoqëror të të dhënave të listëpagesës vendos zero, si dhe në rubrikën “Shënime” ky subjekt shënon “Deklaruar kontribute shoqërore me pagë maksimale te subjekti “x” me NIPT.....”, si dhe ruan vërtetimin e lëshuar nga tatimpaguesi që deklaroi dhe paguan kontributet shoqërore në nivelin e pagës maksimale. Për këtë rast, nga personi fizik, kontributi i sigurimit shëndetësor të të vetëpunësuarit për vete llogaritet dhe deklarohet mbi bazën e pagës minimale për kontributin e sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarin, njësoj sikur i vetëpunësuar të mos ishte edhe i punësuar.

iii. Në të njëjtën mënyrë, si rastet më sipër në pikën 9.3 për të vetëpunësuarin, veprohet edhe për punonjës in e papaguar të familjes, i cili punon e bashkëjeton ligjërisht me të vetëpunësuarin, kur ai është edhe i punësuar në një punëdhënës.

9.4 Në rastet kur i njëjti person, ortak i vetëm, është i regjistruar si person juridik dhe paguan kontribute si i punësuar te shoqëria, por njëkohësisht është i regjistruar edhe si person fizik, për llogaritjen dhe deklarimin e kontributeve për vete veprohet si më poshtë:

a. Personi juridik, kontributet e sigurimeve shoqërore, për ortakun e vetëm si i punësuar i shoqërisë i llogarit dhe deklaroi mbi pagën bruto jo më pak nga paga minimale në shkallë vendi deri në nivelin e pagës maksimale për kontributet shoqërore. Kontributi i sigurimit shëndetësor llogaritet dhe deklarohet mbi bazën e pagës bruto të ortakut të vetëm si i punësuar, jo më pak nga paga minimale në shkallë vendi dhe pa kufi të sipërm të saj.

b. Personi fizik, për të vetëpunësuarin për vete do të llogaritë dhe deklarojë kontribute

shoqërore deri në kufirin e pagës minimale në shkallë vendi, në atë masë që shumën e pagës si punëmarrës të personi juridik dhe paga deri në kufirin minimal si i vetëpunësuar të mos kalojë kufirin maksimal të pagës për kontributet shoqërore. Në këtë rast të emri i tij në rubrikën “Shënime” të të dhënave të listëpagesës, shënon “Deklaruar kontribute shoqërore me pagë te subjekti “x” me NIPT.....”, si dhe ruan vërtetimin e subjektit ku është i punësuar. Për këtë rast, nga personi fizik, kontributi i sigurimit shëndetësor të të vetëpunësuarit për vete llogaritet dhe deklarohet mbi bazën e pagës minimale për kontributit e sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarit njësoj sikur i vetëpunësuarit të mos ishte edhe i punësuar.

9.5 Në rastet kur i njëjti individ ka të regjistruar në emër të tij dy tatimpagues persona fizikë me ose pa punëmarrës dhe punonjës të papaguar të familjes, të dy tatimpaguesit bëjnë llogaritjen dhe deklarimin e kontributeve të të vetëpunësuarit për vete njësoj sikur i vetëpunësuarit të mos ishte i vetëpunësuar në dy tatimpagues persona fizikë. Pra secili prej tatimpaguesve persona fizikë, për të vetëpunësuarin, për vete, llogarit dhe deklarohet kontributet e sigurimeve shoqërore mbi një pagë jo më të vogël se paga minimale në shkallë vendi e deri në atë masë sa që shumën e pagave të të dy personat fizikë të mos kalojë kufirin e pagës maksimale për kontributet shoqërore. Për këtë rast, nga secili personi fizik, kontributi i sigurimit shëndetësor të të vetëpunësuarit për vete llogaritet dhe deklarohet mbi bazën e pagës minimale për kontributin e sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarit.

9.6 Për rastet kur, gjatë muajit, një person i regjistruar si tatimpagues person fizik (i vetëpunësuar), me ose pa punëmarrës, punon edhe si punonjës i papaguar i familjes, në një tatimpagues person fizik (i vetëpunësuar) i regjistruar në emër të familjarëve të tij, me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht, të dy tatimpaguesit bëjnë deklarimin e personit në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse. Personi fizik, ku i vetëpunësuarit punon si punonjës i papaguar i familjes bën deklarimin, në drejtorinë rajonale tatimore, me të dhënat sipas rubrikave të deklaratës “Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”. Personi i regjistruar si person fizik i vetëpunësuar por edhe si punonjës i papaguar i familjes në një person fizik të familjarëve të tij, pasqyrohet në të dhënat e rubrikave të listëpagesës përkatësisht nga të dy subjektet por llogaritja dhe deklarimi i kontributeve kryhet vetëm nga personi fizik i regjistruar në emër të personit në fjalë, si më poshtë:

a. Personi fizik, për të vetëpunësuarin për vete llogaritet dhe deklarohet kontributet e sigurimeve shoqërore mbi një pagë jo më të vogël se paga minimale në shkallë vendi e deri në kufirin e pagës maksimale për kontributet shoqërore. Për këtë rast kontributi i sigurimit shëndetësor të të vetëpunësuarit për vete llogaritet dhe deklarohet mbi bazën e pagës minimale për kontributin e sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarit.

b. Personi fizik tjetër, i regjistruar në emër të familjarëve, të i cili i vetëpunësuarit punon si punonjës i papaguar i familjes, të emri i tij në rubrikat e vlerave të kontributit shoqëror dhe shëndetësor të listëpagesës, vendos zero dhe në rubrikën “Shënime” të listëpagesës bën shënimin “Punonjës i papaguar i familjes ka deklaruar kontribute të personi fizik “x” i regjistruar në emër të tij me NIPT.....”.

9.7 Për rastet kur punonjësi i papaguar i familjes (pjesëtari i familjes, që nuk trajtohet me pagë), që punon e bashkëjeton ligjërisht me të vetëpunësuarin, gjatë muajit punon në dy tatimpagues persona fizikë, të regjistruar në emër të familjarëve të tij me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht, të dy tatimpaguesit bëjnë deklarimin e punonjësit të papaguar të familjes, me të dhënat sipas rubrikave të deklaratës “Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”. Të dy tatimpaguesit në të dhënat e rubrikave të listëpagesës së kontributeve pasqyrojnë punonjësin e papaguar të familjes, por llogaritja dhe deklarimi i kontributeve kryhet vetëm nga njëri prej tatimpaguesve (person fizik) i regjistruar në emër të familjarëve të tij, në nivelin e pagës minimale, sipas përkatësisë për kontributet shoqërore dhe ato shëndetësore për të vetëpunësuarit. Tatimpaguesi tjetër (person fizik) të emri përkatës i familjarit, në rubrikat e vlerave të kontributit shoqëror dhe shëndetësor të listëpagesës vendos zero dhe në rubrikën “Shënime” të listëpagesës bën shënimin “Deklaruar kontribute si punonjës i papaguar i familjes të personi fizik “x” me NIPT.....”.

9.8 Kur rezulton që kontributi shoqëror në total i paguar për të njëjtin person nga të dy tatimpaguesit është më i madh se kontributi i llogaritur mbi pagën maksimale për kontributet shoqërore për të punësuarit, atëherë për shumën totale të kontributeve shoqërore të paguara më tepër për punonjësin e punësuar në të dy tatimpaguesit, drejtoria rajonale tatimore, mbi bazën e kërkesës së tij me shkrim, bën rimbursimin e tatimpaguesit nga i cili punonjësi ka marrë pagën më të lartë. Ky tatimpagues bën rimbursimin e punonjësit për shumën totale të pjesës së kontributeve të punëmarrësit të paguar më tepër në të dy subjektet. Veprimet e rimbursimit të kontributeve duhet të pasqyrohen në versionin e listëpagesës me të dhëna të ndryshuara, të periudhës tatimore përkatëse, e cila i kërkohej dhe duhet të deklarohet nga tatimpaguesi përkatës. Kur të dhënat e listëpagesës janë dërguar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor atëherë versioni i listëpagesës me të dhënat e ndryshuara për kontributet i dërgohet edhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

9.9 Për të gjitha rastet e përmendura në pikat 9.1 deri 9.8 më sipër administrata tatimore kryen verifikimet e vlerësimet përkatëse. Të dhënat e nevojshme për të verifikuar kontributet e deklaruara për personat e dypunësuar nga tatimpaguesit përkatës, janë të disponueshme për punonjësit e administratës tatimore në sistemin informatik të deklarimit elektronik të të dhënave të listëpagesës. Për personat, të cilët gjatë të njëjtit muaji kanë punuar njëkohësisht në dy ose më shumë tatimpagues sistemi informatik bën evidentimin e punonjësve sipas tatimpaguesve ku kanë punuar gjatë muajit përkatës, bazuar kjo në numrin personal të letërnjoftimit të deklaruar në listëpagesa.

9.10 Për gjitha rastet e trajtuara në pikat si më sipër, për personat ekonomikisht aktivë në dy ose më shumë subjekte, për llogaritjen dhe deklarimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të tyre, nga secili prej tatimpaguesve, zbatohen rregullat dhe kufizimet e përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

10. TË TJERA

10.1 Për punëmarrësit, që gjatë periudhës tatimore, për një pjesë, apo për gjithë periudhën, nuk kanë punuar për arsye se u ka lindur e drejta për të marrë përfitime afatshkurta nga skema e sigurimeve shoqërore, përfitimet do të kërkohej në organet e sigurimeve shoqërore nëpërmjet tatimpaguesit përkatës sipas rregullave të përcaktuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Përfitimet nga skema e sigurimit shëndetësor, kontribuuesi i kërkon sipas rregullave të përcaktuara nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Në të dhënat e deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” tatimpaguesi nuk deklaron përfitimet e punonjësve të ndryshëm nga skema e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

10.2 Në mbështetje të Kodit të Punës dhe të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për rastet e sëmundjeve dhe të kujdesit të fëmijës në ngarkim të sëmurë, të vërtetuara me raport mjekësor, deri në 14 ditët e para të raportit paguhet nga punëdhënësi ndërsa pas ditës së 14 raportet mjekësore paguhet nga fondet e sigurimeve shoqërore. Të ardhurat e personit si pasojë e raportit mjekësor deri në 14 ditët e para, për efekt të pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi trajtohen, njëllëj si edhe të ardhurat nga paga, pavarësisht nga mënyra e llogaritjes së shpërblimit ditor. Pra nga shuma e përlllogaritur e të ardhurave të punëmarrësit ndalet kontributi i sigurimeve shoqërore, shëndetësore si dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi sipas përcaktimeve ligjore. Gjithashtu punëdhënësi paguan kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që është detyrimi i tij dhe që llogariten kundrejt të ardhurave të punëmarrësit.

10.3 Në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore ndahen, në përqindje mbi pagën bruto mujore, sipas degëve të sigurimit si më poshtë:

Nr	Dega e sigurimit shoqëror të:	Kontributet në përqindje			
		Për punëmarrësit			Personi fizik (i vetëpunësuar) për veten e vet dhe për punonjësit e papaguar të familjes
		Gjithsej	Pjesa e punëdhënësit	Nga paga e punëmarrësit	
1	Sëmundjeve (paafhtësi e përkohshme)	0.30	0.18	0.12	0.00
2	Barrë lindjeve	1.40	0.83	0.57	1.40
3	Pensione	21.60	12.79	8.81	21.60
4	Aksidente dhe sëmundjeve profesionale	0.30	0.30	0.00	0.00
5	Papunësisë	0.90	0.90	0.00	0.00
	Shuma sigurim shoqëror	24.50	15.00	9.50	23.00
	Shuma sigurim shëndetësor	3.40	1.70	1.70	3.40
	T O T A L I	27.90	16.70	11.20	26.40

10.4 Sipas përqindjeve në tabelën më sipër, kontributet e sigurimeve shoqërore për të punësuarin llogariten mbi pagën bruto mujore brenda kufirit të pagës minimale në shkallë vendi dhe kufirit të pagës maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore të miratuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

10.5 Kontributi i sigurimit shëndetësor për të punësuarin llogaritet mbi pagën bruto mujore, e cila nuk mund të jetë më e vogël nga paga minimale në shkallë vendi dhe nuk ka kufi të sipërm të saj.

10.6 Në pagën bruto për llogaritjen dhe deklarimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përfshihet edhe shuma e lekëve që zbritet nga paga dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit.

Në pagën bruto për llogaritjen dhe deklarimin e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi nuk përfshihet shuma e lekëve që zbritet nga paga dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit.

10.7 Për personin fizik, i vetëpunësuar, me ose pa punëmarrës, si dhe për punonjësit e papaguar të familjes me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht, kontributi i sigurimit shoqëror llogaritet mbi pagën minimale në shkallë vendi, ndërsa kontributi i sigurimit shëndetësor llogaritet mbi dyfishin e pagës minimale në shkallë vendi mbi të cilën edhe llogariten kontributet e sigurimeve shoqërore.

Personi fizik, për vete, me dëshirën e tij, kontributet e sigurimeve shoqërore mund t'i llogarisë e paguajë mbi bazën e një page edhe më të madhe nga paga minimale në shkallë vendi deri në kufirin e pagës maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore të punëmarrësit.

10.8 Në rubrikën e listëpagesës “Numri i kategorisë të punonjësve për kontributet” shënohet një numër i paracaktuar që përfaqëson kategorinë e punonjësve për efekt të deklarimit dhe llogaritjes së kontributeve të cilës i përket punonjësi përkatës, si vijon :

- Kategoria 1. I punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme që ka punuar më shumë se 87 orë në muaj.

- Kategoria 2. I punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme që ka punuar më pak se 87 orë në muaj.

- Kategoria 3. I punësuar, i cili për një pjesë të muajit ka qenë me raport paafhtësie të përkohshme deri në 14 ditët e para me raport mjekësor dhe më tej vijon të punojë ose jo, por nuk vazhdon me raport mjekësor, si dhe nuk ka shkëputur marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës. Kur shuma e orëve të punës për ditët e punuara së bashku me orët e llogaritura për ditët e raportit deri 14 ditët e para (sipas përcaktimit në kontratën e punës për orët ditore të punës) është më shumë se 87 orë në muaj.

- Kategoria 4. I punësuar, i cili për një pjesë të muajit ka qenë me raport paaftësie të përkohshme deri në 14 ditët e para me raport mjekësor dhe më tej vijon të punojë ose jo, por nuk vazhdon me raport mjekësor, si dhe nuk ka shkëputur marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës. Kur shuma e orëve të punës për ditët e punuara së bashku me orët e llogaritura për ditët e raportit deri 14 ditët e para (sipas përcaktimit në kontratën e punës për orët ditore të punës) është më pak se 87 orë në muaj.

- Kategoria 5. I punësuar, i cili për një pjesë të muajit ka punuar, më pas ka qenë me raport paaftësie të përkohshme deri në 14 ditët e para me raport dhe më tej nga dita e 15 vazhdon me raport mjekësor deri në fund të muajit dhe merr përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, pavarësisht nga shuma e orëve të punës për ditët e punuara së bashku me orët e llogaritura për ditët e raportit deri 14 ditët e para (sipas përcaktimit në kontratën e punës për orët ditore të punës).

- Kategoria 6. I punësuar për herë të parë apo rishtazi te subjekti përkatës pavarësisht nga data e fillimit dhe orët e punuara gjatë muajit.

- Kategoria 7. I punësuar i larguar nga puna (shkëputur përfundimisht marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës) pavarësisht nga data e shkëputjes dhe orët e punuara gjatë muajit.

- Kategoria 8. I punësuar në dy subjekte (i dypunësuar) kur shuma e pagave të dy subjektet është më e vogël, nga paga maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore.

- Kategoria 9. I punësuar në dy subjekte (i dypunësuar) kur shuma e pagave të dy subjektet është sa ose më e madhe nga paga maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore dhe paga e realizuar të njëri subjekt është më e madhe nga paga e realizuar të subjekti tjetër.

- Kategoria 10. I punësuar në dy subjekte (i dypunësuar) kur paga vetëm të njëri subjekt është sa ose më e madhe nga paga maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore.

- Kategoria 11. I vetëpunësuar (person fizik, me ose pa punëmarrës), pavarësisht nga orët e punuara gjatë muajit.

- Kategoria 12. Punonjës i papaguar i familjes të personit fizik me të cilin ai punon e bashkëjeton ligjërisht, pavarësisht nga orët e punuara gjatë muajit.

- Kategoria 13. I vetëpunësuar (person fizik, me ose pa punëmarrës) i regjistruar për herë të parë apo pas ndërprerjes së veprimtarisë.

- Kategoria 14. I vetëpunësuar (person fizik, me ose pa punëmarrës) i çregjistruar nga organet tatimore apo që ndërpret veprimtarinë gjatë muajit.

- Kategoria 15. Punonjës i papaguar i familjes të personit fizik me të cilin ai punon e bashkëjeton ligjërisht, i regjistruar për herë të parë apo rishtazi te ky subjekt.

- Kategoria 16. Punonjës i papaguar i familjes të personit fizik me të cilin ai punon e bashkëjeton ligjërisht, i larguar nga puna gjatë muajit.

- Kategoria 17. I vetëpunësuar edhe i punësuar në subjekt tjetër (person juridik ose person fizik) te i cili paguan kontribute mbi pagë më të vogël se paga maksimale mbi të cilën llogariten kontributet shoqërore.

- Kategoria 18. Punonjës i papaguar i familjes që punon në personin fizik të regjistruar në emër të familjarëve të tij me të cilët ai punon bashkëjeton ligjërisht, dhe gjithashtu është i punësuar edhe në subjekt tjetër (person juridik ose person fizik) te i cili paguan kontribute mbi pagë më të vogël se paga maksimale mbi të cilën llogariten kontributet shoqërore.

- Kategoria 19. I vetëpunësuar (person fizik) apo dhe punonjës i papaguar i familjes me të cilin ai punon e bashkëjeton ligjërisht, i punësuar edhe në subjekt tjetër (person juridik ose person fizik) te i cili paguan kontribute mbi pagë sa ose më të madhe se paga maksimale mbi të cilën llogariten kontributet shoqërore.

- Kategoria 20. Ortak i vetëm i punësuar në personin juridik të regjistruar në emër të tij dhe gjithashtu i regjistruar edhe si person fizik (i vetëpunësuar).

- Kategoria 21. I vetëpunësuar në dy subjekte persona fizikë të regjistruara në emër të tij.

- Kategoria 22. I vetëpunësuar (person fizik), i cili punon edhe si punonjës i papaguar i familjes në një subjekt person fizik i regjistruar në emër të familjarëve të tij, me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht, pavarësisht nga orët e punuara gjatë muajit.

- Kategoria 23. Punonjës i papaguar i familjes që punon në dy subjekte persona fizikë dhe të regjistruara në emër të familjarëve të tij me të cilët ai punon bashkëjeton ligjërisht, pavarësisht nga orët e punuara gjatë muajit.

- Kategoria 24. I punësuar me kontratë me afat më pak se një javë gjatë vitit.

- Kategoria 25. I punësuar për herë të parë apo rishtazi në këtë profesion që deklarohet, në subjekte, të cilat punojnë me material porositësi (fason), së bashku me kohën e punuar në të njëjtin profesion në subjekte fason, për afatin e caktuar sipas kuptimit të VKM-së përkatëse.

- Kategoria 26. Person në periudhën e programit të nxitjes së punësimit të miratuar dhe me financim të pjesshëm nga zyra përkatëse e punësimit të totalit të detyrimit për kontributet.

- Kategoria 27. Person në periudhën e kursit të formimit profesional, apo dhe programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë, të miratuara dhe me financim nga zyra përkatëse e punësimit të detyrimit të kontributeve vetëm për degën e aksidenteve në punë

- Kategoria 28. Nxënës i shkollës së mesme apo profesionale, apo student, për kohën e praktikës mësimore të miratuar nga institucionet përkatëse shtetërore

- Kategoria 29. I vetëpunësuar në aktivitet tregtar apo shërbimi, ambulant

- Kategoria 30. I punësuar si punëtor shtëpie nga kryefamiljari i regjistruar në organin tatimor.

- Kategoria 31. I punësuar, i cili për gjithë muajin ka qënë me raport leje barrëllindje ose raport mjekësor pas ditës së 14 dhe merr përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, por nuk i ka shkëputur (zgjidhur) marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës.

10.9 Për kohën që të dhënat e formularit listëpagesa e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, nga administrata tatimore nuk janë dërguar akoma në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, vërtetimet për kontributet e paguara, që kërkojnë tatimpaguesit dhe individët kontribuues, lëshohen zyrtarisht nga drejtoria rajonale tatimore përkatëse sipas rregullave dhe afateve të miratuara nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Këto vërtetime, të cilat konfirmojnë situatën e tatimpaguesit dhe individit përkatës lidhur me kontributet, janë si më poshtë:

- Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin;

- Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për individët.

Modeli i vërtetimeve të mësipërme është sipas formateve bashkëngjitur këtij udhëzimi.

10.10 Të dhënat e rubrikave të deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, nga drejtoria rajonale tatimore dërgohen në formë elektronike, në organet e sigurimeve shoqërore dhe ato të sigurimeve të kujdesit shëndetësor, vetëm pasi ato të jenë likuiduar plotësisht nga tatimpaguesi përkatës për shumën totale të detyrimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të periudhës tatimore përkatëse. Listëpagesat e palikujduara plotësisht nga tatimpaguesi administrohen në drejtorinë rajonale tatimore deri sa të kryhet pagesa e plotë e shumës së kontributeve që ato përmbajnë.

10.11 Me kërkesën e vetë tatimpaguesve, drejtoria rajonale tatimore mund të konfirmojë zyrtarisht të dhënat e formularit të listëpagesave, të cilat nuk i ka dërguar akoma në organet përkatëse të sigurimeve shoqërore apo të sigurimeve të kujdesit shëndetësor. Për rastet kur organeve tatimore i del e nevojshme të kryejnë verifikime në listëpagesa, të cilat i kanë dorëzuar në organet e sigurimeve shoqërore, kopje të tyre do të kërkojnë zyrtarisht dhe dërgohen nga organet e sigurimeve shoqërore.

10.12 Instituti i Sigurimeve Shoqërore furnizon punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit me librezat e sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore. Punëdhënësi pajis të punësuarit e tij me librezën e kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, dhe i plotëson ato çdo muaj në datën e pagesës së pagës mujore. Për të vetëpunësuarit dhe pjesëtarët e familjes të patrajtuar me pagë, si dhe për punëmarrësit e punësuar te i vetëpunësuar, që ka statusin “i vetëpunësuar me punëmarrës”, librezat e kontributeve plotësohet dhe vërtetohet nga strukturat lokale, të autorizuar, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

11. Bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe pjesë e pandarë e tij janë:

11.1 Deklarata “Listëpagesa e Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi”;

11.2 Shënime për plotësimin e rubrikave me të dhënat që përmban deklarata “Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi”;

11.3 “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”;

11.4 Shënime për plotësimin në formë elektronike të rubrikave me të dhënat që përmban deklarata “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”;

11.5 Tabela “Rregullat e kontrollit të listëpagesës sipas kategorive të punonjësve”;

11.6 Vërtetim “Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin”;

11.7 Vërtetim “Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për individin”;

12. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe drejtoritë rajonale tatimore për zbatimin e këtij udhëzimi. Për problemet përkatëse udhëzimi zbatohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

13. Udhëzimi nr.26, datë 16.4.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

SHËNIME PËR PLOTËSIMIN E RUBRIKAVE TË DEKLARATËS “LISTËPAGESA E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE, SHËNDETËSORE DHE TATIMIT MBI TË ARDHURAT NGA PUNËSIMI”

Për plotësimin e rubrikave të deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë mbajnë parasysh sa më poshtë:

1. Në rubrikën 1 “NIPT”- shënohet numri i NIPT-it kryesor të tatimpaguesit.
2. Në rubrikën 2 “Emri i tatimpaguesit” – shënohet emri i tatimpaguesit sipas NIPT-it kryesor të tij.
3. Në rubrikën 3 “Periudha tatimore” – shënohet viti dhe muaji për të cilin bëhet deklarimi. Për çdo muaj kalendarik duhet të deklarohet një listëpagesë.
4. Në rubrikën 4 “Periodiciteti i deklarimit” – shënohet shpeshësia apo periodiciteti i deklarimit. Personat juridikë e fizikë, përjashtuar personat juridikë e fizikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël shënojnë fjalën “Mujor”, ndërsa personat juridikë e fizikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël shënojnë fjalën “Tremujor”.
5. Në rubrikën 5 “Adresa kryesore” – shënohet adresa kryesore e tatimpaguesit.
6. Në rubrikën 6 “Veprimtaria kryesore” – shënohet veprimtaria kryesore e tatimpaguesit
7. Në rubrikën 7 “Veprimtaria e degës/njesisë” – shënohet veprimtaria ekonomike e degës/njesisë së tatimpaguesit, në rast se ka një degë, filial, apo njësi.
8. Në rubrikën 8 “Pa veprimtari” – shënohet X për ato periudha tatimore kur tatimpaguesi nuk kryen veprimtari. Në këto raste nëpërmjet “Deklaratës së të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna” më përpara duhet të jetë deklaruar largimi nga puna i të gjithë punonjësve, përjashtuar administratorin e personit juridik dhe personin fizik për veten e vet, për të cilët deklarohen të dhënat duke plotësuar rubrikat përkatëse me zero. Të gjithë personat juridikë dhe fizikë të cilët kanë kaluar në regjistrin pasiv të tatimpaguesve në zbatim të pikës 1, shkronja “a”, “b” dhe “c” të nenit 44 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nuk llogariten dhe paguhen detyrime për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Në rubrikën “Shënime” të listëpagesës jepen shpjegimet për arsyet e mosdeklarimit të detyrimeve për kontributet.
9. Në rubrikën 9 “Numri personal” – për punonjësit shtetas shqiptarë, shënohet numri personal i identitetit sipas kuptimit të ligjit nr.8951, datë 10.10.2002 “Për numrin e identitetit të shtetasve”, të ndryshuar dhe vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave. Për të punësuarit apo të vetëpunësuarit shtetas të huaj që punojnë në Shqipëri, si numër personal për efekt të deklarimit të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore shërben numri i lejes së qëndrimit ose i lejes provizore të qëndrimit.
10. Në rubrikën 10 “Emri e mbiemri” – shënohet emri e mbiemri i çdo punonjësi kundrejt numrit personal të identitetit të tij sipas kuptimit të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.
11. Në rubrikën 11 “Detyra, funksioni, profesioni apo puna që ka kryer punonjësi” – shënohet detyra apo profesioni që punonjësi kryen në tatimpaguesin përkatës. Detyra apo profesioni zgjidhen nga lista kombëtare e profesioneve sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.627, datë 11.6.2009 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve”, të ndryshuar.
12. Në rubrikën 12 “Numri i kategorisë të punonjësit për kontributet” – Shënohet numri i kategorisë së punonjësve duke zgjedhur një nga kategoritë e punonjësve për efekt të deklarimit dhe llogaritjes së kontributeve të cilës i përket punonjësi përkatës, si vijon :
Kategoria 1. I punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme që ka punuar më shumë se 87 orë në muaj.
Kategoria 2. I punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme që ka punuar më pak se 87 orë në muaj.

Kategoria 3. I punësuar, i cili për një pjesë të muajit ka qenë me raport paaftësie të përkohshme deri në 14 ditët e para me raport mjekësor dhe më tej vijon të punojë ose jo, por nuk vazhdon me raport mjekësor, si dhe nuk ka shkëputur marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës. Kur shumta e orëve të punës për ditët e punuara sëbashku me orët e llogaritura për ditët e raportit deri 14 ditët e para (sipas përcaktimit në kontratën e punës për orët ditore të punës) është më shumë se 87 orë në muaj.

Kategoria 4. I punësuar, i cili për një pjesë të muajit ka qenë me raport paaftësie të përkohshme deri në 14 ditët e para me raport mjekësor dhe më tej vijon të punojë ose jo, por nuk vazhdon me raport mjekësor, si dhe nuk ka shkëputur marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës. Kur shumta e orëve të punës për ditët e punuara së bashku me orët e llogaritura për ditët e raportit deri 14 ditët e para (sipas përcaktimit në kontratën e punës për orët ditore të punës) është më pak se 87 orë në muaj.

Kategoria 5. I punësuar, i cili për një pjesë të muajit ka punuar, më pas ka qenë me raport paaftësie të përkohshme deri në 14 ditët e para me raport dhe më tej nga dita e 15 vazhdon me raport mjekësor deri në fund të muajit dhe merr përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, pavarësisht nga shumta e orëve të punës për ditët e punuara sëbashku me orët e llogaritura për ditët e raportit deri 14 ditët e para (sipas përcaktimit në kontratën e punës për orët ditore të punës).

Kategoria 6. I punësuar për herë të parë apo rishtazi te subjekti përkatës pavarësisht nga data e fillimit dhe orët e punuara gjatë muajit.

Kategoria 7. I punësuar i larguar nga puna (shkëputur përfundimisht marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës) pavarësisht nga data e shkëputjes dhe orët e punuara gjatë muajit.

Kategoria 8. I punësuar në dy subjekte (i dypunësuar) kur shumta e pagave të të dy subjektet është më e vogël, nga paga maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore.

Kategoria 9. I punësuar në dy subjekte (i dypunësuar) kur shumta e pagave të të dy subjektet është sa ose më e madhe nga paga maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore dhe paga e realizuar të njëri subjekt është më e madhe nga paga e realizuar të subjekti tjetër.

Kategoria 10. I punësuar në dy subjekte (i dypunësuar) kur paga vetëm të njëri subjekt është sa ose më e madhe nga paga maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore.

Kategoria 11. I vetëpunësuar (person fizik, me ose pa punëmarrës), pavarësisht nga orët e punuara gjatë muajit.

Kategoria 12. Punonjës i papaguar i familjes të personit fizik me të cilin ai punon e bashkëjeton ligjrisht, pavarësisht nga orët e punuara gjatë muajit.

Kategoria 13. I vetëpunësuar (person fizik, me ose pa punëmarrës) i regjistruar për herë të parë apo pas ndërprerjes së veprimtarisë.

Kategoria 14. I vetëpunësuar (person fizik, me ose pa punëmarrës) i çregjistruar nga organet tatimore apo që ndërpret veprimtarinë gjatë muajit.

Kategoria 15. Punonjës i papaguar i familjes të personit fizik me të cilin ai punon e bashkëjeton ligjrisht, i regjistruar për herë të parë apo rishtazi te ky subjekt.

Kategoria 16. Punonjës i papaguar i familjes të personit fizik me të cilin ai punon e bashkëjeton ligjrisht, i larguar nga puna gjatë muajit.

Kategoria 17. I vetëpunësuar edhe i punësuar në subjekt tjetër (person juridik ose person fizik) te i cili paguan kontribute mbi pagë më të vogël se paga maksimale mbi të cilën llogariten kontributet shoqërore.

Kategoria 18. Punonjës i papaguar i familjes që punon në personin fizik të regjistruar në emër të familjarëve të tij me të cilët ai punon bashkëjeton ligjrisht, dhe gjithashtu është i punësuar edhe në subjekt tjetër (person juridik ose person fizik) te i cili paguan kontribute mbi pagë më të vogël se paga maksimale mbi të cilën llogariten kontributet shoqërore.

Kategoria 19. I vetëpunësuar (person fizik) apo dhe punonjës i papaguar i familjes me të cilin ai punon e bashkëjeton ligjrisht, i punësuar edhe në subjekt tjetër (person juridik ose person fizik) te i cili paguan kontribute mbi pagë sa ose më të madhe se paga maksimale mbi të cilën llogariten kontributet shoqërore.

Kategoria 20. Ortak i vetëm i punësuar në personin juridik të regjistruar në emër të tij dhe gjithashtu i regjistruar edhe si person fizik (i vetëpunësuar).

Kategoria 21. I vetëpunësuar në dy subjekte persona fizikë të regjistruara në emër të tij.

Kategoria 22. I vetëpunësuar (person fizik), i cili punon edhe si punonjës i papaguar i familjes në një subjekt person fizik i regjistruar në emër të familjarëve të tij, me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht, pavarësisht nga orët e punuara gjatë muajit.

Kategoria 23. Punonjës i papaguar i familjes që punon në dy subjekte persona fizikë dhe të regjistruara në emër të familjarëve të tij me të cilët ai punon bashkëjeton ligjërisht, pavarësisht nga orët e punuara gjatë muajit.

Kategoria 24. I punësuar me kontratë me afat më pak se një javë gjatë vitit.

Kategoria 25. I punësuar për herë të parë apo rishtazi në këtë profesion që deklarohet, në subjekte, të cilat punojnë me material porositësi (fason), së bashku me kohën e punuar në të njëjtin profesion në subjekte fason, për afatin e caktuar sipas kuptimit të VKM-së përkatëse.

Kategoria 26. Person në periudhën e programit të nxitjes së punësimit të miratuar dhe me financim të pjesshëm nga zyra përkatëse e punësimit të totalit të detyrimit për kontributet.

Kategoria 27. Person në periudhën e kursit të formimit profesional, apo dhe programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë, të miratuara dhe me financim nga zyra përkatëse e punësimit të detyrimit të kontributeve vetëm për degën e aksidenteve në punë.

Kategoria 28. Nxënës i shkollës së mesme apo profesionale, apo student, për kohën e praktikës mësimore të miratuar nga institucionet përkatëse shtetërore.

Kategoria 29. I vetëpunësuar në aktivitetet tregtar apo shërbimi, ambulant.

Kategoria 30. I punësuar si punëtor shtëpie nga kryefamiljari i regjistruar në organin tatimor.

Kategoria 31. I punësuar, i cili për gjithë muajin ka qenë me raport leje barrë lindje ose raport mjekësor pas ditës së 14 dhe merr përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, por nuk i ka shkëputur (zgjidhur) marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës.

13. Në rubrikën 13 “Ditë kalendarike pa punuar gjatë muajit nga punonjësi (e drejta për përfitime nga sigurimet shoqërore)” – shënohet numri i ditëve kalendarike të papunuara gjatë muajit nga punonjësi, për ato raste që ai duhet të marrë përfitime afatshkurta nga skema e sigurimeve shoqërore, p.sh. ditë me raport paaftësie të përkohshme (duke filluar nga dita e 15 e raportit), ditë me leje barrë lindje; etj. përfitime sipas ligjit. Nëqoftëse një punonjës për të gjithë muajin raportues ka qenë me raport (pas ditës së 14 të raportit), apo leje barrë lindje etj. përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, dhe personi nuk i ka shkëputur përfundimisht marrëdhëniet e punës me atë tatimpagues, emri i tij do të pasqyrohet në listëpagesë, do të shënohet numri i të gjitha ditëve të muajit, ndërsa në kolonat e tjera shënohet zero. Nëqoftëse punonjësi nuk ka asnjë “Ditë kalendarike pa punuar gjatë muajit (e drejta për përfitime nga sigurimet shoqërore)” në këtë rubrikë vendoset zero dhe nuk lihet bosh.

14. Në rubrikën 14 “Ditë kalendarike të punuara gjatë muajit nga punonjësi” – shënohet numri i ditëve kalendarike të muajit në të cilat punonjësi ka punuar tek tatimpaguesi. Këto ditë të punuara duhet të jenë të rakorduara me deklaratimet e dorëzuara gjatë muajit në organin tatimor me deklaratën “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”. Këtu do të shënohen edhe ditët me raport deri në ditën e 14, për të cilat punëmarrësi paguhet nga tatimpaguesi sipas Kodit të Punës dhe për këto ditë i llogariten kontribute, si dhe tatim mbi të ardhurat nga punësimi. Nëqoftëse punonjësi nuk ka asnjë “Ditë kalendarike të punuar te ky tatimpagues gjatë muajit” për arsye se i ka të gjitha ditët e muajit të plotësuar sipas rubrikës 13 me “Ditë kalendarike pa punuar gjatë muajit (e drejta për përfitime nga sigurimet shoqërore)” etj. në këtë rubrikë vendoset zero dhe nuk lihet bosh.

15. Në rubrikën 15 “Paga bruto gjithsej (përfashtuar shumën e lekëve që zbritet nga paga dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit)” – Shënohet paga bruto gjithsej nga punësimi që i është llogaritur punonjësit për muajin raportues. Nga kjo pagë përjashtohet shuma e lekëve që zbritet nga paga bruto gjithsej dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit.

Personi fizik për vete dhe për punonjësit e papaguar të familjes në këtë rubrikë vendos numrin zero. Në pagën bruto gjithsej përfshihen edhe të ardhurat e të punësuarit për deri 14 ditët e para me raport mjekësor, për të cilat punëdhënësi i jep punëmarrësit në bazë të Kodit të Punës. Këtu nuk deklarohen përfitimet e punonjësve të ndryshëm nga skema e sigurimeve shoqërore e shëndetësore si p. sh. të ardhurat e përfituara nga leja e barrëlindjes, raporteve mjekësore nga dita e 15, etj.

16. Në rubrikën 16 “Paga bruto mbi të cilën llogariten kontributet për sigurimet shoqërore” – shënohet paga bruto mujore mbi të cilën llogariten kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe kontributi shtesë për punonjësit e minierave që punojnë në nëntokë, brenda kufijve minimal e maksimal të pagës për efekt të llogaritjes së kontributeve të të punësuarve, sipas përcaktimit në vendimin e Këshillit të Ministrave. Në këtë pagë përfshihet gjithashtu edhe shuma e lekëve që zbritet nga paga bruto gjithsej dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit.

Personi fizik për vete dhe për punonjësit e papaguar të familjes shënon pagën minimale për efekt të llogaritjes së kontributeve, e cila sipas përcaktimit në vendimin e Këshillit të Ministrave është paga minimale në shkallë vendi. Personi fizik, për vete, me dëshirën e tij në këtë rubrikë mund të vendosë një pagë edhe më të madhe nga paga minimale në shkallë vendi deri në kufirin e pagës maksimale për kontributet shoqërore të të punësuarve. Në pagën bruto mbi të cilën llogariten kontributet për sigurimet shoqërore përfshihen edhe të ardhurat e të punësuarit për deri 14 ditët e para me raport mjekësor, për të cilat punëdhënësi i jep punëmarrësit në bazë të Kodit të Punës. Për efekte të zbatimit të kufirit minimal e maksimal të pagës, llogaritja dhe vlerësimi i detyrimit për kontributin e sigurimeve shoqërore për punonjësin, i cili gjatë muajit ka punuar në dy rrethe brenda të njëjtit subjekti (NIPT-i) bëhet mbi bazën e shumës së pagave të punonjësit në të dy rrethet.

17. Në rubrikën 17 “Punëdhënësi” – shënohet kontributi i sigurimeve shoqërore të detyrueshme për tu paguar nga punëdhënësi sipas pagës mujore mbi të cilën llogariten kontributet, rubrika 16 shumëzuar me përqindjen përkatëse sipas VKM-së në fuqi. Personi fizik për vete dhe për punonjësit e papaguar të familjes në këtë rubrikë shënon të gjithë shumën e kontributit.

18. Në rubrikën 18 “Punëmarrësi” – shënohet kontributi i sigurimeve shoqërore të detyrueshme i mbajtur në burim nga punëdhënësi për punëmarrësin sipas pagës mbi të cilën llogariten kontributet, rubrika 16 shumëzuar me përqindjen përkatëse sipas VKM-së në fuqi. Personi fizik për vete dhe për punonjësit e papaguar të familjes në këtë rubrikë vendos zero.

19. Në rubrikën 19 “Gjithsej” – shënohet shuma totale e kontributit të sigurimeve shoqërore të detyrueshme për tu paguar. Shuma e rubrikave 17 dhe 18.

20. Në rubrikën 20 “Punëdhënësi” – shënohet kontributi shtesë p.sh. kontributet për punonjësit e minierave që punojnë në nëntokë për t’u paguar nga punëdhënësi sipas pagës mujore mbi të cilën llogariten kontributet, rubrika 16 shumëzuar me përqindjen përkatëse sipas ligjit në fuqi. Nga tatimpaguesit dhe për punonjësit që nuk duhet të paguajnë këtë kontribut kjo kolonë plotësohet me zero.

21. Në rubrikën 21 “Punëmarrësi” – shënohet kontributi shtesë për punonjësit e minierave që punojnë në nëntokë i mbajtur në burim nga punëdhënësi për punëmarrësin sipas pagës mbi të cilën llogariten kontributet, rubrika 16 shumëzuar me përqindjen përkatëse sipas ligjit në fuqi. ose Gjithashtu në këtë rubrikë shënohet kontributi për sigurimin shoqëror suplementar, i detyrueshëm, që mbahet në burim nga punëdhënësi për punëmarrësin, për punonjësit e përcaktuar në ligjet dhe VKM-të përkatëse, në përqindjet e caktuara mbi pagën bruto gjithsej, rubrika 15 24, pa kufi të sipërm. Pra në pagën për llogaritjen e kontributeve në këtë rubrikë përfshihet edhe shuma e lekëve që zbritet nga paga bruto gjithsej dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit.

Nga tatimpaguesit dhe për punonjësit që nuk duhet të paguajnë këto kontribute kjo rubrikë plotësohet me zero.

22. Në rubrikën 22 “Gjithsej” – shënohet shuma totale e rubrikave 20 dhe 21 për t’u paguar e kontributit shoqëror shtesë për punonjësit e minierave që punojnë në nëntokë dhe kontributit për sigurimin shoqëror suplementar për punonjësit e caktuar sipas ligjit përkatës në fuqi. Nga tatimpaguesit dhe për punonjësit që nuk duhet të paguajnë këtë kontribut kjo kolonë plotësohet me zero.

23. Në rubrikën 23 “Totali kontribut për sigurimet shoqërore” – shënohet kontributi gjithsej i sigurimeve shoqërore për t’u paguar, përfshirë, kontributin shoqëror të detyrueshëm, kontributin shtesë për punonjësit e minierave që punojnë në nëntokë, si dhe kontributin për sigurimin shoqëror suplementar, pra shuma e rubrikave 19 dhe 22, e cila është shuma që duhet të kalojë për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

24. Në rubrikën 24 “Paga bruto mbi të cilën llogariten kontributet e sigurimit shëndetësor” – shënohet paga bruto mujore mbi të cilën llogariten kontributet e sigurimeve shëndetësore për personat e punësuar. Kjo pagë nuk mund të jetë më e vogël nga paga minimale e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të të punësuarve (paga minimale në shkallë vendi) dhe nuk ka kufi të sipërm (tavan) të pagës bruto mujore. Në këtë pagë përfshihet edhe shuma e lekëve që zbritet nga paga bruto gjithsej dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit.

Personi fizik për vete dhe për punonjësit e papaguar të familjes në këtë rubrikë shënon pagën minimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimit shëndetësor, e cila është e barabartë me dyfishin e pagës minimale mujore mbi të cilën llogariten kontributet e sigurimeve shoqërore (pra dyfishin e pagës minimale në shkallë vendi), rubrika 16, sipas përcaktimit të VKM-së në fuqi. Në pagën bruto mbi të cilën llogariten kontributet për sigurimet shëndetësore përfshihen edhe të ardhurat e të punësuarit për deri 14 ditët e para me raport mjekësor, për të cilat punëdhënësi i jep punëmarrësit në bazë të Kodit të Punës.

25. Në rubrikën 25 “Kontribute për sigurimet shëndetësore gjithsej” – shënohet kontributi i sigurimit shëndetësor për t’u paguar nga punëdhënësi sipas pagës mujore mbi të cilën llogariten kontributet rubrika 24 shumëzuar me përqindjen përkatëse sipas VKM-së në fuqi. Për personat, i vetëpunësuar në aktivitet tregtar apo shërbimi, ambulant, si dhe i punësuar si punëtor shtëpie në këtë rubrikë vendoset kuota fikse e kontributit sipas përcaktimit në VKM-së në fuqi.

26. Në rubrikën 26 “Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi (TAP) gjithsej” – shënohet shuma e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi e mbajtur në burim nga paga e çdo punëmarrësi gjatë muajit. Kjo rubrikë plotësohet mbi bazën e përlllogaritjeve përkatëse në masën e caktuar sipas ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Në pagën bruto për llogaritjen dhe deklarimin e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi përfshihen edhe të ardhurat e të punësuarit për deri 14 ditët e para të raportit mjekësor, për të cilat punëmarrësi i jep pagën punonjësit në bazë të Kodit të Punës. Në pagën bruto për llogaritjen dhe deklarimin e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi përjashtohet shuma e lekëve që zbritet nga paga bruto gjithsej dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit.

Në këtë rubrikë, i vetëpunësuar, person fizik, për vete dhe për punonjësit e papaguar të familjes me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht, vendos zero.

27. Në rubrikën 27 “Shënime” – shënohen sqarime për punonjës të veçantë ashtu si përcaktohet në këtë udhëzim, në kreun (pikat) për deklarimin e kontributeve për personat ekonomikisht aktivë në dy ose më shumë subjekte, për rastet e zbritjeve nga paga dhe derdhjeve nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit, rastet e llogaritjes së kontributit shtesë për punonjësit e minierave që punojnë në nëntokë, rastet e llogaritjes së kontributit suplementar, si dhe për raste të tjera nëse është e nevojshme.

28. Në rubrikën 28 “Punonjës që duhet të paguajnë kontribute shoqërore” – shënohet numri i punonjësve të personit juridik dhe fizik (përfshirë të vetëpunësuarin dhe punonjësit e papaguar të familjes) që janë llogaritur të paguajnë kontribute shoqërore sipas listëpagesës, pavarësisht nga shuma e kontributit. Ky numër nxirret duke numëruar punonjësit bazuar në numrat personalë të listëpagesës. Në rastet kur gjatë muajit i njëjti punonjës ka lëvizur brenda tatimpaguesit dhe ka

punuar në dy rrethe ai vlerësohet një punonjës. Nuk përfshihen në numrin e “Punonjësve që paguajnë kontribute shoqërore” punonjësit, të cilët për gjithë muajin kanë qenë me raport paaftësie të përkohshme (pas ditës së 14 të raportit), lejë barrëindjeje etj. përfitime për gjithë muajin nga skema e sigurimeve shoqërore, të cilët tatimpaguesi duhet t’i mbajë të regjistruar në listëpagesë për deri sa ata nuk kanë shkëputur përfundimisht marrëdhëniet e punës me të dhe nuk janë deklaruar të larguar nga puna me pasqyrën e ndryshimit të numrit të punonjësve.

29. Në rubrikën 29 “Shuma totale e detyrimit për kontribute dhe TAP, për t’u paguar” – shënohet shuma e totaleve e rubrikave 23; 25 dhe 26 të listëpagesës përkatëse. Kjo shumë nxirret duke mbledhur totalët përkatëse të tre rubrikave dhe kjo është shuma e detyrimit për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të sigurimeve suplementare, të sigurimeve shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, që duhet të paguajë tatimpaguesi për muajin përkatës.

30. Në rubrikën 30 “Përfaqësuesi i personit juridik (administratori/administratorët)” – shënohet emri e mbiemri i administratorit apo administratorëve aktualë të personit juridik.

31. Në rubrikën 31 “Deklaruesi (administratori ose personi i autorizuar për deklarimin)/personi fizik (i autorizuari)” – shënohet emri e mbiemri dhe nënshkrimi elektronik i personit që bën deklarimin në formë elektronike të të dhënave të listëpagesës për këtë muaj. Nga personat juridikë shënohet emri e mbiemri i administratorit, ose i personit të autorizuar zyrtarisht, që bën deklarimin në formë elektronike të të dhënave të listëpagesës për muajin, si dhe vendoset nënshkrimi elektronik i personit. Nga personat fizikë vendoset emri e mbiemri i personit fizik ose personit të autorizuar zyrtarisht prej tij, si dhe vendoset nënshkrimi elektronik i personit.

Shënim

a. Shënimet si më sipër janë pjesë e pandarë e udhëzimit “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” dhe janë të detyrueshme për t’u zbatuar.

b. Bashkëlidhur është formulari i deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”.

c. Deklarimi për herë të parë pas regjistrimit nga personi juridik apo fizik i të dhënave për punonjësit e deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, përfshirë sipas përkatësisë, administratorin, vetë personin fizik apo punonjësin e papaguar të familjes me të cilin ai punon e bashkëjeton ligjërisht, si dhe ndryshimet (shtesa ose paksime) në numrin e personave të një listëpagese ekzistuese, bëhen vetëm me anë të deklarimit elektronik të të dhënave të rubrikave të deklaratës “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”.

ç. Në kuptim të zbatimit të nenit 119, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, punonjës që fillojnë punë për herë të parë apo rishtas konsiderohen ata që fillojnë apo rifillojnë një marrëdhënie të re punësimi me tatimpaguesin mbi bazën e një kontrate të re pune, ndërsa punonjës që largohen nga puna konsiderohen ata që shkëpusin përfundimisht marrëdhëniet e punës me tatimpaguesin përkatës.

d. Plotësimi i rubrikave përkatëse të listëpagesës bëhet bazuar mbi të dhënat e dokumentit “Rregullat e kontrollit të listëpagesës sipas kategorive të punonjësve”.

II. PENSIONE

LIGJ

Nr.9588, datë 25.7.2006

PËR RILLOGARITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1 **Përkufizim**

Në kuptim të këtij ligji, quhen pensione pleqërie në qytet pensionet e caktuara sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

Neni 2 **Rillogaritja e pensioneve për periudhën 1.1.1994 - 31.12.1996**

Pensionet e pleqërisë në qytet, që kanë datë fillimi datën 1.1.1994 deri më 31.12.1996, përfshirë edhe këtë datë dhe që vazhdojnë të paguhen pas datës 1.7.2006, rillogariten duke indeksuar pagat, mbi të cilat është llogaritur baza e vlerësuar dhe pagën neto, sipas koeficientëve të indeksimit, të miratuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.

Indeksi bëhet në bazë të pagave të dokumentuara e të paraqitura në kohën e caktimit të pensionit.

Neni 3 **Rillogaritja e pensioneve për periudhën 1.1.1997 - 14.6.2005**

Pensionet e pleqërisë në qytet, që kanë datë fillimi datën 1.1.1997 deri më 14.6.2005, përfshirë edhe këtë datë dhe që vazhdojnë të paguhen pas datës 1.7.2006, rillogariten sipas neneve 32, 33, 34, 59, 60, 61 e 62 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të akteve nënligjore në fuqi, të dala në zbatim të tij.

Rillogaritja bëhet në bazë të pagave të dokumentuara e të paraqitura në kohën e caktimit të pensionit.

Masa e rillogaritur e pensionit rritet sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave për rritjen e pensioneve.

Neni 4 **Të drejtat e fituara**

Kur masa e pensionit të rillogaritur rezulton më e vogël se pensioni ekzistues, pensioni nuk ndryshon, duke u vlerësuar si e drejtë e fituar.

Neni 5
Legjislacioni i zbatueshëm

Për pensionet e rillogaritura sipas neneve 2 e 3 të këtij ligji zbatohen të gjitha dispozitat e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij.

Neni 6

Ky ligj i fillon efektet financiare nga data 1.7.2006.

Neni 7

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të tij.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5008, datë 4.8.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.590, datë 31.8.2006

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.9588, DATË 25.7.2006 "PËR RILLOGARITJEN E PENSIONEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.9588, datë 25.7.2006 "Për rillogaritjen e pensioneve" dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Rillogaritjen e pensioneve të caktuara nga data 1.1.1994 deri më 31.12.1996.

1. Në zbatim të nenit 2 të ligjit nr.9588, datë 25.7.2006 "Për rillogaritjen e pensioneve", pensione, që kanë datë fillimi nga data 1.1.1994 deri më 31.12.1996, përfshirë edhe këtë datë, u indeksohet paga mbi të cilën është llogaritur baza e vlerësuar dhe paga neto, për periudhën nga data 1.1.1994 deri në datën e fillimit të pensionit individual por, në çdo rast, brenda periudhës 1.1.1994 deri më 31.12.1996.

2. Indeksi bëhet sipas procedurave dhe koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit përkatës. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar individuale, pas vitit 1994, sipas viteve, përcaktohen në vendimin nr.400, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual për llogaritjen fillestare të pensioneve".

3. Rillogaritja e masës së pensionit dhe indeksimet bëhen në bazë të pagave të dokumentuara e të paraqitura në dosjen individuale të pensionit dhe mbi të cilat është caktuar masa e pensionit fillestar.

II. Rillogaritjen e pensioneve të caktuara nga data 1.1.1997 deri më 14.6.2005.

1. Në zbatim të nenit 3 të ligjit nr.9588, datë 25.7.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”, pensione, që kanë datë fillimi nga data 1.1.1997 deri më 14.6.2005, përfshirë edhe këtë datë, u rillogaritet baza e vlerësuar, sipas nenit 59, dhe u indeksohet paga neto, sipas nenit 32 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Për periudhën e sigurimit para datës 1.1.1994, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar, përdoren pagat referuese, të përcaktuara në vendimin nr.561, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagës referuese për llogaritjen e pensioneve”.

3. Nga data 1.1.1994 dhe deri më datën e fillimit të pensionit këto paga do të indeksohen me koeficientin e indeksimit të vitit përkatës, të përcaktuara në vendimin nr.400, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve”.

4. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 dhe deri në datën e fillimit të pensionit, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar, merren pagat mbi të cilat janë paguar kontributet, të indeksuara me koeficientin e indeksimit të vitit përkatës, sipas përcaktimeve të vendimit nr.400, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve”.

5. Paga neto e tri viteve rresht, në dhjetë vitet e fundit të punës, rillogaritet duke përdorur të njëjtët koeficientë indeksimi, si edhe për rillogaritjen e bazës së vlerësuar.

6. Periudhat e sigurimit pas datës 1.10.1993, të njohura të vlefshme për efekt llogaritjeje pensioni, por të pashoqëruara në kohën e caktimit të pensionit me dokumentin që vërteton pagën për çdo muaj, duke u bazuar në nenin 60 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në nivel minimal.

III. Masa e re e pensionit, e rillogaritur sipas kërreëve I dhe II, të këtij vendimi, rritet radhazi, sipas përqindjeve të rritjes së pensioneve të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave, për rritjen e pensioneve, por, në çdo rast, për periudhat nga data e caktimit të pensionit individual e deri në datën 1.7.2006, përfshirë edhe rritjen e caktuar me vendimin nr.399, datë 21.6.2003 të Këshillit të Ministrave “Për rritjen e pensioneve”.

Masa e pensionit, që rezulton pas rillogaritjeve dhe zbatimit të rritjeve, është masa përfundimtare e pensionit individual. Kur kjo masë pensioni rezulton më e vogël se pensioni ekzistues, atëherë nuk ndryshon, duke u vlerësuar si e drejtë e fituar.

IV. Efektet financiare, për vitin 2006, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 465 000 000 (katërqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, nga të cilat 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë shpenzime administrative, dhe përballohen nga fondi i kontigjencës së Këshillit të Ministrave dhe nga fondet shtesë, të përcaktuara në ligjin nr.9601, datë 28.7.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006””.

V. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 130, datë 22.2.2017

PËR INDEKSIMIN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 61 e 88, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 17, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, të nenit 24, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të nenit 6/1, të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të nenit 1, të ligjit nr. 8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruer të nëndetësve dhe palombarëve të forcave detare në pension”, të nenit 8, të ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar dhe të nenit 4, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Indeksimin, në masën 3 për qind të:
 - a) pensioneve të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, nr.4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuara;
 - b) pensioneve sociale, të caktuara në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - c) shtesës mujore, të përfituar me vendimin nr. 326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”;
 - ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr. 758, datë 1.2.1994, të Presidentit të Republikës, “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”;
 - d) shtesës mbi pension, të dhënë sipas nenit 33, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - dh) shtesave mbi pension, të dhëna sipas neneve 38, 39 e 48, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 24, të ligjit nr. 4171, datë 13.6.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;
 - e) pensioneve të caktuara dhe të rillogaritura me ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të

Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara me nenin 21, të këtij ligji;

ë) trajtimeve të veçanta financiare të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara sipas ligjeve nr. 8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, dhe nr. 9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar;

f) trajtimeve të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetëseve dhe palombarëve të Forcave Detare në pension”;

g) trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të caktuara sipas ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar,

gj) pensioneve të pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

h) trajtimeve të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”;

i) pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”;

j) pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar;

k) shpërblimit të caktuar sipas ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të ndryshuar.

2. Indeksimin, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, e përfitojnë edhe pensionet të cilat caktohen nga data 1.3.2017 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 28.2.2017, përfshirë edhe këtë datë.

3. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të këtij ligji, si dhe pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr. 150/2014, që kanë datë fillimi deri më 31.12.2014, pas datës 1.3.2016, nuk do të jenë më pak se 13 014 (trembëdhjetë mijë e katërmëdhjetë) lekë në muaj dhe më shumë se 26 028 (njëzet e gjashtë mijë e njëzet e tetë) lekë në muaj.

4. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.12.2014, nuk do të jenë më pak se 8 912 (tetë mijë e nëntëqind e dymbëdhjetë) lekë në muaj, por jo më shumë se 13 014 (trembëdhjetë mijë e katërmëdhjetë) lekë në muaj.

5. Pensionet e parakohshme, të caktuara sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.3.2017 e në vazhdim, nuk do të jenë më pak se 13 014 (trembëdhjetë mijë e katërmëdhjetë) lekë në muaj.

6. Përfituesit e pensioneve, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nr. 150/2014, të caktuara pas datës 1.3.2017, por me datë të fillimit të pensionit deri më 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë, përveç pensionit, do të përfitojnë edhe kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”; nr.763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”; nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr. 17, datë 20.1.2007, “Për kompensimin e të

ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”, me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave, pas indeksimit të pensioneve sipas pikës 1, të këtij vendimi, të jetë:

a) deri në 14 664 (katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, përfshirë edhe përfituesit e pensioneve sipas ligjit nr. 150/2014;

b) deri në 14 164 (katërmëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë në muaj, për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare;

c) deri në 9 602 (nëntë mijë e gjashtëqind e dy) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

7. Kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”; nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”; dhe nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, do t’i marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione të parakohshme sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, me datë fillimi nga 1.3.2017 e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor të parakohshëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 14 664 (katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë në muaj.

8. Përfituesit e pensioneve, sipas shkronjave “a”, “e” dhe “gj”, të pikës 1, të këtij vendimi, krahas pensionit dhe kompensimeve, sipas përcaktimeve në pikat 6 dhe 7, të këtij vendimi, do të marrin edhe kompensimet sipas masës dhe kriterëve të përcaktuara në vendimet nr. 138, datë 31.3.1994, Këshillit të Ministrave, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”; nr. 471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”.

Pas datës 1.3.2017, të ardhurat minimale nga pensionet e plota të qytetit me datë fillimi deri në 31.12.2014, shtuar me kompensimet, nuk mund të jenë më të vogla se 15 164 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë në muaj, të ardhurat maksimale arrijnë 26 528 (njëzet e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet e tetë) lekë në muaj, të ardhurat minimale nga pensionet e plota të fshatit nuk mund të jenë më të vogla se 9 802 (nëntë mijë e tetëqind e dy) lekë në muaj, ndërsa të ardhurat minimale nga pensionet e parakohshme, shtuar me kompensimet, nuk mund të jenë më të vogla se 15 164 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë në muaj.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përlllogariten në shumën 2 600 000 000 (dy miliardë e gjashtëqind milionë) lekë, dhe përballohen nga fondi për politikën e indeksimit të pensioneve, i parashikuar në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore të vitit 2017 dhe ndahen përkatësisht:

a) 2 574 500 000 (dy miliardë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër milionë e pesëqind mijë) lekë, për mbulimin e pagesave të pensioneve;

b) 25 500 000 (njëzet e pesë milionë e pesëqind mijë) lekë, për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare sh.a.

10. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a., për nxjerrjen e udhëzimit teknik në/dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, dhe i fillon efektet financiare nga data 1.3.2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 409, datë 1.6.2016

PËR NGUSHTIMIN E DIFERENCAVE NË MASËN E PENSIONEVE

(Ndryshuar me vendimin nr. 161, datë 1.3.2017⁴)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 88, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republi-kën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara në periudhën 1.10.1993 deri në 31.12.1996, sipas neneve 31 dhe 32, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, dhe që vazhdojnë të paguhen pas datës 31.3.2016, ndryshohen, si më poshtë vijon:

a) Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara në periudhën nga 1.10.1993 deri në 31.12.1993, me masë pensioni në këtë periudhë nga 1 401 (një mijë e katërqind e një) lekë deri në 2 474 (dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) lekë në muaj, shtohen me shuma fikse, duke arritur në masën 14 085 (katërmëdhjetë mijë e tetëdhjetë e pesë) lekë deri në 23 640 (njëzet e tre mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë në muaj;

b) Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara në periudhën 1.1.1994 deri në 30.9.1994, me masë pensioni në këtë periudhë, pas rillogaritjes sipas ligjit nr. 9588, datë 25.7.2006, “Për rillogaritjen e pensioneve”, nga 2 175 (dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë deri në 3 840 (tre mijë e tetëqind e dyzet) lekë në muaj, shtohen me shuma fikse, duke arritur në masën 14 088 (katërmëdhjetë mijë e tetëdhjetë e tetë) lekë deri në 23 640 (njëzet e tre mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë në muaj;

c) Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara në periudhën nga 1.10.1994 deri në 30.4.1995, me masë pensioni në këtë periudhë, pas rillogaritjes sipas ligjit nr. 9588, datë 25.7.2006, “Për rillogaritjen e pensioneve”, nga 2 492 (dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy) lekë deri në 4 400 (katër mijë e katërqind) lekë në muaj, shtohen me shuma fikse, duke arritur në masën 14 087 (katërmëdhjetë mijë e tetëdhjetë e shtatë) lekë deri në 23 640 (njëzet e tre mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë në muaj;

ç) Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara në periudhën nga 1.5.1995 deri në 30.9.1995, me masë pensioni në këtë periudhë, pas rillogaritjes sipas ligjit nr. 9588, datë 25.7.2006, “Për rillogaritjen e pensioneve”, nga 2 741 (dy mijë e shtatëqind e dyzet e një) lekë deri në 4 400 (katër mijë e katërqind) lekë në muaj, shtohen me shuma fikse, duke arritur në masën 14 086 (katërmëdhjetë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekë deri në 23 640 (njëzet e tre mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë në muaj;

d) Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara në periudhën nga 1.10.1995 deri në 31.3.1996, me masë pensioni në këtë periudhë, pas rillogaritjes sipas ligjit nr. 9588, datë 25.7.2006, “Për rillogaritjen e pensioneve”, nga 3 070 (tre mijë e shtatëdhjetë) lekë deri në 5 420 (pesë mijë e katërqind e njëzet) lekë në muaj, shtohen me shuma fikse, duke arritur në masën 14 088 (katërmëdhjetë mijë e tetëdhjetë e tetë) lekë deri në 23 640 (njëzet e tre mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë në muaj;

dh) Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara në periudhën nga 1.4.1996 deri më 31.12.1996, me masë pensioni në këtë periudhë, pas rillogaritjes sipas ligjit nr.9588, datë 25.7.2006, “Për rillogaritjen e pensioneve”, nga 3 682 (tre mijë e gjashtëqind tetëdhjetë e dy) lekë deri në 5 420

⁴ Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.6.2016.

(pesë mijë e katërqind e njëzet) lekë në muaj, shtohen me shuma fikse, duke arritur në masën 14 089 (katërmëdhjetë mijë e tetëdhjetë e nëntë) lekë deri në 23 640 (njëzet e tre mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë në muaj;

Shuma individuale e pensionit, e rillogaritur sipas kësaj pike, paraqitet në tabelat A1, A2, A3-1, A3-2, A4, A5-1, A5-2 dhe A6, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Pensionet për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas nenit 40, të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Mbi sigurimet shoqërore shtetërore të Republikës Popullore të Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilat, sipas nenit 88, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kalojnë në masën 70% të pagës që i është llogaritur pensioni, por jo më shumë se kufiri maksimal i pensionit të pleqërisë, të caktuar në ligj, pavarësisht kohës kur kanë kaluar me 70% të pagës, përveç rritjeve dhe indeksimeve të zakonshme do të përfitojnë edhe rritjet e diferencuara që kanë përfituar të gjitha pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara deri në datën 30.9.1993, në varësi të datës së fillimit të pensionit dhe masës së rivlerësuar këtij pensioni me 70% të pagës.

3. Pensionet e pleqërisë të punonjësve të nëntokës dhe ato të grave që kanë punuar në punët e kategorisë së parë e të dytë, të caktuara sipas nenit 97, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kur llogariten si pensione të plota, pavarësisht kohës kur kanë kaluar si të tilla, përveç rritjeve dhe indeksimeve të zakonshme do të përfitojnë edhe rritjet e diferencuara që kanë përfituar të gjitha pensionet e plota të pleqërisë me datë fillimi në harkun kohor 1.10.1993 -31.12.1996, përfshirë edhe rritjen e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, në varësi të datës së fillimit të pensionit dhe masës së rivlerësuar si të plotë të këtij pensioni.

4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2016, llogariten në shumën 324 100 000 (treqind e njëzet e katër milionë e njëqind mijë) lekë dhe përballohen nga rezultati pozitiv financiar i Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2015.

5. Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për përballimin e vëllimit të punës për zbatimin e këtij vendimi, t’i shtohet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh në planin e shpenzimeve administrative, i cili të përballohet brenda shpenzimeve të programuara për sigurimet shoqërore për vitin 2016.

6. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve në zbatim të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.6.2016.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 550, datë 27.7.2016

PËR BARAZIMIN E MASËS SË SHITESËS SË PENSIONEVE TË POSAÇME SHETETËRORE, TË CAKTUARA NË HARKUN KOHOR 1.10.1993–31.12.2014, DHE INDEKSIMIN E PENSIONEVE TË POSAÇME E TË SHITESËS SË PENSIONEVE TË POSAÇME SHETETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 429, datë 12.9.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve”, të ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të gjitha shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në masën e pensionit maksimal, në harkun kohor 1.10.1993–31.12.2014, të cilat vazhdojnë të paguhen edhe sot, do të bëhen 24 872 (njëzet e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë në muaj, me kusht që shuma e kësaj shtese, bashkë me masën e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, përjashtuar shtesën sipas nenit 33, të këtij ligji, të mos kalojë vlerën 49 744 (dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e katër) lekë në muaj.

2. Në të njëjtën masë do të kalojnë edhe shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave në harkun kohor 1.10.1993–31.12.2014, për familjarët e personit të vdekur, që merrte ose i takonte të merrte pension të posaçëm shtetëror ose shtesë pensioni të posaçëm.

3. Pas këtij ndryshimi, të gjitha pensionet e posaçme dhe shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore, përfshirë edhe ato që nuk janë të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, do të indeksohen me 1,6%.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2016, përlllogariten në shumën 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë dhe përballohen nga fondet e sigurimeve shoqërore, të parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2016.

5. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për të nxjerrë udhëzimet përkatëse teknike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.8.2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIGJ
Nr.8097, datë 21.3.1996

**PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË
KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHETIT**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; nr.9061, datë 8.5.2003; nr. 9827, datë 5.11.2007;
nr. 9990, datë 15.9.2008; nr. 27/2015, datë 26.3.2015)*

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizime

(Ndryshuar pikat 8,9 me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; ndryshuar pika 9 me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003; ndryshuar pika 8 shkronja “b” me ligjin nr. 9990, datë 15.9.2008; ndryshuar pikat 7,8 dhe shtuar pikat 11,12 me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

1. Me termin “Ligj për sigurimet shoqërore” do të kuptohet ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Me termin “Sigurim shoqëror i detyrueshëm” do të kuptohet sigurimi sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

3. Me termin “Kushtetuese” do të kuptohet legjislacioni kushtetues.

4. Me termin “Përfitime shtetërore suplementare” do të kuptohen përfitimet që jepen sipas këtij ligji.

5. Me termin “Vite shërbimi” do të kuptohen vitet e punës së kryer në një nga funksionet që burojnë nga Kushtetuta ose një nga detyrat në administratën publike, sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

6. Me termin “Aksident në shërbim” do të kuptohet ndryshimi i gjendjes shëndetësore (i njohur nga KMCAP sipas ligjit për sigurimet shoqërore), ose vdekja për shkak dhe gjatë kryerjes së funksionit a detyrës (për këto të fundit sipas përkufizimeve të dhëna në këtë nen).

7. Me termin “Pagë referuese” do të kuptohet paga e muajit më të fundit sipas legjislacionit në fuqi që zbatohet për atë funksion a detyrë. Paga referuese është bazë e llogaritjes së pensioneve suplementare dhe pagesës kalimtare.

8. Në termin “Grupi i parë” do të përfshihen:

a) Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Këshillit të Ministrave, Zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave, ministër, Zëvendëskryetari i Kuvendit dhe të barazuar me ligj me ta, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

b) Deputetët e Kuvendit, anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, si dhe Avokati i Popullit, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive, Komisioneri për të Drejtën e

Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Gjeneralët e Forcave të Armatosura dhe punonjësit e Policisë së Shtetit të rolit madhor.

9. Në termin “Grupi i dytë” do të përfshihen:

a) Sekretarët e Shtetit, zëvendësministrat, zëvendësprokurorët e Përgjithshëm, si dhe personat e tjerë të barazuar me ta, sekretarët e përgjithshëm dhe funksionarët politikë pranë Presidentit, Kuvendit, Këshillit të Ministrave, ministrive, institucioneve qendrore, buxhetore, prefekturave, këshillave të rretheve, këshillave të qarqeve, bashkive dhe personave të tjerë të barazuar me ta, sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe Kryetari i Arbitrazhit të Lartë Shtetëror;

b) Personat që kryejnë detyra në administratën e Presidentit, të Kuvendit, Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, buxhetore të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, gjykatave të apelit, prokurorive të rretheve, prefekturave dhe të pushtetit vendor dhe personave të tjerë të barazuar me ta, sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

c) Personeli drejtues ku do të përfshihen drejtorët e drejtorive, përgjegjësit e sektorëve, si dhe personat e tjerë të barazuar me ta në funksion, personat të cilët punojnë në organet drejtuese të pushtetit vendor dhe në funksione të tjera drejtuese, sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

d) Personeli specialist ku do të përfshihen specialistët dhe personat e tjerë të barazuar me ta në funksion sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave.

10. Në termin “Persona të punësuar” do të përfshihen gjithë personat që janë përcaktuar në pikat 8 dhe 9 të këtij neni.

11. Me termin “pagesë kalimtare” kuptohet pagesa që përfitojnë personat, subjekt i këtij ligji, pas ndërprerjes së funksionit ose kur punësohen në një funksion me pagë më të ulët se paga pararendëse.

12. Në kuptim të pikës 9, të këtij neni, institucionet qendrore buxhetore, që do të përfshihen në këtë skemë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të jepen përfitime shtetërore suplementare si të ardhura shtesë mbi përfitimet që jepen nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror për personat e grupit të parë dhe të dytë.

Neni 3

Personat e mbrojtur

Përfitojnë nga ky ligj personat që përcaktohen në nenin 1.

Neni 4

Financimi

Përfitimet shtetërore suplementare që jepen sipas këtij ligji financohen:

- a) nga buxheti i shtetit;
- b) nga kontributi që derdhin personat e punësuar.

Neni 5

Masa e kontributeve

(Ndryshuar me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003; ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Kontributet, që paguajnë personat e punësuar në fondin e sigurimit shtetëror suplementar, janë:

- a) 5 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të parë;

b) 4 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të dytë, që përmenden në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji;

c) 3 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të dytë, që përmenden në shkronjën “d”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji.

Neni 6

Pagesa e kontributeve

Kontributet paguhen çdo muaj në fondin e sigurimit shtetëror suplementar. Afati i derdhjes është jo më vonë se fundi i muajit pasardhës.

KREU II

PËRFITIMET

(Ndryshuar titulli me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

PJESA E PARË

PAGESË KALIMTARE

Neni 7

*(Shtuar 2 paragrafë me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; ndryshuar me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003;
ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)*

Personave të grupit të parë, që përmenden në shkronjën “a” të pikës 8 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen tri paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 50 për qind të pagës referuese bruto, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion.

Personave të grupit të parë, që përmenden në shkronjën “b” të pikës 8 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen dy paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 50 për qind të pagës referuese bruto, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion.

Personave të grupit të dytë, që përmenden në shkronjën “a” të pikës 9 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen dy paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 40 për qind të pagës referuese bruto, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 1 vit nga momenti i largimit nga ky funksion.

Personat, të cilët gjatë periudhës së përfitimit të pagesës kalimtare janë të punësuar në një funksion kushtetues, që përfshihet në këtë ligj, pas largimit nga ky funksion, do të marrin pagesë kalimtare vetëm për atë periudhë shërbimi në funksion, gjatë së cilës nuk janë trajtuar edhe me pagesë kalimtare nga funksioni paraardhës.

Periudha, gjatë së cilës personat nuk janë të punësuar dhe përfitojnë pagesë pas ndërprerjes së funksionit të fundit dhe pagesë kalimtare, njihet si periudhë sigurimi për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë, familjar dhe invaliditeti, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Kontributi i sigurimit të detyrueshëm shoqëror për këta persona derdhet në fondin e sigurimeve shoqërore nga buxheti i shtetit.

Në rastet kur përfituesi punësohet, brenda periudhës së përfitimit të pagave të funksionit të fundit apo të pagesës kalimtare, masa e pagesës mbi pagën e re është një kompensim deri në nivelin e pagës referuese të funksionit, por në çdo rast ajo nuk mund të jetë më shumë se paga e funksionit të fundit apo pagesa kalimtare e tij.

Në rastet kur gjatë trajtimit me pagesë kalimtare lind e drejta për një përfitim nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore, përfituesi nga ky ligj ka të drejtën e zgjedhjes së njërit prej tyre.

PJESA E DYTË
PENSIONE SHTETËRORE SUPLEMENTARE

Neni 8

Kushtet e përfitimit për grupin e parë

(Ndryshuar e shtuar me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; ndryshuar e shtuar me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003; ndryshuar pika 2 shkronja "a" me ligjin nr. 9827, datë 5.11.2007; ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Kushtet e përfitimit për personat e grupit të parë, sipas këtij ligji, janë:

1. Të kenë mbushur moshën 60 vjeç ose para kësaj moshe, kur deklarohet invalid i plotë, sipas ligjit për sigurimet shoqërore të detyrueshme. Duke filluar nga data 1.1.2032, mosha e përfitimit rritet me nga 6 muaj për çdo vit, deri në arritjen e moshës 63 vjeç.
2. Të kenë periudha të njohura shërbimi në një nga funksionet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 8, të nenit 1.
3. Të ketë ndërprerë veprimtarinë ekonomike.

Neni 9

Masa e pensionit

(Shtuar shkronja "c" me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003; ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Masa e pensionit shtetëror suplementar është:

- a) për Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin, 25 për qind e pagës referuese, edhe nëse periudha e shërbimit është më e vogël se dy vjet, dhe 5 për qind më shumë për çdo vit shërbimi mbi dy vjet;
- b) për grupin e parë, përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 8, të nenit 1, përjashtuar personat e përmendur në shkronjën "a", të këtij neni, 25 për qind e pagës referuese për 2 vjet shërbim dhe 5 për qind më shumë për çdo vit shërbim mbi këta 2 vjet. Kur këta persona nuk plotësojnë periudhën e shërbimit prej dy vjetësh, përfitojnë pension suplementar të reduktuar në masën 1 për qind të pagës referuese për çdo muaj shërbimi;
- c) për grupin e parë, përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 8, të nenit 1, 20 për qind e pagës referuese për 2 vjet shërbim dhe 5 për qind më shumë për çdo vit shërbim mbi këta 2 vjet. Kur këta persona nuk plotësojnë periudhën e shërbimit prej dy vjetësh, përfitojnë pension suplementar të reduktuar, në masën 0,8 për qind të pagës referuese për çdo muaj shërbimi.

Masa e pensionit nuk duhet të jetë më e madhe se:

- a) 60 për qind e pagës referuese për personat e grupit të parë, përcaktuar në shkronjën "a", të nenit 1;
- b) 50 për qind e pagës referuese për personat e grupit të parë, përcaktuar në shkronjën "b", të nenit 1.

Masa e pensionit shtetëror suplementar, plus pensionin e përfituar nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Shqipërisë", të ndryshuar, nuk mund të jetë më e madhe se 75 për qind e pagës referuese mesatare të funksioneve.

Neni 10

Kushtet e përfitimit për grupin e dytë

(Shtuar paragrafi me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; ndryshuar shkronja "b" me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003, ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Kushtet e përfitimit për personat e grupit të dytë, sipas këtij ligji, janë:

- a) të kenë kryer 35 vite shërbimi në detyrat ose funksionet e parashikuara nga ky ligj; ose

b) të kenë arritur moshën për pension pleqërie, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ose

c) para kësaj moshe, kur deklarohet invalid i plotë, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Personat, të cilët plotësojnë njërin nga kushtet e sipërpërmendura, duhet të kenë ndërprerë veprimtarinë ekonomike.

Neni 11

Masa e pensionit

(Ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Masa e pensionit shtetëror suplementar në kushtet e nenit 10 është:

a) për personat e grupit të dytë, sipas shkronjës “a”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji, 1,5 për qind në vit të pagës referuese, për çdo vit shërbimi;

b) për personelin drejtues të grupit të dytë, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji, 1,3 për qind në vit të pagës referuese, për çdo vit shërbimi;

c) për personelin specialist të grupit të dytë, sipas shkronjës “d”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji, 1,1 për qind në vit të pagës referuese, për çdo vit shërbimi.

Pensioni shtetëror suplementar maksimal, sipas këtij neni, nuk duhet të jetë më i madh se 40 për qind e pagës referuese.

Masa e pensionit shtetëror suplementar, plus pensionin e përfituar nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk mund të jetë më e madhe se 75 për qind e pagës referuese të funksionit.

PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE FAMILJARE

Neni 12

Kushtet e përfitimit

Përfitojnë pensione familjare nga personi që vdes dhe që përfitonte ose kishte kushtet për pension shtetëror suplementar sipas këtij ligji, këta persona në ngarkim:

- bashkëshorti pasjetues,
- jetimi

dhe kur kanë plotësuar kushtet për pension familjar sipas ligjit për sigurimet shoqërore.

Neni 13

Masa e pensionit

(Ndryshuar me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003)

Masa e pensionit në kushtet e nenit 12 është:

a) 50 për qind për bashkëshortin pasjetues dhe

b) 25 për qind për jetimin.

Kur nuk merret pensioni i parashikuar në shkronjën “a” të këtij neni, masa e pensionit për jetimin është vetëm 50 për qind.

Në çdo rast masa e pensionit suplementar familjar nuk mund të jetë më e lartë se pensioni suplementar që kishte ose i takonte të përfitonte mbajtësi i familjes.

Neni 14

Personat që aksidentohen në shërbim dhe deklarohen invalidë të përhershëm, sipas ligjit për sigurimet shoqërore, përfitojnë pension shtetëror suplementar në masën 40 për qind të pagës referuese, pavarësisht nga koha e punës në funksionet a detyrat sipas përkufizimeve të nenit 1.

KREU III DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 15

(Shtuar paragrafi me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; ndryshuar me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003; ndryshuar e shtuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Vite shërbimi për efekt përfitimi nga ky ligj do të njihen vitet e punuara në funksionet apo detyrat e përcaktuara nga ky ligj nga data 1 prill 1991. Periudhë shërbimi, për efekt përfitimi nga ky ligj, pas 1 prillit 1996, do të njihet periudha, gjatë së cilës është derdhur kontribut në fondin e sigurimit shtetëror suplementar.

Kanë të drejtë të marrin përfitime shtetërore suplementare presidentët e Republikës, që kanë qenë në këtë funksion prej datës 1 prill 1991. Përfitimet e mësipërme do të jepen që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”. Efektet financiare, për pagimin e këtyre përfitimeve, të përballohen nga buxheti i shtetit.

Procedurat dhe institucionet kompetente për njësimin e funksioneve dhe të pagës referuese, kur emërtimet e funksioneve kanë ndryshuar, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Paga referuese, për efekt të llogaritjes së pensionit suplementar, sipas këtij ligji, për deputetët e legjislaturës 1991-1992, që në të njëjtën kohë punonin në funksione dhe detyra të tjera, do të jetë paga referuese e deputetit, në momentin e daljes së tyre në pension.

Neni 16

Kur vitet e shërbimit nuk janë vite të plota, për efekt llogaritjeje të masës së përfitimit, do të llogariten edhe ditët ose muajt mbi këto vite. Mënyra e llogaritjes do të përcaktohet në udhëzimin që do të nxjerrë Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Neni 17

Indeksimi

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003; ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Pensionet shtetërore suplementare indeksohen. Koha dhe masa e indeksimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18

Pagesa e pensionit shtetëror suplementar ndërpritet kur personi zgjidhet ose caktohet në funksionet a detyrat e grupit të parë ose të dytë. Në këtë rast, pas përfundimit të shërbimit në funksion a detyrë, pensioni shtetëror suplementar do të rillogaritet.

Neni 19

E drejta për përfitim

(Ndryshuar me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

E drejta për përfitim shtetëror suplementar nuk parashkruhet.

Personit, që kërkon përfitim shtetëror suplementar brenda një viti nga data që i ka lindur e drejta, i jepet ky përfitim që nga kjo datë. Në raste të tjera, përfitimi do të paguhet nga data e regjistrimit të kërkesës.

Përfitimet e njohura nga ky ligj, por të patërhequra, do të paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se tre vjet.

Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për tre vjet.

E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti ushtrohet jo më vonë se tre vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se gjashtë muaj nga data e konstatimit dhe masa e ndalesës, për çdo muaj, është 20 për qind e kështit mujor të përfitimit.

Neni 19/1

Të drejtat e fituara

(Shtuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Pensionet shtetërore suplementare me datë fillimi deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfshirë edhe këtë datë, caktohen sipas dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi deri në atë datë dhe nuk janë objekt ndryshimi apo rillogaritjeje, përveç indeksimit, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

Personat, që kanë fituar të drejtën për pension shtetëror suplementar në moshën 55 vjeç e lart, do të vazhdojnë të paguhen, pavarësisht se nuk e kanë arritur moshën e përcaktuar në këtë ligj.

Personat, që janë trajtuar me pension shtetëror suplementar dhe e kanë ndërprerë atë për arsye punësimi, kanë të drejtën e rikthimit në skemën e pensioneve suplementare edhe përpara moshës 60 vjeç.

Neni 20

Pensionet shtetërore suplementare administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Neni 21

Kërkesa

Pensionet shtetërore suplementare jepen me kërkesën e të interesuarit, i cili do të paraqesë dokumentacionin përkatës.

Kërkesa për pension paraqitet pranë organeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Dokumentet që i bashkëngjiten kërkesës, përcaktohen me akte nënligjore.

Neni 22

Pagesa e pensioneve shtetërore suplementare bëhet nga organi i caktuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Neni 23

Apelimet kundër vendimeve të përfitimit bëhen në gjykatë e cila e zgjidh çështjen përfundimisht.

Neni 24

(Ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Pensioni shtetëror suplementar ndërpritet vetëm me vendim gjykate të formës së prerë dhe, në këtë rast, vendoset edhe për kthimin e kontributeve.

KREU IV DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 25

(Ndryshuar me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Pensioni shtetëror suplementar, sipas këtij ligji, përfitohet edhe në rastet kur personi përfiton pension të posaçëm shtetëror, pension nga një skemë tjetër suplementare ose trajtim të veçantë, me kusht që periudhat e shërbimit të mos mbivendosen.

Neni 26

Personi që ka përfituar pension nga ligji për sigurimet shoqërore dhe pas datës 1 prill 1991 është në marrëdhënie pune në funksionet a detyrat e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, merr përfitimet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 27

Personi, i cili, sipas ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës kundër Pushtuesve Nazifashistë”, përfiton shtesë pensioni dhe në rast se pas datës 1 prill 1991 është në marrëdhënie pune në funksionet a detyrat e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, merr përfitimet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 28

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999)

Neni 29

(Shtuar paragrafi me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 1, 15 dhe 17 të këtij ligji.

2. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Financave të nxjerrin aktin nënligjor të përbashkët për procedurat e pagimit të kontributeve dhe të përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj.

Neni 30

Ky ligj hyn në fuqi më 1 prill 1996.

**Shpallur me dekretin nr.1445, datë 5.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**

III. SIGURIME DHE PENSIONE SUPLEMENTARE

LIGJ

Nr.10 142, datë 15.5.2009

PËR SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË GARDËS SË REPUBLIKËS, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, TË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES, TË POLICISË SË BURGJEVE, TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT E TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË⁵

(Ndryshuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.33, datë 24.6.2010, aktin normativ nr.5, datë 10.11.2010 (miratuar me ligjin nr. 10 367, datë 23.12.2010), ligjin nr. 102/2016, datë 20.10.2016)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

(ndryshuar me ligjin nr. 102/2016, datë 20.10.2016)

Qëllimi i këtij ligji është t'u garantojë përfitime suplementare, mbi ato të përcaktuara në ligjin nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ushtarakëve të Forcave të Armatosura, punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës së Shqipërisë, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm e anëtarëve të familjeve të tyre, kur ata e ndërpresin karrierën, sipas përcaktimeve në ligjet nr.9171, datë 22.1.2004 "Për gradat dhe karrierën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", nr.8869, datë 22.5.2003 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nr.9357, datë 17.3.2005 "Për Shërbimin Informativ të Shtetit", nr. 65/2014, "Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes" nr. 10 032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve", nr.8766, datë 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin" dhe nr.10 002, datë 6.10.2008 "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme".

⁵ Ligji nr. nr.10 142, datë 15.5.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 87/2009, datë 12 qershor 2009.

Akti normativ nr. 5, datë 10.11.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.161/2010, datë 6 dhjetor 2010.

Ligji nr.10 367, datë 23.12.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 181/2010, datë 15 janar 2011.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.33, datë 24.6.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 94/2010, datë 22 korrik 2010.

Ligji nr. 102/2016, datë 20.10.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 207, datë 4 nëntor 2016.

Neni 2

Përfituesit

(shtuar pika 4/1 me ligjin nr. 102/2016, datë 20.10.2016)

Përfitues, sipas këtij ligji, janë:

1. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë: oficerë, nënoficerë, studentë ushtarakë dhe kursantë për nënoficerë, ushtarë me pagesë/profesionistë, ushtar i shërbimit të detyrueshëm, ushtarak në rezervë/lirim/pension pleqërie.

2. Punonjësit e Policisë së Shtetit kur janë aktivë, me pagesë kalimtare, në pension pleqërie, studentë kursantë dhe ushtarë (ndihmës agjentë).

3. Punonjësit e Gardës, që gjenden në karrierë, punonjësit me status si kursantë, studentët dhe ushtarët, ish-punonjësit e Gardës, që janë në dispozicion, në pritje për riemërim në detyrë dhe ish-punonjësit e Gardës, që kanë dalë në rezervë ose në lirim pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.8869, datë 25.3.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilët trajtohen me pagesë kalimtare apo që kanë dalë në pension.

4. Punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, në marrëdhënie pune me këtë shërbim, ata në lirim, me pagesë kalimtare, në pension, si dhe kursantët.

4/1. Punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në marrëdhënie pune me këtë agjenci, ata në lirim, me pagesë kalimtare dhe në pension.

5. Punonjësit e Policisë së Burgjeve, kur janë aktivë, me pagesë kalimtare, në pension pleqërie, studentë kursantë dhe ushtarë (ndihmës agjentë).

6. Punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit.

7. Punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm.

8. Anëtarët e familjeve të personave të përmendur në pikat 1-7 të këtij neni.

Neni 3

Vjetërsia në shërbim

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 102/2016, datë 20.10.2016)

1. Vjetërsia në shërbim, sipas kategorive të përfituesve, është ajo e përcaktuar në ligjet nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nr.9357, datë 17.3.2005 “Për Shërbimin Informativ të Shtetit”, nr. 65/2014, “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”, nr.10 032 datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin” dhe nr.10 002, datë 6.10.2008 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme”.

2. Për efekt të zbatimit të këtij ligji, vjetërsia e shërbimit, e njohur sipas ligjeve të sipërpërmendura, bashkohet.

3. Për efekt të përllogaritjes së përfitimeve, viti i shërbimit njihet vetëm kur është vit i plotë.

4. Në vjetërsinë në shërbim përfshihen edhe:

a) koha e ndërprerjes së karrierës, për shkak të një urdhri apo vendimi të padrejtë, të deklaruar me vendim gjykatë;

b) koha e plotë e vuajtjes së dënimit me burgim ose internim, për motive politike, pas titullimit në karrierë, nga personat, që kanë shërbyer në strukturat e përcaktuara në këtë ligj, kur kanë përfutur sipas ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”.

5. Për efekt të llogaritjes së vjetërsisë në shërbim, koha e shërbimit në disa funksione organike, me specifike të veçantë vështirësie, llogaritet me 1,5-fishin. Për përmbajtjen e kësaj dispozite shprehen strukturat respektive, me shkrim, se cilat do të jenë funksionet e veçanta organike, që do të rivlerësohen me 1,5-fishin. Këto funksione organike miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Paga referuese

(ndryshuar paragrafi i dytë dhe i tretë i pikës 2 dhe shtuar pika 5 me aktin normativ nr.5, datë 10.11.2010 (miratuar me ligjin nr. 10 367, datë 23.12.2010),

1. Përfitimet, që jepen nga ky ligj, llogariten në bazë të pagës referuese.
2. Paga referuese përbëhet nga paga bazë mujore për gradë, sipas viteve të shërbimit dhe shtesat mbi pagë, ose nga paga bazë mujore për funksion dhe shtesat, të cilat përcaktohen e zbatohen për të njëjtën gradë apo funksion në datën e lindjes së të drejtës së një përfitimi.
Për efekt të llogaritjes së përfitimeve:
 - a) Paga referuese neto është paga që rezulton pas zbritjes, nga paga referuese, të kontributit të detyrueshëm të sigurimit shoqëror dhe shëndetësor plus tatimin mbi të ardhurat personale plus kontributin suplementar, sipas këtij ligji, të cilat mbahen nga paga.
 - b) Paga mesatare referuese llogaritet si mesatare e pagave referuese sipas periudhave të qëndrimit në atë gradë apo funksion.
 - c) Paga mesatare referuese neto është paga e barabartë me pagën referuese mesatare, pasi i zbritet shuma e kontributit të sigurimit shoqëror shëndetësor, tatimit mbi të ardhurat dhe kontributit suplementar, sipas këtij ligji, të cilat mbahen nga paga.
3. Paga referuese të njësuara, rregullat e llogaritjes së pagës referuese neto dhe rregullat e llogaritjes së pagës mesatare referuese neto, për të gjithë karrierën, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Për studentët e shkollave të larta, që përgatiten si ushtarakë, si punonjës të Policisë së Shtetit, si punonjës të Gardës së Republikës së Shqipërisë, si punonjës të Policisë së Burgjeve e të tjerë, apo kursantët, që përgatiten si punonjës të Shërbimit Informativ të Shtetit, paga referuese, për efekt përfitimi, është paga e gradës apo funksionit më të ulët të oficerit ose e inspektorit të SHISH-it, ndërsa për kursantët për nënoficerë, paga referuese është paga më e ulët e gradës apo funksionit të nënoficerit ose ndihmësinsektorit të SHISH-it të nivelit përkatës.
5. Kur funksioni ose grada, që kishte përfituesi, nuk ekziston më, Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm (Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Komandanti i Gardës), Ministri i Drejtësisë dhe Drejtori i SHISH-it, me urdhër, bëjnë njësimin e tyre me ato funksione apo grada, që janë në fuqi në çastin e lindjes të së drejtës për përfitim.
6. Kudo ku, në këtë ligj, për efekt të llogaritjes së përfitimeve, përdoret shprehja “pagë mesatare referuese”, do të zëvendësohet me shprehjen “pagë mesatare referuese neto”, ndërsa shprehja “pagë referuese” zëvendësohet me “pagë neto referuese”.

Neni 5

Financimi

(ndryshuar shifra në pikën 3 me aktin normativ nr.5, datë 10.11.2010, miratuar me ligjin nr. 10 367, datë 23.12.2010)

1. Përfitimet nga ky ligj financohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga kontributet suplementare. Mënyra e llogaritjes, procedurat e financimit dhe të pagesës së përfitimeve, shpenzimet e administrimit dhe të financimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Llogaritja dhe pagimi i përfitimeve, që rrjedhin nga ky ligj, me përjashtim të atyre të përcaktuara në nenet 9, 10, 11, 12 e 22, bëhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.
3. Personat e përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji, gjatë kohës që janë aktivë, paguajnë kontribut shtesë në masën 5% të pagës referuese.
4. Kontributet shtesë llogariten mbi pagën referuese mujore, në përputhje me të njëjtat rregulla, procedura afatpaguese dhe kontribute, si për sigurimin shoqëror të detyrueshëm.

Neni 6
Përfatimi nga tatimet

Përfatimet nga ky ligj nuk tatohen.

KREU II
FUSHA E MBROJTJES

Neni 7
Llojet e përfatimeve suplementare dhe kushtet e përfatimit

Personave të përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji apo familjeve të tyre u sigurohen përfatime suplementare, mbi ato të përcaktuara në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për:

- a) paaftësi të përkohshme në punë e shërbim;
- b) parandalim për sëmundje;
- c) rehabilitim shëndetësor;
- ç) shpërbim i menjëhershëm dhe pagesë kalimtare, kur nxirren në lirim/rezervë;
- d) pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi;
- dh) pension suplementar, mbi pensionin e plotë të pleqërisë;
- e) pension suplementar invaliditeti;
- ë) pension suplementar familjar;
- f) pension suplementar familjar, kur, për shkak të detyrës, humbasin jetën;
- g) pagesa suplementare për shpenzime varrimi.

KREU III
PËRFATIMET SUPLEMENTARE

Neni 8
Kushtet e përfatimit për paaftësi të përkohshme në punë
(ndryshuar me ligjin nr. 102/2016, datë 20.10.2016)

Ushtaraku i shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura, punonjësi i Policisë së Shtetit, i Gardës, i Shërbimit Informativ të Shtetit, i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, i Policisë së Burgjeve, i Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm për kohën që, për arsye shëndetësore, bëhen të paaftë për punë, paaftësi e cila vërtetohet me raport mjekësor, marrin përfatime suplementare.

Neni 9
Masa e përfatimit për paaftësi të përkohshme në punë

Masa e përfatimit suplementar për paaftësi të përkohshme në punë llogaritet:

- a) 100 për qind e pagës referuese të muajit të fundit kalendarik të shërbimit, kur paaftësia e përkohshme zgjat deri në 14 ditë;
- b) 20 për qind e pagës referuese të muajit të fundit kalendarik të shërbimit, nga dita e pesëmbëdhjetë e paaftësisë e në vazhdim;
- c) 10 për qind e pagës referuese të muajit të fundit kalendarik të shërbimit për periudhën e shtrimit në spital, kur përfatuesi ka persona në ngarkim.

Neni 10

Parandalimi për sëmundje

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 102/2016, datë 20.10.2016)

Ushtaraku i Forcave të Armatosura, punonjësi i Policisë së Shtetit, i Gardës, i SHISH-it, i/të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, i Policisë së Burgjeve, i Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në varësi të situatave operationale, sipas përcaktimit të bërë nga komisioni mjekësor ushtarak, pranë Spitalit Universitar Qendror Ushtarak, gëzojnë të drejtën e parandalimit për sëmundje.

Ministri i Mbrojtjes, me udhëzim, përcakton rastet, procedurat dhe kriteret përkatëse për zbatimin e këtij neni.

Neni 11

Rehabilitimi shëndetësor

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 102/2016, datë 20.10.2016)

Shpenzimet për trajtimin shëndetësor dhe rritimin e ushtarakut të Forcave të Armatosura, të punonjësit të Policisë së Shtetit, të Gardës, të SHISH-it, i/të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, punonjësit të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, për rikthimin e aftësive në punë, nga një sëmundje apo dëmtim trupor, të ndodhur për shkak të detyrës dhe të vërtetuar nga komisioni mjekësor ushtarak, pranë Spitalit Universitar Qendror Ushtarak, përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Kriteret dhe masa e trajtimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Shpërblimi i menjëhershëm dhe pagesa kalimtare

(ndryshuar pika 1 dhe 4 me ligjin nr. 102/2016, datë 20.10.2016)

1. Ushtaraku i shërbimit aktiv të përhershëm i Forcave të Armatosura, i Policisë së Shtetit, i Gardës së Republikës, i SHISH-it, i/të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, i Policisë së Burgjeve, i Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të cilët, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxirren në rezervë apo lirim, marrin një shpërblim të menjëhershëm, në masën e dy pagave referuese mujore dhe pas këtij fillon trajtimi financiar me pagesë kalimtare.

2. Pagesë kalimtare jepet kur përfituesi ka jo më pak se 3 muaj shërbim. Pagesa kalimtare llogaritet në masën 50 për qind të pagës referuese mujore dhe fillon në muajin e tretë nga data e nxjerrjes në rezervë apo lirim.

3. Trajtimi financiar me shpërblimin e menjëhershëm dhe me pagesë kalimtare, për të dyja llojet e përfitimeve së bashku, zgjat për aq muaj sa përfituesi ka vjetërsi shërbimi, por jo më shumë se 24 muaj.

4. Personat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni nuk përfitojnë shpërblim të menjëhershëm dhe pagesë kalimtare, në rastet kur:

a) kryejnë vepra penale ose shkelje, që dënohen me masën disiplinore përjashtim nga Forcat e Armatosura, nga Policia e Shtetit, Garda e Republikës, SHISH-i, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Policia e Burgjeve;

b) largohen me kërkesën e vet për të filluar një veprimtari tjetër ekonomike ose për t'u punësuar në një sektor tjetër;

c) dërgohen me një detyrë shtetërore më të lartë ose paralele, me pagë mujore jo më të vogël se paga që merrnin.

5. Në rastet kur përfituesi punësohet, mund të përfitojë pagesë kalimtare për aq kohë sa është

përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, por deri në atë masë, sa paga e re plus pagesën kalimtare të mos e kalojnë pagën referuese mujore, në bazë të së cilës është llogaritur pagesa kalimtare.

Neni 13

Kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi

(ndryshuar me ligjin nr. 102/2016, datë 20.10.2016)

Ushtaraku i shërbimit aktiv të përhershëm në Forcat e Armatosura, punonjësi i Policisë së Shtetit, i Gardës së Republikës, i SHISH-it, i/të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, i Policisë së Burgjeve, i Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, pavarësisht nga koha e daljes në rezervë/lirim, deri në plotësimin e moshës për pension të plotë pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, fitojnë të drejtën e pensionit të parakohshëm, kur:

- a) plotësojnë vjetërsinë në shërbim, 12 vjet për femrat dhe 15 vjet për meshkujt;
- b) kanë mbushur moshën 42 vjeç femrat dhe 47 vjeç meshkujt.

Neni 14

Masa e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi

(Shfuqizuar pika 2 me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.33, datë 24.6.2010, ndryshuar pika 1 dhe 2 me aktin normativ nr.5, datë 10.11.2010 (miratuar me ligjin nr. 10 367, datë 23.12.2010))

1. Pensioni i parakohshëm, për personat që plotësojnë kushtet e përfitimit, është 1.5 për qind e pagës mesatare referuese mujore neto, për çdo vit shërbimi.

2. Në çdo rast, masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e ulët se pensioni bazë, i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi ndërpritet kur përfituesi rikthehet në shërbimin aktiv.

4. Kur përfituesi i pensionit të parakohshëm punësohet në vende të tjera pune, që nuk lidhen me funksionin e tij të mëparshëm, masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi bëhet sa një pension bazë, i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Në rastet kur karriera është ndërprerë, për shkaqet e përcaktuara në pikën 4 të nenit 12 të këtij ligji, e drejta për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, nëse plotësohen kushtet e përcaktuara për këtë përfitim, fillon pas 24 muajve.

Neni 15

Kushtet e përfitimit të pensionit suplementar të pleqërisë

(ndryshuar me ligjin nr. 102/2016, datë 20.10.2016)

Ushtaraku i Forcave të Armatosura, punonjësi i Policisë së Shtetit, i Gardës së Republikës, të SHISH-it, i/të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, i Policisë së Burgjeve, i Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, që përfitojnë pension pleqërie, sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, gëzojnë të drejtën e një pensioni suplementar pleqërie.

Neni 16

Masa e përfitimit të pensionit suplementar të pleqërisë

Pensioni suplementar i pleqërisë llogaritet me 1 për qind të pagës mesatare referuese mujore për çdo vit shërbimi, por jo më shumë se 50 për qind e pensionit të pleqërisë, që përfituesi gëzon në çastin e lindjes së të drejtës për pension suplementar.

Neni 17

Kushtet e përfitimit të pensionit suplementar të invaliditetit

(ndryshuar me ligjin nr. 102/2016, datë 20.10.2016)

Ushtaraku i shërbimit aktiv të përhershëm në Forcat e Armatosura, punonjësi i Policisë së Shtetit, i Gardës së Republikës, i SHISH-it, i/të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, i Policisë së Burgjeve, i Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm përfitojnë të drejtën për pension invaliditeti suplementar në rastet kur janë deklaruar invalidë dhe përfitojnë pension invaliditeti të plotë apo të pjesshëm, sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” ose ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 18

Masa e përfitimit të pensionit suplementar të invaliditetit

1. Pensioni suplementar i invaliditetit llogaritet 1 për qind për çdo vit shërbimi mbi pagën mesatare referuese mujore, por jo më shumë se 50 për qind të pensionit të invaliditetit, që përfitohet sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” ose ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Kur personat e sipërpërmendur bëhen invalidë në krye të detyrës apo për shkak të saj, masa e pensionit suplementar të invaliditetit është 20 për qind e pagës referuese.

Neni 19

Kushtet e përfitimit të pensionit suplementar familjar

Pjesëtarët e familjes, në ngarkim të personave të përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji, kur përfitojnë pension familjar, sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” ose ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përfitojnë edhe pension suplementar familjar.

Neni 20

Masa e përfitimit të pensionit suplementar familjar

Pensioni suplementar familjar llogaritet në bazë të pensionit suplementar mujor, që kishte ose i takonte të merrte i ndjeri/e ndjera dhe është 50 për qind për bashkëshortin/bashkëshorten e ve dhe 25 për qind për çdo jetim, prind ose pjesëtar tjetër të familjes në ngarkim.

Kufiri maksimal i këtij përfitimi nuk duhet të jetë më i lartë se shuma e plotë e pensionit suplementar, që kishte ose i takonte të merrte i ndjeri/e ndjera, sipas këtij ligji.

Neni 21

**Pensioni suplementar familjar për personat që humbasin jetën
në detyrë apo për shkak të saj**

(ndryshuar me ligjin nr. 102/2016, datë 20.10.2016)

Pjesëtarët e familjes në ngarkim të ushtarakut të shërbimit aktiv të përhershëm në Forcat e Armatosura, të punonjësit të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të SHISH-it, i/të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësit të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, që humbasin jetën në detyrë apo për shkak të saj, përveçse përfitojnë pension familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përfitojnë edhe pension suplementar familjar sa diferenca ndërmjet pagës referuese të të ndjerit/së ndjerës, në çastin e humbjes së jetës dhe pensionit familjar, që përfitonte, sipas dispozitave të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 22

Pagesa për shpenzime varrimi

(ndryshuar me ligjin nr. 102/2016, datë 20.10.2016)

Pjesëtarëve të familjes së ushtarakut të Forcave të Armatosura, të punonjësit të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësit të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, që humbasin jetën në detyrë apo për shkak të detyrës, u jepet ndihmë e menjëhershme dhe u kompensohen shpenzimet e varrimit. Kriteret dhe masa e ndihmës së menjëhershme e të kompensimit të shpenzimeve të varrimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

PERIUDHAT E SIGURIMIT

Neni 23

Periudha e sigurimit dhe kontributet

1. Periudha e trajtimit me pagesë kalimtare apo me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi njihet si periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni pleqërie, invaliditeti e familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Kontributi për këto periudha përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe derdhet në bazë të pagës referuese, sipas së cilës është llogaritur përfitimi mujor, e indeksuar çdo vit me koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar, por, në çdo rast, brenda kufijve të pagës minimale dhe maksimale, të caktuar nga Këshilli i Ministrave, për efekt të pagesës së kontributeve të detyrueshme.

Në rastet kur përfituesi i pagesës kalimtare apo i një pensioni të parakohshëm për vjetërsi shërbimi punësohet, kontributi nga Buxheti i Shtetit derdhet në nivelin minimal.

2. Për të gjithë ushtarakët, që kanë dalë në rezervë apo në lirim, periudha e trajtimit financiar, sipas vendimeve nr.225, datë 29.5.1992 dhe nr.7, datë 10.1.1996 të Këshillit të Ministrave, njihet si periudhë sigurimi, për efekt përfitimi të pensionit të pleqërisë, të invaliditetit e familjar, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Kontributet llogariten në bazë të pagës referuese, sipas së cilës është llogaritur trajtimi financiar, e indeksuar me koeficientin e indeksimit të bazës së vlerësuar për të gjithë periudhën.

Për këtë periudhë, fondet për pagesën e kontributeve jepen nga Buxheti i Shtetit, në varësi të numrit të personave që përfitojnë pension.

Paga, sipas së cilës është llogaritur trajtimi financiar, kur zgjidhet nga ushtaraku, merret edhe si pagë bruto, për efekt të rilogaritjes së pensionit të pleqërisë dhe të pensionit suplementar.

3. Procedurat e llogaritjes dhe të pagesës së kontributeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 24 **Indeksi**

1. Përfitimet suplementare, sipas neneve 14, 16, 18, 20, 21 e 26 të këtij ligji, llogariten në bazë të pagës mesatare referuese mujore në çastin e lindjes së të drejtës dhe më pas nuk janë objekt i ndonjë ndryshimi, me përjashtim të indeksimit. Ato indeksohen sa herë indeksohen edhe pensionet e caktuara sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Indeksi dhe koha e zbatimit të tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Përfitimet që jepen në përputhje me nenin 21 të këtij ligji vendosen në vlerën 100 për qind të pagës, sa herë që paga, sipas së cilës është llogaritur ky përfitim, ndryshon.

Neni 25 **Mospërjashtimi nga përfitimet e përcaktuara nga ligje të tjera**

Personat e përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji apo familjarët e tyre, kur plotësojnë kushtet për përfitim, sipas këtij ligji dhe, njëkohësisht, u lind e drejta të përfitojnë nga ligjet nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension” të ndryshuar, nr.9361, datë 24.3.2005 “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave oficerë dhe nënoficerë, lundruar, të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare në pension”, nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar dhe nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, kanë të drejtë të zgjedhin përfitimin më të favorshëm.

E drejta e zgjedhjes së përfitimit më të favorshëm ushtrohet edhe në rastet kur personit i lind më shumë se një e drejtë, e parashikuar në këtë ligj.

Neni 26 **Pensioni suplementar për ushtarakët në pension**

Ushtaraku, që ka ndërprerë karrierën para hyrjes në fuqi të ligjit nr.7496, datë 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakëve të Forcave të Armatosura”, të ndryshuar dhe e ka përfituar pensionin sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” apo sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përfiton pension suplementar.

Kushtet e përfitimit dhe masa e pensionit suplementar janë sipas këtij ligji dhe të njëjta me ato të përcaktuara edhe për ushtarakët, që e kanë ndërprerë karrierën pas kësaj date. Kategoritë e përfituesve dhe mënyra e llogaritjes së pagës referuese caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27

Përfitimi nga përfitimi

(Shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.33, datë 24.6.2010)

Neni 28

E drejta e përfitimeve

1. E drejta e përfitimeve nga ky ligj nuk parashkruhet. Personi, që kërkon përfitimet jo më vonë se 1 vit nga data kur i lind kjo e drejtë, përfitimi i paguhet nga data e lindjes së të drejtës. Në raste të tjera, përfitimi paguhet nga data e paraqitjes së kërkesës për përfitim.

2. Përfitimet e njohura, por të patërhequra nga personi, paguhet në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet.

3. Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo për më shumë se për një vit.

4. Personi, që ka përfitur pension ose të ardhura të tjera nga sigurimet shoqërore suplementare, në mënyrë e mjete në kundërshtim me ligjin, detyrohet ta kthejë të gjithë shumën e marrë tepër, e cila i mbahet çdo muaj, në masën 50 për qind të kështit mujor të përfitimit, si dhe dënohet me gjobë, në masën katërfish të shumës së përfitur në kundërshtim me ligjin, pavarësisht nga dënimi i parashikuar në dispozitën përkatëse të Kodit Penal.

Për rastet kur përfitimi është llogaritur gabim, masa e ndalesës është 20 për qind e kështit mujor.

Neni 29

Rillogaritja e të drejtave të njohura

1. Dispozitat e ligjeve nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nr.8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit” zbatohen deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare, të caktuara në përputhje me ligjet nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nr.8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, si edhe ato të caktuara me vendime të gjykatave, pavarësisht nga mosha e vjetërsia në punë, në çastin e fillimit të së drejtës, do të rillogariten. Rillogaritja bëhet sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në bazë të pagave referuese, në çastin që i ka lindur e drejta për përfitim. Mbi këtë masë përfitimi të rivlerësuar zbatohen koeficientët e rritjes apo të indeksimit të pensionit, sipas vendimeve të veçanta të Këshillit të Ministrave, nga çasti i lindjes së të drejtës dhe deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Masa e pensionit, e rivlerësuar si më lart, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vlerësohet si shumë përfundimtare e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ose e pensionit suplementar.

3. Pensionet për vjetërsi shërbimi, kur plotësohen kriteret e nenit 11 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe kur e drejta për përfitim ka lindur në harkun kohor l. 1.1999 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, por nuk është caktuar, llogariten sipas kriterëve të këtij ligji.

Neni 30

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të neneve 3, 4, 5 pika 1, 11, 22, 23 pika 3, 24 pika 1, 26 e 29 të këtij ligji.

Neni 31
Shfuqizimet

Shfuqizohen:

Ligji nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të ndryshuar;

Ligji nr.9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Dekreti nr.758, datë 1.2.1994 “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”;

Ligji nr.8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”;

Pikat 1 e 2 të nenit 35 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”;

Neni 89 i ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”;

Pikat 1 e 2 të nenit 39 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Nenet 24, 25 pika 1, 42 pika 4 dhe 43 të ligjit nr.9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të SHISH-it”.

**(DISPOZITA KALIMTARE TË AKTIT NORMATIV NR.5, DATË 10.11.2010,
MIRATUAR ME LIGJIN NR. 10 367, DATË 23.12.2010)**

Neni 4

Kërkesa për përfitim, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 28 të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, nga personat që e drejta u ka lindur por nuk është ushtruar, mund të ushtrohet deri më 31.12.2010 dhe përfitimi do të jepet nga data e hyrjes në fuqi të ligjit të sipërpërmendur.

Shumat e pensioneve të parakohshme, të rillogaritura, kur rezulton shtesë mbi shumat e përfituara më parë, i paguhen përfituesit me këste, sipas përcaktimeve, me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me parashikimet në buxhetin e vitit përkatës.

Neni 5

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare, si më poshtë:

- a) Për përfitimet, nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009;
- b) Për ndryshimin e normës së kontributit, nga data 1.1.2011.

Neni 32
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6200, datë 5.6.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM
Nr. 429, datë 12.9.2002

**PER KUSHTET E PERFITIMIT, SHUMEN DHE PROCEDUREN E DHENIES
SE PENSIONEVE TE POSAÇME SHTETERORE DHE TE SHITESAVE TE
PENSIONEVE TE POSAÇME SHTETERORE**

(Ndryshuar me VKM Nr. 730, datë 2.9.2015)

Ne mbeshketje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 5 te ligjit nr. 7703, date 11.5.1993 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise", me ndryshimet perkatese, me propozimin e Ministrit te Punes dhe Çeshtjeve Sociale, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pension te posacem shteteror ose shtese pensioni te posacem shteteror perfiton personi, qe ploteson kushtet e percaktuara ne shkronjat "a", "b" dhe "c" te nenit 5 te ligjit nr. 7703, date 11.5.1993 "Per ndryshimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise", me ndryshimet perkatese.

2. Moshja dhe vjetersia ne pune per perfitimin e pensionit te posacem shteteror eshte percaktuar ne ligjin nr.7703, date 11.5.1993, me ndryshimet perkatese.

3. Personave te cilesuar te paafte per pune, me vendim te KMCAP-it, mund t'u jepet pension i posacem shteteror ose shtese pensioni i posacem shteteror edhe nen kufijte e moshave te percaktuara ne nenin 92 te ligjit nr.7703, date 11.5.1993, me ndryshimet perkatese.

4. Kerkesa per perfitimin e pensionit te posacem shteteror ose shteses se pensionit te posacem shteteror behet nga i interesuari ose nga organizatat a shoqatat, nepermjet keshillit te qarkut te vendbanimit te personit te propozuar, ministrave perkates, Kryeministrit, Kryetarit te Kuvendit ose Presidentit.

Keshilli i qarkut, Ministri, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit ose Presidenti, pasi shqyrtojne kerkesen dhe dokumentacionin shoqerues, i propozojne Keshillit te Ministrave, me vendim te argumentuar, dhenien e pensionit te posacem shteteror ose shteses se pensionit te posacem shteteror . Vendimi i paraqitet Keshillit te Ministrave, se bashku me dokumentacionin qe kerkohet sipas ketij vendimi. Kur kerkesa nuk vleresohet si e drejte, i kthehet kerkuesit, e shoqeruar me argumentet perkatese.

Ministri, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit ose Presidenti mund te propozojne drejtpedrejt, me nismen e tyre, pavaresisht nga mosparaqitja e kerkeses se te interesuarit, dhenien e pensionit te posacem shteteror ose shtetes se pensionit te posacem shteteror, personave qe vleresohen se plotesojne kriteret ligjore.

5. Propozimi, qe paraqitet ne Keshillin e Ministrave, per perfitimin e pensionit te posacem shteteror ose shtese pensioni te posacem shteteror, shoqerohet me:

-kerkesen e te interesuarit, te shoqates a te organizates, e cila duhet te permbaje: gjeneralitetet, emrin, atesine, mbiemrin, datelindjen, vendlindjen etj;

Ne rastin e propozimit te drejtpedrejte, gjeneralitetet jepen ne vendim.

-vendimin e institucionit propozues, te shoqeruar me relacionin, i cili argumenton arsyet e propozimit dhe paraqet proceduren e ndjekur, etj ;

-certifikaten e gjendjes civile;

-vertetimin nga organet e sigurimeve shoqerore nese merr pension dhe, nese merr pensionin, vertetimin per masen e pensionit;

-vertetimin nga KMCAP-i per personat e paafte per pune;

-kopjet e noterizuara te dokumenteve, qe vertetojne meritat e vecanta te personit per te cilin behet propozimi, si titujt, medaljet, urdhrat etj;

-kopjen e noterizuar te dokumentit te statusit per perfituesit, sipas shkronjes "c" te nenit 5 te ligjit nr. 7703, date 11.5.1993.

6. Pensioni i posaçëm shtetëror nuk mund të jetë më i ulët se dyfishi i pensionit social dhe as më i lartë se katërfishi i tij.

Kufiri maksimal i shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror të jetë deri në katërfishin e pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

7. Per shqyrtimin e dokumentacionit për pension të posaçëm shtetëror ose shtese pensioni të posaçëm shtetëror ngrihet një komision i veçantë. Perberja dhe rregullorja e funksionimit të këtij komisioni miratohen nga Kryeministri. Komisioni për gatit relacion për plotesimin ose jo të kushteve të përcaktuara me ligj dhe me këtë vendim dhe ia paraqet Kryeministrit.

8. Pensioni, data e fillimit të pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror caktohen me vendim individual të Këshillit të Ministrave.

9. Pensioni i posaçëm shtetëror ose shtesa e pensionit të posaçëm shtetëror indeksohen sa herë dhe në masën që indeksohen pensionet e pleqërisë, të përfituara nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993.

10. Instituti i Sigurimeve Shoqërore administron pensionet e posaçme shtetërore dhe shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore. Në buxhetin e sigurimeve shoqërore, çdo vit, parashikohen fonde për 10-15 pensione të posaçme shtetërore ose shtesa pensioneesh të posaçme shtetërore.

11. Shpenzimet për administrimin dhe pagesën e këtyre pensioneve të përballohen nga Buxheti i Shtetit.

12. Vendimi nr .152, datë 5.4.1994 i Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.476, datë 30.6.2010

PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT DHE TË TRAJTIMEVE TË VEÇANTA FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetësve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension”, të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, dhe të ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen, në masën 4 për qind, të:

a) pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, të pensioneve suplementare të pleqërisë, të pensioneve suplementare të invaliditetit, të pensioneve suplementare të invaliditetit të ushtarakëve që, për shkak të detyrës, bëhen plotësisht të paaftë për shërbim, të pensioneve suplementare familjare, të pensioneve suplementare familjare të ushtarakëve, që kanë humbur jetën për shkak të detyrës, të caktuara me ligjin nr.8087, datë 13.3.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, dhe ligjin nr.8661, datë 18.9.2000, “Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar me ligjin nr.10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakut të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”;

b) trajtimit të veçantë financiar të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara me ligjin nr.8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar;

c) trajtimit të veçantë financiar të pilotëve fluturues sipas ligjit nr. 9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”;

ç) trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruar të nëndetësve dhe polumbarëve të forcave detare, në pension”;

d) trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të caktuara sipas ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar;

dh) trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”;

e) pensioneve suplementare, të caktuara sipas ligjit nr.10 139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, të Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë.”.

2. Rritjen, në masën 4 për qind, do ta marrin edhe të gjitha përfitimet e përcaktuara në pikën 1, kur caktohen pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, por me datë fillimi të së drejtës deri më 30.6.2010, përfshirë edhe këtë datë.

3. Efektet financiare, për vitin 2010, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të llogariten në shumën 98 420 mijë lekë dhe të përballohen nga fondi i kontigjencës, i caktuar në buxhetin e shtetit të vitit 2010, për rritjen e pensioneve.

4. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.793, datë 24.9.2010

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.10 142, DATË 15.5.2009 “PËR SIGURIMIN
SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË GARDËS SË
REPUBLIKËS, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, TË POLICISË SË
BURGJEVE, TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT E
TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.252, datë 9.2.2011⁶)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 4, 5, pika 1, 11, 22, 23, pika 1, 26 e 29, të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, të Ministrit të Mbrojtjes, të Ministrit të Brendshëm e të Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Përcaktimin, në zbatim të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, të vjetërsisë në shërbim, të pagës referuese, të procedurave të përfitimeve, të dokumentacionit, të kontributeve dhe të periudhave të sigurimit e të financimit të përfitimeve, si më poshtë vijon:

I. VJETËRSIA NË SHËRBIM

Në mbështetje të ligjeve nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nr.9357, datë 17.3.2005 “Për Shërbimin Informativ të Shtetit”, nr.10 032 datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, nr.10 002, datë 6.10.2008 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme” dhe të nenit 3 e për zbatimin e neneve 12, 13, 14, 16, 18 dhe 26 të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009,

A. Njihet si vjetërsi në shërbim:

1. periudha nga data e titullimit oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist, në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, deri në datën e daljes në rezervë ose lirim;
2. koha e kryerjes së studimeve, brenda dhe jashtë vendit, pas përfundimit të shkollës së lartë ushtarake ose të Akademisë së Rendit;
3. periudha e shërbimit si punonjës i Policisë së Shtetit, nga grada më e ulët e nivelit zbatues në gradën më të lartë në nivelin drejtues e deri në daljen në rezervë ose lirim;
4. koha e qëndrimit në dispozicion për shkak të pritjes për sistemim në një funksion tjetër vetëm kur personi është trajtuar me pagën sipas gradës;
5. periudha e punës si ushtarak në strukturat e Policisë së Kufirit dhe të Gardës së Republikës, kur ata ishin pjesë e Forcave të Armatosura;
6. periudha e punës me statusin e punonjësit të Gardës së Republikës, si gardist, punonjës i Gardës nga niveli i ulët në nivelin madhor deri në datën e daljes në rezervë ose lirim;
7. periudha e punës në strukturat e Ministrisë së Brendshme ose të Ministrisë së Rendit Publik, si punonjës me status policor;

⁶ Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2009

8. periudha kur punonjësi i Policisë, SHKB-së, Gardës, SHISH-it, Policisë së Burgjeve dhe Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, ka punuar si ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm;

9. periudha e punës si punonjës i Shërbimit Informativ të Shtetit nga fillimi si punonjës në detyrë e deri në lirim nga detyra;

10. periudha e punës si punonjës i Shërbimit Informativ të Ushtrisë;

11. periudha e shërbimit si punonjës i PMNZSH-së, nga grada më e ulët e nivelit bazë në gradën më të lartë në nivelin madhor, deri në daljen në rezervë ose lirim;

12. periudha e shërbimit si punonjës i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, nga grada më e ulët e nivelit bazë në gradën më të lartë në nivelin madhor deri në daljen në rezervë ose lirim;

13. periudha e shërbimit si punonjës i Policisë së Burgjeve, nga data e fillimit të shërbimit deri në daljen në rezervë ose lirim;

14. koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të një urdhri të padrejtë të deklaruar me vendim gjykatë;

15. koha e plotë e vuajtjes së dënimit me burgim ose internim pas titullimit në karrierë nga personat, që kanë shërbyer në strukturat e përcaktuara në këtë ligj, kur kanë përfutur sipas ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”.

B. Njihet periudha e punës e kaluar në sektorët civilë nga specialistë të profesioneve shumë të veçanta, të kërkuara nga strukturat e Policisë së Shtetit ose të Gardës së Republikës, vjetërsi shërbimi sa gjysma e saj. Lista e profesioneve me specifike të veçantë, të kërkuara në strukturat e Policisë së Shtetit ose të Gardës së Republikës i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

C. Njihet si vjetërsi shërbimi me 1.5-fishin koha e shërbimit në disa funksione organike, me specifike të veçantë vështirësie, për efekte të plotësimit të kushteve për lindjen e së drejtës për të përfutur nga sigurimet suplementare. Lista e funksioneve i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ç. Për efekt të zbatimit të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, vjetërsia e shërbimit, e përcaktuar sipas pikave 1 e 2 të shkronjës “A” të këtij kreu, si dhe periudha kontributive bashkohen dhe pas bashkimit njihen vetëm vitet e plota.

II. PAGA REFERUESE

Në mbështetje të nenit 4 dhe për zbatimin e neneve 12, 13, 14, 16, 18 e 26 të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, pagat referuese të njehsuara dhe rregullat e llogaritjes së pagës mesatare referuese për të gjithë karrierën janë si më poshtë vijon:

A. Pagë mujore referuese është paga bazë mujore për gradë dhe shtesat mbi pagë me karakter të përhershëm ose paga bazë mujore për funksion dhe shtesat, e cila zbatohet për të njëjtën gradë a funksion, në datën kur personave përfitues u lind e drejta për përfitim.

B. Paga mesatare referuese mujore për të gjithë karrierën llogaritet si shumë e produktit të numrit të muajve të qëndrimit në çdo gradë a funksion me pagën referuese të përcaktuar të shkronjës “A” të këtij kreu, pjesëtuar me numrin total të muajve të qëndrimit në çdo gradë apo funksion. Vjetërsia e shërbimit në çdo gradë a funksion përgjatë karrierës, pagat respektive referuese sipas gradës a funksionit dhe paga mesatare referuese mujore evidentohen në formularët bashkëlidhur këtij vendimi, ku janë përcaktuar edhe rregullat e plotësimit e të arkivimit. Paga mesatare mujore për të gjithë karrierën llogaritet në bazë të pagës ditore. Për llogaritjen e pagës ditore referuese dhe të pagës mesatare mujore referuese, muaji merret me 30 (tridhjetë) ditë.

C. Paga referuese mujore për vjetërsinë në shërbim, përcaktuar në kreun I, shkronja “A”, pikat 4, 14 dhe 15, merret e njehsuar sipas gradës apo funksionit që kishin personat deri në çastin e ndërprerjes së karrierës.

Ç. Paga referuese mujore për vjetërsinë në shërbim, e përcaktuar në kreun I, shkronja “B”, merret e njehsuar sipas gradës apo funksionit që i jepet personit, në çastin e fillimit të karrierës në strukturat e Policisë së Shtetit ose të Gardës së Republikës.

D. Paga referuese e përfituesit, në çastin e lindjes të së drejtës për përfitim, për funksionet ose gradat që nuk ekzistojnë, përcaktohet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, të Ministrit të Brendshëm, të Ministrit të Drejtësisë, të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të komandantit të Gardës së Republikës dhe të drejtorit të SHISH-it. Në urdhër evidentohen funksionet që kishte personi përfitues, funksionet apo gradat me të cilat njehsohen ato, si dhe paga referuese e funksionit apo gradës në çastin e lindjes të së drejtës për një përfitim. Urdhri, në bazë të të cilit plotësohet dokumentacioni i përcaktuar për efekt të përfitimeve suplementare, arkivohet në arkivin e institucionit përkatës.

DH. Paga mesatare referuese për funksionet organike me specifikë të veçantë, ku vjetërsia në shërbim, bazuar në pikën 5 të nenit 3 të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, merret me 1.5- fish, llogaritet në bazë të pagës referuese e të periudhës faktike të shërbimit.

E. Paga mesatare referuese, e përcaktuar dhe e llogaritur sipas shkronjave “a” deri në “dh” të këtij kreu, kthehet në pagë mesatare referuese neto, pas zbritjes së shumës së kontributit të detyrueshëm të sigurimit shoqëror; kontributit të detyrueshëm të sigurimit shëndetësor; tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimit suplementar, që mbahen nga paga, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin në fuqi, në kohën kur personit i ka lindur e drejta për përfitim. Paga mesatare referuese neto evidentohet sipas formularit bashkëlidhur.

III. PROCEDURAT E PËRFITIMEVE DHE DOKUMENTACIONI

Në mbështetje të nenit 5 dhe për zbatimin e neneve 13, 14, 16, 18, 26 e 27, të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, procedurat, dokumentet, procedura e llogaritjes së përfitimeve dhe përjashtimet nga e drejta për përfitime suplementare janë si më poshtë vijon:

A. Personat, të cilëve u lind e drejta për përfitime pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, paraqiten në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore ku kanë vendbanimin e përhershëm, e cila i pajis me 2 (dy) kopje të kërkesës format dhe me listën e dokumenteve të nevojshme për dhënien e përfitimeve. Një kopje e kërkesës, e plotësuar nga vetë përfituesi, me të gjitha të dhënat, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm, dorëzohet në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore, ndërsa kopja tjetër e kërkesës u dërgohet me postë strukturave të ministrisë apo të institucionit nga ku përfituesi është nxjerrë në rezervë/lirim, për procedurë të mëtejshme.

B. Personat e interesuar duhet të dorëzojnë, së bashku me fletëkërkesën, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Për të përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi:
 - Fotokopje të letërnjoftimit elektronik të nënshkruar nga vetë personi ose certifikatë personale me fotografi.
 - Certifikatë familjare;
 - Deklaratë individuale për gjendjen e punësimit;
 - Vërtetim nga zyrat e tatim-taksave nëse ushtron veprimtari ekonomike si punëdhënës ose i vetëpunësuar;
 - Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive nëse ka përfituar ose jo tokë, sipas ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” të ndryshuar, dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, vetëm nga personat që janë banorë në fshatra.
2. Për të përfituar pension suplementar pleqërie apo suplementar invaliditeti, fotokopje të letërnjoftimit elektronik ose certifikatë personale me fotografi.
3. Për të përfituar pension suplementar familjar:
 - Certifikatë familjare;
 - Certifikatë vdekjeje.
4. Për të përfituar pension suplementar familjar, në rastet kur personat kanë humbur jetën në detyrë dhe për shkak të saj:
 - Certifikatë familjare;

- Certifikatë vdekjeje;
- Vërtetim nga prokuroria e rrethit gjyqësor për shkakun e vdekjes.

C. Dokumentacioni që plotësohet nga ministritë dhe institucionet përkatëse, është si më poshtë vijon:

1. Nga ministritë dhe institucionet përgjegjëse:

- Vërtetim për periudhën e shërbimit dhe pagën referuese *neto*;
- Vërtetim për periudhën e trajtimit me pagesë kalimtare;
- Vërtetim i pagës referuese të gradës ose të funksionit më të fundit, për përfituesit sipas nenit 21 të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009;
- Vërtetim kronologjik për kontributet suplementare të paguara, sipas muajve.

2. Nga drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore:

- Vërtetim për llojin dhe masën e pensionit sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Vendim i Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.

Ç. Dokumentacioni i plotësuar në ministritë apo institucionet përkatëse dërgohet në drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore, i veçantë për çdo përfitues nëpërmjet postës zyrtare dhe i shoqëruar me shkresë përcjellëse.

D. Për ushtarakët që kanë ndërprerë karrierën para hyrjes në fuqi të ligjit nr.7496, datë 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakëve të Forcave të Armatosura”, do të ndiqen procedurat e mëposhtme:

1. Vjetërsia e përgjithshme në shërbim është ajo e evidentuar në formularin përkatës të vjetërsisë në shërbim, që ndodhet në dosjen e pensionit, sipas të cilit është llogaritur masa e pensionit të pleqërisë në zbatim të ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” ose të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar.

2. Paga referuese individuale sipas gradës apo funksionit evidentohet nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme ose institucionet përkatëse, sipas rastit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në kreun II të këtij vendimi.

3. Pensionet suplementare jepen me kërkesë të ish-ushtarakut të Forcave të Armatosura, në pension. Kërkesa plotësohet në 2 (dy) kopje, sipas formatit të përcaktuar, dhe dorëzohet, së bashku me një fotokopje të letërnjoftimit elektronik, në drejtorinë rajonale përkatëse të sigurimeve shoqërore, ku ndodhet dosja e pensionit të pleqërisë. Një kopje e kërkesës për pension, e shoqëruar me fotokopjen e formularit të vjetërsisë së shërbimit që ndodhen në dosjen e pensionit të pleqërisë, u dërgohet me shkresë përcjellëse e postë zyrtare Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme ose institucioneve përgjegjëse, të cilat administrojnë dosjet personale të ish-ushtarakut.

4. Ministria e Mbrojtjes, *komanda e forcave, komanda e doktrinës dhe stërvitjes, brigada, regjimenti, reparti ose njësi në varësi të drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe institucioni në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Mbrojtjes* ose Ministria e Brendshme a institucioni përgjegjës plotëson formularin e posaçëm për periudhën e shërbimit dhe pagën referuese, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim, të cilin ia dërgon zyrtarisht drejtorisë rajonale përkatëse të sigurimeve shoqërore. Kjo e fundit me kopjen e kërkesës, fotokopjen e letërnjoftimit elektronik, fotokopjen e formularit të vjetërsisë së shërbimit që ndodhen në dosjen e pensionit të pleqërisë dhe me formularin e ri të vjetërsisë në shërbim dhe të pagës referuese, të dërguar nga strukturat përkatëse, krijon një dosje për përfituesin, llogarit masën e përfitimit mujor, harton vendimin për caktimin e pensionit dhe urdhërpagesën, përgatit librezën e pensionit dhe i dërgon ato në destinacion për realizimin e pagesës në favor të përfituesit.

5. *Ministri i Mbrojtjes dërgon në Institutin e Sigurimeve Shoqërore listën e strukturave që do të përgatitin këto dokumentacione dhe do të plotësojnë formularët përkatës.*

DH. Drejtoria rajonale e sigurimeve shoqërore, në bazë të dokumenteve, krijon një dosje për përfituesin, llogarit masën e përfitimit mujor, harton vendimin për caktimin e pensionit dhe urdhërpagesën, përgatit librezën e pensionit dhe i dërgon ato në destinacion për realizimin e pagesës në favor të përfituesit. Procedurat konkrete të caktimit të përfitimit suplementar, të

lëvizjes së dokumentacionit, të arkivimit të tij e të pagesës së përfitimeve dhe detyrat e personelit përcaktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

E. Masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe e pensionit suplementar, për rastet kur vjetërsia e shërbimit njihet me 1.5-fish, llogaritet në bazë të periudhës së rivlerësuar të shërbimit dhe të pagës referuese, të llogaritur sipas përcaktimeve të bëra në kreun II, shkronja "DH", të këtij vendimi.

Ë. Shfuqizuar.

F. Për personat që punësohen dhe vetëpunësohen, bazuar në deklaratën e personit dhe vërtetimin e lëshuar nga organet përkatëse, masa e pensionit të parakohshëm vihet në nivelin e pensionit bazë të pleqërisë, të caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, që është apo ka qenë në fuqi për atë periudhë. Në çastin e ndërprerjes së veprimtarisë ekonomike, me kërkesë të përfituesit dhe shoqëruar me dokumentacionin për ndërprerjen e veprimtarisë, drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore i japin përfituesit pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Masa e tij mujore do të jetë sa masa e pensionit të parakohshëm në çastin e kufizimit për shkak të fillimit të veprimtarisë ekonomike, duke bërë shtesat e nevojshme sipas të gjitha indekseve të përcaktuara nga vendimet e Këshillit të Ministrave për rritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, gjatë periudhës së kufizimit të tij.

G. E drejta për përfitime të njohura nga ligji nr.10 142, datë 15.5.2009, e lindur në harkun kohor, nga hyrja në fuqi e ligjit të sipërshënuar deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.33, datë 24.6.2010, por të pacaktuara dhe të kaluara për pagesë, do të paguhet nga data e lindjes së kësaj të drejte. Vetëm për këto raste, data e ushtrimit të kërkesës do të jetë deri me 31.12.2010 dhe pagesat fillojnë nga data e lindjes të së drejtës.

IV. KONTRIBUTET, PERIUDHAT E SIGURIMIT DHE FINANCIMI I PËRFTIMEVE

Në zbatim të neneve 5 e 23 të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, procedurat e llogaritjes dhe të pagesës së kontributeve, periudhat e sigurimit, procedurat e financimit, të pagesës së përfitimeve e të administrimit të sigurimeve suplementare janë si më poshtë vijon:

A. Fondi i sigurimeve suplementare përbëhet nga:

1. Kontributi që paguajnë vetë ushtarakët e Forcave të Armatosura, punonjësit e Policisë së Shtetit, punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë, punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, punonjësit e Policisë së Burgjeve, punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, kur janë aktivë;

2. Financimet nga Buxheti i Shtetit për diferencën ndërmjet të ardhurave nga kontributet dhe shpenzimeve të programuara e të realizuara, në zbatim të neneve 13, 14, 16, 18 dhe 26 të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009;

3. Financimi nga Buxheti i Shtetit, në zbatim të neneve 9, 10, 11, 12 e 22 të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009;

4. Financimet nga Buxheti i Shtetit për përballimin e shpenzimeve për administrimin e sigurimeve suplementare.

B. Fondet për përballimin e shpenzimeve sipas shkronjës "A", pikat 2 dhe 4, të këtij kreu i jepen Institutit të Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet ministrive përkatëse sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".

Fondet për përballimin e shpenzimeve sipas pikës 3 të shkronjës "A" të këtij kreu, jepen dhe zbatohen nga ministritë dhe institucionet përgjegjëse.

C. Kontributet shtesë mbahen (ndalohen) nga paga e personave dhe derdhen në fondin e sigurimit shoqëror suplementar çdo muaj, deri në datën 20 të muajit pasardhës për kontributet që i takojnë muajit paraardhës.

Ç. Strukturat kompetente që kanë llogari bankare dhe që realizojnë dhënien e pagës, janë të detyruara të ndalojnë nga paga kontributin suplementar dhe ta derdhin atë në të njëjtën llogari dhe me të njëjtën procedurë, krahas derdhjes së kontributit të detyrueshëm të sigurimit shoqëror. Strukturat përgjegjëse, nëpërmjet degës së tatimeve, sipas formateve dhe procedurave të përcaktuara edhe për kontributet e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, u dërgojnë, në letër dhe në

format elektronik, drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore edhe listat emërore përkatëse për kontributet e derdhura. Për rastet që klasifikohen “Konfidenciale”, deklarata e pagesës së kontributit bëhet e veçantë dhe listat për kontributpaguesit, sipas këtij rasti, dërgohen, ruhen e administrohen si të tilla, në përgjegjësinë e organeve të sigurimeve shoqërore.

Përfundimisht, kontributet e pallogaritura dhe të paderdhura për subjektet e parashikuara në ligjin nr.10 142, datë 15.5.2009, që i takojnë periudhës nga data e hyrjes në fuqi të ligjit deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, llogariten nga punëdhënësit dhe derdhen në llogarinë e ISSH-së, gradualisht deri në datën 31.12.2010, duke u shoqëruar edhe me listëpagesat tip të muajve për të cilat bëhet derdhja.

D. Për struktura të veçanta, lista emërore e të cilave ose ekspozimi i gjenealiteteve të punonjësit është sekret ose përbën rrezik për jetën e personit a të familjes së tij, këto lista administrohen, përkatësisht, nga ministritë apo strukturat përkatëse, ndërsa marrëdhëniet me Institutin e Sigurimeve Shoqërore për evidentimin e kontributeve individuale dhe arkivimin e dokumentacionit rregullohen me marrëveshje të përbashkët ndërmjet tyre.

DH. Kontributi i sigurimit shoqëror të detyrueshëm, për periudhat e njohura si periudha sigurimi në zbatim të nenit 23 të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, dhe të pikës 2 të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, llogaritet dhe paguhet në bazë të:

1. pagës referuese, sipas së cilës është llogaritur shpërblimi i menjëhershëm ose pagesa kalimtare apo sipas pagës së përcaktuar për gradën a funksionin, e cila është në fuqi në periudhën kur përfituesi trajtohet me pagesë kalimtare.

2. pagës referuese, sipas së cilës është llogaritur pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi, e indeksuar çdo vit me koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar, të caktuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për zbatimin e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar.

3. pagës referuese, sipas së cilës është llogaritur trajtimi financiar, e indeksuar çdo vit me koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar për periudhat e trajtimit me pagesë, sipas vendimeve nr.225, datë 29.5.1992 dhe nr.7, datë 10.1.1996 të Këshillit të Ministrave.

E. Programimi i fondeve për pagesën e kontributeve bëhet nga ministritë e institucionet përkatëse në bashkëpunim me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008.

Ë. Bazë për derdhjen e kontributeve janë listat emërore dhe pagat referuese, të cilat:

1. Për personat që janë në shërbim aktiv ose me pagesë kalimtare, përpilohen nga ministritë ose institucionet që kryejnë pagesat dhe dërgohen deri në datën 15 të çdo muaji në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

2. Për personat që janë në pension të parakohshëm, përpilohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Një kopje e këtyre listave arkivohet në arkivat e sigurimeve shoqërore dhe do të shërbejë për njohjen e periudhës së sigurimit dhe të bazës së vlerësuar për efekt të zbatimit të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar.

F. Transferimi i fondeve për derdhjen e kontributeve të detyrueshme, nga buxheti i shtetit në buxhetin e sigurimeve shoqërore, bëhet sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin vjetor të Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit.

V. RILLOGARITJA E PËRFITIMEVE

Në mbështetje të paragrafit të tretë të pikës 2 të nenit 23 dhe për zbatimin e pikës 2 të nenit 29 të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, rillogaritja e pensioneve do të bëhet, si më poshtë vijon:

A. Për pensionet e pleqërisë, të caktuara sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar:

1. Paga, sipas së cilës është llogaritur trajtimi financiar në përputhje me vendimet nr.225, datë 29.5.1992 dhe nr.7, datë 10.1.1996 të Këshillit të Ministrave, kur zgjidhet nga ushtaraku, merret edhe si pagë bruto e 3 (tri) viteve rresht në dhjetë vitet e fundit të punës, për efekt të rillogaritjes së pensionit të pleqërisë dhe të pensionit suplementar.

2. Për pagat që i përkasin periudhës para datës 1.1.1994, të cilat pas indeksimit me indekset e përcaktuara nga Ministria e Financave për atë periudhë rezultojnë më të vogla se pagat referuese

të përcaktuara me vendimin nr.561, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”, për efekt të rillogaritjes së pensionit të pleqërisë, si pagë bruto merret paga referuese përkatëse sipas përcaktimeve të bëra në vendimin nr.561, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave.

3. Përveç rregullave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 më sipër, do të zbatohen edhe rregullat e caktuara në ligjin nr.9588, datë 25.7.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve” dhe në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për zbatimin e atij ligji, për efekt të rillogaritjes së pensionit të pleqërisë sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, dhe për rillogaritjen e pensioneve suplementare, bazuar në ligjin nr.10 142, datë 15.5.2009.

4. Instituti i Sigurimeve Shoqërore nxjerr udhëzim teknik për procedurat e rillogaritjes së pensionit të pleqërisë dhe të pensioneve suplementare.

B. Për pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe për pensionet suplementare të caktuara sipas ligjeve nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr.8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, do të vepohet, si më poshtë vijon:

1. Vjetërsia në shërbim është ajo e pasqyruar në formularin tip, që administrohet në dosjen e pensionit dhe mbi bazë të së cilës është llogaritur pensioni i parakohshëm ose suplementar, sipas dispozitave të ligjeve nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr.8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”.

2. Paga referuese do të llogaritet në bazë të rregullave të përcaktuara në kreun II të këtij vendimi. Formulari që evidenton pagën referuese mesatare, sipas viteve të shërbimit, dhe rregullat e plotësimit të tij, janë ato të përcaktuara në kreun III të këtij vendimi. Formulari që evidenton kontributet e përcaktuara dhe rregullat e plotësimit janë ato të përcaktuara në kreun III të këtij vendimi.

3. Procedura e rillogaritjes dhe e lëvizjes së informacionit do të jetë, si më poshtë vijon:

a) Drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore, me shkresë përcjellëse dhe në rrugë postare, do t’i dërgojnë institucionit, që ka urdhëruar daljen në rezervë apo lirim të personit, listat emërore (emër, atësi, mbiemër, datëlindje) për çdo përfitues, të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe për çdo përfitues të pensionit suplementar, të caktuara përpara datës 27 qershor 2009, e që vijnë të përfitohen edhe pas kësaj date.

b) Institucionet e linjës, në bashkëpunim ndërmjet tyre, për rastet kur ushtarakët kanë kryer funksione në struktura të ndryshme, brenda 1 (një) muaji nga data e mbërritjes me postë të listës emërore të personave, plotësojnë formularin tip të periudhës së shërbimit dhe të pagës mesatare, të cilin ia përcjellin strukturës rajonale të sigurimeve shoqërore (DRSSH) që ka iniciuar procedurën e rillogaritjes së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

c) Drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e mbërritjes në rrugë postare të dokumentacionit individual, përfundojnë rillogaritjen e përfitimit, llogarisin diferencat, zbatojnë procedurat ligjore të evadimit të tyre dhe njoftojnë zyrtarisht përfituesin duke dërguar edhe dokumentacionin përfundimtar për realizimin e pagesës mujore.

4. Përfitimet e ndërprera për shkak të punësimit, vetëpunësimit dhe vetëpunësimit në bujqësi, para datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, do të jenë objekt i rillogaritjeve sipas rregullave të përcaktuara më lart dhe do të vihen në kufirin e pagesës sa masa e një pensioni bazë, të përcaktuar me vendimin e Këshillit të Ministrave në datën e hyrjes në fuqi të atij ligji. Në rastet e një kërkesë për përfitimin e pensionit të plotë të parakohshëm, pasi është ndërprerë veprimtaria ekonomike, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në shkronjën “F” të kreut III të këtij vendimi.

5. Për personat, të cilëve u ka lindur e drejta për pension për vjetërsi shërbimi, përpara datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, kohëzgjatja e periudhës së shërbimit, për efekt përfitimi, mbetet ajo e përcaktuar nga dispozitat e mëparshme.

C. Rregullat e rillogaritjes për pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi janë, si më poshtë vijon:

1. Masa fillestare e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të caktuar do të rillogaritet sipas kritereve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 14 të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, dhe, pas këtij veprimi, kur masa mujore e përfitimit, në momentin e lindjes së të drejtës, është më e vogël se pensioni bazë, sipas nenit 32 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendoset sa pensioni bazë i pleqërisë. Mbi këtë masë përfitimi zbatohen koeficientët e rritjes apo të indeksimit të pensionit, të zbatuar për pensionet e pleqërisë në përputhje me nenin 32 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të përcaktuara me vendime të Këshillit të Ministrave, deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit të sipërpërmendur, dhe shuma që del vlerësohet si shumë përfundimtare e pensionit.

2. Për efekt të rillogaritjes së masës fillestare të pensionit të parakohshëm, data, mbi të cilën do të referohet pagë mujore mesatare referuese neto, do të jetë:

a) data 1 janar 1999 (data e shtrirjes së efekteve financiare të ligjit nr.8087, të ndryshuar) për ata persona, të cilët kanë dalë në rezervë/lirim para kësaj date dhe kanë përfituar pension të parakohshëm nga kjo datë e në vazhdim;

b) data kur ka lindur e drejta për të përfituar pension të parakohshëm, për ata persona, të cilët kanë dalë në rezervë/lirim para datës 1 janar 1999, por kanë plotësuar kushtin e moshës pas kësaj date;

c) data kur ka lindur e drejta për të përfituar pension të parakohshëm, për ata persona, të cilët kanë dalë në rezervë/lirim pas datës 1 janar 1999.

D. Rregullat e rillogaritjes për pensionin suplementar janë, si më poshtë vijon:

1. Masa fillestare e pensionit suplementar të caktuar do të rillogaritet sipas kritereve të përcaktuara në nenet 16, 18 dhe 20, të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, në përputhje me llojin e së drejtës dhe, më pas, mbi këtë masë përfitimi, zbatohen koeficientët e rritjes apo të indeksimit të pensionit, të zbatuar për pensionet e pleqërisë në përputhje me nenin 32 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të përcaktuara me vendime të Këshillit të Ministrave, deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit të sipërpërmendur, dhe shuma që del vlerësohet si shumë përfundimtare e pensionit.

2. Për efekt të rillogaritjes së masës fillestare të pensionit suplementar, çasti i llogaritjes së pagës mujore mesatare referuese më të fundit do të jetë sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2 të shkronjës "C" të këtij kreu.

3. Kur pensioni i pleqërisë është rillogaritur sipas kritereve të përcaktuara në ligjin nr.9588, datë 25.7.2006 "Për rillogaritjen e pensioneve", dhe sipas kritereve të përcaktuara në shkronjën "A" të kreut V të këtij vendimi, masa e pensionit suplementar vihet në kufirin deri në 50% të masës së pensionit të caktuar nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009.

VI. EFEKTET FINANCIARE

Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, parashikohen në buxhetin vjetor dhe llogariten:

A. Në shumën 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë në muaj, për pagesat e përfitimeve suplementare të ish-ushtarakëve në pension dhe për pensionet që rillogariten.

B. Në shumën 1 000 000 (një milion) lekë në muaj, për komisionet e pagesave të përfitimeve, për prodhimin e dokumentacionit dhe për shpenzime të tjera administrative.

C.1. Personat që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas nenit 14 të ligjit, të ndryshuar (përfshirë të punësuarit që përfitojnë njëkohsisht dhe pension të parakohshëm), përfitojnë kompensim, në masën 350 (treqind e pesëdhjetë) lekë në muaj, në përputhje me vendimin nr.138, datë 31.3.1994 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse", dhe kompensim, në masën 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj, në përputhje me vendimin nr.471, datë 15.7.1996 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e shpenzimeve nga liberalizimi i çmimit të bukës, lëndëve djegëse dhe vajgurit."

2. Personat, që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas nenit 14, të ligjit, të ndryshuar, kur janë kryefamiljarë dhe kanë të ardhura familjare vetëm nga pensioni i parakohshëm, përfitojnë kompensim, në masën 640 (gjashtëqind e dyzet) lekë në muaj, në përputhje me kushtet e përcaktuara në vendimin nr.565, datë

9.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”, të ndryshuar.

3. Kur personat që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, në çastin e lindjes së të drejtës dhe pas shtesës së kompensimeve, sipas pikës 1, të këtij vendimi, kanë të ardhura mujore, më pak se të ardhurat minimale mujore, të përcaktuara për pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ardhurat e tyre kompensohen, deri në nivelin e të ardhurave minimale, të përcaktuara për pensionet e pleqërisë.

D. Kur shuma e pensionit të parakohshëm, të rilogaritur sipas dispozitave të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, rezulton në shtesë mbi shumat e përfëtuara më parë në një masë më të madhe se shuma e të ardhurave individuale vjetore nga pensioni, pagesa bëhet me këste. Madhësia e këstit vjetor do të jetë deri në shumën e të ardhurave nga pensioni aktual për një vit. Fondet për pagesën e diferencave të pensioneve programohen në buxhetin vjetor.

 Inspektor i Lartë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Kryetar i njësisë bashkiake të Tiranës (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Drejtor i Kabinetit të Kryetarit të Komisionit të Shërbimit Civil (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Sekretar i Përgjithshëm i Komisionit të Shërbimit Civil (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Drejtor kabineti në ministri dhe në institucione qendrore/*buxhetore* (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Anëtar i Komisionit të Konkurrencës të Autoritetit të Konkurrencës (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Avokat i Prokurimeve (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Kryeinspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Shef kabineti në Gjykatën Kushtetuese (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Anëtar i Grupit Mbikëqyrës të Shoqërive Huamarrëse (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Avokat i Përgjithshëm i Shtetit dhe Kryetar i Arbitrazhit të Lartë Shtetëror (ligji nr. 9061, datë 8.5.2003).

Për grupin e dytë germa “b”, e pikës 9, të nenit I, të këtij ligji:

Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave;
 Zëvendëskryetar i Komitetit të Zhvillimit të Turizmit;
 Sekretar Shkencor në Akademinë e Shkencave;
 President i Komitetit Olimpik Shqiptar;
 Zëvendëskryetar i Komitetit Kombëtar të Energjisë;
 Kryetar i Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve;
 Kryetar i Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve Bujqësore;
 Shef kabineti i Avokatit të Përgjithshëm të Avokaturës së Shtetit (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);
 Avokat Shteti pranë Gjykatës së Apelit në zyrat vendore (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);
 Shef i protokollit dhe ceremonisë në Presidencë;
 Shef i zyrës së pritjes së popullit në Presidencë;
 Kryeinspektor në Kontrollin e Lartë të Shtetit;
 Drejtor i përgjithshëm në ministri;
 Zëvendësdrejtor i përgjithshëm në RTV;
 Drejtor departamenti në Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit (VKM nr. 120, datë 8.3.2001);
 Kryetar i Këshillit të Ankesave në Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit (VKM nr. 120, datë 8.3.2001);
 Drejtor i Radios së Jashtme;
 Drejtor i Radios së Brendshme;
 Drejtor i Televizionit;
 Drejtor i Përgjithshëm i Arkivave të Shtetit;
 Kryetar i Qendrës për Nxitjen e Investimeve të Huaja;
 Kryetar i Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit;

Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve;
 Drejtor i përgjithshëm i Institutit të Statistikës;
 Kryetar i Komitetit Shqiptar të Birësimeve;
 Zëvendëskryetar i Komisionit Shtetëror të Kthimit të Pronave;
 Drejtor i përgjithshëm i Njesisë së Implementimit të Projektit Mobil;
 Shef i Shërbimit të Inspektoratit të Përgjithshëm Financiar në Ministrinë e Financave;
 Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshëm të Aviacionit Civil;
 Zëvendësdrejtorët e përgjithshëm të ministrive dhe institucioneve qendrore/*buxhetore* (ligji nr. 9061, datë 8.5.2003);
 Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve;
 Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
 Drejtor i ligjshmërisë në Gjykatën e Kasacionit;
 Drejtor i përgjithshëm i ish-të Përndjekurve Politikë;
 Drejtor i Drejtorisë Kombëtare të Meteorologjisë dhe Kalibrimit;
 Drejtor i Drejtorisë së Standardizimit dhe Cilësisë;
 Drejtor i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë;
 Drejtor i Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë;
 Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor;
 Përgjegjës i sektorit në Presidencë;
 Sekretar i Presidentit;
 Kryetar i Komisionit Shtetëror Trepalësh për Dhënien e Statusit të ish-të Përndjekurve Politikë;
 Kryekëshilltar në Kuvend;
 Këshilltar Komisioni në Kuvend;
 Zëvendësdrejtor i ATSH-së;
 Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Institutit të Statistikës;
 Zëvendëskryetar i Qendrës Shqiptare të Nxitjes së Investimeve të Huaja;
 Zëvendëskryetar i Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve;
 Zëvendësdrejtor i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;
 Zëvendësdrejtor i Agjencisë së Prokurimit Publik;
 Zëvendësdrejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave;
 Zëvendëspresident i Komitetit Olimpik;
 Këshilltar në ministri dhe institucione qendrore/*buxhetore* (ligji nr. 9061, datë 8.5.2003);
 Drejtor drejtorie (për probleme të veçanta) në Këshillin e Ministrave, Presidencë dhe Kuvend;
 Sekretar i Komitetit Olimpik Shqiptar;
 President i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekut;
 Zëdhënës i Gjykatës së Lartë;
 Drejtor i përgjithshëm i Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Çështjeve Sociale;
 Drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit;
 Drejtor i përgjithshëm i Inspektoratit të Punës;
 Koordinator në Këshillin e Ministrave;
 Drejtor i përgjithshëm i Pyjeve dhe Kullotave;
 Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tij;
 Drejtor drejtorie (prokuror) në Prokurorinë e Përgjithshme;
 Prokuror, hetues, oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme;
 Prokuror në prokurorinë e Apelit Civil dhe Ushtarak në Tiranë;
 Zëvendësprokuror në Prokurorinë e Rrethit;
 Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Civil dhe Ushtarak në Tiranë;
 Zëvendëskryeinspektor dhe inspektor i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (VKM nr. 120, datë 8.3.2001);

Kryetar në gjykatat e rretheve;
 Kryetar i Gjykatës së Apelit në rrethe;
 Prokuror rrethi;
 Zëvendësprokuror rrethi;
 Zëvendëskryetar në gjykatat e rretheve;
 Zëvendëskryetar i Gjykatës së Apelit në Rrethe;
 Inspektor i Kontroll-Bashkërendimit në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ në Këshillin e Ministrave;
 Këshilltar i Avokatit të Popullit (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Kryetar i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Gjyqtari Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Drejtues i Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Prokuror i Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Kryetar i Gjykatës për Krime të Rënda (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Drejtues i Prokurorisë për Krime të Rënda (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Zëdhënës i ministrit (VKM nr. 467, datë 23.6.2005);
 Inspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Këshilltar në Gjykatën Kushtetuese (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Zëvendësdrejtore i përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);
 Sekretar i përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (VKM nr. 641, datë 11.6.2009).

Për grupin e dytë germa “c” e pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji:

Drejtor drejtorie në Presidencë, Kuvend, Këshill të Ministrave, ministri, institucione qendrore buxhetore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në Institucionin e Avokaturës së Shtetit, në Institucionin e Avokatit të Popullit, në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në Komisionin e Shërbimit Civil (VKM nr. 467, datë 23.6.2005); Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Prokurimeve dhe Gjykatën Kushtetuese (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);

Zëvendësdrejtore në Këshill të Ministrave, ministri, institucione qendrore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit;

Ambasador i Republikës së Shqipërisë;

Ministër fuqiplotë në ambasadë;

Shef sektori në Presidencë, Kuvend, Këshill të Ministrave, ministri, institucione qendrore buxhetore, Kontrollin e Lartë të Shtetit; Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Institucionin e Avokaturës së Shtetit, Institucionin e Avokatit të Popullit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Komisionin e Shërbimit Civil, Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Prokurimeve dhe Gjykatën Kushtetuese (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);

Konsull në konsullatat e Republikës së Shqipërisë;

Kryetar dege në ministri, institucione qendrore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit;

Ministër këshilltar në ambasadë;

Këshilltar në ambasadë;

Sekretar i parë në ambasadë;

Sekretar i dytë në ambasadë;

Sekretar i tretë në ambasadë;

Ndihmës i këshilltarit të Presidentit (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);

Zëvendëskryetar i këshillit të qarkut (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);

Jurist në Departamentin Juridik në Kryeministri (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);

Nënprefekti (VKM nr. 476, datë 23.6.2005);

Ndihmës/inspektor i lartë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (VKM nr. 476, datë 23.6.2005);

Ndihmës/komisioner i komisionerit të Avokatit të Popullit (VKM nr. 476, datë 23.6.2005);
Gjyqtar i Gjykatës për Krime të Rënda (VKM nr. 476, datë 23.6.2005);
Prokuror i Prokurorisë për Krime të Rënda (VKM nr. 476, datë 23.6.2005);
Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë për Krime të Rënda (VKM nr. 476, datë 23.6.2005).

Për grupin e dytë germa “d”, e nenit 9, të këtij ligji:

Specialist në Presidencë, Kuvend, Këshill të Ministrave, ministri, institucione qendrore buxhetore, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Këshillin e Lartë të Drejtësisë (VKM nr. 120, datë 8.3.2001); në institucionin e Avokaturës së Shtetit, në institucionin e Avokatit të Popullit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në Komisionin e Shërbimit Civil, Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Prokurimeve dhe Gjykatën Kushtetuese (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);

Anëtar i Komitetit Shtetëror të Kulteve (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);

Sekretar i kryetarit të Gjykatës Kushtetuese (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);

Ndihmësligjor në Gjykatën e Lartë (VKM nr. 347, datë 19.3.2008);

Gjyqtarë në gjykatat e rretheve;

Prokurorë;

Hetues, oficer i Policisë Gjyqësore;

Gjyqtarë në gjykatat e apelit;

Prokuror në Prokurorinë e Apelit;

Sekretar i Kryetarit të Kuvendit;

Sekretar i Kryeministrit;

Atashe në ambasadë;

Asistent i Inspektorit të Kontroll-Bashkërendimit në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ në Këshillin e Ministrave;

Sekretar i Sekretarit të Përgjithshëm në Presidencë (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);

Sekretar i shefit të kabinetit në Presidencë (VKM nr. 296, datë 8.5.2003);

Sekretar i këshilltarit të Presidentit (VKM nr. 296, datë 8.5.2003).

Shënim.

Periudha që punonjësit ushtarakë përfitojnë nga ligji nr. 8087, datë 13.3.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, përjashtohet.

VENDIM
Nr. 651, datë 14.9.2016

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 10139, DATË 15.5.2009, “PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PUNONJËSVE TË UNIVERSITETEVE, TË SHKOLLAVE TË LARTA, QENDRËS SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË GJITHA INSTITUCIONEVE TË TJERA KËRKIMORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË CILËT KANË TITUJ SHKENCORË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 7, 12 e 15, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Aka-demisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në zbatim të shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 2, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, institucionet jopublike, të cilat për-fshihen në këtë skemë për efekt të këtij ligji, janë universitetet, akademitë, kolegjet universitare, kolegjet profesionale të larta, si dhe institutet, qendrat e agjencitë e kërkimit shkencor të akredituara.

2. Lista e institucioneve të arsimit të lartë hartohet dhe përditësohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sipas kërkesës së Institutit të Siguri-meve Shoqërore.

3. Në zbatim të pikës 4, të nenit 2, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, “paga referuese” është paga bazë për titullin në institu-cionet publike, duke përjashtuar shtesat për funksion. Për efekt të përcaktimit të përfitimeve, paga referuese llogaritet si mesatare e pagave referuese, sipas viteve të ushtrimit të titullit. Si pagë bazë do të jetë ajo e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

Për efekt të llogaritjes së përfitimit, për titujt:

a) “Profesorë” dhe “Drejtnes kërkimesh”, të cilët kanë periudhë ushtrimi të titullit, sipas pikës 3, të nenit 2, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, pagë referuese e titullit do të merret ajo për titullin “Profesor” në institucionet e arsimit të lartë;

b) “Profesorë të asociuar” dhe “Mjeshtër kërkimesh”, të cilët kanë periudhë ushtrimi të titullit, sipas pikës 3, të nenit 2, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, pagë referuese e titullit do merret ajo për titullin “Profesor i asociuar” në institucionet e arsimit të lartë;

c) “Docent” dhe “Bashkëpunëtor i vjetër shkencor”, të cilët i kanë pasur këta tituj para vitit 1994 dhe i kanë përfituar pasi është fituar më parë grada shkencore “Kandidat i shkencave”, pagë referuese e titullit do merret ajo e pozicionit “Lektor” në institucionet e arsimit të lartë;

4. Në zbatim të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, masa e pensionit suplementar plus pensionin e pleqërisë nuk mund të jetë më e madhe se dyfishi i masës së pensionit të caktuar sipas nenit 31/1 ose masës së pensionit të caktuar sipas nenit 32 e 33, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për personat, të cilëve e drejta për pension suplementar, sipas këtij ligji, u lind pas hyrjes në fuqi të tij, ndërsa pensioni i pleqërisë u llogaritet sipas dispozitave në fuqi deri në 31.12.2014, shuma e pensionit të pleqërisë plus pensionin suplementar nuk mund të jetë më e lartë se dyfishi i masës mujore të pensionit të pleqërisë dhe shtesës së pensionit të pleqërisë sipas nenit 33, në momentin e lindjes së të drejtës për pension suplementar.

5. Kontributet suplementare, sipas masës së përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, llogariten nga subjekti punëdhënës dhe derdhen në organet tatimore sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara për mbledhjen e kontributeve nga skema e sigurimit shoqëror të detyrueshëm.

6. Organet tatimore dhe të sigurimeve shoqërore nuk do të pranojnë kontribute suple-mentare për persona që gëzojnë titullin, por e ushtrojnë atë duke punuar në institucione kërkimore publike apo institucione jopublike, të cilat nuk janë të përcaktuara sipas pikës 2, të këtij vendimi.

7. Personat e interesuar për të përfutur pension suplementar sipas ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, duhet të paraqesin pranë organeve të sigurimeve shoqërore ku kanë qendrën e tyre të banimit kërkesën për përfitim, të shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm për këtë qëllim, si më poshtë vijon:

a) Fotokopje të kartës së identitetit;

b) Fotokopje të noterizuar të dëshmisë për dhënien e titullit ose vërtetim për dhënie titulli nga Komisioni i kualifikimit shkencor apo nga Komisioni i vlerësimit të titujve;

c) Vërtetim, lëshuar nga qendra e punës, për pagën referuese, si dhe kohën e gëzimit të titullit, në zbatim të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar.

8. Shpenzimet administrative për funksionimin e kësaj skeme të përballohen nga buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

9. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

UDHËZIM

Nr.17, datë 10.5.2010

PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PUNONJËSVE TË UNIVERSITETEVE, TË SHKOLLAVE TË LARTA, QENDRËS SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË GJITHA INSTITUCIONEVE TË TJERA KËRKIMORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË CILËT KANË TITUJ

Në mbështetje të nenit 12 dhe 13 të ligjit nr.10139, datë 15.5.2009 “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj”, Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës

UDHËZOJNË:

1. Në zbatim të nenit nr.7, si bazë për llogaritjen e pensionit mujor suplementar për personat e përcaktuar në nenin 2 të ligjit të sipërshtënuar janë:

a) Periudha nga data e marrjes së titullit shkencor respektiv, të njohur nga ky ligj dhe deri në datën e lindjes të së drejtës për pension suplementar. Kur e drejta për përfitim suplementar lind pas datës 1.1.2010, periudha e gëzimit të titullit është e vlefshme vetëm në rast se janë paguar kontributet suplementare sipas nenit 4 të ligjit.

b) Paga referuese, e cila është paga bazë mujore, përjashtuar shtesat për funksion, që zbatohet për të njëjtin titull në momentin kur personi ka plotësuar kushtet e përfitimit, sipas nenit 6 të ligjit të sipërshtënuar.

2. Në zbatim të nenit nr.11 dhe 12 të ligjit, llogaritja, caktimi dhe pagesa e përfitimeve suplementare bëhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Përfitimet suplementare për personat me tituj shkencorë, jepen me kërkesën e të interesuarit, i cili paraqet në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore përkatëse, dokumentacionin, si më poshtë:

- a) Kërkesa për pension suplementar, sipas modelit bashkëlidhur;
- b) Një fotokopje e kartës së identitetit e nënshkruar nga personi i interesuar, me emër, mbiemër, firmë dhe me adresën e vendbanimit ose certifikatë personale me fotografi;
- c) Fotokopje e noterizuar e dëshmisë për shenjën e titullit;
- d) Vërtetim për tituj shkencorë, lëshuar nga Komisioni i Kualifikimit Shkencor;
- e) Vërtetim nga qendra e punës për kontributet suplementare të paguara nga data 1.1.2010 dhe deri në datën e lindjes të së drejtës.

Formulari i kërkesës për pension (a) dhe vërtetimi për kontributet e paguara (e) gjendet në agjencinë e sigurimeve shoqërore të qytetit ku i interesuari ka vendbanimin.

Për çdo përfitues, drejtoria rajonale e sigurimeve shoqërore krijon një dosje me dokumente. Rregullat e pranimit të dokumenteve, regjistrimit të kërkesës për përfitim suplementar, plotësimit të dosjes së pensionit me vërtetime të brendshme që lëshohen nga strukturat e sigurimeve shoqërore, rregullat dhe procedurat e plotësimit të vendimit të caktimit të përfitimit, të plotësimit të kartelës financiare dhe urdhërpagesës, veprimet për ndryshimin, pezullimin, mbylljen apo transferimin e përfitimit, janë të njëjta me ato të përcaktuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në rregulloren nr.3, datë 15.8.1996 “Për caktimin, administrimin dhe pagimin e përfitimeve suplementare shtetërore”.

3. Në zbatim të nenit nr.4 të ligjit:

a) Kontributet suplementare për subjektet e këtij ligji, 3.5 për qind të pagës bruto mujore, për personat me titull të punësuar në institucione publike dhe 7 për qind të pagës bruto mujore, për personat me titull të punësuar në institucione jopublike, derdhen në llogaritë e drejtorive rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, çdo muaj, me të njëjtat rregulla dhe në të njëjtat afate, si edhe sigurimi i detyrueshëm shoqëror.

b) Kontributi suplementar i përcaktuar mbahet nga paga e personit që gëzon titullin dhe ushtron veprimtari ekonomike. Institucioni ku personi është i punësuar është përgjegjës për llogaritjen, ndalesën nga paga dhe xhirimin e shumës së kontributit në llogaritë bankare të adresuara. Në të njëjtën kohë me xhirimin e kontributeve, institucioni publik ose jopublik dërgon në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore përkatëse edhe informacionin individual për çdo kontributpagues i cili modelohet në formën e një formulari, ku shënohen: numri i sigurimit/identifikimit; emri, mbiemri; titulli; funksioni ose detyra aktuale; paga bruto; kontributi mujor për çdo person. Në këtë formular regjistrohet edhe banka ku është bërë derdhja e kontributit, data dhe shuma e kontributit të transferuar, nënshkruhet nga drejtuesi i autorizuar i subjektit, i vihet vula dhe i bashkëlidhet transferues ose dërgohet drejtpërdrejt në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore përkatëse. Ky informacion do të shërbejë për çeljen e kartelave individuale të kontributeve suplementare të paguara nga çdo person.

c) Institucionet jopublike, në të cilat punësimi konsiderohet periudhë e ushtrimit të titullit, janë universitetet dhe shkollat e larta të akredituara.

d) Detyrimi për të paguar kontribute fillon nga data 1.1.2010. Subjektet punëdhënëse të personave me tituj dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrin masa për derdhjen e kontributeve të prapambetura nga 1.1.2010 deri në daljen e këtij udhëzimi dhe në vazhdim.

4. Programi i të ardhurave nga kontributet dhe i volumit të transfertës nga Buxheti i Shtetit, për mbulimin e shpenzimeve të kësaj skeme, ndjek të njëjtat rregulla, procedura dhe afate, si edhe për programimin e buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
(EMRI I SUBJEKTTIT QË LËSHON VËRTETIMIN)

Nr. _____prot

Tiranë më _____

VËRETIM
MBI PAGËN REFERUESE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.10139, DATË 15.5.2009

Me anën e të cilit vërtetojmë se znj./z. _____

emër atësia mbiemri

ka përfituar pagë referuese sipas pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr.10139, datë 15.5.2009 si më poshtë vijon:

Nr.	Përshkrimi i vendeve të punës	Periudha		Paga referuese për këtë titull në datën
		Fillim	Mbarim	
I	Profesor ose drejtues kërkimesh			
1				
2				
3				
4				
5				
II	Profesor i asociuar ose mjeshtër kërkimesh			
1				
2				
3				
4				
5				

E lëshojmë këtë vërtetim për ta paraqitur pranë strukturave të sigurimeve shoqërore në mbështetje të pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr.10139, datë 15.5.2009.

ADMINISTRATORI

Vula

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË TITUJVE AKADEMIKË

Nr. _____ prot _____ me _____

VËRTETIM

Me anën e të cilit vërtetojmë se znj./z. _____/_____/_____
emër atësi mbiemër

ka fituar titullin:

1. “Profesor” sipas vendimit nr. _____ datë _____/_____/_____ me numër regjistri themeltar nr. _____
2. “Profesor i asociuar” sipas vendimit nr. _____ datë _____/_____/_____ me numër regjistri themeltar nr. -----
3. “Drejtues kërkimesh” sipas vendimit nr. _____ datë _____/_____/_____ me numër regjistri themeltar nr. -----
4. “Mjeshtër kërkimesh” sipas vendimit nr. ----- datë -----/-----/----- me numër regjistri themeltar nr. _____

Lëshohet ky vërtetim në mbështetje të ligjit nr.10 139, datë 15.5.2009 “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, për ta paraqitur pranë drejtorisë rajonale të sigurimeve shoqërore, ku ka vendbanimin.

PËR KOMISIONIN E KUALIFIKIMIT SHKENCOR

Vula

SKEMA E TRAJTIMEVE TË VEÇANTA

LIGJ

Nr.8607, datë 27.4.2000

STATUSI I DËSHMORIT TË ATDHEUT

(Ndryshuar me ligjin nr.9243, datë 17.6.2004;

ndryshuar me ligjin nr.9650, datë 27.11.2006)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nderim të të rënëve në luftën për liri dhe pavarësi të Shqipërisë, miratohet “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i cili përcakton nocionin, kriteret, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej tij.

Neni 2

(Shtuar shkronja “e/1” me ligjin nr.9243, datë 17.6.2004, neni 1)

Statusi i Dëshmorit të Atdheut u njohet:

a) personave të rënë në luftë për liri dhe pavarësi kombëtare para 28 nëntorit 1912 dhe shtetasve shqiptarë që kanë rënë në luftë për mbrojtjen e integritetit territorial, të lirisë dhe pavarësisë të Shqipërisë para 7 prillit 1939;

b) shtetasve shqiptarë që kanë marrë pjesë me armë në dorë ose në formë të organizuar në

Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare (7 prill 1939 deri më 29 nëntor 1944) dhe kanë rënë duke luftuar kundër pushtuesve nazifashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre; që kanë vdekur për shkak të plagëve të marra në luftë ose janë ekzekutuar, ose kanë vdekur nga torturat në burgje e kampe përqëndrimi nazifashiste deri më 9 maj 1945;

c) shtetasve shqiptarë, pjesëtarë të formacioneve ushtarake të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që kanë rënë në luftën kundër pushtuesve nazifashistë jashtë kufijve shtetëror, deri më 9 maj 1945;

ç) shtetasve shqiptarë, pjesëmarrës në formacione të rregullta të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që kanë vdekur për shkak të sëmundjeve, të të ftohtit ose të fatkeqësive të ndryshme, duke qenë në krye të detyrës luftarake deri më 9 maj 1945;

d) shtetasve shqiptarë, që kanë rënë duke luftuar për çlirimin e Kosovës nga pushtuesit serb në vitet 1998-1999;

dh) shtetasve shqiptarë që kanë rënë duke luftuar në Spanjë (1936-1939) ose në vende të tjera, të inkuadruar në formacionet e koalicionit antifashist, deri më 9 maj 1945 ose kanë vdekur nga plagët e marra në këtë luftë;

e) shtetasve shqiptarë që kanë rënë ose bien në krye të detyrës për mbrojtjen e integritetit territorial, për mbrojtjen e institucioneve shtetërore nga terrorizmi ose në luftë kundër bandave të armatosura dhe kundër krimit ndaj jetës së individit;

e/1) shtetasve shqiptarë që kanë rënë ose bien në krye të detyrës për mbrojtjen e paqes dhe të lirisë së kombit shqiptar, ose atyre që kanë rënë apo bien në mbrojtje të paqes e të sigurisë së popujve të tjerë në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar ose për mbrojtjen e pasurisë

shtetërore, apo që humbasin jetën në krye të detyrës nga rreziqet e fatkeqësitë natyrore

ë) shtetasve të huaj, pjesëtarë të formacioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që kanë rënë duke luftuar kundër pushtuesve nazifashistë.

Neni 3

Për kërkimin dhe njohjen e Statusit të Dëshmorit të Atdheut vlejnë dokumentet shtetërore, që e vërtetojnë atë.

Të gjitha vendimet e mbështetura në ligjet ose dekretet e organeve shtetërore të mëparshme për shpalljen “Dëshmor”, nuk janë objekt rishikimi. Personi i rënë në luftë dhe i shpallur “Dëshmor” konsiderohet “Dëshmor i Atdheut” në kuptim të këtij ligji.

Kërkesën për shpalljen “Dëshmor i Atdheut” e bën familja e dëshmorit, organet shtetërore ose përfaqësues të shoqërisë civile.

Neni 4

(Shtuar fjaltë në fund të paragrafit të parë me ligjin nr.9650, datë 27.11.2006, neni 2/1; ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr.9650, datë 27.11.2006, neni 2/2)

Pranë Këshillit të Ministrave krijohet Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut, i cili vendos për njohjen ose jo të Statusit të Dëshmorit të Atdheut, në bazë të propozimit të bërë nga këshilli i qarkut apo prefekti.

Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë, 4 nga ministrinë dhe 2 nga shoqëria civile, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave. Kryetari caktohet nga Këshilli i Ministrave, ndërsa përfaqësuesit e ministrive janë në rang zëvendësministri.

Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut, për ushtrimin e përgjegjësisë të caktuara në ligj, mbështetet nga një staf teknik. Këshilli i Ministrave përcakton organin e linjës, pranë të cilit funksionon ky staf. Përgjegjësi i stafit teknik ushtron funksionet e sekretarit të Komisionit Qendror të Statusit të Dëshmorit të Atdheut. Stafi teknik ka përgjegjësi që, brenda 45 ditëve nga afati i mbërritjes së propozimit, të verifikojë dokumentacionin, sipas nenit 3 të këtij ligji, të hartojë relacionin, projektaktin, si dhe projektin e rendit të ditës dhe t’ia përcjellë ato kryetarit.

Kryetari i Komisionit, sipas dokumentacionit të dërguar nga stafi teknik, cakton rendin e ditës. Çdo propozim përfshihet në rendin e ditës dhe shqyrtohet në Komision brenda 3 muajve nga afati i dorëzimit të praktikës së plotë nga stafi teknik.

Kur kanë kaluar 3 muaj, por kërkesa nuk është shqyrtuar sipas këtij ligji, kërkuesi ka të drejtë t’i kërkojë gjykatës të vendosë detyrimin ndaj Kryetarit të Komisionit, për të përfshirë kërkesën menjëherë në mbledhjen më të parë të Komisionit. Gjykata, brenda 10 ditëve, shqyrton kërkesën dhe jep vendim për çështjen.

Stafi teknik ndjek zbatimin e vendimeve të Komisionit dhe njofton të interesuarin.

Komisioni brenda 2 muajve nga krijimi i tij, harton rregulloren e funksionimit të tij dhe e paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave.

Komisioni merr vendime me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Komisioni është komision i përhershëm, për funksionimin e të cilit Këshilli i Ministrave cakton fondin e shpenzimeve administrative brenda muajit janar të çdo viti.

Këshilli i Ministrave cakton një shpërblim për anëtarët e Komisionit.

Komisioni raporton para Këshillit të Ministrave, të paktën 1 herë në vit, për punën e bërë për Statusin e Dëshmorit të Atdheut.

Deri në krijimin e qarqeve, kompetencat e detyrat e këshillit të qarkut, për Statusin e Dëshmorit të Atdheut do t’i kryejnë këshillat e rretheve (Këshilli Bashkiak i Tiranës).

Neni 5

(Zëvendësuar fjalia e parë me paragrafët me ligjin nr.9650, datë 27.11.2006, neni 3)

Kërkesa, së bashku me dokumentet përkatëse, sipas nenit 3 të ligjit, i paraqitet për shqyrtim këshillit të qarkut ose prefektit, që ka juridiksion në territorin ku ka vendbanimin familja e dëshmorit. Këshilli i qarkut ose prefekti, brenda 6 muajve nga afati i regjistrimit, shqyrton kërkesën për shpalljen “Dëshmor i Atdheut”.

Kur është plotësuar afati 6-mujor nga afati i regjistrimit dhe kërkesa nuk është shqyrtuar sipas ligjit, kërkuesi ka të drejtë t’i kërkojë gjykatës të vendosë detyrimin e institucionit për të trajtuar kërkesën menjëherë, sipas procedurës në fuqi. Gjykata, brenda 10 ditëve, shqyrton kërkesën dhe jep vendim për çështjen.

Kundër vendimit të Komisionit, të interesuarit kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, brenda një muaji nga data e marrjes në dijeni për vendimin.

Neni 6

Dita përkujtimore e Dëshmorëve të Atdheut është 5 Maji.

Neni 7

Dëshmori i Atdheut prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut. Çdo dëshmor ka një varr në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut, të ngritura në territorin e qarkut.

Në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut në kryeqytet përfaqësohen të gjitha qarqet e Republikës së Shqipërisë.

Në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut nuk mund të varrosen persona të tjerë, që nuk kanë statusin e Dëshmorit të Atdheut.

Neni 8

Varrimi i Dëshmorit të Atdheut në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut bëhet me ceremoni zyrtare me arkivol të mbuluar me flamurin kombëtar.

Ceremonia organizohet dhe zhvillohet nga organet e pushtetit vendor, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave.

Shpenzimet e varrimit të Dëshmorit të Atdheut përballohen nga buxheti i shtetit.

Ato përcaktohen çdo vit në buxhetin e Ministrisë së Pushtetit Vendor.

Neni 9

Në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut në shenjë nderimi qëndron gjithmonë i ngritur flamuri kombëtar.

Neni 10

Ndërtimi, mirëmbajtja dhe ruajtja e Varrezave të Dëshmorëve të Atdheut bëhet nga shteti dhe përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Në shenjë nderimi për Dëshmorët e Atdheut, me vendim të këshillit të qarkut ose të bashkisë (komunës) ngrihen, mirëmbahen dhe ruhen lapidare, pllaka përkujtimore, përmendore etj., si dhe emërtohen mjedise dhe institucione publike.

Neni 12

Zhvendosja e përmendoreve, lapidareve, pllakave përkujtimore, si dhe e objekteve të tjera, që kanë lidhje me Dëshmorët e Atdheut, bëhet vetëm në raste të veçanta, kur këtë e kërkojnë interesa të lartë shtetërore.

Zhvendosja bëhet me vendim të këshillit të qarkut, ku ndodhet objekti. Ky këshill përballon edhe shpenzimet për zhvendosjen.

Objektet e mësipërme rivendosen në një mjedis publik të përshtatshëm, para se të fillojnë punimet në vendndodhjen e mëparshme të objektit.

Neni 13

Familjet e Dëshmorëve të Atdheut gëzojnë nderim e përkrahje të veçantë nga shteti. Ato përfitojnë shpërblim financiar mujor. Kriteret dhe masa e shpërblimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 14

(Ndryshuar neni me ligjin nr.9650, datë 27.11.2006, neni 4)

Shpërblimi, sipas nenit 13 të ligjit, u jepet familjarëve. Në rrethin e familjarëve bëjnë pjesë bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët nën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur kryejnë studimet e larta, prindërit bashkëjetues dhe personat në kujdestari, sipas certifikatës së gjendjes familjare, në çastin e vdekjes së Dëshmorit të Atdheut. Shpërblimi ndërpritet kur asnjëri nga familjarët nuk plotëson kushtet e përcaktuara më sipër. Shpërblimi familjar tërhiqet nga kryefamiljari i Dëshmorit të Atdheut ose, në rast mosmarrëveshjeje, kur është më shumë se një person, nga secili sipas pjesës që i përket.

Neni 14/1

(Shtuar neni me ligjin nr.9650, datë 27.11.2006, neni 5)

Në familjen e Dëshmorit të Atdheut, për efekt nderimi dhe mirënjohjeje, përfshihen bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, prindërit dhe vëllezërit e motrat.

Neni 15

Familja e Dëshmorit të Atdheut dhe shoqatat e tyre kanë të drejtë të kërkojnë në organet e pushtetit vendor dhe në Këshillin e Ministrave, marrjen e masave për mirëmbajtjen e varrezave dhe të lapidareve, busteve, pllakave përkujtimore etj., sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 16

Familja e Dëshmorit të Atdheut ruan e trashëgon reliket, dokumentet vetjake, fotografitë, dekoratat, urdhrat etj., që i janë dhënë Dëshmorit të Atdheut, si dhe çdo gjë tjetër që lidhet me të dhe mundet që vullnetarisht t'i dorëzojë ato në muze, ku ruhen e mirëmbahen si objekte të rëndësishme të veçantë.

Neni 17

Familja e Dëshmorit të Atdheut pajiset nga Komisioni me vendimin e tij për njohjen e Statusit të Dëshmorit të Atdheut dhe me simbolin "Familje e Dëshmorit të Atdheut", të cilin ajo ka të drejtë ta ekspozojë në mjedise të dukshme të banesës së saj në ditët përkujtimore, më 5 Maj, më 28 dhe 29 Nëntor.

Simboli “Familje e Dëshmorit të Atdheut” përbëhet nga një copë e kuqe me thekë, me përmasa 30 x 50 cm, në të cilën është stamposur në ngjyrë ari përmendorja “Nënë Shqipëri” dhe është shkruar anash “Familje e Dëshmorit të Atdheut”.

Neni 18

Organet shtetërore dhe organet e pushtetit vendor organizojnë dhe marrin pjesë në ceremonitë përkujtimore për Dëshmorët e Atdheut, me rastin e 5 Majit, të 28 dhe 29 Nëntorit.

Neni 19

Pjesëtarëve të familjeve të dëshmorëve, kur kanë statusin “I pastrehë” dhe “I papunë”, u sigurohet përparësi për strehim e punësim nga organet e pushtetit vendor.

Neni 20

Dispozita kalimtare

(Shtuar me ligjin nr.9650, datë 27.11.2006)

Pas mbarimit të tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përfitues të shpërblimit financiar mbeten vetëm personat e përcaktuar në rrethin e familjarëve, sipas nenit 4 të këtij ligji.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda një muaji nga data e hyrjes në fuqi, të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e nenit 4 të këtij ligji.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për të nxjerrë aktet nënligjore, në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

Neni 21

Dekreti nr.4558, datë 18.10.1969 “Për dëshmorët e Atdheut” dhe dekreti nr.7155, datë 29.1.1998 “Për një ndryshim në dekretin nr.4558, datë 18.10.1996 “Për dëshmorët e Atdheut”, shfuqizohen.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2618, datë 11.5.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

VENDIM
Nr. 151, datë 25.04.2002

PËR STATUSIN "DËSHMOR I ATDHEUT"

(Ndryshuar me VKM: nr. 393, datë 12.06.2003; nr. 95, datë 15.02.2006; nr. 554, datë 15.08.2007; nr. 834, datë 11.06.2008; nr. 1033, datë 08.10.2009; nr. 503, datë 23.06.2010; nr. 471, datë 03.06.2015)

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 13 dhe 20 të ligjit nr. 8607, datë 27.4.2000 "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut" dhe të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. a) Komisioni Qendror për dhënien e statusit "Dëshmor i Atdheut" kryesohet nga ministri i Mbrojtjes dhe përbëhet nga:

- | | |
|---|-------------|
| - Zëvendësministri i Mbrojtjes | nënkryetar; |
| - Zëvendësministri i Punëve të Brendshme | anëtar; |
| - Zëvendësministri i Drejtësisë | anëtar; |
| - Zëvendësministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë | anëtar; |
| - Një përfaqësues i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të LANÇ-it | anëtar; |
| - Një përfaqësues i Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it të Popullit Shqiptar | anëtar." |

b) Komisioni Qendror i statusit "Dëshmor i Atdheut" mbështetet nga një staf teknik, që funksionon pranë Ministrisë së Mbrojtjes, përbërja e të cilit përcaktohet nga Ministri i Mbrojtjes.

Përgjegjësi i këtij stafi ushtron funksionet e sekretarit të Komisionit Qendror të statusit "Dëshmor i Atdheut".

c) Komisioni Qendror për Statusin "Dëshmor i Atdheut" mbledhet me kërkesën e kryetarit të Komisionit Qendror për dhënien e statusit "Dëshmor i Atdheut".

Masa e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit për pjesëmarrjen në mbledhje është 3000 (tre mijë) lekë.

Në rast shërbimi për çështje të vërtetimit të kërkesave për statusin "Dëshmor i Atdheut" dhe për pjesëmarrje në ceremoni varrimi, anëtari i Komisionit merr dietë, sipas vendit të punës.

Anëtarët e komisionit, përfaqësues të shoqërisë civile, marrin dietë të bazuar në pagën e zëvendësministrit.

Pagesa e dietave për shërbim dhe pagesat për pjesëmarrje në mbledhje të komisionit bëhen nga Ministria e Mbrojtjes.

2. a) Kërkesa për shpalljen "Dëshmor i Atdheut" përmban identitetin, e plotë dhe të saktë, të të rënit, një jetëshkrim të tij dhe përshkrimin e saktë të luftimit apo të rrethanave të ngjarjes ku ka mbetur i vrarë, sipas dokumenteve zyrtare, shtetërore, dhe i paraqitet Këshillit të Qarkut ose të prefektit. Këshilli i Qarkut ose i prefektit pas shqyrtimit e përcjell kërkesën, së bashku me dokumentet e lartpërmendura, pranë stafit teknik të Komisionit Qendror të statusit "Dëshmor i Atdheut".

b) Kërkesa për njohjen e statusit "Dëshmor i Atdheut" shoqërohet me certifikatën e gjendjes civile të të rënit dhe me certifikatën e trungut të tij familjar .

Kërkesën, në emër të familjes, e paraqet njëri nga pjesëtarët, bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët përfitues, prindërit bashkëjetues dhe personat në kujdestari, sipas certifikatës së gjendjes familjare, në çastin e vdekjes së Dëshmorit të Atdheut.

c) Komisioni Qendror për dhënien e statusit "Dëshmor i Atdheut" shqyrton dokumentet e dërguara nga Këshilli i Qarkut ose Prefekti dhe relacionin e stafit teknik. Komisioni Qendror merr vendimin për shpalljen ose jo "Dëshmor i Atdheut" të të ndjerit dhe njofton të interesuarin nëpërmjet Këshillit të Qarkut ose Prefektit.

Vendimi i Komisionit Qendror për mos dhënien e statusit "Dëshmor i Atdheut" duhet të jetë i arsyetuar.

ç) Kur familja e "Dëshmorit të Atdheut" paraqet vendimin e organit shtetëror, me statusin me të cilin personi është shpallur "Dëshmor i Atdheut" Komisioni Qendror për Statusin "Dëshmor i Atdheut" njihet me dokumentet e paraqitura, nga familja ose institucionet e përcaktuara në ligj, dhe, pasi e gjen të saktë shpalljen "Dëshmor i Atdheut", merr vendimin përkatës për dhënien familjes së simbolit "Familje e Dëshmorit të Atdheut". Ky simbol i dërgohet familjes jo më vonë se 20 ditë nga data e marrjes së vendimit, së bashku me dokumentin për shpërblim mujor .

3. a) Varrimi i "Dëshmorit të Atdheut" në varrezat e Dëshmorëve të Atdheut, në kryeqytet, bëhet me vendim të Komisionit Qendror për Statusin "Dëshmor i Atdheut" .

Kërkesën për varrosjen ose rivarrosjen e Dëshmorit të Atdheut në kryeqytet e bën Këshilli i Qarkut ose Prefekti.

Varrimi i Dëshmorit të Atdheut në varrezat e Dëshmorëve të Atdheut në qarqe bëhet me vendim të Këshillit të Qarkut ose Prefektit.

b) Varrimi i "Dëshmorit të Atdheut" organizohet nga prefekti dhe Këshilli i Qarkut, të cilët caktojnë edhe një komision për ceremoninë.

Për varrimin e ish-ushtarakëve të Forcave të Armatosura dhe të efektivave të *Ministrisë e Brendshme*, që shpallen "Dëshmor i Atdheut", zbatohen rregulloret e ceremonialit të këtyre institucioneve.

Institucionet e tjera, të interesuara drejtpërdrejt, ndihmojnë organet e pushtetit vendor për organizimin dhe zhvillimin e ceremonisë .

c) Ceremoniali i varrimit të "Dëshmorit të Atdheut" përmban këto elemente:

-vendosjen për homazhe të arkivolit në një mjedis publik të Bashkisë a Këshillit të Qarkut *ose Prefektit*, të një institucioni kulturor ose të institucionit ku ka shërbyer "Dëshmor i Atdheut" ;

-arkivoli mbulohet me Flamurin Kombëtar, orkestra frymore ekzekuton muzikë funebre dhe Himn Kombëtar;

-truproje nderi, e nxjerrë nga komanda e garnizonit ushtarak;

-miting në sheshin e institucionit ku do të bëhen homazhe (ose në një shesh tjetër, të përshtatshëm, të afërt). Fjala e rastit nga përfaqësues të organeve shtetërore, familja dhe shoqëria civile.

-masa për sigurimin e ceremonisë;

-autobusë për transportimin e familjareve.

ç) Shpenzimet e varrimit të "Dëshmorit të Atdheut" përfshijnë shpenzimet për arkivolin, për transportin, për qëndrimin në morg, për ceremoninë, për kurorat, për dreken (deri në 150 mijë lekë) dhe një ndihme të menjëhershme për familjen, në masën e tri pagave minimale, në shkallë vendi. Shpenzimet përballohen nga *Ministria e Brendshme* dhe planifikohen në buxhetin vjetor të saj

4. Këshillat e Qarqeve (Këshilli Bashkiak i Tiranës), çdo vit, në periudhën e planifikimit të buxhetit, i paraqesin *Ministrisë së Brendshme* planin financiar për shpenzimet për varrim dhe për meremetimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të Dëshmorëve të Atdheut e të simboleve të Luftës në qarqet e tyre.

5. a) *Shpërblimi financiar mujor për familjen e Dëshmorit të Atdheut caktohet në masën 7 000 (shtatë mijë) lekë. Komisioni Qendror për dhënien e statusit "Dëshmor i Atdheut" i dërgon Institutit të Sigurimeve Shoqërore emrin e familjarit që përfiton shpërblimin financiar bashkë me një kopje origjinale të vendimit për dhënien e statusit "Dëshmor i Atdheut". Një kopje e vendimit të komisionit, në çdo rast, vendoset në dosjen përkatëse të "Dëshmorit të Atdheut".*

b) Shpërblimi i familjes së Dëshmorit të Atdheut jepet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sipas vendimit të Komisionit Qendror për Statusin "Dëshmor i Atdheut", certifikatës së gjendjes civile, familjare dhe personale.

c) Shpenzimet financiare për shpërblimin e familjeve të Dëshmorëve të Atdheut për vitin 2002 do të jenë në masën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë, të cilat janë parashikuar në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në fondin e sigurimeve suplementare, në zërin e ri "Pagesat e familjeve të Dëshmorëve të Atdheut" .

6. Efektet financiare fillojnë nga data 1 janar 2002.

7. *Trajtimi financiar për rrethin familjar të Dëshmorit të Atdheut fillon në datën e shpalljes së vendimit të Komisionit Qendror për dhënien e statusit "Dëshmor i Atdheut".*

Trajtimi financiar për rrethin familjar të Dëshmorit të Atdheut, i cili e ka fituar të drejtën për t'u njohur si Dëshmor i Atdheut me vendim gjykatë të formës së prerë, fillon nga data e vendimit të komisionit për mosdhënien e statusit "Dëshmor i Atdheut".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

LIGJ
Nr.7874, datë 17.11.1994

PËR STATUSIN E VETERANIT TË LUFTËS ANTIFASHISTE
NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR

*(Ndryshuar me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999; ndryshuar me ligjin nr.9568, datë 19.6.2006;
ndryshuar me ligjin nr.9724, datë 3.5.2007)*

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

(Ndryshuar titulli i ligjit me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999)

Statusi i veteranit të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, që më poshtë do të quhet "Status", përcakton kriteret që një person të njihet veteran i kësaj lufte, si dhe të drejtat që fitohen nga ky status.

Neni 2

(Ndryshuar neni me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999)

Statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e përfitojnë shtetasit shqiptarë e të huaj, që kanë marrë pjesë me armë në dorë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve nazifashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre, që nga 7 prilli i vitit 1939 deri më 29 nëntor 1944; luftëtarët e inkuadruar në ato njësi të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që luftuan jashtë kufijve tanë shtetërore deri më 9 maj 1945; ata që kanë zhvilluar veprimtari të organizuar antifashiste nacionalçlirimtare në ilegalitet, në prapavijë të armikut e në zonat e çliruara; kryefamiljarët e atëhershëm të familjeve të njohura si baza të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare; të burgosurit antifashistë dhe të internuarit në burgjet dhe në kampet nazifashiste brenda dhe jashtë vendit, si dhe shtetasit shqiptarë, që kanë marrë pjesë aktive në luftë kundër nazifashizmit në vende të tjera.

Neni 3

*(Ndryshuar shkronja "d" me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999;
shtuar paragraf në shkronjën "dh" me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999;
shtuar shkronja "e" me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999)*

Qenia veteran i Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar vërtetohet me njërin prej këtyre dokumenteve:

- a) Librezën e pensionit, ku tregohet shtesa prej 100 lekësh në muaj për pjesëmarrje në luftë.
 - b) Dokumentin që vërteton zotërimin të paktën të një dekorate të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar.
 - c) Vërtetimin e degës ushtarake të rrethit, të Ministrisë së Mbrojtjes ose të Ministrisë së Rendit për pjesëmarrjen në Luftën kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar.
 - ç) Vendimin e ish-komiteteve ekzekutive të rretheve, me të cilin veteranit i është njohur dyfishi i kohës së luftës për vjetërsi në punë.
 - d) Me çdo dokument tjetër zyrtar, me burim arkivor të referuar qartë, i cili vërteton pjesëmarrjen në Luftën a në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare.
 - dh) Për ata që veprimtarinë e tyre kundër pushtuesve nazifashistë e kanë kryer jashtë vendit, për njohjen e statusit vlen dokumentacioni i njëjtë, i marrë nga shteti i huaj.
- Për raste të veçanta, kur ka mungesa objektive, vendos Komisioni Qendror i Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.
- e) Plagosja, për efekt të statusit të veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, mund të vërtetohet edhe me vërtetim të komisionit të spitalit qendror të ushtrisë dhe me një dokument të arkivave shtetërore (ose me tri deklarata të bashkëluftëtarëve për rrethanat e plagosjes).

Neni 4

(Shtuar paragraf pas paragrafit të fundit me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999)

Kërkesa dhe dokumenti vërtetues i paraqiten komisionit përkatës të ngritur në çdo rreth me vendim të Këshillit të Ministrave sipas propozimit të Ministrisë së Mbrojtjes. Dokumentet përkatëse, së bashku me mendimin e tij, komisioni i rrethit ia paraqet Ministrisë së Mbrojtjes, e cila, pas shqyrtimit të nevojshëm, vendos për njohjen ose jo të qënies veteran, me përjashtim të përcaktimit të gërmës "a" të nenit 3, të cilat nuk janë objekt rishikimi. Veterani pajiset me dokumentin përkatës, të emërtuar "Libreza e veteranit". Dokumenti përmban identitetin e plotë dhe fotografinë e veteranit.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit.

Kur kërkesi që nuk i është drejtuar gjykatës, pas vendimit të Komisionit Qendror, paraqet disa dokumente të reja, dosja e tij rishqyrtohet nga ky komision. Të drejtën e rishqyrtimit e kanë edhe kërkesat e pashqyrtuara të veteranëve të depozituara pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Neni 5

Me vdekjen e veteranit libeza i dorëzohet organit që e ka lëshuar atë. Familjes i jepet një dokument që vërteton se është familje veterani.

Neni 6

(Ndryshuar neni me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999)

Statusi i veteranit nuk u njihet ose u hiqet personave që janë dënuar ose dënohen me vendim gjykatë të formës së prerë, për krime lufte, për bashkëpunim me pushtuesit nazifashistë ose për veprimtari agjenturore kundër interesave të atdheut.

Neni 7

Veterani i Luftës kundër pushtuesve nazifashistë, si figurë e lartë e popullit dhe e atdheut, gëzon mbrojtje të veçantë ligjore.

Neni 8

*(Shtuar fjali në fund të paragrafit të parë me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999;
shfuqizuar paragrafi i dytë dhe i tretë i nenit me ligjin nr.9568, datë 19.6.2006)*

Këshilli i Ministrave cakton një shpërblim mujor për personat që gëzojnë statusin e veteranit, për ata që gëzojnë statusin e invalidit të luftës, si dhe për të internuarit në kampet e përqendrimit nazifashist. Veteranëve të plagosur në Luftën kundër pushtuesve nazifashistë që nuk përfitojnë statusin e invalidit të luftës, u jepet një shpërblim plus mbi atë të veteranit në masën që cakton Këshilli i Ministrave. Të internuarve në kampet e përqendrimit nazifashist, përveç shpërblimit të veteranit, u jepet plus shpërblimi i invalidit të luftës të grupit të parë. Një shpërblim shtesë jepet për të burgosurit politikë antifashistë.

Masa e shpërblimit ndryshohet në varësi nga indeksi i çmimeve dhe inflacionit.

Neni 9

*(Shtuar paragrafë me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999;
ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9724, datë 3.5.2007)*

Veteranët gëzojnë të drejtën e kurimit falas në spitalet, klinikat dentare dhe qendrat e kurimit që financohen nga shteti, si dhe përfitojnë falas barnat për sëmundje kronike, sipas kriterëve të caktuara nga Këshilli i Ministrave.

Shteti financohet organizatat e veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe organizatat e tjera të veteranëve të kësaj lufte.

Masa vjetore e financimit përcaktohet në Buxhetin e Shtetit. Ministria e Mbrojtjes bën ndarjen e fondit për çdo organizatë veteranësh, bazuar në numrin e anëtarësisë dhe planin vjetor të veprimtarive, të planifikuara nga këto organizata në fillim të çdo viti.

Neni 10

Veteranëve u sigurohet falas udhëtimi me mjetet e komunikacionit urban shtetëror, kurse udhëtimi interurban shtetëror me gjysmë çmimi. Për këtë si dokument provues shërben librezja e veteranit.

Neni 11

Organet e pushtetit lokal duhet t'u japin përparësi zgjidhjes së kërkesave të veteranëve për strehim, duke mbajtur parasysh kushtet, veçoritë dhe gjendjen shëndetësore të tyre.

Neni 12

Veteranët gëzojnë të drejtën e pushimit në shtëpitë e pushimit të punonjësve dhe ushtarakëve, sipas çmimit dhe kohës së caktuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 13

Veteranët e Luftës kundër pushtuesve nazifashistë nuk paguajnë asnjë lloj takse të drejtpërdrejtë.

Neni 14

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Këshilli i Ministrave.

Neni 15

Çdo dispozitë që është në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.962, datë 22.11.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

VENDIM

Nr.190, datë 3.5.1995

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7874, DATË 17.11.1994 “PËR STATUSIN E VETERANIT TË LUFTËS KUNDËR PUSHTUESVE NAZIFASHISTË”

(ndryshuar me vendimin Gjykatës Kushtetuese nr.15, datë 8.11.1995, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.467, datë 4.9.1995, nr.232, datë 10.4.1998, nr. 782, datë 17.12. 1998, nr.562, datë 2.12.1999, nr. 353, datë 7.7.2000, nr. 29, datë 28.1.2002, nr.217, datë 10.4.2003, nr.748, datë 11.11.2004, nr. 627, datë 7.9.2016)

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI :

1. Për organizimin dhe drejtimin e punës për dhënien e statusit të veteranit të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë, në Ministrinë e Mbrojtjes krijohet “Departamenti i veteranëve dhe invalidëve të luftës”.

Në Ministrinë e Mbrojtjes krijohet kartoteka e departamentit të veteranëve dhe të invalidëve të Luftës, e cila administron dosjet e veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare deri në përfundimin e punës së Komisionit Qendror të Statusit të Veteranit të Luftës Nacionalçlirimtare dhe dorëzimit në Arkivin Qendror të Ushtrisë.

2. Shfuqizuar.

3. Shfuqizuar.

4. Përbërja emërore e komisioneve në rrethe të caktohet nga ministri i Mbrojtjes. Për hartimin e listave të komisioneve Ministria e Mbrojtjes mbështetet në propozimet e pushtetit në rreth dhe të organizatave të veteranëve.

5. Për qenien veteran i luftës, në kuptimin e shkronjës “d” të nenit 3 të ligjit, për raste të veçanta do të konsiderohen edhe dëshmi individuale për veteranët, të cilëve nuk u është njohur kjo e drejtë nga regjimi totalitar për shkaqe politike e biografike.

Dokument zyrtar, me burim arkivor të referuar qartë, vlerësohet dokumenti i dalë nga arkivat e institucioneve zyrtare, ku janë shënuar qartë, referencat e regjistrimit të tij: institucioni që e lëshon, numri i fondit, numri i dosjes, numri i fletës, viti i dokumentit dhe lloji i tij.

6. Në zbatim të nenit 6 të ligjit, statusin e veteranit të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë nuk do ta përfitojnë personat që janë dënuar për krime kundër lirisë e pavarësisë, të cilët nuk kanë përfituar nga ligji mbi fajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve e të përndjekurve politikë.

7.a. Për veteranët që luftuan në formacione luftarake, të çdo rangu, kundër pushtuesve nazifashistë, të inkuadruar përpara datës 10.7.1943, shpërblimi të bëhet 3 092 (tre mijë e nëntëdhjetë e dy) lekë në muaj.

b. Për veteranët që luftuan në formacione luftarake, të çdo rangu, kundër pushtuesve nazifashistë, të inkuadruar në periudhën 11.7.1943 deri në 24.5.1944, shpërblimi të bëhet 2476 (dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

c. Për veteranët që luftuan në formacione luftarake, të çdo rangu, kundër pushtuesve nazifashistë, të inkuadruar në periudhën 25.5.1944 deri në 29.11.1944, shpërblimi të bëhet 2 061 (dy mijë e gjashtëdhjetë e një) lekë në muaj.

ç. Për veteranët që luftuan në formacione luftarake, pas datës 29.11.1944 e që vazhduan luftën jashtë kufijve të atdheut, shpërblimi të bëhet 618 (gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) lekë në muaj.

8.a. Të burgosurit në burgjet nazifashiste, brenda dhe jashtë vendit, për kohën e burgosjes mbi 6 muaj të marrin një shpërblim prej 1 030 (një mijë e tridhjetë) lekësh në muaj.

b. Të burgosurit në burgjet nazifashiste, brenda dhe jashtë vendit, për kohën e burgosjes deri në 6 muaj të marrin një shpërblim prej 618 (gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) lekësh në muaj.

9.a. Të internuarit në kampet e përqëndrimit nazifashist të marrin një shpërblim prej 3 092 (tre mijë e nëntëdhjetë e dy) lekësh në muaj, plus masën e shpërblimit të invalidit të grupit të parë.

b. Të internuarit në kampet e internimit, brenda dhe jashtë vendit, të marrin një shpërblim prej 2 061 (dy mijë e gjashtëdhjetë e një) lekësh në muaj.

10. Dokumentet bazë (dëshmi, lista, vërtetime) për të burgosurit dhe të internuarit në kampet e përqëndrimit nga pushtuesit nazifashistë janë ato që kanë ardhur nga kampet (burgjet), Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, organizma shtetërorë të vendeve që kanë pasur kampe (burgje) të tilla, si dhe nga ambasadat shqiptare në ato shtete.

Për raste të veçanta, kur ka mungesa objektive për vërtetimin e internimit jashtë vendit në kampet e përqëndrimit nazifashist, Komisioni Qendror i Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare mund të vendosë, në bazë të dokumenteve të arkivave zyrtare, shqiptare. Në çdo rast përmbajtja e dokumentit duhet të verifikohet.

11. Veteranët e plagosur në luftë, të cilët nuk përfitojnë statusin e invalidit të luftës, përveç shpërblimit mujor të veteranit, të marrin edhe një shtesë prej 1 030 (një mijë e tridhjetë) lekësh në muaj.

12. Personat që kanë statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë, përveç shpërblimit që marrin si të tillë, përfitojnë edhe shpërblimin e veteranit të luftës që u takon.

13. Familjeve të veteranëve të vdekur, që përfitojnë këtë status, por që nuk kanë marrë shpërblimin prej 100 (njëqind) lekësh në muaj, t'u jepet një shpërblim i menjëhershëm prej 41 253 (dyzet e një mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) lekësh.

14. Anëtarëve të komisioneve në rrethe për statusin e veteranit të luftës që nuk janë në marrëdhënie pune, për kohën që do të punojnë, u jepet një shpërblim mujor sipas vlerësimit të Ministrisë së Mbrojtjes, por jo më shumë se 300 lekë në ditë.¹⁰

14/1. Në funksion të Komisionit qendror të departamentit të veteranëve dhe invalidëve të luftës e të ushtrisë, Ministria e Mbrojtjes mund të angazhojë në punë specialistë veteranë të luftës e të ushtrisë. Shpërblimi i tyre të jetë i njëjlojtë me atë të anëtarëve që nuk janë në marrëdhënie pune, në përputhje me pikën 14 të këtij vendimi.

15. Shfuqizuar.

16. Komisioni qendror për dhënien e statusit të veteranit të LANÇ-it të popullit shqiptar i dërgon Institutit të Sigurimeve Shoqërore një kopje origjinale të vendimit për dhënien e statusit të

¹⁰ 3. Në pikën 14 masa e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit Qendror të "statusit të veteranit" të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare nga 900 (nëntëqind) lekë bëhen 2 000 (dy mijë) lekë për pjesëmarrjen në mbledhje, për specialistët nga 540 (pesëqind e dyzet) lekë bëhet 700 (shtatëqind) lekë për ditë punë.

5. Vendimi nr.540, datë 09.10.1995 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Komisionit Qendror dhe të komisioneve të rretheve për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare", shfuqizohet.

veteranit, ku përcaktohet identiteti i personit që e ka fituar këtë status dhe masa e shpërblimit që ai përfiton, sipas këtij vendimi.

17. Shpërblimi i veteranit të luftës jepet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, kundrejt paraqitjes së librezës së Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, të lëshuar nga Komisioni Qendror, pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

18. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë të lëshojnë udhëzime në zbatim të këtij vendimi dhe të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994.

19. Veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë u jepet e drejta të pushojnë individualisht një herë në tre vjet në shtëpitë e pushimit që financohen nga shteti, kundrejt pagesës me 1/3 e çmimit, sipas organizimit që kryen departamenti në Ministrinë e Mbrojtjes.

20. Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 1995 i shtohen 600 milionë lekë, të parapara në buxhetin e shtetit për efektet financiare të këtij vendimi. Në këtë shumë përfshihen edhe efektet financiare për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.189, datë 6.3.1995 “Për trajtimin shëndetësor të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, si dhe 8 milionë lekë për shpenzimet administrative të Ministrisë së Mbrojtjes.

21. Në zbatim të nenit 5, të ligjit nr.8526, datë 23.9.1999, Departamenti i Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës, në Ministrinë e Mbrojtjes, paraqet listat e kërkuesve për “statusin e veteranit”, të ardhura në zyrën e gjendjes gjyqësore, pranë Ministrisë së Drejtësisë.

- Pas paraqitjes së dëshmisë së penaltetit dosja përkatëse e personit rishihet nga Komisioni Qendror i Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, i cili merr vendimin përkatës.

- Departamenti i Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës të paraqesë, në zyrën e gjendjes gjyqësore, kërkesat për dëshmi penalteti për veteranët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, të cilëve u është njohur deri tani statusi. Kjo zyrë, deri më 31 gusht 2001, të lëshojë për to dëshmi penalteti.

Dosja e veteranit, për të cilin, sipas dëshmisë së penaltetit, rezulton se është dënuar për krime lufte, për bashkëpunim me pushtuesit nazifashistë ose për veprimtari agjenturore kundër interesave të atdheut, me vendim gjykate të formës së prerë, rishqyrtohet nga Komisioni Qendror i Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, i cili merr edhe vendimin përkatës.

22. Për financimin e organizatave të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, Ministria e Financave paraqet çdo vit, në buxhetin e shtetit, fondin përkatës.

Ndarja e fondit për organizatat e veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare bëhet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, në përputhje me numrin e veteranëve që e kanë përfituar statusin e veteranit, e që janë anëtarë të këtyre organizatave, për çdo rreth, me listat emërore përkatëse të veteranëve që jetojnë dhe me numrin e regjistrimit themeltar të librezës së tyre.

23.a. Komisioni Qendror i “Statusit të veteranit” të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ia njeh këtë status veteranit, që ka marrë shpërblimin prej 100 lekësh në muaj dhe që ka vdekur para hyrjes në fuqi të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 dhe i jep familjes së tij dëshminë “Familje veterani”.

b. Dëshmia “Familje veterani” i jepet edhe familjes së veteranit, pas vdekjes së tij, i cili e ka pasur “Statusin e veteranit” të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Dëshmia “Familje veterani” jepet me firmë të kryetarit të komisionit qendror për dhënien e statusit të veteranit të LANÇ-it të popullit shqiptar dhe me kërkesë të një pjesëtari të familjes së veteranit, i cili duhet të paraqesë dhe këto dokumente:

- librezën e veteranit të ndarë nga jeta;
- certifikatën e vdekjes së veteranit;
- certifikatë familjare të kërkuesit.

24. Forma dhe përmbajtja e dëshmisë miratohen nga Ministri i Mbrojtjes.

25. Përbërja e Komisionit Qendror të “Statusit të veteranit” të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të jetë sipas funksioneve organike, të përcaktuara në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

26. Komisioni Qendror i “Statusit të veteranit” të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe stafi teknik i tij të vazhdojnë veprimtarinë edhe për vitin 2002.

Deri më 30 korrik 2002 të përfundojnë praktikën për dhënien e “Statusit të veteranit”.

Deri më 30 nëntor 2002 të përpunohet, inventarizohet, përgatitet e dorëzohet i tërë dokumentacioni në Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura.

Komisioni qendror për dhënien e statusit të veteranit të LANÇ-it të popullit shqiptar dhe stafi teknik i tij, në përjashtim nga sa është thënë në paragrafët e mësipërm, të vazhdojë veprimtarinë e tij, duke u mbledhur, të paktën një herë në vit, për shqyrtimin e kërkesave të personave që e fitojnë statusin e veteranit ose të drejtën për t’u shqyrtuar nga ky komision me vendim gjykatë të formës së prerë. Këto kërkesa, bashkë me vendimin e gjykatës së formës së prerë, adresohen në Ministrinë e Mbrojtjes.

Stafi teknik i komisionit qendror për dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut”, i përcaktuar në vendimin nr. 151, datë 25.4.2002, “Për statusin “Dëshmor i Atdheut””, të ndryshuar, të shërbejë si staf teknik edhe për komisionin qendror për dhënien e statusit të veteranit të LANÇ-it të popullit shqiptar.

Përjashtimisht për vitin 2016, komisioni të ngrihet vetëm për shqyrtimin e kërkesave të personave që u është njohur statusi i veteranit me vendim gjykatë të formës së prerë.

27. Trajtimi financiar për personat që kanë fituar të drejtën për t’u shqyrtuar nga komisioni qendror për dhënien e statusit të veteranit të LANÇ-it të popullit shqiptar me vendim gjykatë të formës së prerë, në rast se komisioni u njeh statusin e veteranit, fillon nga data e marrjes së vendimit të komisionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij financiare nga data 1.12.1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Lista nr. 1

PËRBËRJA E KOMISIONIT QENDROR PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VETERANIT TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR

- | | |
|---|----------|
| 1. Zëvendësministri i Mbrojtjes | kryetar; |
| 2. Drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe Përkujdesjes Sociale të Ushtrakeve | anëtar; |
| 3. Përfaqësuesi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore | anëtar; |
| 4. Një përfaqësues i strukturës juridike në Ministrinë e Mbrojtjes | anëtar; |
| 5. Drejtori i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura | anëtar; |
| 6. Një specialist i Arkivit Qendror të Shtetit | anëtar; |
| 7. Një përfaqësues i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës | anëtar; |
| 8. Një përfaqësues të Organizatave të Invalidëve të Luftës dhe të Ushtrisë | anëtar; |
| 9. Një përfaqësues i Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar | anëtar. |

VENDIM
Nr. 652, datë 22.7.2015

PËR INDEKSIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Indeksimin në masën 15.6 për qind të shpërblimit të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, i përcaktuar në vendimin nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar”, duke arritur vlerat e mëposhtme:

- a) Shpërblimi sipas shkronjës “a”, të pikës 7, nga 3 383 lekë bëhet 3 911 lekë në muaj.
- b) Shpërblimi sipas shkronjës “b”, të pikës 7, nga 2 709 lekë bëhet 3 132 lekë në muaj.
- c) Shpërblimi sipas shkronjës “c”, të pikës 7, nga 2 255 lekë bëhet 2 607 lekë në muaj.
- ç) Shpërblimi sipas shkronjës “e”, të pikës 7, nga 676 lekë bëhet 781 lekë në muaj.
- d) Shpërblimi sipas pikës 8/1 (për kohën e vuajtjes në burg mbi 6 muaj), nga 1 127 lekë bëhet 1 303 lekë në muaj.

dh) Shpërblimi sipas pikës 8/2 (për kohën e vuajtjes në burg nga 1 deri në 6 muaj), nga 678 lekë bëhet 784 lekë në muaj.

- e) Shpërblimi sipas shkronjës “a”, të pikës 9, nga 3 383 lekë bëhet 3 911 lekë në muaj.
- ë) Shpërblimi sipas shkronjës “b”, të pikës 9, nga 2 255 lekë bëhet 2 607 lekë në muaj.
- f) Shpërblimi sipas pikës 11 nga 1 127 lekë bëhet 1 303 lekë në muaj.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përlllogariten në shumën 16 600 mijë lekë dhe përballohen nga fondi i kontingjencës, të parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2015.

3. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për të nxjerrë udhëzimet përkatëse teknike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.8.2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIGJ
Nr.7663, datë 20.1.1993

PËR STATUSIN E INVALIDIT TË LUFTËS KUNDER PUSHTUESVE
NAZIFASHISTE TE POPULLIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Statusin e invalidit të luftës e gëzojnë të plagosurit dhe të gjymtuarit, të cilët:

- a) Kanë marrë pjesë në luftë me armë në dorë kundër okupatorëve nazifashistë prej datës 7 prill 1939 gjer më 9 maj 1945.
 - b) Kanë zhvilluar veprimtari në ilegalitet, në prapavija të armikut ose në zona të çliruara.
 - c) Kanë qenë të burgosur ose të internuar në kampet nazifashiste.
- Qënia invalid dhe grupi përkatës vërtetohet me aktin e Komisionit të ekspertizës mjekoligjore, sipas kriterëve të ligjit "Për sigurimet shoqërore".

Neni 2

Invalidi i luftës kundër pushtuesve nazifashistë, si figurë e lartë e popullit dhe e atdheut gëzon mbrojtje të veçantë ligjore.

Neni 3

Invalidët e mësipërm gëzojnë këto të drejta financiare:

- a) Invalidi i mësipërm merr një shtesë mbi pensionin e invaliditetit, masa e së cilës caktohet nga Këshilli i Ministrave.
Këtë shtesë invalidi i luftës e merr edhe kur del në pension pleqërie.
- b) Invalidëve që nuk kanë asnjë lloj pensioni u jepet pension invaliditeti, i barabartë me pensionin mesatar të invaliditetit të punës, sipas grupit të invaliditetit që ka.
- c) Në ndihmë të invalidëve të luftës të grupit të parë që ka nevojë për shërbim, caktohet një person për shpërblim. Masa e shpërblimit caktohet nga Këshilli i Ministrave dhe paguhet nga bashkitë ose komunat.
- ç) Fondet shtesë për invalidët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë përballohen nga buxheti i shtetit.
- d) Në rastet e ndryshimit të pagave, pensioni i invaliditetit, së bashku me shpërblimet, pësojnë ndryshimet përkatëse.

Neni 4

Invalidët e luftës gëzojnë të drejtën e kurimit falas në spitalet dhe qendrat e ndryshme kurative që financohen nga shteti.

Barnat, sipas raporteve mjekësore jepen falas. Vlefte e tyre përballohet nga shteti.

Neni 5

Invalidët që kanë gjymtime të rënda, kanë të drejtë të diagnostikohen e kurohen në klinikat jashtë shtetit. Dërgimi për kurim bëhet me vendim të komisionit përkatës mjekësor. Invalidët e luftës pajisen me mjete ortopedike, proteza dhe mjete lëvizëse për invalidë.

Neni 6

Udhëtimi me mjetet e komunikacionit qytetar bëhet falas, kurse me mjetet e komunikacionit ndërqytetar me gjysmë bilete.

Për këtë qëllim dëshmia e invaliditetit shërben si dokument ligjor, e cila duhet të ketë firmën dhe vulën e organit drejtues të shoqatës dhe të organit financiar të vendbanimit të invalidit.

Dëshmia i jepet invalidit pavarësisht nga anëtarësia në shoqatën e invalidëve.

Neni 7

Shteti u krijon invalidëve të luftës kushte të mira për strehim.

Shpenzimet e varrimit për invalidët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë përballohen nga pushteti lokal.

Neni 8

Shoqata e invalidëve të luftës financohet nga buxheti i shtetit. Ajo gëzon përkrahjen sociale dhe materiale nga shteti.

Neni 9

Invalidët e luftës nuk paguajnë asnjë lloj takse të drejtpërdrejtë.

Neni 10

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Këshilli i Ministrave.

Neni 11

Çdo dispozite që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.454, datë 8.2.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**

VENDIM
Nr. 326, datë 21.6.1993

**PËR KRITERET E TRAJTIMIT TË INVALIDËVE TË LUFTËS KUNDËR
PUSHTUESVE NAZIFASHISTË TË POPULLIT SHQIPTAR**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.186, datë 21.4.2000; ndryshuar me vendim të KM nr. 332,
datë 29.5.2003)*

Në zbatim të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 "Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", me propozimin e Minsitrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personit i lind e drejta të njihet si invalid i luftës, kur paraqet këto dokumente:
 - a) Librezën e pensionit të invalidit të luftës ose të pensionit të pleqërisë, kur në të është llogaritur edhe shtesa si invalid i luftës.
 - b) Vërtetimet zyrtare të lëshuara nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik, degët ushtarakë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit e spitalit ushtarak, si dhe çdo akt tjetër zyrtar që vërteton plagosjen a gjymtimin në kushtet e parashikuara në nenin 1 të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993.
 - c) Kur nuk ka dokumente zyrtare, plagosja a gjymtimi në luftën kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar vërtetohet në rrugë gjyqësore, sipas dispozitave në fuqi.
2. Qenia invalid, grupi përkatës dhe ndryshimi i grupit të invaliditetit përcaktohen nga Komisioni mjekësor i caktimit të aftësive për punë, mbi bazën e kërkesës së të interesuarit ose të degëve të sigurimeve shoqërore, sipas kritereve të ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".
3. Invalidit të luftës i jepet një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit në masën:
 - Për grupin e parë të invaliditetit 4000 lekë
 - Për grupin e dytë të invaliditetit 3500 lekë
 - Për grupin e tretë të invaliditetit 3000 lekë
 - Për grupin e katërt të invaliditetit 2500 lekëKëtë shtesë invalidi i luftës e merr edhe kur përfiton pension pleqërie. Kjo shtesë do t'u nënshtrohet të gjitha rritjeve që kanë pësuar dhe do të pësojnë pensionet për shkak të rritjes e të ndryshimit të çmimeve, duke filluar nga data 20 janar 1993.
4. Personi i ngarkuar sipas vendimit të KMCAP-së për t'i shërbyer invalidit të luftës të grupit të parë merr pagën bazë të caktuar në klasën II të lidhjes nr.II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 (pa përfituar shtesat e tjera), që paguhet nga bashkitë ose komunat.
5. Invalidët e luftës gëzojnë te drejtën e kurimit falas ne spitalet, klinikat dentare dhe qendrat e kurimit, qe financohen nga shteti, si dhe përfitojnë falas te gjitha bamat, sipas recetës se mjekut.
 - 5/a. Invalidët e luftës me gjymtime te renda, ne pamundësi te kurimit brenda vendit, te diagnostikohen e kurohen jashtë shtetit, sipas vendimit te komisionit nderspitalor, qe funksionon pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nene Tereza" Tiranë.
 - 5/b. Invalidët e luftës te pajisen falas nga Ministria e Shëndetësisë me mjete ortopedike, proteza dhe mjete lëvizëse, te përshtatshme për ta.
 - 5/c. Udhëtimi i invalidëve te luftës me mjetet e transportit qytetës, publik behet falas, ndërsa me mjetet e transportit ndërqytetës te behet duke paguar gjysmën e vlerës se biletës, kundrejt paraqitjes se dëshmisë se invalidit. Për rastet kur këto transporte janë private organet përkatëse, ne kontratat me subjektet private, parashikojnë efektet qe rrjedhin nga zbatimi i kësaj pike.
 - 5/ç. Kur invalidi i luftës vdes, komuna ose bashkia i bën nderimet përkatëse dhe përballon shpenzimet e varrimit, duke i dhënë familjes se te ndjerit 150 000 (njëqind e pesëdhjete mije) leke.

Ne shpenzimet e varrimit përfshihen arkivoli, transporti, qëndrimi ne murg, ceremonia dhe dreka.

5/d. Organet e qeverisjes vendore trajtojnë me strehim, me përparësi, familjet e konsideruara te pastreha, qe ne çastin e hyrjes ne fuqi te ligjit nr.8647, date 24.7.2000 "Për disa shtesa ne ligjin nr.8030, date 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha"" kane ne përbërje te tyre invalid, te Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

6. Shoqata e invalidëve të luftës për vitin 1993 të financohet me 400 mijë lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave në buxhetin e shtetit për vitin 1993.

7. Dëshmia e invaliditetit lëshohet nga kryesia e shoqatës dhe seksioni i financës i vendbanimit të invalidit. Ajo përmban gjeneralitetet e invalidit, fotografinë e tij dhe të drejtat që ai gëzon të përcaktuara në ligj. Kur invalidi vdes, dëshmia e tij i dorëzohet organit drejtues të shoqatës.

7/a. Departamenti i veteraneve e invalidëve te Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe dëshmorëve te atdheut, ne Ministrinë e Mbrojtjes, ndjek zbatimin e politikave te qeverise për përkujdesjen ndaj invalidëve te luftës, sipas te drejtave dhe detyrimeve, qe rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore ne fuqi.

7/b. Deklarimi invalid lufte nga Komisioni i Ekspertizës Mjekoligjore dhe përcaktimi ne grupin përkatës konsiderohen te mbyllura.

8. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Ministria e Rregullimit te Territorit dhe e Turizmit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Sigurimeve te Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

9. Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 1993 i shtohen 13 milionë lekë, që përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave në buxhetin e shtetit për vitin 1993.

10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 "Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar".

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

LIGJ
Nr. 8626, datë 22.6.2000

STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK
*(Ndryshuar me: Ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005; Ligjin nr. 9506, datë 03.04.2006;
Ligjin nr. 27/2012 datë 15.03.2012)*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Nga ky ligj përfitojnë të gjithë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga mosha, koha, vendndodhja e aksidentit dhe çasti i sigurimit.

Neni 2

(Sbfuqizuar neni me ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005)

Neni 3

Shteti krijon kushte për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëloj si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive.

Ministria e Shëndetësisë parashikon çdo vit në buxhetin e shpenzimeve të saj fondet e nevojshme për kontrole periodike vjetore nga mjekë të specializuar për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 4

Shteti mbron të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga të gjithë llojet e shfrytëzimit, të diskriminimit, të abuzimit dhe të fyerjes.

Neni 5

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi.

Kriteret e dhënies së dëshmisë dhe forma e saj përcaktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe të Shërbimeve Sociale.

Neni 6

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta. Në rastet kur ata vetëpunësohen si persona fizikë dhe janë subjekte të tatimit mbi biznesin e vogël, kuota e tatimit fiks është sa gjysma e asaj të përcaktuar në nenin 3 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

Neni 7

Personat juridikë, shtetërorë ose privatë që punësojnë të sëmurë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përveç kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 7955, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, përfitojnë për çdo vit kalendarik ulje tatimi mbi fitimin, të barabartë në përqindjen e fuqisë punëtore të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Ministria e Financave nxjerr aktet nënligjore përkatëse në bazë të këtij ligji.

Neni 8

Shteti favorizon arsimimin e të sëmurëve paraplegjikë në shkollat e larta të sistemit shtetëror. Këshilli i Ministrave merr masa dhe përcakton fonde për ngritjen e shkollave dhe të institucioneve për arsimimin, edukimin dhe rehabilitimin e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 9

(Ndryshuar neni me Ligjin Nr. 9506, datë 03.04.2006)

Shteti përjashton të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga pagesat për kontributet shëndetësore dhe u jep të drejtën e përfitimit falas të barnave, të mbuluara nga skema e sigurimeve të kujdesit shëndetësor.

Paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët kanë përfituar statusin, përfitojnë një shtesë në të ardhura për mbulimin e shpenzimeve të paketës së domosdoshme me materiale të veçanta higjieno-sanitare. Masa, kriteret dhe procedura e përfitimit të kësaj shtese në të ardhura përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që janë në gjendje të rëndë dhe në pamundësi për t'u paraqitur në institucionet shtetërore, përfitojnë shërbimin në banesë nga mjeku i familjes dhe mjeku specialist për ato procedura mjekësore që mund të kryhen në mënyrë ambulatorë dhe në kushte shtëpie. Ministria e Shëndetësisë nxjerr aktet nënligjore përkatëse për këtë qëllim.

Neni 11

(ndryshuar me ligjin nr. 27/2012 datë 15.03.2012)

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

(ndryshuar me ligjin nr. 27/2012 datë 15.03.2012)

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët kanë përfituar statusin, përfitojnë kompensim të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse. Masa, kriteret dhe procedura e përfitimit të këtij kompensimi financiar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Shteti financo veprimtaritë e organizuara nga shoqatat e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim në buxhetin e shtetit.

Neni 14

Shteti merr përsipër të vërë në dispozicion dhe të japë falas mjedise për zhvillimin e veprimtarisë së shoqatës të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 15

Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga të ardhurat që përfitojnë nga shteti, marrin një shtesë në të holla për shkak të paralizës së tyre, në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Kjo shtesë nuk llogaritet në të ardhurat familjare për efekte të nivelit ekonomik. Invalidët kanë të drejtë për një pagesë, po në këtë masë, për kujdestarin e tyre, të zgjedhur sipas procedurave ligjore.

Neni 16

Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe e Shërbimeve Sociale administron mjetet e përshtatura për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Kriteret përcaktohen me rregullore nga Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe e Shërbimeve Sociale.

Personat e sëmurë paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga taksat doganore për mjete, të cilat ndihmojnë në integrimin e tyre në jetë, përfshirë këtu dhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre.

Neni 17

Shteti merr përsipër trajtimin me përparësi me strehim, nëpërmjet kredive të dhëna me kushte lehtësuese për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 18

(shfuqizuar me Ligjin Nr. 27/2012 datë 15.03.2012)

Neni 19

Ministria e Shëndetësisë merr masa që në spitalet e nivelit të dytë dhe të tretë të përshtaten dhe të pajisen një deri dy dhoma për shtrimin eventual të të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 20

Në vende publike (aeroporte, stacione treni, stadione, hotele etj.) krijohen mjedise për lëvizjen, qëndrimin dhe shërbimin për të sëmurët paraplegjikë sipas ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Statusi i invalidit”.

Neni 21

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të neneve 6, 9, 11, 12, 13, 14, 16, 17 dhe 19 të këtij ligji.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2670, datë 04.07.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

VENDIM
Nr.78, datë 14.2.1994

PER ÇMIMET E SHITJES SË KARBURANTEVE PËR INVALIDËT
PARAPLEGJIKE

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Çmimet e shitjes me pakicë të benzinës e të vajit lubrifikant për invalidët paraplegjikë, që përdorin pajisje motorike sipas miratimit të Drejtorisë (degës) së Sigurimeve Shoqërore, caktohen:

-Benzinë(vendi)RON 70-85..... 1.5 lekë /litri

-Vaj SAE..... 22 lekë /kg

-Vaj Aftol..... 16 lekë /kg

2. Sasia vjetore e konsumit të benzinës e të vajit lubrifikant për pajisjet motorike që kanë në përdorim invalidet paraplegjike, caktohet nga Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimeve Shoqërore.

3. Efekti ekonomik deri në 8 milionë lekë për vitin 1994 përballohet nga diferenat e çmimeve për nënproduktet e naftës që korporata e Albpetrolit derdh buxhetin e shtetit mbi bazën e ligjit përkatës “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”.

4. Çdo akt tjetër nënligjor që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 mars 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr. 31, datë 20.1.2001

**PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE
TETRAPLEGJIK**

(Ndryshuar me vendime të KM nr. 302, datë 27.06.2002; nr. 619, datë 07.09.2006; nr. 871, datë 18.06.2008; nr. 1689, datë 17.12.2008; nr. 326, datë 12.03.2009; nr. 1236, datë 16.12.2009; Nr. 604, datë 23.7.2010; nr. 37, datë 19.1.2011)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) në rreth shqyrton të gjitha kërkesat e paraqitura nga personat e bërë paraplegjikë apo tetraplegjikë, për shkaqe që lidhen me punësimin, të cilët përfitojnë nga ligji nr. 8626, datë 22.6.2000.

Komisioni vendos edhe shkallën e invaliditetit, sipas ndarjes që vijon:

I. Grupi i parë, ku përfshihen:

a) të sëmurët tetraplegjikë, që kanë humbur mbi 55 për qind të aftësisë për punë, që nuk kanë mundësi fizike për të vetëshërbyer e që kanë nevojë për kujdestar.

b) të sëmurët paraplegjikë, që kanë humbur mbi 55 për qind të aftësisë për punë, që nuk kanë mundësi fizike për të vetëshërbyer e që kanë nevojë për kujdestar.

II. Grupi i dytë, ku përfshihen të sëmurët paraplegjikë, pjesërisht të aftë për punë të përzgjedhur, që janë në gjendje për të vetëshërbyer.

2. KMCAP-ja i lëshon të interesuarit raportin mjekësor, duke përcaktuar shkallën e paaftësisë dhe nevojën për kujdestar. Invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, duhet të deklarojë para administratorit shtetëror emrin e kujdestarit i cili shënohet në një regjistër të veçantë. Ndërrimi i kujdestarit mund të bëhet sa herë që invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, e sheh të arsyeshme, por është i detyruar të njoftojë menjëherë KMCAP-në.

3. Invalidët, paraplegjikë ose tetraplegjikë, pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi.

4. Masa e përfitimit për invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, është 8 700 (tetë mijë e shtatëqind) lekë në muaj dhe kjo masë indekssohet me indeksin e çmimeve të konsumit, por masa e indeksuar e pagesës të mos jetë më shumë se masa e pensionit minimal në qytet, në shkallë vendi. Kujdestari i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, i caktuar në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi, përfiton një pagesë, në masën 9200 (nëntë mijë e dyqind) lekë në muaj.

Pagesa e aftësisë së kufizuar në masën e përcaktuar në paragrafin e parë të kësaj pike, paguhet nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë njësive të qeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.

4/1. Periudha e shërbimit si kujdestar, për invalidin paraplegjik dhe tetraplegjik, i cili nuk është ekonomikisht aktiv, si dhe nuk përfiton të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë dhe sëmundje profesionale, dhe sigurimi shëndetësor.

Kontributi paguhet në bazë të pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, dhe përballohet nga Buxheti i Shtetit.

4/2. Shërbimi Social Shtetëror, mbështetur në informacionin e dërguar nga njësitë e qeverisjes vendore, harton listat e kujdestarëve përfitues, çdo vit dhe sa herë ndryshon kjo listë, në bazë të të cilave përlllogariten fondet, që nevojiten për pagesën e kontributit për këtë kategori personash. Procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

5. Efektet financiare për këto pagesa të përballohen brenda fondeve të dhëna për vitin 2001, Administratës së Përgjithshme të ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, në zërin "Përfitim paaftësie".

6. Personat që do të fitojnë statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, para datës 30 qershor 2001, do ta përfitojnë këtë pagesë, në zbatim të pikës 4 të këtij vendimi, që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik ose tetraplegjik"

Të gjithë personat e tjerë që do ta fitojnë këtë status pas datës 30 qershor 2001, do ta përfitojnë këtë pagesë një muaj pas daljes në KMCAP.

7. Për çdo shpërdorim, personit përgjegjës i merret dëshmia për një periudhë deri në 3 vjet dhe, sipas rastit, zbatohen edhe dispozitat për kundërvajtjet administrative deri në kallëzim për ndjekje penale.

8. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimet përkatëse, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

UDHËZIM

Nr. 365, datë 21.9.2017

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 31, DATË 20.1.2001, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK", TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të pikës 8, të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 10.330 (dhjetë mijë e treqind e tridhjetë) lekë në muaj.

2. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, bëhet 10.850 (dhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj.

3. Efektet financiare për zbatimin e këtij udhëzimi fillojnë nga 1 shtator i vitit 2017 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2017, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Udhëzimi nr. 19, datë 30.8.2016 i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2017.

MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Ogerta Manastirliu

VENDIM
Nr. 404, datë 20.6.2012

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË KRITEREVE E TË PROCEDURAVE TË PËRFITIMIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR, NGA PERSONAT ME STATUSIN E TË VERBRIT DHE INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK, PËR FATURËN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE FATURËN E TELEFONISË FIKSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të nenit 12 të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në muaj.

2. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në muaj.

3. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar dhe individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të cilët nuk kanë nevojë për kujdestarë, u jepet një kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 1 400 (një mijë e katërqind) lekë në muaj.

4. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, u jepet kompensim për faturën e telefonisë fikse, në masën 1 000 (një mijë) lekë në muaj.

5. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të cilët kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e telefonisë fikse, në masën 1 000 (një mijë) lekë në muaj.

6. Masa e kompensimit llogaritet dhe përfitohet pranë njësisë së qeverisjes vendore ku individ i verbër, paraplegjik dhe tetraplegjik, ka vendbanimin.

7. Përfituesit, objekti i këtij vendimi, përjashtohen nga kompensimi i çmimit të energjisë elektrike, të parashikuar në vendimin nr. 565, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”.

8. Për përfitimin e kompensimit të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse, të përcaktuara sipas pikave 1, 2, 3, 4 e 5 të këtij vendimi, individët duhet të paraqesin pranë administratorëve shoqërorë në njësitë e qeverisjes vendore dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesë për të përfituar kompensim dhe deklaratën sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi;
b) certifikatë familjare, që vërteton se individ është anëtar i familjes, e cila rinovohet çdo fillim viti;

c) kopjen e kontratës me entin shpërndarës të energjisë elektrike;

ç) kopjen e librezës së energjisë elektrike, e cila dorëzohet çdo fillim viti;

d) kopjen e kontratës me entin e shërbimit të telefonisë fikse;

dh) kopjen e librezës së telefonisë fikse, e cila dorëzohet çdo fillim viti.

e) kopje të librezave të paraplegjikut dhe tetraplegjikut apo të verbërisë, të lëshuara nga Shërbimi Social Shtetëror.

9. Njësitë e qeverisjes vendore i shpërndajnë pagesat për kompensimin e faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse nga shërbimet bankare ose “Posta Shqiptare” sh.a.

10. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2012, të përballohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

11. Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të nxjerrë udhëzimin përkatës të këtij vendimi.

12. Vendimi nr. 83, datë 26.2.2001 i Këshillit të Ministrave “Për tarifat telefonike dhe për pagesat elektrike nga personat me aftësi të kufizuara”, i ndryshuar, shfuqizohet.

13. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Qarku _____

Njësia e qeverisjes vendore (bashkia, komuna) _____

DEKLARATË

Për efekt të kompensimit të faturës së energjisë elektrike dhe telefonisë fikse

I nënshkruari _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale
(emri, atësia, mbiemri)

sa më poshtë vijon:

Jam individ, përfitues i statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar/individët, përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, jam banor i bashkisë/komunës _____ me adresë _____, (adresa e plotë).

Kam kontratë me degën e shitjes së energjisë, e cila ka numrin _____
(numri gjendet te fatura ose libreza)

Kam kontratë me degën e shitjes së telefonisë fikse, e cila ka numrin _____
(numri gjendet te fatura ose libreza)

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	K/familjari (lidhja e të verbrit/paraplegjikut dhe tetraplegjikut me të)	Ditëlindja	Përfiton nga skema e kompensimit të energjisë/telefonisë fikse

- Deklaroj se nuk kam detyrime të papaguara ndaj degës së shitjes së energjisë elektrike/telefonisë fikse.

- Deklaroj se të dhënat janë të vërteta dhe në rast se vërtetohet e kundërta, unë do të kthej kompensimin dhe do të mbaj përgjegjësi sipas ligjit.

Deklaruesi shoqëror

_____më____/____/____
(vendi dhe data)

Administratori

LIGJ
Nr. 7889, datë 14.12.1994

PËR STATUSIN E INVALIDEVE TË PUNËS

Ndryshuar me ligjin: nr. 8052, datë 21.12.1995; nr. 9143, datë 16.10.2003)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI:

Neni 1

(Ndryshuar me ligjin nr. 9143, datë 16.10.2003)

Statusin e invalidit e gëzon personi i aksidentuar në punë, i sëmurë nga sëmundje profesionale ose sëmundje të ndryshme, që përfiton pension invaliditeti nga sistemi i sigurimeve shoqërore, sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972 "Për pensionin e ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore", i ndryshuar dhe ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 2

Shoqëria dhe shteti marrin në mbrojtje invalidët, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëloj si të tjerët, t'u sigurohet niveli ekonomik i nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, të kenë kushte banimi, të shfrytëzojnë mjedisin e jashtëm, të kenë një punë të përshtatshme, si dhe t'u krijohen mundësi normale për kurim, arsimim dhe veprimtari çlodhëse e argëtuese.

Neni 3

Shteti mbron invalidët nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes.

Neni 4

(Ndryshuar me ligjin nr. 8052, datë 21.12.1995)

Invalidët pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi. Dëshmia lëshohet nga Shoqata e Invalidëve të Punës, në bazë të KMAC.

Neni 5

Asnjë organ nuk ka të drejtë të japë të dhëna për gjendjen e invaliditetit të një personi pa pëlqimin e tij.

Neni 6

Statusi i invalidit vazhdon edhe pas mbushjes së moshës për pension pleqërie.

Neni 7

(Ndryshuar me ligjin nr. 9143, datë 16.10.2003)

Invalidët e punës, që kane qenë të punësuar në ndërmarrjet, institucionet shtetërore, ish-kooperativat bujqësore, repartet ushtarake, si dhe ushtarët e shërbimit të detyrueshëm, që vuajnë nga sëmundje profesionale, të aksidentuar në punë dhe me sëmundje të ndryshme, që marrin pension invaliditeti, në mbështetje të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972 "Për pensionin e ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore", i ndryshuar dhe ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përfitojnë një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie, nga Buxheti i Shtetit.

Kriteret e marrjes së përfitimit të, paaftësisë dhe masa e tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

(Ndryshuar me ligjin nr. 8052, datë 21.12.1995)

8.1. Instituti i Sigurimeve Shoqërore administron pajisjen e invalidëve me:

- a) mjete lëvizëse, përfshi dhe autovetura dhe pajisje të ndryshme ortopedike;
- b) me mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale;
- c) me mjete ndihmëse kardiake etj.

Kriteret përcaktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

8.2. Invalidët nuk paguajnë taksa doganore për mjetet lëvizëse dhe ndihmëse të përcaktuara në pikat a,b dhe c të pikës 8.1 të nenit 8.

Neni 9

(Ndryshuar me ligjin nr. 8052, datë 21.12.1995)

Në shtëpitë ekzistuese të pushimit shteti në marrëveshje me subjektet që i kanë në pronësi cakton një kontingjent vendesh për pushimin e invalidëve.

Në vendet e përshtatshme klimaterike, shteti cakton sipërfaqe të lira për ndërtimin e kampeve të pushimit dhe qendrave të rehabilitimit për invalidët. Rregullat e financimit për ndërtimin e tyre vendosen me vendim të Këshillit të Ministrave

Neni 10

Për të paralizuarit dhe të gjymtuarit rëndë që nuk lëvizin, organizohet shërbimi mjekësor në banesë falas.

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Neni 11

11.1. Udhëtimi i invalidëve me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat qytetas bëhet falas.

11.2. Udhëtimi me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat ndërqtetas bëhet me 50 për qind të vlerës së biletës.

11.3. Të gjitha mjetet e udhëtimit qytetas dhe ndërqytetas rezervojnë vende të veçanta për invalidët.

Ministria që mbulon transportin dhe komunikacionin nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Neni 12

Hyrja e invalidëve në shfaqje artistike, muze, ndeshje e manifestime sportive bëhet me 50 për qind të çmimit të biletës.

Ministria që mbulon kulturën, rininë e sportet nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Neni 13

13.1. Mjediset e institucioneve shëndetësore, të përkujdesjes shoqërore dhe ato publike përshtaten për përdorimin e tyre nga të verbrit dhe paraplegjikët. Procedura dhe fazat e përshtatjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

13.2. Të gjitha ndërtimet e reja publike që realizohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të ofrojnë mundësi përdorimi nga kategoritë e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara.

Ministria që mbulon ndërtimin, strehimin dhe rregullimin e territorit nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Neni 14

(Ndryshuar me ligjin nr. 8052, datë 21.12.1995)

Dërgimi i statistikave në institucione të tjera financiare, shëndetësore ose studimore, bëhet në bazë të marrëveshjeve të lidhura me këto institucione për shkëmbimin e statistikave ose në mungesë të tyre, në bazë të kërkesës së institucionit të interesuar dhe me miratim të drejtorit të përgjithshëm të Fondit, në përputhje me legjislacionin për bazat e të dhënave shtetërore dhe atij për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 28

Informimi publik

1. Fondi është i detyruar të ndërtojë faqen e tij në internet (*ëbsite*), nëpërmjet së cilës do të publikojë në mënyrë të vazhdueshme informacion në lidhje me aktivitetin e Fondit, lidhur me:

- a) legjislacionin e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore;
- b) aktet e nxjerra nga Fondi;
- c) veprimtarinë e Fondit;
- ç) paketat e përfitimit;
- d) pagesat e drejtpërdrejta dhe tarifa;
- e) regjistrin e dhënësve të shërbimit.

2. Fondi ka të drejtë të përcjellë informacione edhe nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit publik, si dhe të publikojë mjete të tij të informimit, si: revista, broshura, fletëpalosje, reklama etj.

Neni 29

Ruajtja e konfidencialitetit të informacionit

1. I gjithë informacioni i lidhur me shëndetin e një personi të siguruar, i mbledhur dhe i transferuar në Fond, është konfidencial dhe Fondi ka përgjegjësinë për ta administruar informacionin e krijuar në përputhje me rregulloren e Këshillit Administrativ dhe duke respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, të kujdesit shëndetësor dhe legjislacione të tjera përkatëse.

2. Çdo shkelje e informacionit konfidencial nga Fondi dhe punonjësit e tij, mund të ankimohet te drejtori i përgjithshëm, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe në gjykatë.

VIII. DISPOZITA TË POSAÇME

Neni 30

Marrëdhëniet me institucionet publike brenda vendit

1. Fondi kryen detyrat e tij në mënyrë të pavarur nga institucionet publike qendrore apo vendore.

2. Institucionet publike janë të detyruara të japin informacione për Fondin, sipas kërkesës së tij, për të ndihmuar në zbatimin e legjislacionit; në vendosjen e kontrollit mbi pagimin e kontributeve shëndetësore; informimin mbi personat që përfitojnë shërbim shëndetësor pa pagesë; informim për personat që përfitojnë nga sigurimet shoqërore sipas kriterëve të Agjencisë Kombëtare Shqiptare të Informacionit.

Neni 31

Marrëveshjet ndërkombëtare

1. Fondi ka të drejtë të bashkëpunojë me institucione të huaja dhe organizata joqeveritare në fushën e sigurimeve shëndetësore.
2. Fondi ka të drejtë të negociojë, të lidhë marrëveshje bashkëpunimi, me karakter teknik, në fushën e sigurimeve shëndetësore, me institucione të huaja homologe, duke ndjekur procedurat ligjore në fuqi.
3. Fondi ka të drejtë të anëtarësohet në organizma ndërkombëtarë dhe të marrë pjesë në aktivitete dhe veprimtari të përbashkëta ndërkombëtare në fushën e sigurimeve shëndetësore.

Neni 32

Logo

Këshilli Administrativ miraton logon e Fondit dhe mënyrën e përdorimit zyrtar të saj.

Neni 33

Rregullore plotësuese

Të gjitha çështjet që nuk janë përcaktuar në këtë statut do të rregullohen sipas legjislacionit në fuqi.

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 34

Aktet e nxjerra nga Këshilli Administrativ dhe drejtori i përgjithshëm para hyrjes në fuqi të këtij statuti, do të vazhdojnë të zbatohen për aq kohë sa nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Këto akte mund të shfuqizohen vetëm nga organi që i ka nxjerrë.

VENDIM
Nr. 185, datë 2.4.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË REALIZIMIT TË KONTROLLIT
MJEKËSOR BAZË PËR SHTETASIT E MOSHËS 35-70 VJEÇ¹²**

(Ndryshuar me VKM nr.721, datë 12.10.2016)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 12 të ligjit nr.10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kontrolli mjekësor bazë është një program kombëtar që synon depistimin e popullatës për faktorët e rrezikut dhe sëmundjet prevalente me qëllim kujdesin për shëndetin, parandalimin e sëmundjeve dhe komplikacioneve, zbulimin e hershëm të çrregullimeve, mjekimin në fazat e hershme dhe përmirësimin e kulturës shëndetësore.

2. Të gjithë shtetasit e grupmoshës 35-70 vjeç, me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, përfitojnë pa pagesë nga programi kombëtar i kontrollit mjekësor bazë. Identifikimi i shtetasve të grupmoshës 35-70 vjeç me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë realizohet nga të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të regjistrit elektronik, që administrohet nga mjekët e përgjithshëm të qendrave shëndetësore.

3. Paketa e kontrollit mjekësor bazë përfshin këta komponentë:

a) Vlerësim, këshillim, trajtim dhe ndjekje për faktorët e stilit të jetesës:

i) Puna që kryen apo ka kryer;

ii) Ushqyerja;

iii) Konsumimi i duhanit;

iv) Konsumimi i alkoolit;

v) Niveli i stresit dhe depresionit.

b) Matje, vlerësim, këshillim, referim dhe ndjekje e parametrave fiziologjikë:

i) Tensioni arterial;

ii) Pesha trupore;

iii) Aktiviteti i zemrës.

c) Matje, vlerësim, këshillim, trajtim, referim dhe ndjekje e parametrave biokimikë:

i) Formula e gjakut;

ii) Hb, HCT, MCV, MCH, MCHC;

iii) Kolesterol total, HDL kolesterol, LDL kolesterol, trigliceride;

iv) Glicemia;

v) Feçe për gjak okult;

vi) Albuminuria, prania e qelizave, cilindrave, kristaleve në urinë;

vii) urea;

viii) kreatinina.

vii) Bilirubinë totale dhe direkte, transaminaza (SGPT, SGOT).

4. Ministria e Shëndetësisë harton protokollet e realizimit të çdo komponenti të paketës së kontrollit mjekësor bazë dhe udhëzuesin e kriterëve e të lëvizjes së shtetasve në sistemin shëndetësor për përfitim të këtij kontrolli.

5. Ministria e Shëndetësisë miraton institucionet shëndetësore ku do të realizohen pjesë të ndryshme të paketës së kontrollit mjekësor bazë, duke garantuar mbulesën e plotë të grupmoshës

¹² VKM nr.185, datë 2.04.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.43/2014.
VKM nr.721, datë 12.10.2016, është botuar në Fletoren Zyrtare nr.195/2016.

së përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, bazuar në popullsinë e zonës së mbulimit, distancat e infrastrukturës, si dhe disponueshmërinë e shpërndarjen e personelit mjekësor e atij mbështetës.

6. Mjeku i familjes/qendra shëndetësore pranë të cilit janë regjistruar shtetasit që përfitojnë të drejtën për kontroll mjekësor bazë sipas këtij vendimi, njofton shtetasit për kryerjen e këtij kontrolli periodik vjetor, sipas një grafiku të bazuar në muajin e lindjes.

7. Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratën për financimin e shërbimit të kontrollit mjekësor bazë me operatorë të përzgjedhur sipas dispozitave të ligjit nr.125/2013, “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”. Kontrata duhet të rregullojë e të përcaktojë, në mënyrë të hollësishme, formën e dhënies së këtij shërbimi dhe mënyrën e pagesës së tij.

8. Informacioni i gjeneruar nga programi i kontrollit mjekësor bazë, bazuar në formularin përkatës, i cili miratohet me urdhër të ministrit të Shëndetësisë, përbën Regjistrin Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë, të vendosur në Institutin e Shëndetit Publik. Mënyra e grumbullimit, përpunimit, analizës dhe diseminimit, si dhe aksesit në të dhënat e Regjistrit të Kontrollit Mjekësor Bazë përcaktohen me udhëzim të ministrit të Shëndetësisë.

9. Programi i kontrollit mjekësor bazë fillon të zbatohet brenda vitit 2014.

10. Ministria e Shëndetësisë përcakton mesazhin, mjetet e identifikimit, planin, kanalet e komunikimit, shtrirjen dhe kohëzgjatjen e fushatës së informimit dhe komunikimit për pjesëmarrjen e popullatës në programin e kontrollit mjekësor bazë.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Fondin e Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor.

12. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 307, datë 21.5.2014

PËR REGJISTRIMIN DHE IDENTIFIKIMIN E PERSONAVE TË SIGURUAR
NGA SIGURIMI I DETYRUESHËM SHËNDETËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 27, pikat 5 e 6, dhe 41, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të siguruar në skemën e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor quhen personat ekonomikisht aktivë, me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, që paguajnë kontributin e detyrueshëm të sigurimit shëndetësor, personat ekonomikisht joaktivë, pagesa e kontributeve të të cilëve financohet nga buxheti i shtetit ose burime të tjera, të përcaktuara me ligj, si dhe personat e siguruar në mënyrë vullnetare.

2. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor krijon regjistrin e të siguruarve, në të cilin regjistron të gjithë personat e siguruar në sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, sipas kategorive përkatëse, me qëllim që të evidentohen, në mënyrë të saktë, të gjithë personat e siguruar në

mënyrë të detyrueshme dhe veçoritë e sigurimit të tyre (masa e kontributit, kohëzgjatja e sigurimit etj.).

3. Regjistrimi i të siguruarve bëhet duke u mbështetur në të dhënat e ofruara nga institucionet përgjegjëse, bazuar në numrin e përgjithshëm, si dhe në identitetin e personave që bëjnë pjesë në grupet e veçanta.

4. Institucionet përgjegjëse për dhënien e informacionit, sipas kategorive të të siguruarve, janë si më poshtë:

a) Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për dhënien e informacionit për kategorinë e shtetasve të huaj azilkërkues në Republikën e Shqipërisë;

b) Ministria e Arsimit dhe Sportit është përgjegjëse për dhënien e informacionit për kategoritë e nxënësve dhe të studentëve të moshës 18 deri në 25 vjeç, të regjistruar në sistemin arsimor parauniversitar apo të lartë;

c) Instituti i Sigurimeve Shoqërore është përgjegjës për dhënien e informacionit për kategorinë e personave që përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore, si dhe për kategorinë e personave të vetëpunësuar në fshat;

ç) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është përgjegjëse për dhënien e informacionit të përditësuar për kategoritë e të punësuarve, të punëdhënësve, të vetëpunësuarve në qytet dhe anëtarëve të papaguar të familjes së tyre, si dhe për kategorinë e personave me të ardhura të rregullta, nga prona ose burime të tjera të krahaseshme;

d) Shërbimi Social Shtetëror është përgjegjës për dhënien e informacionit për kategorinë e personave që përfitojnë ndihmë ekonomike, të personave që përfitojnë pagesën për aftësinë e kufizuar, të verbrit dhe jetimët;

dh) Shërbimi Kombëtar i Punësimit është përgjegjës për dhënien e informacionit për kategorinë e personave të regjistruar si të papunë - punëkërkues;

e) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është përgjegjëse për dhënien e informacionit për kategorinë e fëmijëve nën moshën 18 vjeç, si dhe për rastet e lindjeve e të vdekjeve;

ë) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i vë në dispozicion Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor përbërësit e gjendjes civile (ku përfshihet dhe numri personal) nëpërmjet Regjistratit Kombëtar të Gjendjes Civile;

f) Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve që kërkojnë të hyjnë dhe të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë, është përgjegjës për dhënien e informacionit për të huajt e pajisur me leje qëndrimi.

5. Qendrat shëndetësore janë përgjegjëse për regjistrimin e të dhënave të popullsisë së regjistruar pranë mjekëve të familjes.

6. Të dhënat nga institucionet përgjegjëse, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij vendimi, i jepen Fondit në mënyrë elektronike jo më pak se 2 (dy) herë në vit, brenda muajit janar dhe qershor të çdo viti. Fondi lidh marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave me institucionet e mësipërme, në të cilën parashikohen afatet konkrete të kalimit të të dhënave, modalitetet dhe detajimin e informacionit të kërkuar për nevojat e Fondit.

7. Marrja e të dhënave, përpunimi dhe ruajtja e tyre bëhen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimeve të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

8. Identifikimi i personave të siguruar në skemën e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor bëhet me anë të kartës së shëndetit.

9. Karta e shëndetit është dokumenti që vërteton se mbajtësi i saj është person i siguruar, sipas ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

10. Karta e shëndetit është personale dhe e patjetërsueshme. Ajo përmban numrin e identitetit të personit, i cili është edhe numri i sigurimit shëndetësor të detyruar. Për të huajt, si numër i sigurimit shëndetësor të detyruar do të shërbejë numri i lejes së qëndrimit ose i lejes provizore të qëndrimit.

11. Forma, përmbajtja, mënyra e përdorimit të kartës së shëndetit, si dhe modalitetet e zëvendësimit të librezës së shëndetit, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

12. Vendimi nr. 86, datë 13.2.2003, i Këshillit të Ministrave, “Për librezën e shëndetit”, shfuqizohet.

13. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Shërbimi Social Shtetëror, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 308, datë 21.5.2014

PËR MIRATIMIN E PAKETAVE TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË SHËRBIMIN SPITALOR¹³

(Ndryshuar me VKM nr.373, datë 26.4.2017)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore dhe çmimet përkatëse që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, si më poshtë vijon:

- a) Paketa e shërbimit të dializës, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) Paketa e shërbimeve të kardiologjisë, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi;
- c) Paketa e shërbimeve të kardiokirurgjisë, sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi;
- ç) Paketa e shërbimit të transplantit të veshkës, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi;
- d) Paketa e shërbimit të implantit koklear, sipas shtojcës nr. 5, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financohet paketat e mësipërme në institucione shëndetësore publike, në përputhje me kapacitetet e tyre për ofrimin e shërbimeve të paketave. Për rastet që janë përtej kapaciteteve mjekësore të institucioneve shëndetësore publike, Fondi lidh kontrata dhe financohet shërbimet e paketave në institucione shëndetësore private.

3. Kontraktimi me institucionet publike dhe private për financimin e shërbimeve shëndetësore të paketave të mësipërme bëhet në përputhje me legjislacionin e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.

4. Çmimi i paketave të shërbimeve shëndetësore financohet nga Fondi në masë të njëjtë, si në institucionet shëndetësore publike, ashtu dhe në ato private. Personat e siguruar që përfitojnë nga këto paketa janë të përjashtuar nga bashkëpagesa.

5. Paketat e shërbimeve zbatohen në bazë të protokolleve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

¹³ VKM nr.308, datë 21.5.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.80/2014, 4 qershor.
VKM nr.373, datë 26.4.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.100/2017, 9 maj.

6. *Fondi administron Regjistrin Kombëtar të Paketave të shërbimeve shëndetësore. Rregullat, kriteret dhe mënyra e organizimit të Regjistrit Kombëtar të Paketave, të financuara nga Fondi, hartohen nga ky i fundit dhe miratohen nga Këshilli Administrativ i tij.*

7. Fondi ngre strukturat për auditimin dhe monitorimin e ofrimit të paketave të shërbimeve nga institucionet shëndetësore publike dhe private të kontraktuara.

8. Çmimet e paketave të shërbimeve shëndetësore rishikohen çdo vit nga një komision i rishikimit të çmimeve të paketave, i cili caktohet nga Këshilli Administrativ i Fondit, me pjesëmarrës nga shërbimet shëndetësore publike, përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Fondit. Ndryshimi i çmimeve bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. *Për të gjitha institucionet shëndetësore publike, përdorimi i marzhit të fitimit, i përcaktuar sipas shtojcave përkatëse, do të bëhet me vendim të posaçëm të Këshillit Administrativ të Fondit.*

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për programin e financimit spitalor.

11. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PAKETAVE TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË
DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
(Ndryshuar me VKM nr.373, datë 26.4.2017)

Shtojca nr. 1

Paketa e shërbimit të dializës		kosto në lekë	marzhi i fitimit në përqindje	çmimi në lekë
1.	Seanca e dializës <i>Në këtë paketë përfshihen:</i> - Ekzaminimet e nevojshme biokimike klinike dhe mikrobiologjike. - Kryerja e procedurës.	11,530.00	5%	12,106.00
2.	Kryerja e interventin për vendosjen e fistulës	10,127.00	8%	10,937.00
3.	Kryerja e interventin për vendosjen e grafitit - Në këtë paketë përfshihen interventi dhe grafiti me përbërje të thjeshtë.	62,187.00	8%	67,162.00

Shtojca nr. 2

Paketa e shërbimeve të kardiologjisë		kosto në lekë	marzhi i fitimit në përqindje	çmimi në lekë
1.	Angiografi koronare - Në këtë paketë përfshihen: procedura dhe një ditë qëndrimi në pavion (duke përfshirë edhe ekzaminimet).	58,067.83	8%	62,713.26
2.	Angioplastikë koronare (PTCA + stent) - Në këtë paketë përfshihen: procedura, një ditë qëndrimi në terapinë intensive si dhe një ditë qëndrimi në pavion (duke përfshirë edhe ekzaminimet).	137,415.00	8%	148,408.01
3.	Angiografi koronare + Angioplastikë koronare (PTCA + stent) - Në këtë paketë përfshihen procedura: një ditë qëndrimi në terapinë intensive si dhe një ditë qëndrimi në pavion (duke përfshirë edhe ekzaminimet).	147,346.00	8%	159,133.68
4.	Pacemaker definitiv - Në këtë paketë përfshihen procedura, një ditë qëndrimi në terapinë intensive si	138,404.53	8%	149,476.89

4/1	dhe një ditë qëndrimi në pavion (duke përfshirë edhe ekzaminimet). Procedura e vendosjes së aparatit	61,229.53	8%	66,127.89
4/2	Vlera e pacemakerit 73.500 lekë.			73,500.00

Shtojca 3

Paketa e shërbimeve të kardiokirurgjisë:		kosto në lekë	marzhi i fitimit në përqindje	çmimi në lekë
1.	By-Pass aorto koronar	521,735.74	8%	563,474.60
1/1	By-Pass+plastike e valvules	603,362.74	8%	651,631.76
1/2	By-Pass+zevendësim me valvul mekanike	595,392.24	8%	643,023.62
1/3	By-Pass+zevendësim me valvul biologjike	614,445.26	8%	663,600.88
1/4	By-Pass+zevendësim me valvul mekanike: 1 valvul aortale+1 valvul mitrale	712,530.24	8%	769,532.66
-	Në këto paketa përfshihen një ditë qëndrimi pre operator, ndërhyrja, dy ditë qëndrimi në terapinë intensive si dhe pesë ditë qëndrimi në pavion (duke përfshirë edhe ekzaminimet).			
2.	Valvolar			
2/1	Mono valvular me proteze mekanike	593,845.99	8%	641,353.67
2/2	Mono valvular me proteze biologjike	619,638.19	8%	669,209.25
2/3	BI valvular me proteze mekanike	697,771.95	8%	753,593.71
2/4	BI valvular me proteze biologjike	735,231.93	8%	794,050.48

-	Në këto paketa përfshihen një ditë qëndrimi pre operator, ndërhyrja, dy ditë qëndrimi në terapinë intensive si dhe pesë ditë qëndrimi në pavion (duke përfshirë edhe ekzaminimet).			
3.	Congenital Në këtë paketë përfshihen një ditë qëndrimi pre operator, ndërhyrja, dy ditë qëndrimi në terapinë intensive në shërbimin e Kardiokirurgjisë, dy ditë qëndrimi në terapinë intensive në shërbimin e Pediatriisë si dhe pesë ditë qëndrimi në pavion (duke përfshirë edhe ekzaminimet).	397,002.75	8%	428,762.97

Shtojca nr. 4

Paketa e shërbimit të transplantit të veshkës (me dhurues të gjallë)		kosto në lekë	marzhi i fitimit në përqindje	çmimi në lekë
1.	Paketa e shërbimit të transplantit të veshkës është 1,109,719 lekë me marzh fitimi 8 % 1,198,496 lekë. Në këtë paketë përfshihen:	1,109,719.00	8%	1,198,496.00
-	Ekzaminimet para transplantit për marrësin e dhuruesin:			
-	- klinikë biokimike;			
-	- imunologjike;			
-	- markuesit tumoralë;			
-	- imazheri virologjike;			
-	Konsultat;			
-	operacioni dhe ndjekja;			
-	ekzaminimet pas transplantit për marrësin e dhuruesin;			
-	terapia e induksionit;			
-	imunosupresoret (dozimi në gjak).			
1/1	Terapia e flakjes akute	459,553.00	8%	496,317.00

Shtojca nr.5

Paketa e shërbimit të implantit koklear:		kosto në lekë	marzhi i fitimit në përqindje	çmimi në lekë
-	interventi kirurgjikal	192,425.00	8%	207,819.00
-	aparati			2,704,600.00
	-totali			2,912,419.00
Në këtë paketë përfshihen: ndërhyrja dhe aparatura e implantit koklear sipas standardeve të BE-së				

Fondi të bëjë rakordimet me spitalet publike për zbritjen e pjesës së kostove që paguhen në kontratat koncensionare

VENDIM
Nr. 955, datë 29.12.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE TË SIGURUAR QË
PËRJASHTOHEN NGA PAGESAT E DREJTPËRDREJTA TË SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE¹⁴**

(Ndryshuar me VKM nr.946, datë 28.12.2016)

(I perditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pika 2, dhe 41, të ligjit nr. 10 383, datë 24.11.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfshirjen nga pagesat e drejtpërdrejta për shërbimet shëndetësore, që janë pjesë e listës së barnave të rimbursueshme, të paketave të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor dhe të kujdesit spitalor që mbulohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, në masën e përcaktuar, për kategoritë e mëposhtme:

- a) Fëmijët 0 - 18 vjeç;
- b) Invalidët e plotë, përfshirë edhe invalidët paraplegjikë, tetraplegjikë dhe të verbrit e plotë;
- c) Invalidët e luftës;
- ç) Veteranët;
- d) Personat që gëzojnë statusin e ish- të dënuarve dhe të përndjekurve politikë;
- dh) Jetimët.

e) *Personat që përfitojnë pagesën për aftësinë e kufizuar.*

2. Përfshirjen nga pagesat e drejtpërdrejta, për alternativat e para të barnave të listës së barnave të rimbursueshme, për kategoritë e mëposhtme:

- a) Pensionistët;
- b) Personat e paraburgosur dhe të dënuarit me burgim;
- c) Azilkërkuesit;
- ç) Viktimat e trafikimit.

3. *Përfshirjen nga pagesat e drejtpërdrejta për alternativat e para të barnave të listës së barnave të rimbursueshme për personat që nuk bëjnë pjesë në kategoritë e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, për trajtimin e sëmundjeve kronike, sipas listës së miratuar me urdhër të ministrit të Shëndetësisë.*

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹⁴ VKM nr.955, datë 29.12.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.214/2014
VKM nr.946, datë 28.12.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.264/2016.

VENDIM
Nr. 18, datë 11.1.2017

**PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA
SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR
VITIN 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 130/2016, datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore të paketës së shërbimeve të ofruara në spitalet publike, sipas listës së shërbimeve, të dhënë në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Spitali është person juridik, publik, me buxhet të pavarur, me cilësinë e autoritetit kontraktor, i cili organizohet, administrohet dhe vepron sipas ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Spitali e ushtron veprimtarinë në përputhje me standardet, treguesit e cilësisë e të performancës, protokollet e diagnozës e të trajtimit, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

4. Buxheti për mbulimin e paketës së shërbimeve spitalore, sipas listës së shërbimeve që ofron çdo spital, ndahet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratat me spitalet për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore, të ofruara prej tyre.

6. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon paketën e shërbimeve spitalore të kontraktuara me metodat e mëposhtme:

a) buxhetim me zëra shpenzimesh, për:

i) paga dhe shpenzime të tjera lidhur me pagën e personelit;

ii) kontribute për sigurime shëndetësore e shoqërore të personelit;

iii) mallra e shërbime të tjera;

b) buxhetim global për pagesën e paketave të shërbimeve me çmime të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Buxheti global detajohet për çdo spital në zëra shpenzimesh me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

7. Spitali është përgjegjës për zbatimin e buxhetit të kontraktuar, sipas zërave të përcaktuar në buxhet.

8. Rishpërndarja e buxhetit midis spitaleve bëhet brenda një kufiri prej 3% të buxhetit të spitaleve, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

9. Një fond jo më i madh se 25 për qind e buxhetit vjetor, i planifikuar për shërbimet spitalore, mbahet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për ta shpërndarë gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për:

a) financimin e shërbimit spitalor gjatë vitit;

b) pagesat e paketave të shërbimeve të veçanta, të ofruara nga shërbimet spitalore, publike e jopublike, brenda e jashtë vendit, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) pagesat për kujdes shëndetësor në institucione jopublike, brenda e jashtë vendit, sipas miratimit, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) pagesat për kujdes shëndetësor, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;

d) pagesa për referime të pacientëve në Spitalin Universitar të Traumës, në zbatim të sistemit të referimit, sipas tarifave të miratuara nga ministri i Shëndetësisë;

dh) pagesa të shërbimeve të kryera për llogari të spitaleve publike nga operatorë të kontraktuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas legjislacionit për partneritetin publik privat.

10. Shpenzimet kapitale për investimet në spitale mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë. Spitalet mund të kryejnë investime, me miratimin e ministrit të Shëndetësisë, edhe nga burime të tjera.

11. Burime të tjera financimi për spitalet janë fondet e krijuara nga përfitimet e realizuara gjatë veprimtarisë së tyre dhe nga dhurimet. Përdorimi i tyre bëhet totalisht nga vetë spitali, si pjesë e kostos së shërbimit, me miratim të Ministrisë së Shëndetësisë. Këto përfitime vlerësohen si përfitime jashtë limitit.

12. Ministria e Shëndetësisë, për raste të vlerësuara nga ajo ose me kërkesë të autoriteteve kontraktuese (spitaleve), mund të zhvillojë procedura të përqendruara prokurimi për disa mallra, shërbime e investime.

13. Spitali zbaton sistemin e referimit dhe tarifat për shërbimet me pagesë, të miratuara nga ministri i Shëndetësisë.

14. Mënyra e pagesës dhe e shpërblimit të punës së punonjësve të spitaleve, që kanë lidhur kontratë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, sipas këtij vendimi, përcaktohet me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

15. Ministria e Shëndetësisë auditon spitalin, nëpërmjet strukturës së saj audituese, për zbatimin e standardeve të miratuara prej saj dhe për mënyrën e përdorimit të buxhetit total të spitalit.

16. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor kontrollon dhe monitoron spitalin për buxhetin dhe aktivitetin vjetor sipas kushteve të përcaktuara në kontratën dypalëshe.

17. Marrëdhëniet juridike të punës në spitale rregullohen në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

18. Numri i përgjithshëm i punonjësve të spitaleve është 12 016 veta, nga të cilët 141 punonjës në Spitalin Universitar të Traumës për Shërbimin e Urgjencës Ambulatore dhe Shërbimin e Ortopedi-Traumatologjisë. Numri dhe struktura e punonjësve për çdo spital miratohet nga ministri i Shëndetësisë.

19. Për raste të veçanta të mungesës së mjekut specialist në shërbime të ndryshme të spitaleve rajonale e bashkiake, ministri i Shëndetësisë, brenda numrit të përgjithshëm të personelit spitalor, urdhëron kontraktimin, për një periudhë të caktuar, të mjekëve specialistë, sipas nevojave. Këta mjekë të specialiteteve të ndryshme, përveç pagës, trajtohen financiarisht me një bonus në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj. Ky bonus, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, trajtohet sipas shkronjës “e”, të pikës 2, të kreut II, të vendimit nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar.

20. Mjekët e kontraktuar sipas pikës 19, të këtij vendimi, nuk e përfitojnë shpërblimin sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 9/1, të vendimit nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar.

21. Numri i pedagogëve me kontratë shërbimi për spitalet universitare miratohet nga ministri i Shëndetësisë. Pagesa e tyre bëhet nga buxheti i spitalit.

22. Financimi i institucioneve dhe i shërbimeve, të përcaktuara në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, vetëm kundrejt shtesave përkatëse në buxhet, nga Ministria e Shëndetësisë.

23. Vendimi nr. 33, datë 20.1.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2016”, i ndryshuar, shfuqizohet.

24. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
LISTA E SHËRBIMEVE SPITALORE QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

I. SPITALET UNIVERSITARE

1. Shërbimi i kardiologjisë:
 - a) Hemodinamika;
 - b) Reanimacioni i kardiologjisë.
2. Shërbimi i kardiokirurgjisë;
3. Shërbimi i kirurgjisë angiovaskulare;
4. Shërbimi i hematologjisë;
5. Shërbimi i gastrohepatologjisë;
6. Shërbimi i endokrinologjisë;
7. Shërbimi i nefrologjisë dhe hemodializës;
8. Shërbimi i anestezisë-reanimacionit;
9. Shërbimi i urgjencës së sëmundjeve të brendshme;
10. Shërbimi i mjekësisë interne;
11. Shërbimi i alergologjisë;
12. Shërbimi i reumatologjisë;
13. Shërbimi i dermatologjisë;
14. Shërbimi i traumatologjisë;
15. Shërbimi i ortopedisë (SU “Trauma”);
16. Shërbimi i okulistikës;
17. Shërbimi i ORL-së;
18. Shërbimi i kirurgjisë maksilo-faciale;
19. Shërbimi i kirurgjisë së përgjithshme;
20. Shërbimi i urgjencës kirurgjikale;
21. Shërbimi i kirurgjisë digjestive;
22. Shërbimi i urologjisë;
23. Shërbimi i djegie-plastikës;
24. Shërbimi i neurologjisë dhe neurofizio-logjisë;
25. Shërbimi i neurokirurgjisë;
26. Shërbimi i onkologjisë+kirurgjia onkolo-gjike:
 - a) Statistika onkologjike (regjistri i kancerit);
 - b) Laboratori histopatologjik onkologjik;
 - c) Laboratori klinik-biokimik onkologjik;
27. Shërbimi i rrezatim-kobaltit;
28. Shërbimi infektiv;
29. Shërbimi i pediatriisë së përgjithshme:
 - a) Urgjenca pediatrike;
 - b) Fizioterapia pediatrike;
30. Shërbimi i pediatriisë së specialiteteve;
31. Shërbimi i pediatriisë infektive;
32. Shërbimi i kirurgjisë infatle;
33. Shërbimi i onkohematologjisë pediatrike;
34. Shërbimi i reanimacionit pediatrik;
35. Shërbimi i laboratorëve (klinikë-biokimikë, mikrobiologjikë, imunologjikë, atomopatologjikë, gjenetikë mjekësore, laborator i mjekësisë nukleare);
36. Shërbimi i imazherisë;
37. Shërbimi i fizioterapisë;
38. Shërbimi i statistikave;

39. Shërbimi i pneumologjisë;
40. Kirurgjisë torakale;
41. Shërbimi i fiziatrisë;
42. Shërbimi i gjinekologjisë;
43. Shërbimi i obstetrikës;
44. Shërbimi i patologjisë së barrës;
45. Shërbimi i neonatologjisë;
46. Shërbimi i farmacisë;
47. Shërbimi i konsultave të specializuara ambulatorë;
48. Shërbimi i toksikologjisë;
49. Shërbimi i koordinimit të urgjencave;
50. Shërbimi i psikiatrisë (QSUT);
51. Kontrolli i infeksioneve spitalore.
52. Shërbimi për ekzaminimet e shtrenjta të referuara në zbatim të sistemit të referimit, shërbimi i ortopedisë (protezat) dhe një pjesë e shërbimit të urgjencës (SU Trauma).

II. SPITALET NË NIVEL QARKU (SPITALET RAJONALE)

Spitalet publike të qarkut ofrojnë shërbimet e:

1. urgjencës;
2. mjekësisë së përgjithshme;
3. kirurgjisë së përgjithshme, ortopedi-traumatologji, urologji, ORL, okulistikë angiologji, max-facial;
4. obstetrikë-gjinekologjisë;
5. neonatologji;
6. pediatriisë;
7. radiologjisë;
8. fizioterapisë;
9. anatomisë dhe histologjisë patologjike;
10. laboratorëve kliniko-biokimike e të mikrobiologjisë;
11. anestezi-reanimacionit;
12. farmacia;
13. shërbimin e onkologjisë, kimioterapisë*, kujdesin paljativ;
14. kontrolli i infeksioneve spitalore;
15. shërbime psikosocial;
16. këshillimit ambulator, për të gjitha specialitetet e mësipërme;
17. banka e gjakut.

III. SPITALET NË NIVEL BASHKIE

Spitalet publike të përgjithshme në nivel bashkie ofrojnë shërbimet e:

1. urgjencës;
2. mjekësisë së përgjithshme;
3. kirurgjisë së përgjithshme;
4. pediatriisë dhe obstetrikë-gjinekologjisë, neonatologji;
5. radiologjisë;
6. laboratorëve kliniko-biokimike e të mikrobio-logjisë;
7. anestezi-reanimacionit;
8. farmacisë;
9. shërbimin ambulator të specializuar;
10. banka e gjakut.

Trajtimi i kimioterapisë do të jetë në pesë spitale: Durrës, Vlorë, Shkodër, Korçë, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”

IV. SPITALET DITORE

1. Ndihmë e parë mjekësore për trajtim dhe kurim brenda 24 orëve.

BUXHETI I SHËRBIMIT SPITALOR 2017

000 lekë

Nr	INSTITUCIONI	buxheti						Totali
		600	601	602	604	606	rezerve	
1	BERAT	215,200	35,920	164,900				416,020
2	BULQIZË	57,450	9,600	25,950				93,000
3	DELVINË	26,000	4,320	5,850				36,170
4	DEVOLL	36,900	6,150	10,750				53,800
5	DIBËR	201,200	33,600	120,600				355,400
6	ELBASAN	325,500	52,900	259,850				638,250
7	FIER	296,900	49,550	189,550				536,000
8	GRAMSH	90,200	15,050	36,850				142,100
9	GIROKASTËR	152,600	24,320	88,850				265,770
10	HAS	32,930	5,500	12,700				51,130
11	KAVAJË	92,400	15,410	33,550				141,360
12	KOLONJË	68,350	11,400	21,450				101,200
13	KORÇË	319,200	53,300	193,300				565,800
14	KRUJË	84,650	14,120	25,350				124,120
15	KUÇOVË	48,500	8,100	15,600				72,200
16	KUKËS	195,900	32,700	130,200				358,800
17	KURBIN	64,900	10,820	29,250				104,970
18	LEZHË	187,700	31,320	114,700				333,720
19	LIBRAZHD	109,100	18,200	50,700				178,000
20	LUSHNË	163,100	27,220	104,300				294,620
21	MALËSI E MADHE	15,350	2,550	6,350				24,250
22	MALLAKASTËR	30,150	5,000	11,250				46,400
23	MAT	94,200	15,700	46,350				156,250
24	MIRDITË	76,800	12,800	31,900				121,500
25	PEQIN	25,750	4,300	5,850				35,900
26	PËRMET	65,350	10,900	27,300				103,550
27	POGRADEC	131,550	21,950	74,750				228,250
28	PUKË	70,250	11,700	34,700				116,650
29	SARANË	113,500	19,000	67,400				199,900
30	SKRAPAR	66,800	11,150	19,000				96,950
31	SHKODËR	401,500	66,700	207,200				675,400
32	TEPELENË	66,250	11,050	19,950				97,250
33	QSUT	1,643,500	274,400	3,329,955				5,247,855
34	SUOGJ "MBRETËRËSHA GERALDINË"	255,000	42,800	273,750				571,550
35	SUOGJ "KOÇO GLIOZHENI"	189,200	31,600	176,250				397,050
36	SU "SHEFQET NDROQI"	251,000	41,000	319,300				611,300
37	TROPOJË	81,000	13,520	33,550				128,070
38	VLORE	320,000	53,750	281,500				655,250
39	SU TRAUMA	68,000	11,300	123,145				202,445
	Paketat e shërbimeve				2,252,118			2,252,118
	Trajtime me VKM				50,000			50,000
	Transferta për individët (mjekë specialistë)					15,000		15,000
	Pagesa të shërbimeve PPP				1,273,277			1,273,277
	Rezerve						724,405	724,405
	TOTALI	6,733,830	1,120,670	6,723,700	3,575,395	15,000	724,405	18,893,000

SHTOJCA NR. 3
LISTA E INSTITUCIONEVE QË NUK DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

1. Spitali psikiatrik Vlorë;
2. Spitali psikiatrik Elbasan;
3. Shërbimet e shëndetit mendor në rrethe;
4. Shërbimi i psikiatrisë Shkodër;
5. Qendra Kombëtare e Riaftësimit, Mirërritjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve;
6. Shërbimi Kombëtar i Transfuzionit;
7. Qendra Kombëtare Biomjekësore.

VENDIM
Nr. 21, datë 18.1.2017

**PËR SIGURIMIN SHËNDETËSOR TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE TË DISA
STRUKTURAVE TË POLICISË SË SHETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 68, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e strukturave të veçanta të Policisë së Shtetit, në funksion të përmbushjes së detyrës së tyre, përfitojnë sigurim shëndetësor të veçantë për shërbime shëndetësore, të cilat nuk janë pjesë të paketave të shërbimit shëndetësor, që ofrohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

2. Kategoritë e punonjësve të Policisë së Shtetit, që përfitojnë sigurimin shëndetësor të veçantë, janë si më poshtë:

- a) forcat speciale;
- b) forcat operacionale të ndërhyrjes së shpejtë;
- c) forcat e posaçme operacionale;
- ç) punonjësit e policisë që shërbejnë si oficerë kontakti, pranë ministrive homologe të shteteve të huaja, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë.

3. Punonjësit e policisë, të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, përfitojnë nga siguri shëndetësor i veçantë, shërbim shëndetësor:

- a) për kontrollin parandalues;
- b) diagnostikues;
- c) kurues.

4. Policia e Shtetit, për shërbimet shëndetësore, të cilat nuk janë pjesë e paketave të shërbimit shëndetësor, që ofrohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, lidh kontratë me shoqërinë e sigurimit, të përzgjedhur sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

5. Policia e Shtetit, me qëllim ofrimin e shërbimit shëndetësor të veçantë, kryen procedurat si më poshtë vijon:

- a) brenda muajit korrik të çdo viti, parashikon fondet buxhetore, duke përllogaritur një prim sigurimi jo më shumë se 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë për çdo punonjës që do të sigurohet;
- b) brenda muajit dhjetor të çdo viti, harton listën e punonjësve përfitues, sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij vendimi;
- c) përzgjedh shoqërinë e sigurimit sipas rregullave të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik;

ç) njësitë buxhetore i dërgojnë shoqërisë së sigurimit, brenda dy ditëve, çdo ndryshim që ndodh në listën emërore të përfituesve.

6. Fondi i përcaktuar për këtë qëllim, planifikohet për çdo vit në programin buxhetor të Policisë së Shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 138, datë 22.2.2017

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE “REGJISTRI
ELEKTRONIK SHËNDETËSOR KOMBËTAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për Ministrinë e Shëndetësisë, “Regjistri Elektronik Shëndetësor Kombëtar”.

2. Regjistri Elektronik Shëndetësor Kombëtar mban të dhëna për dokumentet mjekësore elektronike të shtetasve që kanë marrë shërbim shëndetësor në institucionet e kujdesit shëndetësor. Institucioni administrues i Regjistrit Elektronik Shëndetësor Kombëtar është Ministria e Shëndetësisë.

3. “Dokument mjekësor elektronik” janë të gjitha dokumentet që krijohen nga profesionistët e shëndetit, nga përdorimi i sistemeve të shëndetësisë elektronike.

4. Vlefshmëria e dokumentit mjekësor elektronik realizohet nëpërmjet nënshkrimit elektronik nga profesionistët e shëndetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për nënshkrimin elektronik.

5. Të dhënat parësore dhe dytësore të Regjistrit Elektronik Shëndetësor Kombëtar janë, si më poshtë vijon:

a) Të dhënat parësore:

i) të dhëna për referimet, ekzaminimet dhe trajtimet e shtetasit;

ii) miratimi (ose refuzimi) i shtetasit për shkëmbim të dokumenteve mjekësore elektronike ndërmjet institucioneve të kujdesit shëndetësor.

b) Të dhënat dytësore, që shkëmbehen me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (DPGjC), janë:

i) Parametrat hyrës:

- NID-i i shtetasit.

ii) Parametrat dalës:

- Emri;

- Mbiemri;

- Emri i babait;

- Adresa;

- Gjinia;

- Vendlindja;

- Datëlindja;

- Lidhja me kryefamiljarin;
- Bashkia;
- Nr. i ID-së të dokumentit.

6. Dhënësi/dhënësit e informacionit për Regjistrin Elektronik Shëndetësor Kombëtar janë:

- a) shtetasit;
- b) institucionet e ofrimit të kujdesit shëndetësor, të krijuara ose licencuara sipas legjislacionit në fuqi;
- c) Ministria e Shëndetësisë;
- ç) Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
- d) Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;
- dh) Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore;
- e) Qendra Kombëtare Teknike Biomjekësore;
- ë) urdhrat e profesionistëve të shëndetësisë.

7. Bazat e të dhënave me të cilat ndërvepron Regjistri Elektronik Shëndetësor Kombëtar janë Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (DPGjC) dhe database-t e tjera shtetërore, të cilat, në aktin e krijimit të tyre, parashikojnë ndërveprimin me Regjistrin Elektronik Shëndetësor Kombëtar.

8. Subjektet e interesuara për përdorimin e Regjistrit Elektronik Shëndetësor Kombëtar, janë:

a) shtetasit, të cilët aksesojnë të dhënat mjekësore nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania.al*. Shtetasit mund të ndryshojnë miratimin për shkëmbimin e dokumenteve mjekësore elektronike ndërmjet institucioneve të ofrimit të kujdesit shëndetësor edhe në portalin qeveritar *e-Albania.al*;

b) institucionet e ofrimit të kujdesit shëndetësor, të krijuara ose të licencuara sipas legjislacionit në fuqi, punonjësit e të cilëve kryejnë regjistrimin e shtetasve në sistem dhe krijojnë dokumentet mjekësore elektronike të tij;

c) Ministria e Shëndetësisë, që ka përgjegjësinë dhe rolin e administratorit të Regjistrit Elektronik Shëndetësor Kombëtar dhe e përdor për gjenerimin e raporteve statistikore;

ç) Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për gjenerimin e raporteve statistikore;

d) Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, për gjenerimin e raporteve statistikore;

dh) Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore, për gjenerimin e raporteve statistikore;

e) Instituti i Shëndetit Publik, për gjenerimin e raporteve statistikore;

ë) Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim, për gjenerimin e raporteve statistikore;

f) Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore, për gjenerimin e raporteve statistikore;

g) Qendra Kombëtare Teknike Biomjekësore, për gjenerimin e raporteve statistikore.

9. Niveli i aksesimit për subjektet e interesuara

a) Shtetasit, nëpërmjet portalit *e-Albania.al*, shohin dokumentet e tyre mjekësore dhe se kush i ka aksesuar këto dokumente. Shtetasit mund të ndryshojnë miratimin për shkëmbimin e dokumenteve mjekësore ndërmjet institucioneve të kujdesit shëndetësor;

b) Institucionet e ofrimit të kujdesit shëndetësor publik dhe/ose privat, të licencuara sipas legjislacionit në fuqi për licencimin.

c) Rolet e përdoruesve të Regjistrit Elektronik Shëndetësor Kombëtar në institucionet shëndetësore, janë:

- i) Receptionsist;
- ii) Operator të dhënash;
- iii) Personel mjekësor;
- iv) Personel për statistika dhe raporte;
- v) Administrator.

Çdo përdorues identifikohet në sistem nëpërmjet llogarisë së tij personale (fjalëkalim/*password*) dhe ka role me nivele aksesit e të drejta sipas rregullores së sistemit, të miratuar nga ministri i Shëndetësisë.

Personeli mjekësor, në institucionet shëndetësore, ka të drejtë të shohë dokumentet mjekësore elektronike të prodhuara në një institucion tjetër për një shtetas që ka dhënë miratimin për shkëmbimin e informacionit.

ç) Ministria e Shëndetësisë ka rolet e përdoruesit “Personel për statistika dhe raporte” dhe “Administrator”;

d) Institucionet shëndetësore, që kanë rolin e përdoruesit “Personel për statistika dhe raporte” janë, si më poshtë vijon:

- i) Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
- ii) Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;
- iii) Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore;
- iv) Instituti i Shëndetit Publik;
- v) Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim;
- vi) Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore;
- vii) Qendra Kombëtare Teknike Biomjekësore.

10. Dokumentet mjekësore në format elektronik, pjesë e sistemit të informacionit shëndetësor, të cilat duhet të nënshkruhen elektronikisht dhe të quhen dokumente mjekësore elektronike, përcaktohen me urdhër të ministrit të Shëndetësisë.

11. Dokumentet mjekësore elektronike, që përdoren në sistemet e informacionit shëndetësor nga subjektet publike ose jopublike, si dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor, të cilët duhet të përdorin nënshkrim elektronik të kualifikuar, të përdorin infrastrukturën e çelësit publik, e cila administrohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ose nga ofrues të kualifikuar të shërbimit të besuar, të akredituar nga autoriteti përkatës, sipas legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik.

12. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *software dhe hardware* të Regjistrit Elektronik Shëndetësor Kombëtar të Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe praktikave evropiane e ndër-kombëtare në fushën e shëndetësisë, të bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

13. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi tre muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

RSH. Kuvendi

Përmbledhje legjislacioni për sigurimet shoqërore /

RSH. Kuvendi. – Tiranë : Qendra e Botimeve

Zyrtare, 2017

... f. ; ... cm.

ISBN 978-9928-01-079-7

1.Sigurime shoqërore 2. Pensione pleqërie
3.Legjislacioni

364.3(496.5) (094.4)

347.464(496.5) (094.4)